PLANI EMERGJENCAVE CIVILE
QARKU GJIROKASTËR

2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 441 prot.

Gjirokastër më, 18 . 5 .2021

MIRATOHET

PREFEKTI

ODISE KOTE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
R-PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

P L A N I
EMERGJENCAVE CIVILE
QARKU GJIROKASTËR

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....2
1.1 Synimet e planifikimit.....6
1.2 Përditësimi/Rishikimi.....7
1.3 Përgjegjësia.....8
1.4 Proçesi planifikimit.....9
1.5 Kuadri ligjor/Referencë.....18
2. KONTEKSTI GJEOGRAFIK.....20
2.1 Pozita gjeografike.....20
2.2 Përshkrimi i shkurtër i zonave vunerabël.....22
2.3 Klima.....25
2.3.1 Temperaturat e ajrit.....26
2.3.2 Rreshjet atmosferike.....27
2.3.3 Lagështia relative.....28
2.3.4 Erërat.....29
2.3.5 Bora dhe ngricat.....30
2.4 Burimet ujore.....31
2.5 Infrastruktura për menaxhimin e emergjencave.....35
2.6 Shëndetësia.....37
2.7 Arsimi.....40
2.8 Demografia.....46
2.9 Ekonomia.....49
3. SKENARËT E RISKUT.....52
3.1 Metodologjitë.....52
3.2 Proçesi përgjithshëm për përcaktimin e skenarëve të riskut.....55
3.3 Identifikimi i riskut.....56
3.4 Analiza e riskut.....58
3.5 Vlerësimi i rreziqeve.....61
3.5.A Rreziqet nga tërmetet.....62
3.5.B Rreziqet nga rrëshqitjet e tokës dhe erozioni.....78
3.5.C Rreziqet nga përmbytjet.....88
3.5.D Rreziqet nga çarja e digave të rezervuarëve.....105
3.5.E Rreziqet nga dëbora dhe ngricat.....109
3.5.F Rreziqet nga zjarret në pyje.....116
3.5.F/1 Rreziqet nga zjarret në fusha.....134
3.5.F/2 Rreziqet nga zjarret në objekte.....136
3.5.F/3 rreziqet nga zjarret në stacione karburantesh.....138
3.5.G Rreziqet nga fatkeqësitë në komunikacion.....141
3.5.H Rreziqet nga epidemitë.....144
3.5.I Rreziku nga sulmi terrorist.....149
3.6 Hartat e rrezikut, ekspozimit dhe riskut.....152

4. SISTEMI I ALARMIT.....152
4.1 Sistemi shqiptar i paralajmërimit të herëshëm.....153
4.2 Aktivitete monitoruese në kohë reale.....153
4.2.1 Proçedurat e monitorimit.....156
4.2.2 Shkëmbimi i të dhënave të monitorimit.....159
5. MODELI I NDËRHYRJES.....161
5.1 Përshkrimi i modelit të ndërhyrjes.....162
5.1.1 Organizimi i Qëndrës operacionale të Emergjencave.....173
5.1.2 Zonat e emergjencës.....174
5.1.3 Burimet (mjetet e brendshme dhe të jashtme).....176
5.1.4 Flukset e komunikimit.....177
6. FAZAT OPERACIONALE.....177
7. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI.....190
8. RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT.....192
9. PËRKUFIZIME.....192
10. SHKURTESAT.....196
11. SHTOJCAT.....197
11.1 Shtojca A Lista me pikat e kontaktit, skemat e lajmërimit
11.2 Shtojca B Hartat e rrezikut nga fatkeqësitë, zonat e emergjencës
11.3 Shtojca C Pozita gjeografike e Qarkut Gjirokastër
11.4 Shtojca D Lista e tabelave me të dhënat përkatëse
12. GRUPI I PUNËS.....198

HYRJE

Plani i Emergjencave Civile për Qarkun Gjirokastër (PECQGj), është dokumenti kryesor që realizon bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjitha institucioneve dhe strukturave që veprojnë në qark, për përballimin e emergjencave civile, bazuar në ligje dhe vendime.

Ky plan përcakton parimet e përgjithshme të sistemit të mbrojtjes civile në përputhje me ligjin.

- **PECQGj** koordinon gjithë aktivitetin e strukturave civile në qark në rast emergjencash si në fazën e para alarmit, alarmit dhe kthimin në normalitet.
- Evidenton strukturat operative, strukturat mbështetëse, institucionet etj, që duhet të futen në veprim.
- Fikson procedurat organizative për t'u përballuar me situatën në rast se kërcënohemi nga dukuri natyrore ose njerëzore me dëme në njerëz, infrastrukturë.
- Jep referenca ligjore sipas natyrës së ndërhyrjes.
- Eshtë një burim praktik i përdorshëm për të gjitha fazat e ciklit të emergjencave, duke filluar nga parapërgatitja, përgjigjja dhe duke vazhduar më tej në fazën e rikthimit në gjendjen normale dhe lehtësimin e pasojave. Sipas studimeve të bëra, për vlerësimin e rreziqeve në Shqipëri, Qarku i Gjirokastrës vlerësohet si një rajon i mundshëm për një numër të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore dhe jo natyrore, që mund të vijnë nga veprimtaria njerëzore. Rreziku më i madh në qark nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga tërmete por dhe nga rrëshqitjet e tokës, përmbytjet, veprimet terroriste dhe më pak nga reshjet e dëborës.

Qarku i Gjirokastrës është plotësisht i ekspozuar nga fatkeqësitë që mund të shkaktohen nga veprimtaria njerëzore.

Si rajon me kufij tokësor, përkatësisht me Greqinë, është vend i mundshëm për ardhje të emigrantëve nga vendet e lindjes. Në këto kushte duhen marrë në konsideratë në PQEC.

Shteti Shqiptar si anëtar i NATO dhe kontribues në misionet paqeruajtëse në disa shtete, është në listën për sulme terroriste.

Nisur nga realitetet dhe përgjegjësitë e të gjithë institucioneve dhe strukturave shtetërore dhe vendore, si dhe të shoqërisë civile që veprojnë në qark ka për qëllim:

- Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet gjendja nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.
- Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla, për ruajtjen e rendit të jetës së njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile.
- Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme në qark dhe mbështetja e qeverisë me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.
- Të koordinohen dhe bashkërendohen detyrat e OQV, me institucionet shtetërore, shërbimin e emergjencës, OJF dhe shërbimet vullnetare për përballimin e emergjencave civile.

Procesi i hartimit të këtij Plani për emergjencat civile është udhëhequr nga parime të cilat do të jenë të njëjta edhe në procesin e zbatimit të tij. Plani pasqyron kuadrin ligjor ekzistues, i cili e bën të mundshëm zbatimin e tij.
Plani përfshin të dhëna e informacione nga të gjitha institucionet në një mënyrë të përshtatshme.
Bashkëpunimi dhe bashkërendimi përbëjnë elementet kryesore që përshkojnë planin për të bërë të mundur shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe kapaciteteve ekzistuese.
Plani inkurajon iniciativa dhe nuk shndërrohet në një dokument (akt) strikt për strukturat dhe njerëzit që duhet të veprojnë.
Plani do të mbetet një punë në progres për të qenë i përshtatshëm dhe i zbatueshëm në çdo kohë.
Aktualisht, Parlamenti i Shqipërisë ka kaluar një sërë reformash duke filluar me rinovimin rrënjësor të të gjithë sistemit të Mbrojtjes Civile. Ndër të tjera, Ligji Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" ndryshoi rrënjësisht organizimin e administratës publike në nivel bashkie, prefektit dhe këshillit të qarkut. Me miratimin e kësaj reforme, sistemi i Mbrojtjes Civile është forcuar përmes ngritjes së komisioneve vendore për planifikimin dhe menaxhimin e emergjencave, që parashikohen për të mbështetur qeveritë vendore në menaxhimin e emergjencave dhe koordinimin me nivelet e tjera administrative. Reforma ka riformësuar hartën e Shqipërisë, duke ndryshuar përbërjen dhe duke kërkuar një përpjekje madhore nga periferitë për përditësimin e procedurave operacionale që kërkohen për të fuqizuar kapacitetet bashkiake.
Krahas ndryshimeve të tilla madhore në hartën administrative, së fundmi ka ndryshuar edhe struktura institucionale e sistemit të Mbrojtjes Civile në Shqipëri (Janar 2018). Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është në varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, duke ripërcaktuar tërësisht zinxhirin e saj të ndërlidhjes, komandës dhe kontrollit. Megjithatë, ligji që drejton sistemin e Mbrojtjes Civile është Ligji Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe vendimet vijuese.
Një rëndësi të veçantë për njohjen e kuadrit ligjor të planifikimit të emergjencave në Shqipëri ka Vendimi Nr. 532, datë 01.08.2003 "PËR PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E DEPARTAMENTIT TË PLANIFIKIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE", i cili në Nenin 1.b i referohet PKEC-së, duke qartësuar se *"Hartimi i planeve për plotësimin dhe freskimin e rezervave të emergjencave civile [duhet bërë] në përputhje me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile".*

Referencat e planeve të emergjencave në PKEC-në janë prezantuar pas publikimit të udhëzimeve të UNDP-së dhe duhet të përfshihen në procesin e përditësimit duke siguruar koherencë me kuadrin normativ.

PKEC-ja pohon qartësisht se *"është përgjegjësia e autoriteteve në nivel qarku, njësi administrative dhe bashkie që të hartojnë planet e tyre të emergjencave, të cilat që të gjitha bëhen pjesë e Planit kombëtar për Emergjencat Civile, si dhe procedurat, rolet dhe përgjegjësitë që ai përshkruan[1]"* (PKEC, 2003, fq.9). Prefekti i qarkut i ndërmerr këto përpjekje duke ngritur Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel qarku, i cili artikulon planet dhe përgjigjen e përgjithshëm në nivel Prefekti qarku. Për më tepër, PKEC-ja bën gjithashtu thirrje për një Sistem më efikas të Paralajmërimit të Hershëm (EWS) duke theksuar se:
"Është përgjegjësi e Departamentit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe autoriteteve vendore të shqetësuara për të siguruar se të gjitha palët e interesit janë njohur me

sistemet vendore dhe kombëtare të paralajmërimit të hershëm dhe kontaktet e procedurat e nevojshme. Gjithashtu, është përgjegjësi e strukturave të emergjencave civile në nivel qendror dhe zyrtarëve të caktuar të emergjencave civile në nivel qarku, njësie administrative dhe bashkie, që të sigurojnë se mesazhet e duhura dhe në kohë të paralajmërimit i përcillet publikut dhe institucioneve, duke këshilluar ata për riskun dhe hapat e nevojshme për t'u ndërmarrë."
Në fakt sipas PKEC-së:

Paralajmërimi i hershëm është detyrë e të gjitha strukturave përgjegjëse duke filluar nga ato në nivel vendor deri në ato në nivel qëndror, si dhe strukturave të specializuara[2]. (PKEC, 2003, fq.30).

Lidhja me planet e tjerë

Plani në nivel qarku për emergjencat civile është dokument harmonizues, gjithëpërfshirës, i cili "*mbledh*" së bashku të gjitha institucionet dhe strukturat që veprojnë në qark. Qeverisja vendore dhe institucionet e ndryshme kanë hartuar dhe do të hartojnë planet e tyre të emergjencave civile. **PECQ** nuk zëvendëson planet sektorialë, por bën harmonizimin dhe bashkërendimin e tyre.

1.1 SYNIMET E PLANIFIKIMIT

- Identifikimi i riskut dhe skenarët e tij.
- Përshkrimi i sistemit të mbrojtjes civile në nivel qarku nënkupton organizimin në nivele të tjera territoriale (Bashki, Njësi Administrative).
- Masa mbështetëse dhe ndihmë për popullsinë (kërkim dhe shpëtim, ndihmë e parë, evakuim nga zonat në risk, strehim i përkohshëm, mbështetje psikologjike dhe sociale, ndihmë për grupet më të cenueshme të popullsisë, etj.).
- Identifikimi i zinxhirit të koordinimit në nivele të ndryshme territoriale.
- Përshkrimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm në nivele të ndryshme institucionale.
- Përcaktimi i procedurave dhe metodave të komunikimit lidhur me sistemin e koordinimit territorial.
- Identifikimi dhe aktivizimi i qendrave të koordinimit, pikave të aksesit për punonjësit e shpëtimit, zonave të emergjencave (pritja, ndihma ndaj popullsisë dhe mbledhja e punonjësve të shpëtimit) sipas kritereve të identifikuara më parë.
- Zbatimi i masave për mbrojtjen dhe sigurimin e godinave publike dhe private dhe të trashëgimisë kulturore, si dhe për të siguruar funksionimin e rrjeteve të transportit, shërbimeve themelore dhe komunikimeve.
- Vlerësimi i masave mbrojtëse dhe riaktivizimi i shpejtë i sistemit ekonomik produktiv, i zinxhirit të furnizimit të shërbimeve personale në vijimin e masave administrative.
- Ndërmarrja e veprimtarive specifike të komunikimit dhe informimit në situata të zakonshme dhe emergjence, synonte publikun lidhur me ekspozimin ndaj rreziqeve, planin e emergjencave dhe sjelljen vetëmbrojtëse.

1.2 PËRDITËSIMI / RISHIKIMI

Ky Plan i Emergjencave Civile për Qarkun Gjirokastër, është rishikim i planeve të Emergjencave Civile, të bëra në vazhdimësi nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër ndërkaq Plani do të ketë përditësim të bazës së të dhënave dhe aspekteve që kanë ndryshuar në kohë.

Plani i Përballimit të Emergjencave Civile të Qarkut Gjirokastër, është një instrument dinamik që përditësohet dhe rishikohet për të bërë të mundur pasqyrimin në të, qoftë të eksperiencave të përfituara nga situata të ndodhura por dhe për të bërë të mundur futjen e informacioneve të reja.

Rishikimi i Plani i e E.C. u imponua nga nevoja e një plani të thjesht, funksional dhe me më shumë akses për këdo që mund ta përdorë këtë plan. Plani nuk do të ketë ndryshime esenciale në krahasim me planet e tjerë në aspektin e objektivit të cilin kërkon të realizojë. Ai është i mbështetur mbi të njëjtën bazë ligjore dhe është në linjë me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile si dhe dokumenteve të tjera. Strukturat monitoruese dhe koordinuese janë të njëjta.

Plani do të ketë disa ndryshime nga planet e prezantuar më parë në disa kënd vështrimesh:

- Në këtë plan do të materializohen një sërë direktivash dhe udhëzimesh të PNUD, të Projektit PRONËS etj. dhe konventa të pranuara nga Qeveria Shqiptare.
- Ndryshimi do të jetë në radhë të parë në lehtësimin e përdorimit jo vetëm të grupit që kanë përgjegjësinë e përpilimit të planit por dhe të tjerëve që në një farë mënyre janë pjesë e zbatimit të këtij plani.
- Ky plan do të përdoret më lehtë nga të gjithë anëtarët e shtabit dhe strukturave që mbajnë përgjegjësi për përballimin emergjencave civile. Plani do të jetë dhe një manual përdorimi. Baza e të dhënave do t'i bashkëngjitet një shtojce më vete, gjë që do të krijojë lehtësira në përdorimin dhe azhurnimin e tij.
- Sipas këtij Plani rreziqet, rrisqet, lajmërimi i hershëm etj. do të jenë të bazuara në vlerësime sasiore (qualititativë) ose në shifra që kanë zënë vend nga studimet dhe eksperiencat në vite.

Procedurat e përditësimit të planit :

- Plani duhet të përditësohet rregullisht.
- Plani duhet të përditësohet sa herë që ndodh një ndryshim madhor në qark, si në aspektin politik edhe në atë territorial:
  - miratimi i një ligji të ri.
  - sa herë që ndryshon një anëtar i komisionit apo shtohet një funksion mbështetës.
  - pas ose para miratimit të master-planit urban.
  - nëse risku ndryshon rrënjësisht në territorin e qarkut.
- Plani duhet përditësuar nëse ndryshon diçka në nivelin teknik apo shkencor.
  - Publikohet një buletin i ri i besueshëm dhe i koduar meteorologjik/ sizmik/për zjarret në pyje.
  - Zbatohen procedurat e reja për monitorimin e rreziqeve natyrore (stacione të reja atmosferike, radarë të rinj, të dhëna të reja).
  - Hartohen procedurat e reja për komunikimin e riskut.

Afati kohor i përditësimit : Çdo muaj dhe sa herë që të ketë ndryshime.
Personi Përgjegjës : Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe Krizave.

- **Procedurat e rishikimit:**
  - Plani rishikohet sa herë që ndodhin ndryshime madhore.
  - Personi/institucioni përgjegjës siguron korrespondencat me kuadrin ligjor dhe institucional në nivel kombëtar dhe prefekture.
  - Personi/institucioni përgjegjës i komunikon DPEC-së ndryshimet përkatëse që i lejojnë institucioneve në nivel kombëtar të kenë një vështrim të përgjithshëm të situatës aktuale të planeve.

Afati kohor : **Sa herë që të ketë ndryshime madhore.**
Personi Përgjegjës : Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku.
Përgjegjësi Sektorit të Emergjencave Civile dhe Krizave

1.3 PËRGJEGJËSIA

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes ka funksionet e saj koordinuese dhe përgjegjësitë përkatëse lidhur me situatat e emergjencave civile në nivel kombëtar, qarku, njësie administrative dhe bashkie. Procedurat e koordinimit kombëtar ndiqen 24 orë nga Qendra Kombëtare Operacionale për Mbrojtjen Civile (QKOMC), e cila ka lidhje të drejtpërdrejta me të gjitha forcat operacionale dhe palët e tjera të interesit, duke përfshirë sektorët e Mbrojtjes Civile të ngritur në secilin institucion të Prefektit të qarku dhe bashki.
Prefekti i Qarkut Gjirokastër luan një rol të rëndësishëm në Planifikimin dhe Menaxhimin e Emergjencave Civile. Duke qenë niveli administrativ i ndërmjetëm midis nivelit kombëtar dhe vendor, ajo ofronë mbështetje themelore për të dyja nivelet në koordinimin e përpjekjeve gjatë emergjencave
Përgjegjësia e menaxhimit të Emergjencave Civile për qarkun mbështetet në ligje dhe vendime, ku ndahen përgjegjësit dhe detyrimet institucionale si më poshtë:

Prefekti i qarkut

Prefekti i qarkut do të:
- Mbikëqyrë dhe menaxhojë, në nivel qarku, të gjithë përfaqësuesit e strukturave qendrore, që janë përfshirë në planin e emergjencave civile të qarkut.
- Ngrejë Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel qarku për Planifikimin dhe Përballimin e Emergjencave Civile dhe Krizave.
- Përgjigjet ndaj situatave të emergjencave civile përtej kapaciteteve dhe mjeteve të qarkut, duke kërkuar shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në një pjesë apo në të gjithë territorin e qarkut me Vendim të Këshillit të Ministrave.

- Përgjigjet ndaj situatave të emergjencave civile në nivel kombëtar, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme, duke raportuar apo duke koordinuar veprimet e tij/saj me Ministrin e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Departamentin e Emergjencave Civile, Komitetin Ndërministror të Emergjencave Civile dhe Drejtorinë e Operacioneve, dhe në varësi të situatës i koordinon ato edhe me Kryeministrin.

Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku.

Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku do të:

• Koordinojë veprimet institucionale të nevojshme në të gjitha fazat e përgjigjes ndaj emergjencave civile.

• Koordinojë veprimet e strukturave qendrore në nivel qarku me veprimet dhe veprimtaritë e strukturave të qeverisjes vendore, Kryqin e Kuq Shqiptar, vullnetarët, dhe donatorë të ndryshëm.

• Diskutojë dhe do të marrë vendime paraprake për nevojat materiale dhe financiare, që kërkohen për të parandaluar dhe lehtësuar situatat e emergjencave civile, për të vlerësuar dëmin e mundshëm të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore apo ato të shkaktuara nga njeriu, për të vlerësuar kostot e rindërtimit dhe rehabilitimit të rajonit të prekur nga fatkeqësitë dhe për të kërkuar mbështetjen e strukturave të tjera qendrore në nivel qarku.

• Koordinojë veprimet e Komisioneve të Mbrojtjes Civile të bashkive, njësive administrative dhe ekipet e ndihmës dhe vullnetarët që veprojnë në rajon.

Në nivel qarku ose Drejtori i Operacioneve të Qarkut

Në situatat e emergjencave civile, burimet materiale dhe njerëzore që sigurohen në Planin e Qarkut për Emergjencat Civile kalojnë nën autoritetin e Drejtorit të Operacioneve të Qarkut. Ai/ajo bëhet përgjegjës sipas rastit për menaxhimin e situatave të emergjencave civile. **Drejtori i Operacioneve të Qarkut do të:**

• Organizojë, mbikëqyrë dhe menaxhojë strukturat qendrore në nivel vendor, si dhe ato struktura të disponueshme për të ofruar ndihmë lehtësuese në emër të strukturave qendrore apo ndërkombëtare.

• Ruajë marrëdhënie të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme, do të informojë dhe do të kërkojë ndihmë nga Komiteti Ndërministror për Emergjencat Civile dhe Drejtori i Operacioneve në qarqet fqinjë.

Në nivel nënprefekti

Nënprefektët, që përfaqësojnë Prefektin në nivel bashkie: në bashkitë Tepelenë, Memaliaj, Përmet dhe Këlcyrë.

Nënprefektët që përfaqësojnë Prefektin në nivel bashkie**:** në bashkitë Tepelenë, Memaliaj, Përmet e Këlcyrë **kanë përgjegjësi dhe detyra:**

• Informojnë Prefektin për ndodhinë e një situate emergjence civile aktuale apo të mundshme në bashkitë ku ata ushtrojnë funksionet e tyre.

• Në bashkëpunim me Pëgjegjësat e Stacioneve të Zjarrfikësve të bashkive respektive, ata do të organizojnë dhe koordinojnë veprimet e forcave operacionale për emergjencat civile, si dhe do të kërkojnë ndihmë për ndërhyrje nga strukturat e tjera në territorin e bashkive.
• Raportojnë te Prefekti dhe te Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku për situatën e emergjencave civile dhe përgjigjen ndaj tyre, si dhe do të trajtojnë kërkesat e nevojshme për të garantuar ofrimin e ndihmëse lehtësuese.

Këshilli i Qarkut

Këshilli i Qarkut është një nivel shtesë vartës i qeverisë vendore, i cili përfshihet edhe në menaxhimin e emergjencave civile, bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimeve të tij me Prefektin, Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel Qarku, si dhe me bashkitë dhe njësitë administarative. Në rast të një situate të emergjencës civile, **Këshilli i Qarkut do të:**
• Përfshijë administratën dhe strukturat e tij aktive dhe ndihmëse në procesin e vlerësimit dhe llogaritjes së dëmit të shkaktuar dhe kërkon masat e duhura mbështetëse për banorët dhe zonat e dëmtuara.
• Në bashkëpunim me organe të ndryshme të qeverisë vendore, përcakton terrenet për ngritjen e strehave të përkohshme, magazinave të përkohshme dhe pikave të shpërndarjes, zonat për varret masive dhe nevojat e tjera të mundshme.

PËRGJEGJËSITË NË NIVEL QARKU



STRUKTURAT E GATISHMËRISË TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE



Këshilli i Qarkut

Këshilli i Qarkut është një nivel shtesë vartës i qeverisë vendore, i cili përfshihet edhe në menaxhimin e emergjencave civile, bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimeve të tij me Prefektin, Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel Qarku për Planifikimin dhe Përballimin e Emergjencave Civile dhe Krizave, si dhe me bashkitë dhe njësitë administrative. Në rast të një situate të emergjencës civile, **Këshilli i Qarkut do të:**

• Angazhojë administratën dhe strukturat e tij aktive dhe ndihmëse në procesin e vlerësimi dhe llogaritjes së dëmit të shkaktuar dhe kërkon masat e duhura mbështetëse për banorët dhe zonat e dëmtuara, si dhe në përballimin e situatës emergjente.

• Bashkëpunojë me organe të ndryshme të qeverisë vendore, përcakton terrenet për ngritjen e strehave të përkohshme, magazinave të përkohshme dhe pikave të shpërndarjes, zonat për varret masive dhe nevojat e tjera të mundshme.

Përgjegjësitë në nivel bashkie

Bashkitë dhe njësitë administrative kanë përgjegjësi për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre.

Menaxhimi i emergjencave civile në bashki, njësi administrative bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që ato përgatitin dhe freskojnë periodikisht. Çdo bashki dhe njësi administrative, krijojnë dhe mbajnë një sistem të:

• Njoftimit të hershëm dhe informimit të strukturave kyç.

• Alarmit dhe evakuimit të popullsisë.

• Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile.

• Ndërmarrin dhe administrojnë aktivitetet e rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjenca.

Komisioni Vendor i Mbrojtjes Civile (KVMC) është përgjegjës për:

- Hartimin e masave për parandalimin, lehtësimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave civile.
- Sigurimin e zonave të emergjencës së përkohshme.
- Vlerësimin e dëmeve dhe nevojave.
- Mbajtjen e kushteve higjienike duke siguruar furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe kujdesen për viktimat.
- Bashkërendimin dhe mbështetjen për grupet e kërkim-shpëtimit dhe të vullnetarëve.
- Çështje të tjera për qëllimin përgjigjen efektive ndaj situatës së emergjencës civile.

PËRGJEGJËSITË NË NIVEL BASHKIE



Strukturat e MC në qark

Strukturat operacionale të mbrojtjes civile, që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera në qark , janë:

a**) Forcat e Armatosura;** (DMR , Grehot Gjirokastër)
b) Policia e Shtetit; (DVP Gjirokastër , komisariatet e policisë Gjirokastër , Tepelenë , Përmet) , Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit Gjirokastër)
c) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit; (Drejtoria e MZSH Gjirokastër dhe Stacionet MZSH të bashkive të qarkut)
ç) Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor; (Drejtoria e Spitalit rajonal të qarkut , spitalet Tepelenë e Përmet , NJVKSH , Shërbimi i ambulancës)
d) Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile. (Njësitë vullnetare në çdo fshat të njësive administrative të bashkive të qarkut)

Detyrat e strukturave operacionale të mbrojtjes civile

1. Strukturat operacionale të mbrojtjes civile, me qëllim menaxhimin e fatkeqësive, kryejnë veprimtari veçmas ose në bashkëpunim me njëra-tjetrën, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, legjislacionin përkatës dhe Planin Kombëtar për Emergjencat Civile.
2. Strukturat operacionale të mbrojtjes civile kryejnë veprimtari që lidhen me planifikimin, kërkim-shpëtimin, dhënien e ndihmës dhe të asistencës në raste fatkeqësish, sigurinë dhe mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, rimëkëmbjen e zonave të dëmtuara, si dhe çdo veprimtari tjetër për përballimin e situatës së krijuar.
3. Gjatë pjesëmarrjes në operacion, efektivat e strukturave operacionale të mbrojtjes civile drejtohen nga eprorët direkt, sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacioneve kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe nga AKMC-ja në rastet e tjera.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

1. Në kuadër të sistemit të mbrojtjes civile, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kryejnë këto detyra:
a) angazhohen në operacione të ciklit të menaxhimit të fatkeqësive, nëse kapacitetet e tjera në dispozicion janë të pamjaftueshme për këtë qëllim, duke mbështetur institucionet, autoritetet qendrore e vendore dhe komunitetin;
b) zhvillojnë kapacitete ndërvepruese, të nevojshme për të bashkëpunuar me strukturat kolektive të sigurisë euroatlantike për përballimin e fatkeqësive.
2. Struktura të posaçme të kërkim-shpëtimit të Forcave të Armatosura angazhohen në kryerjen e operacioneve për përballimin e fatkeqësive.
3. Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, kapacitetet e Forcave të Armatosura angazhohen në zbatim të detyrave të Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile.4. Kur njësitë e Forcave të Armatosura marrin pjesë në operacione, ato drejtohen nga komandantët e tyre,sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit.

Policia e Shtetit

1.Policia e Shtetit organizohet dhe kryen detyrat e saj në operacionet e shpëtimit dhe të lehtësimit,sipas planeve të hartuara më parë, si dhe planeve të përbashkëta me institucionet e tjera për çështje të mbrojtjes civile.
2. Detyrat e saj përfshijnë mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, ruajtjen e rendit publik, procesin e identifikimit dhe të informimit rreth të dëmtuarve dhe viktimave, largimin e tyre nga zona e emergjencës, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit.
3. Kur policia merr pjesë në operacionet e shpëtimit dhe në raste të tjera të fatkeqësive, forcat e saj komandohen nga eprorët e tyre.

Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit

1. Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit është pjesë përbërëse e forcave operacionale në gatishmëri të përhershme dhe vepron për shuarjen e zjarreve, për kërkimin dhe shpëtimin e njerëzve në zonat e emergjencës civile dhe për lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.
2. Në rastet kur shërbimi zjarrfikës merr pjesë në operacionet e shpëtimit dhe në raste të tjera të fatkeqësive, personeli i shërbimit zjarrfikës komandohet nga drejtuesit e tyre përkatës.

Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor

1. Veprimtaria e Shërbimit të Urgjencës Mjekësore në fushën e mbrojtjes civile rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin e urgjencës mjekësore dhe për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.
2. Shërbimi i Urgjencës Mjekësore është pjesë përbërëse e forcave operacionale dhe vepron për dhënien e ndihmës së parë në zonën e emergjencës civile dhe për transportimin e të dëmtuarve për në qendrat spitalore.

Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile

1. Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë kontribuon vullnetarisht në menaxhimin e fatkeqësive dhe në zvogëlimin e pasojave të tyre.
2. Vullnetarët mund të ofrohen individualisht apo në grupe të organizuara,si struktura jofitimprurëse, por në të gjitha rastet, në varësi të situatave të krijuara dhe të nevojave të sistemit të mbrojtjes civile, detyrat e tyre caktohen nga institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile.
3. Trajtimi i vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive miratohenme vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

1.4 PROCESI I PLANIFIKIMIT

Planifikimi për Përballimin e Emergjencave Civile dhe Krizave bazohet në plane e dokumente të rëndësishëm të përpiluara në mbështetje të Ligjit Nr. 45/2019, *"Për mbrojtjen civile*", përditësuar me Ligjin nr. 10137 datë 11.5.2009, Ligjit Nr. 107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", të dispozitave ligjore që kanë lidhje me gjithë legjislacionin drejtpërdrejtë ose të tërthortë me emergjencat civile si dhe për zbatimin e kërkesave të Planit Kombëtar të Emergjencave Civile.
Planifikimi për përballimin e situatave emergjente është i lidhur ngushtë me buxhetin e parashikuar si në nivel qendror ashtu dhe në nivel lokal.
Planifikimi për përballimin e emergjencave civile është i lidhur me strategjinë kombëtare për përballimin e ngjarjeve ndëshkuese, si dhe politikave të qeverisë.
Institucioni i Prefektit nuk ka buxhet për përballimin e emergjencave civile përveç aksesit që qeveria i ka dhënë për koordinime në kohë të shkurtër nëpërmjet QKOMC dhe Zyrës Operative të Situatës. Këto koordinime demonstrohen në kohën e shkurtër të plotësimit të kërkesave të bërë nga Institucioni i Prefektit, për mjete tokësore (*të Forcave të Armatosura*) ose ndërhyrjen nga ajri për shuarjen e zjarreve ose operacioneve të shpëtimit.
Bazuar në udhëzime të AKMC, bashkitë janë të detyruara të planifikojnë mbi 3% të buxhetit të tyre për përballimin e emergjencave civile. Bashkitë duhet të kontribuojnë në dëmshpërblimin në djegien e banesave të dëmeve në infrastrukturë etj. Aktualisht dëmet e krijuara nga reshjet si dhe dëmet nga djegiet e banesave e kalojnë disa herë vlerën e planifikuar në buxhetin e bashkive.
Shqipëria ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me partner evropian dhe fqinj për kontribute të përbashkëta për përballimin e emergjencave civile.
Procesi i planifikimit, mbështetet mbi një sërë dokumentesh bazë dhe raportesh të UNPD, si:

"*Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore në Shqipëri*", Tetor 2003.
"*Manuali i përballimit të emergjencave civile*", Dhjetor 2003.
"*Udhëzues për trajnerët e menaxhimit të fatkeqësive*", Dhjetor 2003.
"Projektit PRONEËS", financuar nga PNUD[i]
"Praktika të mira të nxjerra nga përballimi i emergjencave civile 2018-2019"

Plani i Përballimit të E.C. në Qark ***nuk është një dokument strikt dhe i pa ndryshueshëm***. Ai është gjithmonë **objekt i ndryshimeve** në varësi të defekteve që mund të konstatohen si dhe ndryshimeve strukturore të vetë emergjencave civile.
Në këtë plan janë materializuar e përfshirë eksperienca të një sërë seminaresh e takimesh të nivele kombëtare dhe lokale.
Plani përfshin të dhëna e informacione nga të gjitha institucionet në një mënyrë të përshtatshme.

- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi përbëjnë elementet kryesore që përshkojnë planin për të bërë të mundur shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe kapaciteteve ekzistuese.
- Plani inkurajon iniciativa dhe nuk shndërrohet në një dokument (*akt*) strikt për strukturat dhe njerëzit që duhet të veprojnë.
- Plani do të mbetet një punë në progres për të qenë i përshtatshëm dhe i zbatueshëm në çdo kohë.

1.5 KUADRI LIGJOR REFERENCË

Plani i Emergjencave Civile të Qarkut mbështetet në një sërë ligjesh, vendimesh, udhëzimesh. Në përpilimin e Planit gjejnë reflektim eksperiencat e marra në vite, nga trajnimet e ndryshme dhe së fundi Projekti PRO-NEËS. Përpilimi i planit të E.C. bazohet kryesisht në ligjet, vendimet dhe udhëzimet e më poshtme:

Ligji bazë mbi të cilin mbështet përpilimi i Planit të E.C. është Ligji nr. 45/2019, "***Për Mbrojtjen Civile***". Ligji "***Për Mbrojtjen Civile***" është ligji bazë që përcakton detyrimet dhe përgjegjësitë. Planëzimi dhe përballimi i emergjencave civile janë detyra të shtetit shqiptar dhe strukturave vendore dhe synojnë: a) parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile; b) sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin kundër efekteve të një emergjence civile; c) garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave. Ligji ndan përgjegjësitë ligjore të strukturave.
Vendimi KM nr. 664, datë 18.12.2002, "***Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile***"**.** Vendimi përcakton kriteret për procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile në një pjesë territori. Ky vendim e vë prefektin në krye të detyrimit ligjorë për të konsultuar dhe vendosur për shpalljen e gjendjes së jashtë zakonshme.
Vendimi KM nr. 655, datë 18.12.2002, "***Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile"*** (Nenet 1, 2, 6 të këtij vendimi janë shfuqizuar me VKM Nr.965, Dt.Aktit:02.12.2015) Vendimi përcakton përfaqësimin institucional dhe lokal të anëtarëve të komisionit të planifikimit të përballimit të emergjencave civile, në nivel qendror dhe në nivel prefekture. Vendimi cakton dhe afatet e mbledhjeve.
Vendimi KM nr. 533, datë 1.8.2003, "***Për pjesëmarrjen e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile".*** Vendimi, detajon marrëdhëniet me qeverisjen vendore dhe struktura e tjerave për detyrimin e njësive dhe strukturave të tjera për pjesëmarrje në përballimin e emergjencave civile.
Vendimi KM nr. 835, datë 03.12.2004, "***Për miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile***". Ky vendim i jep fuqi ligjore, "*Planit Kombëtar të Emergjencave Civile*".
Ligji nr. 115/2014 datë 31.07.2014 "***Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".***

Është ligji që përcakton ndarjen administrative në RSH, në 61 bashki dhe njësit administrative. Ligji përcakton detyrimin e parë për kontrollin për territorin në këndvështrimin e emergjencave, arsimit, shëndetësisë etj.
Vendimi KM nr. 965, datë 02.12.2015, "***Për bashkërendimin e ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave***".
Vendimi KM nr. 148, datë 24.02.2016, "***Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të informacionit dhe statistikës të Këshillit të Ministrave".***
ËMO – Sistemet me shumë rreziqe të para alarmit të hershëm (MHEËS), Praktikat e Mira dhe parimet e lidhura me udhëzimet /ËMO - Multi - Hazard Early Ëarning System (MHEËS), Good Practices and related guidiance principles.
IASC Cluster Aproach Evalutation, 2ND phase April 2010.
Udhëzues për Vlerësimin dhe Hartimin e Riskut për Menaxhimin e Fatkeqësive të Komisionit Europain (2010) 1626 final /Eu Risk management Capacities Assessment Guiderlines (2015/C 261/03).
UNISDR Vlerësimi i Aftësive ripërtëritëse nga fatkeqësitë/ UNISDR Disaster Resilence Scorecard.
Udhëzues dhe direktiva të BE-së.
Udhëzimet e Vlerësimit dhe Hartimit të Riskut për menaxhimin në Fatkeqësive SEC (2010) 1626 final.
Direktiva e Përmbytjes 2007/60 e Komisionit Evropian Floods direktivës 2007/60 EC.
Udhëzuesi i Planifikimit të Emergjencave Civile, sipas projektit PRONEËS.

2. KONTEKSTI GJEOGRAFIK

2.1 Paraqitja e përgjithshme

Qarku i Gjirokastrës ndodhet në Jug të Vendit dhe ka një sipërfaqje prej 2.884 km² ose 332.677 ha. Qarku i Gjirokastrës kufizohet në veri me Qarkun e Beratit, në veriperëndim me Qarkun e Fierit, në jug deri në perëndim me Qarkun e Vlorës, në juglindje me Republikën e Greqisë - Rajoni Epirit të Veriut dhe në lindje me Qarkun e Korçës.

Shtrihet në gjerësinë gjeografike $39^0$47'06"Jugore (Sotirë, bashkia Dropull) dhe $40^0$31'22" Veriore (Allkomemaj, bashkia Memaliaj) dhe me gjatësi gjeografike $19^0$44'38" Perëndimore (1 km në jug të m. Kudhësit, bashkia Tepelenë) dhe $20^0$36'42" Lindore (Tri Urat, bashkia Përmet).



Është pozicionuar në qendër të Shqipërisë Jugore dhe përshkohet nga dy prej luginave më të rëndësishme në shqipërinë Jugore, Lugina e Vjosës së Sipërme dhe Lugina e lumit Drino. Qarku i Gjirokastrës shtrihet pjesërisht në zonën e ulët dhe në atë kodrinore malore, duke filluar me lartësi nga niveli i detit prej 160 m në fushën e Subashit (bashkia Gjirokastër) e deri në lartësinë 2484 m Maja e Dritës në malin e Nemërçkës (bashkia Këlcyrë). Relievi i tij përbëhet prej 45.104 ha të sipërfaqes me tokë të punueshme, 95.533 ha e zënë kullotat, 84.662 ha e zënë pyjet me shkurre dhe drurë të ndryshëm, ndërsa 49.053 ha e zë sipërfaqe me lumenjtë dhe male të thatë. Klima në Qarkun e Gjirokastrës është mesdhetare me temperaraturë mesatare vjetore shumë vjeçare 15.3 gradë C, me dimër të lagësht dhe verë të thatë e të nxehtë. Sasia mesatare e rreshjeve në vit është 1426 mm, muaji me rreshje janë Nëntor, me 233 mm, ndërsa muaji më i thatë Korriku me 36 mm. Sasia e rreshjeve më të mëdha prej 2250 m janë shënuar gjatë vitit 1978, ndërsa në vitin 1983 në 5 orë ranë 180 mm rreshje shiu.

Pozita gjeografike kushtëzon tiparet më të shprehura mesdhetare të peisazhit, sidomos të klimës, të hidrografisë, të tokave e të bimësisë së tij. Në të njëjtën kohë, kjo pozitë gjeografike është e përshtatshme për zhvillimin ekonomik, e lidhur me krijimin e kushteve për kultivimin e bimëve dhe zhvillimin e turizmit. Qarku përshkohet nga rrugë të rëndësishme automobilistike, që e lidhin me rajonet e tjera të vendit dhe me Greqinë, nëpërmjet dy pikave të kalimit kufitar: Kakavije, Sopikut dhe Tri Urat.

Përbërja administrative e qarkut

Territori i Qarkut Gjirokastër është rregulluar sipas ligjit 8652, datë 31/07/2000, "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*". Sipas ndarjes administrative të vitit 2015 përfshin tre rrethe: Gjirokastër,Tepelenë dhe Përmet. Qendra e Qarkut është qyteti i Gjirokastrës.
Ka 7 Bashki, 6 Qytete, 32 Njësi Administrative me 271 fshatra.

QARKU	BASHKITË	NJËSITË ADMINISTRATIVE
Gjirokastër	Gjirokastër	Gjirokastër , Lazarat , Antigone , Lunxheri , Odrie , Cepo , Picar
	Dropull	Dropull i Poshtëm , Dropull i Sipërm , Pogon
	Libohovë	Libohovë , Qëndër Libohovë , Zagori
	Tepelenë	Tepelenë , Qëndër Tepelenë , Kurvelesh , Lopës
	Memaliaj	Memaliaj , Memaliaj Fshat , Qesarat , Krahës , Luftinjë , Buz
	Përmet	Përmet , Qëndër Piskovë , Petran , Çarshovë , Frashër
	Këlcyrë	Këlcyrë , Dëshnicë , Sukë , Ballaban

Shënim : Pozita gjeografike , kufijtë administrativë , shtrirja gjeografike , hartat e bashkive dhe njësive administrative shiko **shtojcën C** .

2.2 Përshkrimi i shkurtër i zonave (territoreve) vunerabël

Tiparet natyrore

Qarku Gjirokastër është kryesisht malor, ka natyrë, sidomos ndërtim gjeologjike, reliev më të thjeshtë se rajonet e tjera malore të vendit. Ndërtimi gjeologjik përbëhet nga gëlqerorë dhe terrigjene. Me formacionet sedimentare të ndërtimit gjeologjik lidhen pasuritë nëntokësore, si: qymyrguri, fosforitet, gurët dekorative, materialet e ndërtimit etj.

Relievi

Shtrihet nga niveli i detit deri në 2465 m (Nemërçkë). Mbizotërojnë lartësitë deri në 800 m mbi nivelin e detit. Në përbërje të relievit dallohen: vargje malore, malësi, lugina. Vargjet malore janë formuar në strukturat alkaline, kurse luginat, në strukturat sinklinale. Ato ndërthuren në mënyrë të rregullt. Malësitë janë të pakëta dhe copëtohen nga shumë lumenj e përrenj që rrjedhin

në drejtime të ndryshme. Njësitë e relievit lidhen ndërmjet tyre me gryka të ngushta dhe qafa, nëpër të cilat kalojnë rrugë automobilistike.

Kurrizet malore dhe malësitë

Malësia midis Tomorrit dhe Postenanit shtrihet në verilindje të Qarkut. Është zonë kalimtare midis relievit të rregullt të rajonit jugor, i cili vazhdon me malin e Kulmakut, Miçanit dhe malësinë e Dangëllisë me reliev shumë të copëtuar nga gërryerja. Mbyllet me malin e Pestenanit dhe të Kutulishtës. Dallohet kanioni Langaricës (Degë e Vjosës) monument natyre.

Vargjet malore midis Vjosës së Sipërme e Drinosit përbëhen nga dy vargje: Trebeshinë - Dhëmbel - Nemërçkë dhe Shëndëlli - Lunxhëri - Bureto. Lartësia më e madhe shënohet në **majën e Papingut të malit të Nemërçkës 2465 m**. Me përbërjen gëlqerore lidhen format e shumta karstike dhe relievi i ashpër. Në malin e Lunxhërisë ndodhet **Qafa e famshme e Çajupit (monument natyre)**, ku kalon rruga që lidh luginën e Drinos me të Zagorisë. Midis dy vargjeve malore ndodhet lugina e Zagories dhe e Pogonit. Këto lugina kanë reliev të copëtuar.

Malësia e Kurveleshit dhe vargu Mali Gjerë - Strugarë shtrihen midis luginës së Drinosit dhe asaj të Shushicës. Malësia e Kurveleshit rrethohet nga shpate të thepisura, kurse pjesa e sipërme përbën një pllajë të valëzuar me lartësi 800 – 1000 m dhe me fusha karstike, ku janë vendosur qendrat e banuara. Është e përmendur për puset karstike dhe kanionet e thella. Në juglindje të saj shtrihet **lugina e ngushtë e tërthore e Kardhiqit** dhe në vazhdim **Mali Gjerë (1583 m**) me pjerrësi të vogël të shpatit lindor dhe shumë të madhe të shpatit perëndimor. **Qafa e Muzinës** e ndan këtë mal nga **mali Strugarës** që vazhdon edhe jashtë kufirit shtetëror. Në këtë Qafë kalon rruga automobilistike që lidh Gjirokastrën me Sarandën.

Luginat

Lugina e Vjosës është më e madhja në gjithë qarkun. Pjesa e sipërme (deri në Këlcyrë) me lartësi 200 - 400 m mbi nivelin e detit ka reliev të butë me disa fusha si ajo e **Çarshovës, Kaludhit, Petranit, Kosinës, Këlcyrës**, të formuara në nivelet taracore të lumit të Vjosës. Në këto fusha janë të vendosura tokat e punuara dhe qendrat e banuara kryesore, midis të cilave dhe qytetet Përmet dhe Këlcyrë dhe në vazhdim edhe Tepelenë e Memaliaj.
Në vazhdim, lugina ngushtohet e formon **Grykën e famshme t**ë **Këlcyrës** (13 km e gjatë, rreth 1000 m e thellë). Pas kësaj gryke, lugina dhe shtrati zgjerohen e ngushtohen disa herë deri në grykën e Dorëz - Kalivaç.

LUGINA E VJOSËS

Përmet , Këlcyrë

Tepelenë , Memaliaj

Lugina e Drinosit (degë e Vjosës).

Shtrihet në anën perëndimore të vargut Lunxhëri - Bureto dhe në lindje të shpateve të Malit të Gjerë, në një lartësi rreth 200 m deri në 270 m mbi nivelin e detit. Në sektorin e sipërm lugina është mjaft e gjerë, e rrafshët dhe me toka pjellore. Kjo dukuri lidhet me mbizotërimin e lëvizjeve ulëse. Lugina është e pasur me burime të mëdha ujore të përqëndruara në krahun e saj lindor.

Ajo ka një gjatësi 42 km prej fshatit Kakavijë deri në Hundëkuq dhe një gjerësi deri në 7 km. Vetëm në veri të Hundëkuqit dhe deri afër Tepelenës ajo ngushtohet në formën e një gryke.

Lugina e Drinos është e përbërë nga toka livadhore - aluviale dhe shfrytëzohet gjerësisht për bujqësi. Aty rriten të gjitha llojet e kulturave, që nga drithërat e bukës deri tek pemët e drunjta. Lugina ka dhe një dendësi të madhe popullate, të cilat janë të vendosura në faqet e maleve ku dhe nuk përbën rrezik për përmbytje nga ana e Drinos.
Në luginë shtrihen fushat **e Gjirokastrës, Dropullit të Sipërm, Dropullit të Poshtëm, Suhës, Valares, Mashkullorës, Kardhiqit etj.**

LUGINA E DRINOS

2.3 Klima
Klima është tipike mesdhetare, me dimër më të butë e më të lagësht dhe verë më të thatë. Temperaturat mesatare vjetore lëkunden nga 12^0 C në 17.6^0 C, e janarit nga 3 – 4 ^{0} C në lartësitë e maleve deri në 10^0 C në lugina, kurse e korrikut, nga 23^0 C deri 25^0 C. Më shumë rreshje bien në malësinë e Kurveleshit (mbi 2500 mm në vit). Në drejtim të lartësisë së maleve rriten rastet me dëborë e cila formon shtresë me zgjatje mjaft të mëdha.

Te dhenat vjetore per klimen Gjirokastër													
Muajt	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	VJET
Mesatare e larte °C (°F)	9 (48)	11 (52)	13 (55)	18 (64)	23 (73)	28 (82)	32 (90)	34 (93)	27 (81)	23 (73)	15 (59)	11 (52)	20 (69)
Mesatare ditore °C (°F)	5 (41)	6 (43)	7 (45)	12 (54)	16 (61)	20 (68)	23 (73)	24 (75)	19 (66)	14 (57)	10 (50)	6 (43)	14 (56)
Mesatare e ulet °C (°F)	1 (34)	1 (34)	2 (36)	6 (43)	10 (50)	13 (55)	15 (59)	15 (59)	12 (54)	8 (46)	5 (41)	2 (36)	8 (46)
Rreshjet mesatare mm (inches)	290 (11.4)	230 (9.1)	190 (7.5)	90 (3.5)	50 (2.0)	40 (1.6)	10 (0.4)	10 (0.4)	60 (2.4)	180 (7.1)	400 (15.7)	320 (12.6)	1,870 (73.7)
Rreshjet mesatare ditore (≥ 1 mm)	11	10	8	7	5	2	1	1	3	7	14	12	81
Lageshtia mesatare relative (%)	71	69	68	69	70	62	57	57	64	67	75	73	67



2.3.1 Temperaturat e ajrit – një ndër elementët kryesorë në përcaktimin e veçorive klimatike të qarkut tonë në regjimin e saj mesatar me ecurinë e saj vjetore e ditore si dhe me vlerat ekstreme :

Temperaturë mesatare e ajrit

Tabela 1

Vendmatja	MUAJT E VITIT												Mesatarja
	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	
Gjirokastër	5.4	6.9	9.3	12.8	17.2	21.2	23.5	23.6	20.1	15	10.3	6.7	14.3

Temperaturat maksimale absolute të ajrit

Tabela 2

Vendmatja	MUAJT E VITIT												Vjetore
	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	
Gjirokastër	20.1	22.5	26.2	27.5	32.5	39.9	42.6	39.5	37.4	31.4	26.8	20.6	42.6

Temperaturat minimale absolute të ajrit

Tabela 3

Vendmatja	MUAJT E VITIT												Vjetore
	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	
Gjirokastër	-7.0	-6.4	-6.6	0.0	2.2	6.5	8.7	9.5	5.6	-1.5	-4.6	-17.4	-17.4

Numri ditëve me temperaturat < ose = 0^0

Tabela 4

Vendmatja	MUAJT E VITIT												Vjetore
	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	
Gjirokastër	14.1	8.0	4.3	0.3	0	0	0	0	0	1.3	4.4	13.8	46.2

Numri ditëve me temperaturat < ose = 5^0

Tabela 5

Vendmatja	MUAJT E VITIT												Vjetore
	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	
Gjirokastër	1.5	0.8	0.2	0	0	0	0	0	0	0	0.3	0.6	5.4

Muaji më i ftohtë i vitit është janari ku temperaturat mesatare mujore në Gjirokastër janë 5.4^0 C.
Muaji më i nxehtë është korriku më temperatura mesatare mujore 23.5 C.
Numri i ditëve të akullta (për temperaturën nën zero gradë) është për vendmatjet meteorologjike Gjirokastër 46.2 ditë në vit. Ndërsa numri i ditëve me temperatura nën 5^0 C është respektivisht 5.4.



2.2.2 Reshjet atmosferike

Reshjet atmosferike janë një nga elementët më të rëndësishëm klimatik që përcaktojnë veçoritë klimatike të zonës (Qarkut Gjirokastër).
Reshjet mujore dhe vjetore në mm

Tabela 1

	MUAJT E VITIT	

Vendmatja	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	Vjetore
Gjirokastër	281	237	168	119	77	34	20	32	94	196	324	346	1930

Reshjet më të mëdha 24 – orëshe mujore dhe vjetore në mm

Tabela 2

Vendmatja	MUAJT E VITIT												Vjetore
	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	
Gjirokastër	216	168	93	97	65	53	21	51	95	199	288	216	288

Reshjet mesatare shumëvjeçare në zonën Gjirokastër janë rreth 1800 mm. Kjo tregon se kemi të bëjmë në një zonë me reshje të shumta dhe të rrëmbyera. Në krahasim me vlerën mesatare të territorit shqiptar (1400 mm) kjo zonë renditet ndër zonat më të lagëta të Shqipërisë. Shpërndarja e reshjeve gjatë vitit është tipike e një regjimi Mesdhetar të reshjeve, sasia më e madhe pritet në periudhën e ftohtë të vitit dhe muajt më të lagët janë Nëntor-Dhjetor (Gjirokastra 324/346 mm). Muaji më i thatë është korriku (përkatësisht 20 mm/muaj). Duke patur parasysh sasinë maksimale për 24 orë të reshjeve dhe intensitetin për intervale të ndryshme kohe në periudha të ndryshme kthimi (return periods), kjo zonë karakterizohet nga një intensitet i lartë i reshjeve. Në vendmatjen meteorologjike Gjirokastër sasia e reshjeve 24 orëshe arrin deri në 288 mm. Më datën 15.11.1962 dhe 16.11.1962 me përqendrim të madh në pjesën jugore dhe qendrore të territorit në vendmatjen meteorologjike të qytetit të Gjirokastrës (Aeroporti i Gjirokastrës) ranë 295 mm dhe një shtresë mesatare për të gjithë territorin 105 mm. Plotat e lumit Drinos në urën e Leklit arriti në 3 max Q ms =1280. Prurje të mëdha patën lumi Vjosë. Ky shi që ka rënë në Gjirokastër në 30 minuta 58mm dhe në 1 orë 80 mm, në 12 orë 212 mm që tejkalon kufijtë e rrebesheve që jep Berga (klasifikimi i reshjeve dhe rrebesheve) p.sh. për reshje 1 orëshe më se 6 herë. Ku Bergu thotë se shtrëngatat e shiut në 40 mm në orë ose 0.7 mm në minutë dhe shiu katastrofik 100 mm në orë është 1.7 mm/min.

Sasia më të mëdha të rrebesheve për intervale të ndryshme dhe koha e rënies vërtetuar gjatë viteve me të dhëna (në mm).

Tabela 3

Vendmatja	Data	Minuta			Orë					Sasia	Orë
		2	15	30	1	2	4	8	12		
Gjirokastër	15.01.1962	12	35	53	80	96	123	176	216	295	28.5

Intensiteti (i mm/min) të disa rrebesheve karakteristike në Gjirokastër.

Tabela 4

Viti	Data	Minuta									
		2	5	15	30	60	120	180	240	360	720
1955	14.11	4.0	2.0	1.53	1.32	0.85	0.70	0.57	0.49	0.40	0.28
1962	15.11	5.0	3.6	2.3	1.93	1.33	0.80	0.59	0.59	0.47	0.30
1966	12.01	0.9	0.56	0.33	0.22	0.31	0.29	0.28	0.26	0.24	0.21
1969	31.03	1.5	1.2	0.83	0.65	0.50	0.34	0.30	0.25	0.22	0.18

Në Gjirokastër kanë rënë 523 mm në 5 ditë dhe 405 mm në 3 ditë (1970), ndërsa në vendmatjen meteorologjike Kardhiq (afër Gjirokastrës) ka rënë 571 mm në 5 ditë dhe 480 mm në 3 ditë në shkurt 1953.

Numri i ditëve me reshje atmosferike, gjatë vitit, më të vogla se 0.1 mm është 115 ditë, më të vogla se 1 mm është 103 ditë dhe më të vogla se 10 mm është 54 ditë.

Lagështia relative

Një tregues i rëndësishëm i lagështisë së ajrit shërben lagështia relative e ajrit, e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë të aktivitetit njerëzor dhe ekonomik. Në ecurinë vjetore të këtij treguesi vërehen ndryshimet që janë të kushtëzuar nga qarkullimi stinor dhe relievi sipas të dhënave në tabelë të cilat tregojnë se vlerat më të larta të lagështisë relative të ajrit vrojtohen në gjysmën e ftohtë të vitit gjë që shpjegohet me veprimtarinë ciklonare që vrojtohen në teritorin e qarkut gjatë periudhës së vitit. Vlerat më të larta i takojnë muajve nëntor e pas tyre vjen janari. Ndërkaq vlerat më të ulëta të lagështisë relative vrojtohen në korrik-gusht pikërisht kur mbi rajonet e Mesdheut vërehen një qëndrueshmëri e anticikloneve të theksuar (anticiklonet e Azoreve). Ecuria ditore e lagështisë relative është e kundërt me atë të temperaturës së ajrit në orët e para të mëngjesit realizohen vlerat më të larta, kurse në orët e mesditës (para ose pas mesditës) vlera më të ulëta. Për të nxjerrë më mirë në pah ndryshimet që vërehen në vlerat e lagështisë relative gjatë ditës, muajit apo vitit si tregues karakteristik shërben amplituda e lagështisë relative. Analiza e të dhënave të vrojtuara tregon se në teritorin e qarkut kjo amplitudë luhatet 30%

Tabela . Mesataret mujore e vjetore e lagështisë relative e ajrit në

Muajt	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	Mesatare
% e lagështisë	71	69	68	69	70	62	57	57	64	67	75	73	67



Niveli i perceptuar i lagështisë në Gjirokastër, i matur nga përqindja e kohës në të cilën niveli i rehatisë së lagështisë është i butë, shtypës ose i mjerueshëm, nuk ndryshon ndjeshëm gjatë vitit, duke qëndruar brenda 3% të 3% gjatë gjithë vitit.

2.2.3 Erërat

Pozicioni gjeografik i Qarkut Gjirokastër, bën që zona të jetë nën ndikimin e erërave jo shumë të forta, që janë të ndryshme për nga forca dhe prania gjatë vitit. Erëra të zakonshme janë ato veriore, jugore dhe me drejtim jugperëndimore. Efekti i tyre ndihet më tepër gjatë luginës së Vjosës, Drinos dhe në gryka.

Gjatë periudhës tetor-mars mbizotërojnë erërat nga lindja, ndërsa gjatë pranverës erërat nga jugu dhe veriperëndimi dhe nga qershori në shtator ato nga veriperëndimi e perëndimi. Shpejtësia mesatare e erërave gjatë vitit është 2,5 m/sek. Territori i Qarkut në përgjithësi dallohet për erërat mesatare e kjo për shkak të konfigurimit të relievit.

Ekzistenca e grykave dhe e qafave ndërmalore lejon depërtimin e erërave kontinentale sidomos në stinën e dimrit.

Erërat e dëmshme, si erërat e ftohta dhe të forta të dimrit por edhe erërat e ngrohta dhe të thata të verës, ndikojnë mjaft negativisht në zhvillimin e ekonomisë bujqësore.

Erërat e nxehta dhe të thata sjellin dëme të konsiderushme sidomos në ekonominë bujqësore në faza të ndryshme të jetës së bimëve. Në qarkun tonë këto erëra fryjnë në drejtime të ndryshme edhe mund të kenë origjinë lokale ose origjinë jashtë territorit të Shqipërisë.

Trendafili i erërave



Trëndafili i erës për Gjirokastën tregon sa orë në vit era fryn nga drejtimi i treguar. Shembull SW: Era po fryn nga Jug-Perëndimi (JP) në Veri-Lindje (NE）.

2.2.4 Bora

Në Qarkun Gjirokastër në periudhën e ftohtë të vitit bie një sasi e konsiderueshme bore në zonat malore, ndërsa në luginën e Vjosës dhe të Drinos bie pak borë për shkak të influencës së zonës nën ndikimin e masave ajrore të ngrohta nga deti Adriatik dhe pak nga deti Jon.

Lartësia maksimale e shtresës së borës është 20 deri në 50 cm në zonat malore (Malësia e Dangëllisë, Kurveleshit, Malëshovë e Zagori). Numri i ditëve me borë shkon nga 5 deri në 10 ditë.

Mundësia e rënies së borës për më shumë se 5 ditë të njëpasnjëshme është në masën 35%. Rreziku i mbulimit 5 ditë nga bora për këtë zonë përfshin rreth 30 % të sipërfaqes me një periudhë rikthimi prej 2 vjetësh. Zonat të cilat rrezikohen nga rënia e borës së madhe janë kryesisht zonat malore të cilat ndodhen në lartësitë mbi 1000 m mbi nivelin e detit dhe larg njësive administrative. Si rezultat i rënies së borës së madhe dhe ngricave popullsia e këtyre zonave mund të bllokohet deri në 10 ditë dhe kjo do të ketë pasoja sidomos për arsye të mungesës së shërbimeve të ndryshme dhe sidomos ushqimore dhe shëndetësore.

Sasia e reshjeve të borës vitet e fundit, ka ardhur duke u zvogëluar si rezultat i ndryshimeve klimatike dhe duhet të theksojme se vitet e fundit kanë qënë të pakta ditët me borë dhe për këtë nuk janë shfaqur problematika në lidhje me bllokimin e rrugëve dhe pengesa në transport me përjashtim të Nj. Ad. Frashër (bashkia Pëmet), Fushë Bardhë - Golem (bashkia Gjirokastër), Kurvelesh (bashkia Tepelenë), Malëshovë (bashkia Këlcyrë), Zagori (bashkia Libohovë).

2.4 Resurset Ujore

Lumenjtë

Hidrografia është mjaft e pasur dhe përbëhet nga lumenjtë **Vjosa** dhe **Drino** që dallohen për regjim të shprehur mesdhetar (prurje të mëdha në dimër e të vogla në verë).

Lumi Vjosa me sipërfaqe të përgjithshme të pellgut ujëmbledhës 6710 km^2 dhe gjatësi 272 km është lumi më i madh i Shqipërisë së Jugut. Fillimin e vetë e ka jashtë territorit të Shqipërisë në shpatin jugor të maleve të Voljakalldit, që shtrihen në jug të maleve të Pindit në Greqi. Vjosa merr ujrat e Vojdomares (nga e majta) dhe pak para se të futet në teritorin tonë derdhet dhe dega kryesore Sarandaporos nga territori Grek. Në territorin Shqiptar (Tri Urat), Vjosa futet si një lumë i formuar dhe kalon në ultësirën ndërmjet vargmaleve të Nemërçkës nga Veriperëndimi dhe nga malet e Leskovikut nga Verilindja.

Lumi deri në Dragot formon një luginë të shoqëruar nga taraca në të dy brigjet ose në njërën anë apo tjetrën sipas rastit. Shtrati në këtë pjesë është i ngushtë dhe brigjet e tij janë përbërë prej konglomeratesh plot zgavra. Në sektorin Këlcyrë - Dragot, Vjosa futet në një luginë të tipit erozional me drejtim lindjeperëndim, ku pret tërthorazi një radhë strukturash antiklinale si vargmalet Nemërçkë - Dhembel nga mali Trebeshinës dhe më poshtë malet Lunxhëri - Golik nga mali i Shëndëllisë. Këtu lugina është në formë “V” dhe në përgjithësi është simetrike. E veçanta e kësaj pjese është fakti që masivi gëlqerore Nemërçkë - Dhëmbel si dhe ai Trebeshinë - Shëndëlli drenojnë ujrat e tyre në Grykën e Këlcyrës direkt në Vjosë, ku nga më të shquarit është ai i quajturi burimi i Ujit të Zi me prurje disa m^3 në sekondë.

Gjatësia e Grykës së Këlcyrës ka një gjatësi prej 13 km dhe gjerësi 1-1.5 km. Zona hidrografike e Vjosës pas Dragotit dhe pas bashkimit me lumin Drinos, karakterizohet nga një luginë më e gjerë. Në vendet ku ndërpret gëlqerorët, ka krijuar gryka të ngushta siç është ajo e Dorëz - Kalivaç, e cila është e gjatë rreth 4 km e gjatë dhe gjerësi 150 m.

Në Vjosë derdhen degë të shumta. Përveç degës kryesore të Drinos, që në fakt për nga madhësia e pellgut ujëmbledhës si dhe sasia e ujit që transporton është lumë më vete ka dhe një sërë përrenjsh që derdhen në trungun e Vjosës.

Lumi Drinos

Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës e lumit Drino deri në derdhje në lumin Vjosa është S=1324.4 km^2, gjatësia e lumit L=84 km dhe lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës të lumit Drinos është Hmes=745.5m. Lumi Drinos i ka fillimet e tij në Greqi, në shpatet perëndimore të malit Elatos. Futet në Shqipëri midis Radatit dhe Kakavijës dhe ndjek rrjedhën VP pa dredhime nëpër një luginë relativisht të rregullt. Kalon nëpër ultësirën që shtrihet ndërmjet strukturave të Malit të Gjerë - Stugarës dhe Lunxhëri - Bureto kryesisht nga depozitime fluviale. Ky lumë ka një ndërtim specifik të pellgut ujëmbledhës, ku shkëmbinjtë karstik mbulojnë pjesën më të madhe të territorit. Deri në Hundëkuq lumi Drinos kalon nëpër një shtrat të gjerë, pastaj rrjedh në një grykë të thellë e të ngushtë deri sa derdhet në Vjosë pak më poshtë Urës së Leklit. Gjatë kësaj rrjedhje, nga bregu i djathtë dhe ai i majtë i këtij lumi zbresin përrenj me rrjedhje të përkohshme dhe të vazhdueshme shumë erodues që derdhin në lumin Drinos shumë material të ngurtë si përroi Vriseras, Suhës, Nimicës etj.

Në pellgun ujëmbledhës të lumit Drinos gjatë periudhës së lagët të vitit bien rreth 90% të reshjeve vjetore nga muaji (maj - tetor).

Përrenjtë.

Që nga hyrja në teritorin shqiptar deri në Dragot derdhen përrenjtë e **Çarshovës** (90.8 km^2), **Langaricës** (337 km^2), **Lemnicës** (103 km^2), **Dishnicës** (137 km^2) nga ana e djathtë si dhe përroi i **Zagories** (171.6 km^2) nga ana e majtë. Nga Dragoti deri në Kalivaç derdhen përrenjtë e **Bënçës, Luftinjës, Dhemblanit, Sinanaj** etj.

Tabela e lumenjve të qarkut Gjirokastër sipas bashkive

Në bashkitë Gjirokastër, Dropull, Libohovë: **Tabela 1**

Emërtimi	**Gjatësia (km)**	**Gjatësia brenda bashkive**
Lumi Drino	**75**	**46 km** (Gjirokastër, Libohovë, Dropull)
Lumi Suhës	**34**	**34 km** (Gjirokastër, Libohovë, Dropull)
Lumi Kardhiqit	**24**	**24 km** (Gjirokastër)
Lumi Nimicës	**14**	**14 km** (Gjirokastër)
Lumi Zagories	**19**	**8 km** (Libohovë)
Lumi Kserias	**14**	**14 km** (Dropull)

Në bashkitë Tepelenë, Memaliaj: **Tabela 2**

Emërtimi	**Gjatësia (km)**	**Gjatësia brenda bashkive**
Lumi Vjosës	**272**	**50 km** (Tepelenë, Memaliaj)
Lumi Drino	**75**	**12 km** (Tepelenë)
Lumi Bënçës	**10**	**10 km** (Tepelenë)
Lumi Luftinjës	**15**	**15 km** (Memaliaj)

Në bashkitë Përmet, Këcyrë: **Tabela 3**

Emërtimi	Gjatësia (km)	Gjatësia brenda bashkive
Lumi Vjosës	**272**	**Lumi kryesor është lumi Vjosa** i cili vjen nga Greqia dhe përshkon territorin e rrethit të Përmetit me **58 km**.
Lumi Sarandoporos	**8**	**Është 8 km** i gjatë, vjen nga Greqia, shoqëron kufirin dhe në afërsi të fshatit Perat derdhet në Vjosë.
Lumi Çarshovës	**19**	**Është 19 km** i gjatë, buron nga malet e Kolonjës, derdhet në Vjosë në fshatin Çarshovë.
Lumi Lumnicës	**18**	**Është 18 km** i gjatë mbledh ujrat e Malësisë së Dangëllisë dhe pjesërisht nga Qarishta derdhet në Vjosë, në afërsi të Piskovës.
Lumi Zalli i Dëshnicës	**28**	**Është 28 km** i gjatë mbledh ujrat e Malësisë së Trebeshinës, Qarishtës **dhe Qafës së Kiçokut dhe derdhet në Vjosë në qytetin e Këlcyrës.**
Lumi Zagories	**19**	Buron nga malet e Zagories dhe përshkon **11 km** krahinën e Malëshovës dhe derdhet në Vjosë në Grykën e Këlcyrës.

Ujrat nëntokësore dhe burimet.

Zona është e pasur me ujra nëntokësore, gjë që duket nga numri i madh i burimeve me prurje nga **0,01 - 500 litra në sekondë**. Përhapja e ujrave nëntokësore dhe burimeve si dhe sasia e tyre ndryshon nga njëri territor në tjetrin. Burimet që ndeshen në këtë territor janë të përkohshëm dhe të përhershëm. Burime të përhershme takohen në luginën e Pogonit, në fshatrat Hllomo e Mavrojer, në luginën e Zagories në fshatrat Zhej e Hoshtevë, në Lunxhëri në fshatrat Kakoz (Hosi) e Tranoshishtë, në shpatin e Buretos: Libohovë, Nepravishtë, Glinë, Peshkëpi, Ujët e Ftohtë të Tepelenës e shumë të tjerë.

Nga këto burime bëhet edhe furnizimi me ujë të pijshëm i popullatës së rajonit tonë, duke u grumbulluar në depot përgatitura për këtë qëllim, nëpërmjet rrjedhjes së lirë apo elektropompave me linjat kryesore dhe prej andej bëhet shpërndarja nëpërmjet linjave të shpërndarjes.

Me përjashtim të ujit të burimeve të "Ujit të Ftohtë" dhe të Glinës të cilët përpunohen dhe ambalazhohen, uji i burimeve të tjera nuk përpunohet përveçse kryerjes së klorifikimit të tij.

Burime të rëndësishme janë Gëlqerorët në zonën e Dropullit, të Gurit të Zi në Zagorie dhe Përmet si dhe të Argjilave në Memaliaj.

Zona e Shqerrisë - shtrihet **12 - 15 km** në juglindje të Përmetit. Aty ka burime me ujë termale, flora dhe faunë të pasura dhe pamje piktoreske. Ka burime termale në të dy anët e lumit Langaricë, përroi kryesor i lumit Vjosë e Sipërme. Ujra me bazë sulfuri që kanë vlera të larta kuruese, ku temperatura e ujit varion nga **26 ^{0} C- 32 ^{0} C.**

Në **"Urën e Dashit"** - fillon **kanioni i lumit Langarica**. Është **30 m** e lartë dhe **2 m** e gjerë, pas **5 - 6 km** ai bëhet **10 - 12 m** më i gjerë dhe **150 m** i lartë.

Pranë burimeve ujore termale shtrihet **"Shpella e Pëllumbave"** e erës së Neolitikut, **160 m** e gjatë dhe **3 m** e gjerë. Ajo ka vlera arkeologjike siç janë stalaktidet dhe stalagmitet.

2.3.7 Ujëmbledhësit (Rezervuarët) qarku Gjirokastër

Në territorin e qarkut Gjirokastër ndodhen 63 ujëmbledhës, të cilët shërbejnë për ujitjen e tokave bujqësore. Gjendja teknike e tyre, dëmtimet e pritave dhe argjinaturave, deri më sot nuk kanë ndikuar me problemet që mbartin dhe kanë aktualisht këto ujëmbledhësa për shkak të mungesës së investimeve në vite. Disa nga problemet që kanë këta ujëmbledhës, të cilët mund të ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e fatkeqësisë së përmbytjeve janë:

- Si pasojë e mbushjes me aluvione ekziston rreziku, në rast piku të reshjeve dhe prurjeve, i mbushjes së kupës së ujëmbledhësit dhe ngritjes mbi kurorën e digës, duke rrezikuar shkarkuesin atmosferik.
- Mungesa e funksionimit normal deri në bllokim të ujëlëshuesve, dëmtimi i mureve mbajtëse.
- Bllokimi i pusetave të brendshme etj.

Nga studimet e kryera, institucionet përgjegjëse kanë konkluduar se për shmangien e situatave të emergjencës është kërkuar çelja e investimeve për normalizimin e funksionit të ujëlëshuesve në ujëmbledhësa problematik, riparimin e argjinaturave, mbrojtjen nga gërryerjet, rehabilitimin e veprave të marrjes dhe rivënien në gatishmëri të shkarkuesve katastrofik.

VKM-ja nr.1108 datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve të Kullimit", ngarkon bashkitë për ujëmbledhësat që kanë në territorin administrativ të tyre.

Këta rezervuarë janë të listuar: numri i ujëmbledhësve sipas bashkive, monitoruesi, nr. Telefonit Celular, gjendja teknike, kapaciteti i tyre **bashkëngjitur në Shtojcën D.**



Harta e rrjedhjes ujore qarku Gjirokastër

2.5 Infrastruktura strategjike për menaxhimin e emergjencave civile.

Rrjeti i rrugëve në qarkun e Gjirokastrës është pothuajse 651 kilometra i gjatë, nga të cilat rreth 270 kilometra janë rrugë nacionale dhe rreth 381 janë rrugë rurale.

I një rëndësie të veçantë është sistemi i rrugëve që përbëjnë rrjetin Kakavijë – Gjirokastër - Tepelenë, të cilat jo vetëm lidhin jugun e vendit me veriun, por gjithashtu krijojnë lidhje me Greqinë.
Meqë numri i automjeteve transportuese, që transportojnë si mallra ashtu edhe udhëtarë, rritet çdo vit, riparimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor bëhet nga firmat kontraktore nën mbikëqyrjen e Autoritetit Rajonit Jugor Qarku Gjirokastër.

Rrjeti i rrugëve rurale përbëhet nga 342 kilometra rrugë, që lidhin komunat me rrugët nacionale dhe fshatrat. Ndonëse mirëmbajtja e këtij rrjeti është përgjegjësi e 7 bashkive të Qarkut kushtet mbeten për t'u përmirësuar gjithandej. Nga harta është e dukshme se jashtë rrugëve nacionale të asfaltuara ka vetëm pak rrugë të mirëmbajtura. Me përjashtim të një pakice rrugësh të mirëmbajtura, në të shtatë bashkitë e qarkut ka shumë rrugë fshati dhe rrugë stinore. Këto rrugë fshati dhe rrugë stinore nuk janë as të asfaltuara e as të mirëmbajtura, dhe gjatë ditëve me shi dhe me lagështi mund të jetë e pamundur dhe e rrezikshme për t'i përdorur.
Tabela : Rrjeti i rrugëve kombëtare , rajonale dhe rurale të qarkut

BASHKIA	NJ.ADMINISTRATIVE	RRJETI RRUGOR	GJATËSIA Km	
			Total	Shtruar
Gjirokastër	Cepo	K / Mashkullorë - Mashkullorë	5	5
		K / Ura e Kardhiqit - Fushëbardhë	26	-
	Picar	K/ Votuc - Golem - Guri Shpuar	20	-
	Lunxhëri	Ura e Drinos - Erind - Çajup	22	22
		Dhoksat - Qestorat	3	-
		Erind - Dhoksat	5	5
	Antigone	Ura e Drinos - Sarqinisht	14	14
	Lazarat	K / Lazarat - Lazarat	3	3
	Odrie	Ura e Subashit - Andon Poçi	6	6
		Ura e Subashit - Labovë	9	-
Libohovë	Q. Libohovë	K / Suhës - Labovë e Sipërme	8	-
	Zagori	K / Goranxi - Bulo	3	3
		K / Libohovë - Hoshtevë	38	38
Dropull	Dropull i Sipërm	K / Bularat - Bularat	4	4
		K / Koshovicë - Koshovicë	6	-
		K / Bularat - Bodrishtë	4	4
	Dropull i Poshtëm	Hyrjet në fshtrat Dropull	3	3
		K / Glinës - Glinë	4	4
		Fabrika e Glinës - Glinë	1	1
	Pogon	Poliçan - Sopik	12	-
		Stacioni Pyjor - Çatistër	14	-

Tepelenë	Qendër Tepelenë	Tepelenë - Progonat - Nivicë	31	31
		K / Salari - Salari	4	-
		K/Salari - Salari - Nivicë	20	-
		Subash - Qendër Hormovë	9	9
		Ura e Dragotit - Ish NB	5	4
	Kurvelesh	K / Gusmar - Gusmar	2	-
		Progonat - Kufi Gjirokastër	3	-
Memaliaj	Buz	Kufi Gllavë - Repeditori	2	-
	Luftinjë	Luftinjë - Sektori 4	2	2
		Agjensi - Luftinjë - Izvor	17	17
Përmet	Petran	Petran - Bënjë	7	7
		Degëzim - Bodar	5	5
		Përmet - Badëlonjë	3	-
	Qendër Piskovë	Degëzim - Kosinë	1	1
		Piskovë - Frashër	31	31
Këlcyrë	Ballaban	Kiçok - Malas	10	-
	Dëshnicë	Kthesa e Katundishtës - Katundishtë	4	4
		Bedyqas - Tolar	4	4
		Degëzim - Luarë	5	-
	Sukë	Sukë - Kthesa e Zhepovës	2	2



Harta e rrjetit rrugor qarku Gjirokastër (Rrugët kombëtare , rajonale dhe rrurale)

2.6 Shëndetësia

Qarku Gjirokastër ka një sistem shëndetësor të stabilizuar me Spitalin Rajonal "Omer Nishani" të Gjirokastrës dhe shërbim ambulatorë në çdo lagje dhe fshat. Spitali rajonal është i kompletuar

me personel dhe salla operatore të kohës. Spitali rajonal ka plan gatishmërie dhe veprimi për t'iu përgjigjur çdo situate emergjente.

Reformat e nisura në sistemin shëndetësor kanë filluar të ndjehen dhe të përqafohen nga banorët e qarkut si dhe të inkurajohen për përmirësime të mëtejshme. Konsolidimi i institucioneve bazë që ofrojnë shërbime si poliklinikat, qendrat shëndetësore, ambulancat dhe shërbimet e veçanta të konsultorit të fëmijëve dhe të gruas, ka rritur numrin e shërbimeve si dhe cilësinë e tyre ndër vite.

Strukturat e shëndetësisë që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Qarkut Gjirokastër të cilat angazhohen në përballimin e një emergjence të mundshme:

- Spitale : 3 (Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet)
- Qendra shëndetësore : 31
- Ambulanca: 158
- Konsultore e fëmijëve: 167

Numri më i madh i instucioneve shëndetësore është përqëndruar në qytetet ku dhe numri i popullsisë është më i lartë. Bazuar në statistikat e INSTAT mbi shërbimin spitalor, rezulton se qarku Gjirokastër ka dëndësinë më të lartë të shtretërve spitalor, gati 57 shtretër për 10 mijë banorë.

Institucioni shëndetësor kryesor i rajonit i cili ofron shërbim spitalor për një numër të konsiderueshëm banorësh, jo vetëm për popullsinë lokale, por dhe për popullsinë banuese nga zonat përreth, është Spitali Rajonal "Omer Nishani" i qytetit të Gjirokastrës. Në këtë spital shërbejnë rreth 242 personel dhe ka kapacitet 180 shtretër.

Ky spital është i kompletuar me të gjitha shërbimet spitalore ku përfshihen dhjetra reparte shërbimi spitalor, si reparti i urgjencave, pediatria, patologjia, infektivi, reanimacioni, dializa, kirurgjia, materniteti, radiologjia dhe laboratorë për kryerjen e të gjitha analizave dhe egzaminimeve mjekësore.

Gjithashtu, që prej fillimit të këtij viti ky spital ofron falas një shërbim të domosdoshëm për të gjitha gratë dhe vajzat; mamografinë.

- Qendrat shëndetësore në zonat e thella rurale kanë makinë lëvizëse – tip fouristradë. NJVKSH disponon 2 laboratorë (fiziko - kimik dhe bakterialogjik) për të përballuar çdo problematikë shëndetësore siç janë aplikimi i analizave fizike, kimike dhe bakterialogjike për ndotjet mjedisore të tokës, ujit, ajrit, sëmundjet ngjitëse në komunitet dhe situatën epidemiologjike.
- NJVKSH disponon 2 mjete fouristradë për lëvizjen në zonat e thella dhe në rrugë të vështira. Këto mjete përdoren për furnizimin me mjete, medikamente dhe vaksina për dhënien e ndihmës urgjente në raste emergjencash shëndetësore për evakuimin dhe transportimin e personave të sëmurë në spitale.
- Spitali rajonal disponon një flotë autoambulancash me aksesin e duhur logjistik dhe personel të trajnuar për të ofruar ndihmën e parë dhe kujdesin e specializuar mjekësor në raste emergjencash.
- Në ato raste kur nuk është e mundur të mbërrijnë autoambulancat në vendngjarje koordinohet me njësinë mjekësore të fluturimeve ajrore.

Detyrat që kryejnë ato janë :

- Vënë në dispozicion të gjithë personelin për t'i ardhur në ndihmë komunitetit të zonës së dëmtuar duke aktivizuar qendrat shëndetësore të bashkive si dhe personel rezervë me grup mjekësh dhe infermierësh etj.
- Bëjnë identifikimin e kurimin e njerzve që janë dëmtuar në zonën e dëmtuar.
- Sigurojnë rezerva në medikamente mjekësore e bëjnë kërkesë për ndihmë për medikamente të tjera për kurimin e të sëmurëve në zonat e dëmtuara.
- Në bashkëpunim me OJF bëjnë ekzaminimin e të sëmurëve dhe të komunitetit në nevojë në zonën e dëmtuar.
- Çdo qendër shëndetësore ka një sistem komunikimi të telefonisë fikse – celulare dhe akses interneti.
- Çdo mjek është udhëzuar t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave shëndetësore të popullatës dhe nëpërmjet sistemit on calling 24 orë në 24 orë.

Tabela me të dhënat për shëndetësinë të qarkut

1. NJVKSH Gjirokastër

Nr.	Qendrat Shëndetësore	Nr. i popullatës	Nr. i ambulancave	Nr. i mjekëve	Nr. i infemierëve
1.	Gjirokastër	26498	12	11	41
2.	Picar	1526	3	1	6
3.	Cepo	3628	9	2	16
4.	Odrie	1272	3	1	5
5.	Lunxhëri	4844	10	2	11
6.	Antigone	1620	4	1	5
7.	Lazarat	3483	1	1	5
8.	Libohovë Qendër	2943	1	1	6
9.	Libohovë NJA	2581	7	1	8
10.	Pogon	328	2	1	3
11.	Zagori	915	5	1	5
12.	Dropull i Poshtëm	8787	13	3	17
13.	Dropull i Sipërm	8699	12	1	15
14.	TOTALI	67124	81	27	143

2. NJVKSH Tepelenë

Nr.	Qendrat Shëndetësore	Nr. i popullatës	Nr. i ambulancave	Nr. i mjekëve	Nr. i infemierëve
1.	Tepelenë	11728	5	3	26
2.	Qendër	4800	14	2	15
3.	Fshat Memaliaj	2500	8	1	9
4.	Buz	2900	12	1	12
5.	Lopës	1394	4	1	7
6.	Luftinjë	3252	13	0	13
7.	Qesarat	2500	6	1	10
8.	Krahës	3219	10	2	16
9.	Kurvelesh	1651	4	0	7
10.	Totali	33944	76	11	115

3. NJVKSH Përmet

Nr.	Qendrat Shëndetësore	Nr. i popullatës	Nr. i ambulancave	Nr. i mjekëve	Nr. i infemierëve
1.	Përmet	8658	5	5	16
2.	Këlcyrë	2480	3	1	19
3.	Deshnicë	3127	9	2	11
4.	Sukë	2024	10	1	14
5.	Ballaban	1599	12	1	14
6.	Piskovë	2820	11	0	13
7.	Petran	2852	11	1	11
8.	Frashër	498	5	0	5
9.	Carshovë	2636	7	1	8
10.	Totali	26694	73	11	111

4. Spitali Rajonal "Omer Nishani" Gjirokastër

Nr.	Pavioni/Shërbimet	Nr. i shtretëve	Nr. i persona të shtruar për vitin 2020
1.	Sëmundje të brendshme	55	787
2.	Infektiv	20	79
3.	Kirurgji	39	1271
4.	Reanimacion	4	243
5.	Maternitet	33	631
6.	Pediatri	23	281
7.	Urgjencë	10	11410
	Totali	184	14702

2.7 Arsimi

Qarku Gjirokastër ka një sistem arsimor të stabilizuar, me nivel të ulët të braktisjes së shkollës dhe shkallë frekuentimi mbi mesataren e vendit. Në Qarkun Gjirokastër nuk ekziston gjakmarrja si fenomen. Nuk ka asnjë raste të marrjes hak ndaj fëmijëve.

Në këtë kuadër, institucioni i Prefektit të qarkut ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e politikave në arsimin parauniversitar, me qëllim që këto reforma të funksionojnë dhe të japin inpaktin e dëshiruar. Bazuar në informacionet e marra nga Institucionet arsimore, ZVA Gjirokastër, ZVA Tepelenë dhe ZVA Përmet gjatë vitit 2019 është bërë përmirësimi i infrastrukturës bazë si dhe janë përmirësuar kushtet për zhvillimin e një procesi normal mësimor, me krijimin e laboratorëve të informatikës dhe sigurimin e internetit në të gjitha shkollat. Gjithashtu, janë krijuar struktura mbështetëse për zhvillimin e mësimit për nxënësit me aftësi ndryshe duke caktuar mësues mbështetës për një zhvillimin normal të procesit mësimor për këta nxënës.

Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë për vitin shkollor 2020 -2021 në qarkun e Gjirokastrës është 735 nxënës. Krahasuar me vitin e kaluar, vihet re një rënie e numrit të nxënësve të cilët janë regjistruar e vazhdojnë shkollën, si pasojë jo vetëm nga lëvizja e popullsisë, por edhe nga rënia e numrit të lindjeve.

Tabelat me të dhënat për arsimin në shkallë qarku , shiko në shtojcën D

Të dhëna të përgjithshme mbi numrin e nxënësve dhe të shkollave të ndara sipas ZVA përkatëse paraqiten si më poshtë vijon:

1. Zva Finiq-Dropull

NR.	Emrat e shkollave 9-vjecare dhe te mesme	Njesia administrative	Nr. i nxenesve te shkolles 9-vjecares	Nr. i nxenesve te shkolles se mesme	Nr i mesuesve
Bashkia Dropull					
1	SHMB DERVICIAN	Dropulli i Poshtem	82	38	17
2	SHMB BULARAT	Dropulli i Siperm	21	37	11
Totali:	**2**		**103**	**75**	**28**

2. ZVA Gjirokastër-Libohovë

NR.	Emrat e shkollave 9-vjecare	Njesia administrative	Nr. i nxenesve	Nr. i mesuesve
Bashkia Gjirokaster				
1	"KOTO HOXHI"	Bashkia Gjirokaster	898	58
2	"URANI RUMBO"	Bashkia Gjirokaster	306	34
3	"NAIM FRASHERI"	Bashkia Gjirokaster	191	15
4	"A.Z.CAJUPI"	Bashkia Gjirokaster	194	28
5	"A.Z.CAJUPI" SE BASHKU	Bashkia Gjirokaster	80	
6	“ASIM ZENELI”	NJA Antigone	35	7
7	"PETRO POGA"	NJA Lunxheri	110	13
8	SHMB "MUHAMET GJOLLESHA"	NJA Lazarat	236	27
9	SHMB "BILAL GOLEMI"	NJA Cepo	77	26
10	“XHUZEPE GRAS”	Bashkia Gjirokaster	241	15
11	“9-VJEÇARE FRYMË DASHURIE”	Bashkia Gjirokaster	257	15
Totali	**11**		**2625**	**238**
Bashkia Libohove				
1	"AVNI RUSTEMI"	Bashkia Libohove	212	24
2	“NEPRAVISHTE”	Qender Libohove	64	12
Totali	**2**		**276**	**36**

NR.	Emrat e shkollave te mesme	Njesia administrative	Nr. i nxenesve	Nr. i mesuesve

Bashkia Gjirokaster				
1	"ASIM ZENELI"	Bashkia Gjirokaster	272	23
2	“SIRI SHAPLLO”	Bashkia Gjirokaster	349	
3	“SIRI SHAPLLO” PT	Bashkia Gjirokaster	125	29
4	"PANDELI SOTIRI"	Bashkia Gjirokaster	86	29
5	"FEIM IBRAHIMI"	Bashkia Gjirokaster	29	16
6	“SHMB M. GJOLLESHA “	NJA Lazarat	36	27
7	“SHMB BILAL GOLEMI”	NJA Cepo	26	26
8	GJIMNAZI "FRYME DASHURIE	Bashkia Gjirokaster	62	8
9	KRYQI I NDERUAR	Bashkia Gjirokaster	21	13
10	THOMA PAPAPANO	Bashkia Gjirokaster	160	16
Totali	**10**		**1166**	**187**
Bashkia Libohove				
1	11 SHKURTI	Bashkia Libohove	49	6
Totali	**1**		**49**	**6**

3. ZVA Tepelenë-Memaliaj

NR.	Emrat e shkollave 9-vjecare	Njesia administrative	Totali Nr. i nxenesve
Bashkia Tepelene			
1	"AVNI RUSTEMI", TEPELENE	Tepelene	273
2	"7 MARSI", TEPELENE	Tepelene	216
3	"SHUKO DALIP DALIPI", NIVICE	Kurvelesh	11
4	"ASIM ZENELI", PROGONAT	Kurvelesh	23
5	"SINAN KERPI"	Kurvelesh	6
6	"SELAM MUSAI", SINANAJ	Lopës	34
7	"HALIL RAMO", DHEMBLAN	Lopës	23
8	"SALI BEQIRI", MATOHASANAJ	Lopës	4
9	"NEVRO SELIMI", HORMOVË	Qëndër	23
10	"MISTO SHUMELI", KODËR	Qëndër	4
11	"SEJDI DOSTI", DRAGOT	Qëndër	16
12	"LLUKAN CEKA", PESHTAN	Qëndër	5
13	"XHAFER BANI", MEZHGORAN	Qëndër	8
14	"MEMO NEXHIPI", DUKAJ	Qëndër	31
15	"MUSTAFA ZOTO", SALARI	Qëndër	8
16	"MYSLYM BELULI", VELIQOT	Qëndër	12

17	"FERIT ÇELA", TURAN	Qëndër	5
18	"FATO KUÇI" BENÇE	Qëndër	4
Totali	**18**		**706**
Bashkia Memaliaj			
1	"NIMETE PROGONATI", MEMALIAJ	Memaliaj	238
2	"XHEVIT ÇELA", IZVOR	Luftinjë	40
3	"BABA ABAZ", RABIJE	Buz	6
4	"TEFIK AZBIU", CANAJ	Luftinjë	5
5	SHKOLLA DIDAJ	Luftinjë	4
6	"TAFIL BUZI", BUZ	Buz	8
7	"HASAN DRYKA", SHALES	Buz	13
8	"MUHARREM ILIAZI", SELCKE E MADHE	Buz	3
9	"ALI VELA", SELCKE E VOGEL	Luftinjë	4
10	"BARJAM SELMANI", XHAFAJ	Luftinjë	3
11	"FEIM MAHMUTAJ", GLLAVE	Luftinjë	4
12	SHKOLLA KOMAR	Luftinjë	2
13	"ISMAIL CACA", LUFTINJE	Luftinjë	27
14	MARTALLOZ FSHAT	Luftinjë	1
15	"6 DESHMORET", ZHAPOKIKE	Luftinjë	8
16	"SADIK ÇIÇA", ZHAPOKIKE 2	Luftinjë	5
17	"SKENDER ARAPI", MARICAJ	Luftinjë	4
18	"HYSEN GOXHARA", ARREZ E MADHE	Luftinjë	13
19	"LAME KANANI", DAMES	Memaliaj fshat	4
20	"NIMET MUÇI", KASHISHT	Memaliaj fshat	5
21	"JONUZ BALILI", ÇERRILE	Memaliaj fshat	5
22	"ORMEN SELAMI", QESARAT	Qesarat	64
23	"LILO BETA", VASJAR	Qesarat	23
24	"MEDIN ÇELA", TOÇ	Qesarat	18
25	"SELAM CAUSHI", KAMÇISHT	Qesarat	11
26	"QAZIM SHEHU", ANËVJOSË	Qesarat	2
27	"XHEMAL HADA", KRAHES 1	Krahës	25

28	"SAMI NELA", KALIVAÇ	Krahës	24
29	"MUSA RRAPI", LEVAN	Krahës	9
30	"QANI RAMA", ZHULAJ	Krahës	5
31	ALLKOMEMAJ	Krahës	10
32	XHAXHAJ	Krahës	4
33	"ADEM ALUSHI", LULEZIM	Krahës	106
Totali	**33**		**703**

NR.	Emrat e shkollave te mesme	Njesia administrative	Totali: Nr. i nxenesve
Bashkia Tepelene			
1	ABAZ SHEHU	Tepelene	205
Totali	**1**		**205**
Bashkia Memaliaj			
1	"SALI NIVICA",	Memaliaj	93
2	"ADEM ALUSHI",	Lulezim	79
3	"ORMEN SELAMI",	Qesarat	41
4	"XHEVIT ÇELA",	Izvor	34
5	"TAFIL BUZI",	Buz	38
Totali	**5**		**285**

Numri total i mësuesve në shkollat 9-vjeçare dhe në shkollat e mesme të bashkisë Tepelenë dhe Memaliaj është 308 mësues.

4. ZVA Përmet-Këlcyrë

NR.	Emrat e shkollave 9-vjecare	Njesia administrative	Totali Nr. i nxenesve
Bashkia Permet			
1	Meleq Gosnishti	Përmet	321
2	Nonda Bulka	Përmet	216
3	At Stath Melani	Petran	24
4	Gjinkar	Petran	4
5	Gostivisht	Frashër	2
6	Kutal	Piskovë	2
7	Bual	Piskovë	4
8	Iljar	Çarshovë	39
9	Thoma Doda	Çarshovë	5
10	Draçovë	Çarshovë	2
11	Strëmbec	Çarshovë	2
12	Kaludh	Petran	10
13	1Maji	Piskovë	45
14	Pacomit	Piskovë	5
15	Stefan Zhaka	Piskovë	20
16	Kosovë	Piskovë	2
17	Borockë	Piskovë	2
18	Rapckë	Piskovë	3

Totali	**18**		**708**
Bashkia Kelcyre			
1	Kamber Bënja	Këlcyrë	299
2	Limar	Këlcyrë	2
3	Katundishtë	Deshnicë	
4	Fratar	Deshnicë	4
5	Seniçan	Deshnicë	3
6	Tolar	Deshnicë	2
7	Riban	Deshnicë	2
8	Lumo Pavari	Sukë	64
9	Goricë	Sukë	1
10	Fshat i Ri	Sukë	3
11	Zhepovë	Sukë	3
12	Zyrihana Xhako	Ballaban	59
13	Toshkëz	Ballaban	11
14	Bubësi i Dytë	Ballaban	5
15	Kenaj	Ballaban	3
16	Kajcë	Ballaban	1
Totali	**16**		**462**

NR.	Emrat e shkollave te mesme	Njesia administrative	Totali: Nr. i nxenesve
Bashkia Permet			
1	Gjimnazi "Sami Frasheri	Përmet	241
2	SHMB "1 Maji"	Piskovë	10
Totali	**2**		**251**
Bashkia Kelcyre			
1	Gjimnazi "Sejfulla Malëshova"	Këlcyrë	118
2	SHMB "Lumo Pavari"	Sukë	28
3	SHMB " Zyrihana Xhako"	Ballaban	24
Totali	**3**		**170**



Harta e institucioneve publike dhe arsimore të qarkut Gjirokastë

2.8 Demografia

- **Të dhënat demografike**

Popullimi i hershëm, migrimet e popullsisë dhe pasojat

Zbulimet arkeologjike në Qarkun e Gjirokastrës tregojnë se ka patur një popullim më të hershëm se rajonet e tjera të vendit. Qysh në shekujt VII – VI para Krishtit kanë filluar të ngriheshin qytetet antike. Nga fundi i shekullit të XVI, ky rajon bënte pjesë në zonat me dendësi më të madhe të popullsisë në krahasim me trevat e tjera shqiptare. Në vijim, popullsia u shtua me ritme të ngadalta (shtesa natyrore sa gjysma e mesatares së vendit), si Zona e Zagorisë, Pogonit, Rrëza e Përmetit, qyteti Gjirokastër etj.

Shtimi shumë i vogël i popullsisë lidhet me numrin e pakët të lindjeve, por sidomos me migrimet e shumta dhe të vazhdueshme, veçanërisht jashtë vendit, para vitit 1945. Pas vitit 1992 lidhet me largimin e madh në rajonet e tjera të vendit dhe jashtë shtetit, ku u ripërtëri migrimi i dikurshëm.

Me migrimin lidhet pakësimi i popullsisë në periudhën midis dy luftërave botërore. Disa zona si Zagoria (Libohovë), Shqeria (Përmet) kanë pasur pakësim të popullsisë edhe në periudhën 1945 – 1990. Për shkak të emigracionit të jashtëm e të brendshëm, pas vitit 1990 popullsia e qarkut u pakësua me ritme shumë të shpejta. I gjithë rajoni në vitin 2011 kishte më pak se gjysmën e popullsisë së vitit 1989, dallohet bashkia e Tepelenës e cila kishte 64 % banorë më pak. Me migrimin e madh të popullsisë lidhen dhe ndryshimet strukturore të saj moshore qytet dhe fshat.

Shpërndarja gjeografike e popullsisë

Shpërndarje gjeografike e popullsisë është e pabarabartë. Dëndësia mesatare e popullsisë është më vogël se mesatarja e vendit. Kjo dëndësi është zvogëluar nga 61 banorë / km^2 (viti 1989) në rreth 30 banorë / km^2 në vitin 2011 dhe 22 banorë / km^2 në vitin 2018. Vlerat më të vogla të dendësisë i ka bashkia e Përmetit (rreth 17 banorë / km^2), kurse më të lartat bashkia Gjirokastër (rreth 50 banorë për km^2) me kushte më të mira jetese. Ndryshimet e dendësisë së popullsisë janë më të mëdha në njësi të ndryshme gjeografike. Më të larta këto janë në lugina (Vjosës dhe Drinos) me kushte më të mira jetese. Në zonat kodrinore dhe malore dëndësia është më e vogël se 20 banorë / km^2 dhe prirja është drejt zvogëlimit.

Struktura e popullsisë

Për shkak të emigrimit dhe të rënies së lindjeve po shfaqet plakja e popullsisë: mosha e re (deri në 14 vjeç) është 17%. Kjo përbën pëqindjen më të ulët në vend. Mosha 15-64 vjeç arrin 67 %, kurse mosha mbi 65 vjeç përbën 16% të popullsisë (viti 2011). Siç shihet popullsia mbi 65 vjeç zë përqindjen më të lartë në vend. Kjo flet për shkallën e avancuar të plakjes së popullsisë. Dukuria e plakjes së popullsisë është më e theksuar në njësinë administrative Pogon, ku mosha mbi 65 vjeç zë mbi gjysmën e popullsisë, kurse mosha deri ne 14 vjeç zë mbi 5 % të saj. Prefektura Gjirokastër është më e plakura në vend, sepse mosha mesatare e popullsisë së saj është 39.7 vjeç (2011).

Popullsia fshatare e qytetare

Mbizotëron popullsia qytetare, e cila zë mbi 53% të popullsisë së përgjithshme të qarkut (viti 2011). Shtimi natyror i popullsise qytetare është i ulët. Rritja e saj lidhet më së shumti me ardhjet nga zonat fshatare, sidomos pas vitit 1990. Popullsia ka tradita kulturore, që ka ndihmuar në kulturën kombëtare .



Struktura moshore e qarkut Gjirokastër (Census 2011)



Popullsia qytetare dhe fshatare qarku Gjirokastër (Census 2011)

Vendbanimet

Vendbanimet fshatare

Vendbanimet fshatare janë më të shumta e më të dëndura në luginën e Vjosës dhe të Drinos. Në zonat kodrinore e sidomos në ato malore, vendbanimet rrallohen e zvogëlohen. Duke u nisur nga kushtet gjeografike, dallohen fshatra fushore, kodrinore dhe malore.
Fshatrat fushore janë të përqendruara. Fshatrat kodrinore janë më të vogla, ndërsa fshatrat malore janë të vendosura në reliev të thyer, me ofertë shumë të paktë për toka të punueshme, janë të rralla. Kohët e fundit, popullsia e tyre u zvogëlua shumë, kurse disa fshatra janë shpopulluar. Banesat tradicionale fshatare kanë arkitekturë të veçantë, përgjithësisht shtëpi dy katëshe të ndërtuara me gurë dhe çati me dërrasa guri.

Vendbanimet qytetare

Qarku ka 6 qytete: Gjirokastra, Tepelena, Përmeti, Këlcyra, Memaliaj dhe Libohova. Krijimi i tyre u bë në afërsi të kështjellave (Gjirokastër, Tepelenë, Libohovë, Këlcyrë) dhe pranë objeketve industriale Memaliaj (Qymyrguri).
Qytetet sipas funksioneve ndahen në: qytete komplekese (Gjirokastra), industrialo-bujqësore (Përmet, Këlcyrë, Memaliaj), bujqësore (Libohovë), administrative–ekonomik (Tepelenë).
Qytetet kanë tradita të pasur kulturore, që u japin atyre vlera të mëdha turistike.

POPULLSIA E QARKUT (Sipas Regjistrit të Gjendjes Civile 1 Janar 2021)

NR	EMËRTIMI NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE	POPULLSIA	NR.FAMILJEVE
1.	**BASHKIA GJIROKASTËR**		
-	Njësia Administrative Gjirokastër	33652	11.671
-	Njësia Administrative Lazarat	3.466	964
-	Njësia Administrative Cepo, Picar	6.177	1.934
-	Njësia Administrative Lunxhëri, Odrie, Antigone	8.580	2.489
	TOTAL	**51.875**	**17.058**
2.	**BASHKIA DROPULL**		
-	Njësia Administrative Dropulli Poshtëm	9.302	2.842
-	Njësia Administrative Dropulli Sipërm	10.278	3.181
-	Njësia Administrative Pogon	3.028	956
	TOTAL	**22.608**	**6.979**
3.	**BASHKIA LIBOHOVË**		
-	Njësia Administrative Libohovë, Qendër, Zagori	**7.043**	**2.282**
	TOTAL	**7.043**	**2.282**
4.	**BASHKIA TEPELENË**		
-	Njësia Administrative Tepelenë	7.614	2.866
-	Njësia Administrative Qendër Tepelenë, Kurvelesh, Lopës	8.082	2.540
	TOTAL	**15.695**	**5.406**

5.	**BASHKIA MEMALIAJ**		
-	Njësia Administrative Memaliaj	6.325	2.514
-	Njësia Administrative Fshat- Memaliaj	2.629	848
-	Njësia Administrative Krahës, Qesarat	6.275	2.023
-	Njësia Administrative Luftinjë, Buz	4.637	1.552
	TOTAL	**19.866**	**6.937**
6.	**BASHKIA PËRMET**		
-	Njësia Administrative Përmet	9.703	3.776
-	Njësia Administrative Çarshovë	2.814	907
-	Njësia Administrative Petran	3.048	986
-	Njësia Administrative Piskovë, Frashër	3.707	1.327
	TOTAL	**19.272**	**6.996**
7.	**BASHKIA KËLCYRË**		
-	Njësia Administrative Këlcyrë	5.026	1.819
-	Njësia Administrative Dëshnicë	2.397	827
-	Njësia Administrative Sukë	2.518	896
-	Njësia Administrative Ballaban	1.949	712
	TOTAL	**11.890**	**4.254**
	TOTAL QARKU GJIROKASTËR	**148.250**	**49.912**

Tabelat sipas censusit 2011 , me popullsinë e qarkut sipas grup moshave , shtetësisë , gjinisë , përkatësisë etnike , kulturore , fetare dhe gjëndjes së aftësisë kufizuar shiko shtojcën D

2.9 EKONOMIA

Bujqësia : Në prodhimin e përgjithshëm bujqësor të qarkut, vendi kryesor i takon degës së bujqësisë. Prodhimet bujqësore sigurohen në fushat pjellore të luginës së Vjosës e Drinos. Vendin kryesor e zë blektoria e cila jep mbi gjysmën e prodhimit bujqësor. Kjo degë po zhvillohet më tej, sepse po rritet kërkesa për prodhimet blektorale sidomos nga turizmi. Sipërfaqa e tokës bujqësore zë rreth 15% të sipërfaqes së përgjithshme. Pjesa më e madhe e tokave të punueshme është e kultivuar me bimë të arave sidomos me drithëra. Vend të rëndësishëm zë kultivimi i perimeve, sipërfaqa e të cilave është rritur vazhdimisht për furnizimin e tregut të qyteteve dhe tregun turistik gjithnjë në rritje. Po kështu zhvillim ka marë kultivimi i vreshtarisë si dhe kultura të tjera të drunjta. Qarku ka traditë në mbarështrimin e blektorisë. Vitet e fundit pesha e saj në prodhimin e përgjithshëm bujqësor është rritur vazhdimisht.

Industria : Gjenden këto degë të industrisë:

Industria e materialeve të ndërtimit përbëhet nga nxjerrja e pllakave të gurit, mermerit, shfrytëzimi i argjilave për tulla, rërave etj.

Industria ushqimore përpunon prodhimet bujqësore dhe blektorale. Ajo pothuajse gjendet në të gjitha qytetet e qarkut. Dallohen fabrikat e përpunimit të qumështit, të miellit, të pijeve dhe përpunimi i ujit minerar të Glinës, Tepelenës, Buretos, Trebeshinës etj.

Industria e lehtë përfaqësohet nga veshjet (Fasoneritë në qytetet Gjirokastër e Përmet).

Kjo industri në kushtet e ekonomisë së tregut ka prirje për t'u zhvilluar me ritme të shpejta.

Artizanati ka traditë të lashtë në punimin e leshit, gurit, drurit, metaleve etj.

Transporti përbëhet nga transporti automobilistik për mallra e udhëtare, ku nëpërmjet Kakavijes dhe Tri Urave lidhet me Greqinë.
Mjetet rrugore për pasagjerë kanë një shpërndarje gjeografike në të gjithë territorin e qarkut Gjirokastër, i cili ka rritjen më të madhe të numrit të mjeteve për pasagjerë, llogaritur me 49 mjete për 1000 banorë.
Mjetet e transportit rrugor të pasagjerëve,

Tabela 1

QARKU	GJITHËSEJ	AUTOVETURA	AUTOBUZ MIKROBUZ	MOTOÇIKLETA TRIÇIKLETA
GJIROKASTËR	10 . 122	9 . 791	175	156

Mjetet e transportit rrugor të mallrave

Tabela 2

QARKU	GJITHËSEJ	KAMIONA DHE TRAKTOR	MAKINERI BUJQËSORE	RIMORKIO	MAKINERI TEKNOLOGJIKE
GJIROKASTËR	2 . 580	2 . 301	25	247	7

Turizmi është dega që po merr zhvillim. Kjo lidhet me kushtet e mira për zhvillimin e disa llojeve të turizmit si: blu, qytetar, të gjelbërt, malor dhe fetar.
Turizmi qytetar zhvillohet në të ghitha qytetet sidomos në qytetin – muze të Gjirokastrës i cili ka arkitekturën e veçantë të banesave të gurta, me vendosjen e përgjithshme, me objektet e shumta historike si kështjella, muzeu i armëve etj.
Turizmi i gjelbërt zhvillohet në zonat fshatare. Ai lidhet me traditën e pasur të mikëpritjes dhe me nivelin kulturor të popullsisë.
Turizmi malor ka kushte për t'u zhvilluar në lartësitë e maleve të Kurveleshit, Nemërçkës, Çajupit, Lunxhërisë etj.

Ndërmarrjet
Mbizotërimi i grupit të prodhuesve të shërbimeve është dukuri në të gjitha bashkitë e qarkut Gjirokastër.
Ndërmarrjet e përbashkëta (shqiptare dhe të huaja) kanë aktivitete ekonomike si tregti me shumicë i cili është aktivitet ku pronarët / bashkëpronarët janë të huaj. Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta janë përqëndruar në Gjirokastër, Tepelenë e Përmet. Njësitë lokale janë të pranishme në të gjitha bashkitë.
Aktiviteti ekonomik tregtar mbizotëron ndaj aktiviteteve të tjera. Ky fenomen është i njëjtë si në nivel qarku ashtu dhe bashkie.
Shënim : Ndërmarrjet aktive sipas bashkive , formës ligjore dhe madhësisë dhe pronësisë , shiko **shtojcën D**

Pyjet dhe kullotat
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Qarkut Gjirokater, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5 i këtij Ligji ku shprehimisht thuhet : Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë,

zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit pika 5. administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.
Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor dhe kullosor është ligji nr 9385/2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9385/2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kështu në administrim të Bashkive kalon fondi pyjor/ kullosor i bazuar në VKM nr 433 dt 08.06.2016 " Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike , sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive" pika 48.
Në sistemin natyror pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e qarkut, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhike.
Territoti i qarkut dallohet për katëzimin vertikal të bimësisë së shprehur në praninë e **katër brezave fitoklimatike: brezi shkurreve mesdhetare, brezi dushkut, brezi bredhit dhe brezi kullotave alpine.**
Karakteristike është se ekspozimi i ndryshëm i shpateve kundrejt masave ajrore të ndryshme shkakton shmangie të kufijve të tyre dhe ndërthurje të llojeve me ato të lartësive. Në shpatet jugore e perëndimore më të ngrohtë të maleve, kufinjtë ngjiten më lart se në shpatet lindore e veriore.
Brezi i shkurreve mesdhetare përfshin territore më të ulta të maleve dhe luginat deri në lartësinë **600 m**. Ky brez duket qartë në Grykën e Këlcyrës, Grykën e Suhës dhe rrjedhjen e përrenjve të Mezhgoranit dhe të lumit të Zagories.
Brezi i dushkut është brezi më i rëndësishëm pyjor, ka shtrirje në drejtim **horizontal d**he atë **vertikal d**he zë **80 %** të sipërfaqes së zonës. Llojet më të përhapura të dushkut janë shparthi dhe qarri. Ky brez fillon nga **800 - 900 m** deri në **1000 - 1300 m** mbi nivelin e detit. Në disa sektorë si në Grykën e Selckës ky brez shtrihet nga **550 - 1300 m,** kurse tek pylli i Mavrojerit arrin deri **1500 m.** Pllaja e Hllomosë është e pyllëzuar me qarr dhe arrin lartësinë **1450 m.**
Brezi bredhave mesdhetarë formohet nga bredhi i Maqedonisë që në lartesitë **1000-1700 m**, zë vendin e ahut. Ahu në këtë zonë nuk rritet me përjashtim të një masivi në zonë në faqen verilindore. Bredhi është pak përhapur kryesisht në formë vatrash pa formuar masive të vërtetë. Këtë e shohim ne parkun Kombetar **" Bredhi Hotoves "** Permet , mund ta shohim tek **Shkëmbi i Zhejit** (Mali Lunxhërisë) me një sipërfaqe të kufizuar. Më shpesh duket në faqet lindore të **Malit të Nemërçkës**, në fshatin Kaludh dhe në Petran (Permet) ku ai zbret shumë poshtë duke u përzier me brezin e shkurreve.
Brezi i kullotave alpine përfaqëson brezin bimor më të lartë në zonë nga **1500 - 1700 m** deri në **2400 m**. Bimësia barishtore është mbizotëruese në vargmalet: Trebeshinë - Dhëmbel - Nemërçkë dhe Shëndëlli - Lunxhëri - Bureto po ashtu edhe në Malin e Gjerë, Malin e Leftokaresë dhe atë të Muzinës.
Bashkite ,njësitë Administrative nevoitet që nëpërmjet planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave mund ti ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha ku ka aktivitete të punimeve pyjore. NjA-të, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drunjëve të lartë mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.
Referuar vendimit të mësipërm , të dhënat e fondit pyjor/kullosor qe kanë kaluar në pronësi dhe administrim nga bashkite janë: të kombinuara së bashku mbulojnë 64% të tokës së qarkut të Gjirokastrës.
Kullotat janë të paçmueshme si një burim ushqimi për blegtorinë dhe gjithashtu për rreth 120 llojet e bimëve medicinale të qarkut. Shumica e zonës pyjore gjendet në bashkinë e Përmetit, që përmban edhe pjesëm më të madhe të pyjeve malore dhe tokës së mbuluar, i ndjekur nga Bashkia e Gjirokastrës. Bashkia e Gjirokastrës ka shumicën e pyjeve të tokave të ulëta. Bashkia e

Tepelenës, në mënyrë domethënëse, në gjithë qarkun ka më pak pyje malore, pyje fushore dhe tokë shkurrore.

Shënim : Sipërfaqet pyjore , kullosore sipas bashkive , nj.ad dhe Zonat e Mbrojtura shiko në **shtojcën D**

3. SKENAREËT E RISKUT

3 . 1 METODOLOGJITË

Në aspektin e rreziqeve natyrore, koncepti i *riskut të fatkeqësive* i referohet *"humbjes së mundshme të jetës, lëndimit, pasurive të shkatërruara apo të dëmtuara që mund t'i shkaktohen një sistemi, shoqërie apo komuniteti në një periudhë të caktuar kohore, që përcaktohet me shumë gjasë si funksion i rrezikut, ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit"* [UNISDR, 2009]. Kur ka ndodhur vërtetë një situatë rreziku, që ka shkaktuar dëme dhe shqetësime, ne flasim për *fatkeqësi*: një fatkeqësi është ndodhja e riskut

Matrica për vlerësimin e rrezikut të fatkeqësive dhe emergjencave ndihmon për identifikimin e (llojeve) fatkeqësive dhe emergjencave, mundësinë e ndodhjes së tyre, vulnerabilitetin dhe rrezikun me qëllim identifikimin e rreziqeve prioritare (më të mundshëm për të ndodhur). Fatkeqësitë/emergjencat mund të jenë "natyrore" dhe/ose "të ndikuara nga njeriu".

Fatkeqesia / Emergjenca A	Propabiliteti B	Vulnerabiliteti Impakti C	Përqindja e rrezikut D	Niveli rrezikut E	Prioriteti F
	1=sh.ulet – 5=sh.e larte	1=E pa rendësishme – 5 =Sh. E lartë	B x C	Sh. E ulet – Sh. E larte	E ulet – E larte
Zjarr ne pyje	5	4	5 x 4 = 20	Sh. E larte	I larte

Udhëzime për plotësimin e tabelës (shembull për zjarret në pyje)

Kolona A: Identifikimi i emergjencave

Identifikimi bëhet për të gjitha emergjencat dhe fatkeqësitë nga të cilat mund të rrezikohet komuniteti në gjithë teritorin e bashkisë.

Kolona B: Vlerësohet mundësia e ndodhjes së një fatkeqësie ose emergjencës

Në kolonën B, vendoset mundësia e ndodhjes për secilën fatkeqësi ose emergjencës, duke iu referuar shkallës nga 1deri në 5, ku:

Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4	Shumë e lartë 5

Kolona C: Vulnerabiliteti/shkalla e ndikimit

Në kolonën C, vendoset shkalla e ndikimit të secilës prej emergjencave nga 1deri në 5, ku 1 = e parëndësishme dhe 5 = Sh. E lartë (katastrofike). Kur vlerësohet shkalla e ndikimit, merren në konsideratë të gjitha humbjet me të cilat është përballur komuniteti në teritorin e qarkut . Ndikimi nuk përfshin vetëm humbjen e jetës dhe dëmtimin e aseteve. Disa prej ndikimeve mund të jenë:

- **Njerëzore:** vdekjet, dëmtimet, paaftësia
- **Fizike:** dëmtime të ndërtesave, pajisjeve
- **Socio-kulturore:** humbje e shkatërrim i trashëgimisë kulturore

• **Ekonomike:** kosto e riparimeve
• **Mjedisore:** humbje e burimeve natyrore
• **Psikosociale:** traumë nga humbjet, humbje e shpresës
• **Arsimore:** ndërprerje e mësimit, etj.

Kolona C: Vulnerabiliteti/shkalla e ndikimit

E pa rendësishme 1	E vogël 2	Mesatare 3	E lartë 4	Shumë e lartë 5

Kolona D: Shkalla e rrezikut.

Për të përcaktuar shkallën e rrezikut (kolona D), shumëzohet propabiliteti i emergjencës (kolona B) me shkallën e ndikimit të vulnerabilitetit (kolona C).

Shkalla e rrezikut (kolona D)	**Niveli rrezikut (kolona C)**
1 - 3	Shume e ulet
4 - 8	E ulet
9 - 14	E mesme
15 - 19	E larte
20 - 25	Shume e larte

Interpretimi dhe përdorimi i rezultateve :
Pas plotësimit të matricës së rrezikut të emergjencave, ju duhet ta keni situaten ku behet më e qartë në lidhje me emergjencat dhe fatkeqësitë e mundshme me të cilat mund të përballet qarku . Hapi tjetër në vazhdim ka të bëjë me identifikimin e vulnerabilitetit dhe masave për zbutjen e pasojave, në mënyrë që të përfshihen në planin e veprimit.

Procedurat e vleresimit te rrezikut (Metoda e Kinit)

Gjasat	**Piket**	
Ë	0.1	Shume e larte
Ë	0.2	Praktikisht e pa mundur
Ë	0.5	E mundshme , por pa gjasa
Ë	1	E pa mundshme
Ë	3	E mundshme
Ë	6	Shume e mundshme

Periudha e rrezikut (Pr)	**Piket**	**Mundesia , ndodhja**	**Koha**
B	0.5	Shume e rralle	Nje here ne vit ose me pak
B	1	E rralle	Disa here ne vit
B	2	E jashtezakonshme	Nje here ne muaj
B	3	E rastit	Nje here ne jave
B	3	E shpeshte	E perditshme
B	10	E vazhdueshme	E perhershme

Pasojat (P)	**Piket**	**Demet**
E	1	Deme te paperfillshme
E	3	Deme te lehta

E	7	Deme te medha
E	15	Fatale 1 i vdekur
E	40	Fatkeqesi me me shume se 1 te vdekur

R = Gj x P x Pr = Rezultati i rrezikut dhe aktiviteti korrigjues

R = < 20	Vëmendja jo e nevojshme
20 < R < 70	Vëmendje e nevojshme
70 < R < 200	Veprim i nevojshëm
200 < R < 400	Veprim korrigjues i nevojshëm
R > 400	Ndërprerje e aktiviteteve

Fatkeqësitë vlerësohen (llogariten) duke i shumëzuar pasojat e mundshme të rrezikut me gjasat e ndodhjes dhe periudhës së rrezikut

Rr = GJ x P x Pr = Rezultati i rrezikut dhe aktiviteti korrigjues

- Për qëllime të planifikimit emergjent rreziku llogaritet në mënyr mjaft të thjesht:

Rr = GJ x P x Pr

- Rr – është rreziku
- Gj – Gjasa për ndodhje të rrezikut
- P – Pasoja
- Pr – Periudha e rreziku



3. 2 PROCESI PËRGJITHSHËM PËR PËRCAKTIMIN E SKENARËVE TË RISKUT

Në terma të përgjithshme, në fillim të procesit të vlerësimit të riskut duhet të ngarkohet një autoritet me detyrën e koordinimit të punës; në nivelin e marrë parasysh në këto udhëzime, ky është roli i natyrshëm për prefekturën. Procesi duhet të kërkojë edhe ngritjen e një sërë grupesh pune për llojet e ndryshme të rreziqeve natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu dhe përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit (si reaguesit e parë, operatorët e transportit); mund të përfshihen edhe përfaqësues të bashkive. Procesi i përgjithshëm i vlerësimit të riskut siguron një bazë të dakordësuar për prioritetet në planifikimin e emergjencave, që e lehtësojnë këtë koordinim.

Për vlerësimin e riskut do të ngrihen këto grupe pune :

- Grupi punës për vlerësimin e rrezikut nga tërmetet
- Grupi i punës për vlerësimin e rrezikut nga përmbytjet
- Grupi i punës për vlerësimin e rrezikut nga zjarret
- Grupi i punës për vleresimin e rreziqeve të tjerë

Të gjitha palët e përfshira në procesin e vlerësimit të riskut duhet të:

- ✓ bien dakord për kriteret e pikëzimit në fillim të procesit të vlerësimit,
- ✓ regjistrojnë metodat e përdorura dhe nivelin e tyre të pasigurisë,
- ✓ shënojnë arsyet për përfshirjen ose përjashtimin e risqeve të veçanta,
- ✓ regjistrojnë pikët e shpërndara për secilin risk dhe arsyet për to,
- ✓ hartojnë një protokoll për përdorimin e opinioneve nga ekspertë.

Masat e mëposhtme duhet të shoqërojnë procesin e vlerësimit të riskut:

- Publikimi i skenarëve të riskut të mundshëm për informimin e popullsisë rreth masave përgatitore në nivel prefekture për emergjencat dhe për ofrimin e këshillave se si mund të përgatitet më mirë publiku i gjerë;
- Informacion për palët e interesit dhe publikun e gjerë lidhur rreziqet e veçanta që ata hasin, nëpërmjet shpërndarjes së hartave të rrezikut.

Për qëllime të përcaktimit të skenarëve të riskut për menaxhimin e emergjencave, ndikimet më të rëndësishme që duhen vlerësuar janë NDIKIMI NJERËZOR, i shprehur si numri i vdekjeve, numri i personave të lënduar apo të sëmurë, dhe numri i personave të zhvendosur përgjithmonë që lidhen me skenarin e dhënë. Në këtë nivel informacioni, prefektura mund të zgjedhë të shtojë tregues që lidhen me:

- Tregues ekonomikë dhe mjedisorë;
- Ndikime politike/sociale.

Ndikimet duhet të paraqiten (ose të paktën duhet të jenë në dispozicion) të ndara për kategoritë e ndryshme të ndikimit, edhe pse ato mund të kombinohen apo bashkohen për qëllime të caktuara. Matricat e riskut duhet të jenë në dispozicion në format të veçantë, p.sh. matrica të ndara për secilën kategori të ndikimit.

Një matricë e riskut që lidh dy dimensione, mundësinë dhe ndikimin, është një paraqitje grafike e rreziqeve të ndryshme në mënyrë krahasuese. Matrica përdoret si një mjet vizualizimi kur identifikohen rreziqe të shumta, me qëllim lehtësimin e krahasimit të rreziqeve të ndryshme. Matricat e riskut përdoren edhe për të përcaktuar se cilat rreziqe kanë nevojë më analizë të mëtejshme apo më të detajuar, ose se cili risk i dhënë konsiderohet gjerësisht i pranueshëm apo i papranueshëm, sipas zonës ku ndodhet në matricë.

Megjithëse ka mënyra të ndryshme të ndarjes së procesit të vlerësimit të riskut në një sërë hapash logjikë, kryesisht në varësi të roleve të aktorëve të ndryshëm të përfshirë, për qëllimin e këtyre udhëzimeve, procesi i përgjithshëm i vlerësimit të riskut duhet të përfshijë të paktën tre hapat e mëposhtëm: (1) identifikimi i riskut, (2) analiza e riskut, (3) vlerësimi i riskut.

3.2.1 IDENTIFIKIMI I RISKUT

Identifikimi i riskut është procesi i zbulimit, njohjes dhe përshkrimit të rreziqeve. Ai është një ushtrim ekzaminues dhe shërben si një hap paraprak për fazën vijuese të analizës së riskut. bazohet shumë në të dhëna sasiore (historike, statistikore).
Identifikim i riskut përfshin zakonisht zhvillimin e **skenarëve** të situatave të riskut të mundshëm, të cilat përmbledhin fushën e mundësive në një numër të kufizuar situatash të identifikuara. Skenarët e riskut janë një përshkrim i besueshëm se çfarë mund të ndodhë në të ardhmen. Skenarët duhet të bazohen në një sërë supozimesh koherente dhe të vazhdueshme të brendshme për marrëdhëniet kyçe dhe forcat shtytëse. Duhet të përzgjidhet vetëm një numër i kufizuar skenarësh, p.sh. duke iu referuar disa standardeve, si ai i "rastit më të keq të arsyeshëm". Në fazën e identifikimit të riskut, zhvillimi i skenarëve mund të formulohet në mënyrën më përfshirëse dhe mund t'i referohet vlerësimeve të përafërta apo analizës cilësore
REZULTAT: Listimi i rreziqeve të ndryshme të identifikuara dhe skenarëve të riskut që do të analizohen me më shumë detaje në fazën pasardhëse.



Klasifikimi i katastrofave natyrore

Grupi	Tipi	Nën-Tipi
Gjeofizike	Tërmet	Lekundje Toke
		Tsunami
	Vullkan	Shperthim vullkanik
		Rënie shkëmbinjsh

	Rrëshkitje masive (e thatë)	Ortek
		Rrëshkitje dheu (baltë, gurë)
		Fundosje e tokës
Meteorologjike	Stuhi	Stuhi tropikale (uraganë, tajfunë)
		Ciklon ekstra-tropikal (stuhi dimri)
		Stuhi lokale (rrufe, stuhi dëbore, stuhi rëre, tornado, etj)
Hidrologjike	Përmbytje	Përmbytje nga lumenjtë
		Përmbytje e shpejtë (inondata)
	Rrëshkitje masive (e lagësht)	Valë nga stuhia/përmbytje detare
		Rrëshkitje dheu nga erozioni (baltë e lagësht)
		Rënie shkëmbinjsh të lagur (erozion shkëmbinjsh)
		Fundosje e tokës
		Ortek
Klimatologjike	Temperatura ekstreme	Valë të nxehti
		Valë të ftohti (ngricë, borë)
		Kushte ekstreme në dimër (akull, breshër, etj)
	Thatësirë	Thatësirë
	Zjarr natyror	Zjarr në pyje
		Zjarr në tokë
Biologjike	Epidemi	Infeksione virale
		Infeksione bakterologjike
		Infeksione parazitike
		Infeksione kërpudhash
		Infeksione prionike
	Infektim insektesh	Karkaleca/krimba
	Tufë kafshësh	-
Jashtetokesore	Meteorite/Asteroide	-

Tabela e klsifikimit të rreziqeve në teritorin e Qarkut Gjirokastër .

Nr	Lloji rrezikut	Mundesia e ndodhjes	Efekti	Frekuenca e ndodhjes
1.	Permbytjet , Vershimet	Shume e mundshme	I ulet	Mbi 50 % vitin e ardhshem
2.	Zjarret pyjre	Shume i mundshem	I mesem	80 – 100 % vitin e aedhshem
3.	Zjarr ne objekte banimi	Shume i mundshem	I mesem	75 – 90 % vitin e ardhshem
4.	Zjarr ne stacine karburanti	I mundshem	I larte	Deri ne 10 % ne 10 vitet e ardhsheme
5.	Termetet	Ka mundesi	Katastrofik	1-10 % ne 10 vite ose nje ndodhje ne 100 vjet
6.	Stuhite	I mundshem	I ulet	20 – 30 % ne 10 vitet e

				ardhshme
7.	Erozioni	Ka mundesi	I mesem	10 – 100 % nje mundesi ne 10 vjet
8.	Epidemite	I mundshem	I mesem	10 – 100% nje mundesi ne 10 vjet
9.	Bora	I mundshem	I ulet	10 – 100 % ne 10 vitet e ardhshme
10.	Thatesite	Ka mundesi	I ulet	10 – 100 % nje mundesi ne 20 vjet

3.2.2 ANALIZA E RISKUT

Analiza e riskut është procesi për të kuptuar natyrën e riskut dhe për të përcaktuar nivelin e tij. Për çdo risk dhe skenar risku të identifikuar në fazën e mëparshme të identifikimit të risku, nëpërmjet procesit të analizës së riskut kryhet një vlerësimin i detajuar i probabilitetit të ndodhjes së tij dhe shkalla e rëndësisë së ndikimeve të mundshme.
Sa herë që është e mundur, analiza e riskut duhet të bazohet në të dhëna sasiore:

- Kur është e mundur, vlerësimi i probabilitetit të një ngjarjeje apo rreziku duhet të bazohet në shpeshtësinë historike të ngjarjeve me shkallë të ngjashme dhe në të dhënat statistikore përkatëse në dispozicion për një analizë të forcave kryesore shtytëse, që mund të ndihmojnë në ndjekjen e prirjeve përshpejtuese, p.sh. për shkak të ndryshimeve klimatike.

- Vlerësimi i nivelit të ndikimit duhet të bëhet në terma sasiorë.

Rreziqet e ndryshme natyrore kërkojnë analiza shumë të ndryshme, si p.sh. në krijimin e mundësisë së ndodhisë së tyre dhe nivelin e ndikimeve të mundshme; metodat kuantifikimit të riskut bazuar në praktikat e mira duhen përdorur sa herë që është e mundur.
Pavarësisht përdorimit të rekomanduar të praktikës së mirë, faza e analizës së riskut duhet të trajtojë analizën e rrezikut, ekspozimit dhe cenueshmërisë. Analiza e rrezikut duhet të mbulojë elementet e mëposhtme:

- Analizën gjeografike (vendndodhja, madhësia)
- Analizën e përkohshme (frekuenca, kohëzgjatja, etj.)
- Analizën dimensionale (shkalla, intensiteti)
- Probabiliteti i ndodhisë.

Analiza e ekspozimit duhet të përqendrohet në identifikimin e elementeve mundësisht në risk, me fokus të veçantë te:

- Popullsia, duke identifikuar me shumë gjasë edhe grupet e cenueshme ose personat me nevoja të veçanta;
- Zonat e ndërtuara, me shumë gjasë së bashku me identifikimin e godinave të veçanta, si godinat që i përkasin sistemit të menaxhimit të emergjencave, spitalet ose qendrat e tjera mjekësore, qendra të tjera të grumbullimit;
- Rrjetet e transportit dhe shërbimet e tjera përkatëse në zonë;
- zonat e mbrojtura ose asetet e tjera mjedisore.

Të gjitha këto asete duhet të karakterizohen, në shkallën e duhur, nga faktorët e cenueshmrëisë që lidhen me ndikimet e mundshme (fizike, ekonomike, mjedisore, sociale/politike). Gjithashtu,

duhet kryer edhe analiza e kapaciteteve të vetëmbrojtjes që redukton ekspozimin apo cenueshmërinë.
Integrimi i këtij informacioni duhet të mundësojë vlerësimin e ndikimeve të mundshme. Mjetet softëare, si sistemi i mbështetjes së vendimeve për hartëzimin e skenarëve të rreziqeve të shumta, mund të përdoren dhe lehtësojnë vizualizimin dhe informimin, dhe menaxhimin e skenarëve.
Analizat e riskut duhet të marrin në shqyrtim skenarët me risk të vetëm dhe ata me rreziqe të shumta, dhe duhet të përmbledhin si duhet rreziqet nga rreziqet e shumta natyrore, por duke pasur në dispozicion edhe rezultatet e kategorive të ndryshme të ndikimit, ndërsa analiza duhet kryer veçmas për secilën kategori ndikimi.
REZULTATI: renditja e skenarëve të përzgjedhur të riskut që karakterizohen nga mundësia e ndodhisë dhe niveli përkatës i ndikimit.

Krijimi i profilit të rreziqeve

Vlerësimi i rreziqeve përcakton çështjet si:

- Çfarë mund të ndodh?
- Sa shpesh mund të ndodh?
- Dëmi që ka mundësi të shkaktohet?
- Sa ka mundësi të ndikojë në komunitet?
- Sa është i cenueshëm komuniteti ndaj rrezikut?

Pesë hapat e procesit të analizimit të rrezikut janë:

- Identifiko rrezikun.
- Profilizo secilin rrezik.
- Ndërto profilin e komunitetit.
- Përcakto cenueshmërinë.
- Krijo dhe apliko skenarët

Format standarde për vlerësimin e rreziqeve

A) FREKUENCA E NDODHJES:

- **Shumë e mundshme** : Mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm.
- **E mundshme** : Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm, ose së paku nëmundësi , në 10 vitet e ardhshme.
- **Ka mundësi** : mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një shans në 100 vitet e ardhshme.
- **E pamundshme**: Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme.
- **Tepër e pamundshme**: Mundësia një herë në 500 vjet.

B) EFEKTI GODITES NE KOMUNITET

NIVELI RREZIKUT	KARAKTERISTIKAT
SHUME E LARTE	▪ Vdekje të shumëllojshme ▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për 30 ditë apo më shumë. ▪ Më shumë se 50% e të mirave materiale të dëmtuara rendë.

E LARTE	▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet rezultojnë në paaftësi të përhershme. ▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 2 javë. ▪ Më shumë se 25% e të mirave materiale të dëmtuara rendë
E MESME	▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme. ▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku nje jave. ▪ Më shumë se 15% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë
E ULET	▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme dhe ndihmes se pare ▪ Humbje e vogel e standartit te jeteses ▪ Nderprerja e objekteve /sherbimeve per 24 ore e me pak ▪ Me pak se 10% e te mirave material te demtuara rende

C) PROFILI DHE FAKTORET KYC TE KMUNITETIT

Gjeografik	Demografik	Te mirat materiale	Infrastruktura kritike	Objektet e rendesise vecante
Tiparet e mëdha gjeografike Modelet tipike meteorologjike	Madhësia e popullatës,shtrirja/sh përndarja, përqendrimet Numri i njerëzve në zonat e cenueshme Popullatat e veçanta Kafshë	Numrat Llojet Vjetërsia Rregullat endërtimit Rreziqet e mundshme dytësore	Sistemi i Uji të pijshë Energjia Depot ushqimore Mullinjtë Kanalizimet	Shkolla , kopeshte Spitalet Ndërtesat qeveritare Ndërtesat publike Ndërtesat industriale Pikat e karburanteve
Telekomunikacioni	Trashëgimia kulturore	Mjedisi	Humbjet ekonomike	
Rrugë Urat/Tunelet Hekurudha . Aeroporti . Posta dhe telekomunikimi	Vendet arkeologjike Muzetë Vlerat historike dhe kulturore	Toka Uji Ajri	Sipas klasifikimit	

Pasojat e mundshme dhe kualifikimi i tyre. Kualifikimi i pasojave dhe probabilitetit

Nr	**NIVELI RREZIKUT**	**Pasojat per jete dhe shendete (J)**
1.	I ULET	Nje dem i rende , paaftesi e perkohshme
2.	MESATAR	Nje vdekje , disa lendime serioze
3.	I LARTE	Disa vdekje (< 5), disa lendime serioze deri

		ne 20 , deri ne 500 te evakuar
4.	SHUME I LARTE	Disa vdekje (< 5), disa lendime serioze deri ne 20 , deri ne 500 te evakuar

Nr	NIVELI RREZIKUT	Pasojat per pronat (P), ose nderprerja(N) – harxhimet totale te demeve ne lek
1.	I ULET	< 250 000
2.	MESATARE	250 000 – 2 500 000
3.	I LARTE	2 500 000 – 5 000 000
4.	SHUME I LARTE	5 000 000 – 10 000 000

3.2.3 VLERESIMI RISKUT

Vlerësimi i riskut është procesi i krahasimit të rezultateve të analizës së riskut me kriteret e riskut për të përcaktuar nëse risku dhe/ose magnituda e tij është e pranueshme apo e tolerueshme. Kriteret e riskut janë termat e referencës kundrejt të cilëve vlerësohet rëndësia e riskut. Kriteret e riskut mund të përfshijnë kostot dhe përfitimet që lidhe me to, kërkesat ligjore, faktorët socioekonomikë dhe mjedisorë, shqetësimet e palëve të interesit, etj. Vlerësimi i riskut përdoret për të marrë vendime rreth rëndësisë së rreziqeve nëse secili risk specifik duhet pranuar apo trajtuar.
Për qëllime të menaxhimit të emergjencave, në këtë fazë ndiqet edhe identifikimi i aseteve/sektorëve më të rëndësishme; kjo mund të ndihmojë në hapat e mëposhtëm të planifikimit të emergjencave, posaçërisht për përcaktimin e masave parandaluese apo reaguese.
REZULTATI: Listë me prioritetet e skenarëve të riskut, ku secili shoqërohet me një listë asetesh/sektorësh të rëndësishëm, që karakterizohen lidhur me nevojat.

- Një seri e tretë hartash duhet të tregojnë shpërndarjen hapësinore të cenueshmërisë lidhur me ndjeshmërinë ndaj dëmit për të gjitha çështjet përkatëse të mbrojtjes (në harta të veçanta për çështje të ndryshme të mbrojtjes).
- Në një fazë të dytë, këto harta mund sigurojnë më pas edhe bazën për përgatitjen e hartave të riskut lidhur me paraqitjen e kombinimit të mundësisë dhe ndikimit të një ngjarjeje të caktuar, si dhe për hartat e përmbledhura të rrezikut.

3.5. A) RREZIQET NGA TËRMETET

Referenca historike

Shqipëria shtrihet në brezin sizmik alpin-mesdhetar, që përfshin zonën e kontaktit ndërmjet pllakave litosferike të Afrikës e të Eurazisë, e cila shtrihet nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të pellgut të Mesdheut. Pjesa më aktive e saj është deti Egje dhe rajoni përreth. Në këtë rajon (33-43ºV, 18-30ºL), që karakterizohet nga rënia pothuaj vjetore e një tërmeti me Ms ≥ 6,5, ndodhen: Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv (1.0<M<M<M7.0). Përplasja e pllakës së Adrias dhe Albanideve është shkaku kryesor i tërmeteve në vendin tonë.Vatrat e tërmeteve të Shqipërisë përqendrohen kryesisht përgjatë shkëputjeve tektonike active
Harta e shkëputjeve aktive në Shqipëri përcakton tri zona shkëputjeje aktive gjatësore dhe dy tërthore. **Qarku Gjirokaster** ndodhet ne zonen e shkeputjes me mbihipje Joniane- Adriatike qe

shtrihet ne drejtimin VP – VVP (Bregu Detit- Zona e Kurveleshit) dhe ate terthore Vlore – Tepelene – Erseke.



Zona tërthore Vlorë – Tepelenë - Ersekë është aktivizuar së fundmi duke përfshirë vendin nga lëkundje të njëpasnjëshme, zanafilla e të cilës ka nisur në muajin maj 2006. Nga data 6 gusht 2006 e deri me 9 gusht 2006 u regjistruan 161 ngjarje sizmike në këtë zonë. Në datën 7 gusht 2006 ka pasur 70 lëkundje, në datën 8 gusht 2006, 76 dhe në datën 9 gusht 2006regjistrohen 15 tërmete.

Vija Vlorë-Tepelenë-Ersekë sipas specialistëve të Sizmikës, klasifikohet ndër zonat me periodicitetin më të lartë të lëkundjeve në histori. Duke iu referuar periodicitetit të lëkundjeve maksimale të regjistruara në këtë vijë problematike, sipas specialistëve një herë në 30 vjet këtu regjistrohen tërmete deri në 9 ballë, ku i fundit u regjistrua në 1968 në fshatin Nivice . Kështu, në Tepelenë me 20 nëntor 1920 një tërmet me 8 ballë shkaktoi 36 viktima dhe 102 të plagosur, shkatërroi 2 500 shtëpi dhe la pa strehë 15 000 vetë. Dhjetë vjet më pas në Vlorë dhe Tepelenë regjistrohet një tjetër tërmet, që shkaktoi 30 të vdekur dhe 100 të plagosur. Sipas specialistëve, dhjetëra tërmete të tjerë janë regjistruar gjatë këtyre viteve, por lëkundjet kanë qenë të lehta dhe nuk kanë shkaktuar viktima në njerëz si dhe dëme të mëdha materiale, me përjashtim të çarjes së mureve dhe suvave të shtëpive përgjatë kësaj zone.

HISTORIKU

Me pasoja shkatërruese, sipas studiusve të fushës sizmike, kanë qënë tërmetet që kanë goditur rrethin **e Tepelenës më 10 Tetor 1865 me intesitet rreth 6.4 ballë të shkallës Rihter**, me pasoja shkatërruese në fshatrat **Izvor dhe Rabie (Nj. Ad. Luftinjë)**, me 27 të vdekur, me çarje toke përgjatë një zonë me 10 - 15 m gjerësi dhe gjatësi disa kilometra duke prekur fshatra të rrethit Berat dhe Fier.

Nga tërmeti i rënë në zonën e **Himarës me 14 Qershor 1893, me intesitet 6.4 ballë** pati rënie shkëmbinjsh dhe të çara të mëdha toke edhe në **fshatin Fushë Bardhë (Sot Njësia Administrative Cepo) të bashkisë Gjirokastër.**

Gjatë shekullit XX,ne teritorin e qarkut Gjirokaster janë regjistruar këto tërmete të fuqishme:

Tepelenë, më 20 nëntor 1920, duke shkaktuar 36 të vrarë dhe 102 të plagosur. Ai shkatërroi 2 500 shtëpi e la pa strehë 15 000 veta dhe çarja e tokes pati një amplitudë vertikale, 0.5-1.5 metra

Pasojat : shkatërrime të rënda në qytetin e Tepelenës dhe fshatrat Bënçë (Njësia Administrative Kurvelesh), Turan, Salari, Luzat, Dragot, (Njësia Administrative Qëndër Tepelenë), Dhëmblan, (Njësia Administr ative Lopës), bashkia Memaliaj dhe Kashisht (Njësia Administrative Fshat Memaliaj). Nga ky tërmet pati rënie shkëmbinjsh dhe çarjet të tokës në segmentet e rrugës Sinanaj - Tepelenë - Gjirokastër dhe u bllokua pjesa e rrugës në vendin e quajtur Uji i Ftohtë Tepelenë

Vlore - **Tepelenë** më 21 nëntor 1930, duke shkaktuar 30 të vrarë e mbi 100 të plagosur.

Fier-**Tepelenë**-Berat-Lushnjë, më 18 mars 1962, duke shkaktuar 5 të vrarë e 77 të plagosur dhe ku u shkatërruan 2 700 shtëpi.

Më 3 Prill 1969, rrethi i **Tepelenës** u godit nga një tërmet me intesitet 5.6 ballë të shkallës Rihter, nga i cili u shkatërruan tërësisht fshatrat Rabie, Izvor e Cërrilë (Njësia Administrative Luftinjë) dhe shkëputje të rënda në luginë e Luftinjës.

Fushë-Bardhë-Gjirokastër më 26 mars 1990 , pa shkaktuar dëme në njerëz e materiale .**Tepelene** me 13.06.2006 me manjitude 4.0 , nuk ka patur deme ne njerez dhe material

Termetet me manjitude më të madhe se 4.0 në qarkun gjirokastër dhe në afërsi



Gjate vitit 2018 ne qarkun e Gjirokastres kane ndodhur 20 ngjarje sizmike me M = 1.3 – 4.2 dhe thellesi 1 – 29 km .

Gjatë vitit 2019 në qarkun Gjirokastër kanë ndodhur 15 ngjarje sizmike si dhe janë ndierë lëkundje pa shkaktuar dëme nga tërmeti i 26 Nëntorit në Durrës si dhe tërmetet me epiqëndër në qarqet Korçë , Vlorë si dhe në shtetin Grek.

Magnituda e tyre lokale ka qënë nga 1.2 deri në 3.7 të shkallës rihter në Kalivaç , me thellësi nga 1 deri në 29 km

Gjatë vitit 2020 në qarkun Gjirokastër kanë ndodhur 23 ngjarje sizmike . Magnituda e tyre lokale ka qënë nga 1.4 deri në 3.2 të shkallës rihter , me thellësi nga 1 deri në 37 km , lë kundje që zkonisht nuk ndihen .

Shënim : Tabelat me ngjarjet sizmike 2018,2019,2020 shiko në **shtojcën D**

26.11.2019 ne Durres , Thumane e Lezhe , termet me magnitute 6.4 te shkalles rihter , shkaktoi 51 viktima

Sipas raportit mbi 95 mijë banesa u dëmtuan, mbi 11 mijë janë të pabanueshme, ndërsa janë prekur rreth 200 mijë njerëz në 11 bashki të vendit. Mes tyre, 17 mijë janë të zhvendosur ndërsa 913 të tjerë u plagosën.

Rreth orës 03:55 më 26.11.2019 në qarkun e Gjirokastrës u ndien lëkundje tërmeti. Nga ana e Sektorit të Mbrojtjes Civile të Institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastër menjëherë filloi puna për kontaktimin me gjithë personat përgjegjës të mbrojtjes civile të bashkive në lidhje me situatën e krijuar. Nga informacionet e mara në orët e para të mëngjesit nuk u raportuan probleme për lëndime në njerëz apo dëmtime të banesave.

Nisur nga situata e vështirë në qarkun e Durrësit, ku pati dëme të mëdha në njerëz dhe banesa, nga qarku Gjirokastër shkuan për të marrë pjesë në operacionet e kërkim shpëtimit rreth 25 efektivë të Mzsh-ve dhe 4 mjete zjarrfikëse të bashkive të qarkut. Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ndoqi nga afër situatën e krijuar.

Prej datës 29.11.2019 drejt qarkut Gjirokaster filloi ardhja e banorëve nga zonat e dëmtuara nga tërmeti dhe në orën 12:00 të datës 02.12.2019 rezultoi se:

Në bashkinë Gjirokastër:

- U strehuan 5 familje të ndryshme (14 vetë) pranë familjeve.
- Në hoteleri u akomoduan 51 persona.

Në bashkinë Përmet:

- U strehuan pranë familjeve 19 persona.
- Në hoteleri u akomoduan rreth 37 persona.

Në bashkinë Këlcyrë:

- U strehuan pranë familjeve 505 persona.
- Në hoteleri u akomoduan 46 persona.

Gjithsej 672 persona

Harta e ngjarjeve sizmike qarku Gjirokaster



Harta e ngjarjeve sizmike 2018

Harta e ngjarjeve sizmike 2019



Harta e ngjarjeve sizmike 2020



HARTA E RREZIKUT GJEOLOGJIK QARKU GJIROKASTER

Vlerësimi i rrezikut sizmik

Për të vlerësuar rrezikun sizmik kundrejt popullsisë, infrastrukturës dhe pronës tjetër materiale në qark, janë përzgjedhur skenarët tërmetorë (Tabela) të mjaftueshëm për të paraqitur në mënyrë realiste skenarët e fatkeqësive më të mundshme sizmike, që mund të sjellin një ndikim dëmtues të rëndë mbi popullsinë, pronën materiale dhe ekonominë e qarkut. Elementet e llogaritura janë të mjaftueshme për të siguruar strategjinë e parapërgatitjes, e cila përputhet ose me zhvillimin e tanishëm ekonomik,ose te ardhshëm.

Tërmetet më të mëdha që kanë ndodhur në zonën e burimit sizmik e zgjedhur për skenar tërmetesh . (Brenda qarkut dhe në afërsi)

SKENARI TERMETIT	VITI	GJERESI GJEOGRA	GJATESI GJEOGRA	THELLESI km	I_0 MSK-64	M_{OCC}	$maxM_{exp}$
Vlorë	1962	40.70 ^{0}	19.60 ^{0}	27	8	6.6	6.8
Himarë	1930	40.20 ^{0}	19.60 ^{0}	10	9	6.6	6.6
Tepelenë	1920	40.35 ^{0}	19.95 ^{0}	13	9	6.6	6.8
Sarandë	1920	39.60 ^{0}	20.30 ^{0}	9	8	6.6	6.6
Leskovik	1919	39.70 ^{0}	20.70 ^{0}	10	8	6.7	6.9

Tabela 1: M_{ooc} – Magnituda e shfaqur, maxMexp – Magnituda e priteshme me e madhe , IO – Intesiteti ne epiqender



Tabela 2 Nivelet e ngacmimit për periudhat e përseritjes së tërmeteve

Për të vlerësuar shkallën e ndikimit të ngjarjeve sizmike të mundshme, vlerësimi i rrezikut për çdo skenar është realizuar në terma të nxitimit maksimal të truallit, të vlerësuar në rrugë probabilitare për periudha të përsëritjes të tërmeteve prej 50, 100, 200, 475 dhe 1000 vjetësh. Nga vlerësimet e rrezikut sizmik rezulton se tërmetet me magnitutë Ms = 5,0 kanë periudhë përsëritje prej 3.6 vjetësh (me ± 1 σ vlerësimet janë 3-4.6 vjet), ndërsa tërmetet me Ms = 5.5, 6.0, 6.5 dhe 7.0 kanë periudhë përsëritje 10, 29, 94 dhe 505 vjet, respektivisht (Tabela 2). Nga pikëpamja probabilitare, ka 75 për qind shans që Shqipëria të preket: çdo vit, nga një tërmet me magnitutë jo më të lartë se Ms = 4.7; një herë në 50 vjet nga një tërmet me magnitutë jo më të madhe se Ms = 6.1; një herë në 100 vjet nga një tërmet me magnitutë jo më të lartë se Ms = 6.4.



Harta e e ngjarjeve të mundëshme të rrezikut sizmik për tërmete të skenarit me periudhe rikthimi 200 vjet

SKENARI	BURIMI SIZMIK	PK- 50 VJET	PK – 100 VJET	PK – 200 VJET	PK- 475 VJET	PK – 1000 VJET	maxM exp
TSk - 6	Vlore	10.8 %	18.8 %	28.3 %	44.5 %	62.5 %	6.8
TSk - 7	Himare	9.4 %	15.1 %	23 %	35.4 %	48.7 %	6.6
TSk - 8	Tepelene	12.5 %	18.5 %	26.6 %	39.8 %	54.0 %	6,8
TSk - 9	Sarande	13 %	18.9 %	26.7 %	39.7 %	53.6 %	6.6
TSk - 14	Leskovik	6.4 %	9.3 %	13.4 %	19.1 %	25.5 %	6.3

Tabela : Nxitimi max. i pritshëm i truallit ne % (g = 9.81 cm/s^2)

Një studim i publikuar kohët e fundit mbi sizmicitetin në pjesën jugperendimore të Shqipërisë, jep të dhëna të detajuara për aktivitetin sizmik në brezin e **Kurveleshit (J2)** i cili përfaqëson

pjesët jugore dhe perendimore të qarkut Gjirokaster. Studimi ka konfirmuar se kjo pjesë e zonës karakterizohet nga një aktivitet i dendur mikrotërmetesh (0.1<M<3.0) dhe sizmicitet i cekët i kores së tokës. Pjesa më e madhe e ngjarjeve sizmike janë regjistruar në veri të brezit tektonik, pra jashtë zonës së qarkut. Sipas rezultateve të studimit, sizmiciteti është më së shumti i cekët, i përqëndruar në 10 km e para të kores së tokës, me zhytje të lehtë drejt lindjes. Më pak se 30 ngjarje janë lokalizuar në një thellësi më pak se 1km dhe qartazi të lidhur me zonat ku evaporitet zhvishen në sipërfaqe

Si përfundim :

Zonat që mund të preken më shumë nga ngjarjet sizmike në qarkun Gjirokastër

Bashkia Gjirokastër : Kardhiq , Zhulat , Golemi
Bashkia Libohovë : Libohova
Bashkia Dropull : Poliçan, Skore, Sopik, Çatistër, Mavrojer, Hllomo, Selckë.
Bashkia Tepelenë : Tepelena , Kurveleshi , Sinanaj
Bashkia Memaliaj : Zhapokike , Luftinje , Izvor , Rabie Golemaj, Selckë
Bashkia Përmet : Përmet , Kosinë , Ogren – Gostivisht , Carshovë .
Bashkia Këlcyrë : Fshatrat rrëzë m. Trebeshinë (Katundishtë , Podgoran , Corogunj, Ball , Psar)

(Shif tab. e ngjarjeve sizmike 2018-2019-2020 në shtojcë D)

Shkalla MMI per klasifikimin e termeteve sipas intesitetit

Shkalla	Përcaktimi[15]	Magnituda (shkalla Rihter)	Përshkrimi i pasojave
I	I pandjeshëm	1-2	Zakonisht nuk ndihet përveçse në raste shumë të rralla
II	I dobët	2-3	Mund të ndihet në katet e larta të ndërtesave
III	I lehtë	3-4	Ndihet nga një pjesë e mirë e njerëzve brenda ndërtesave. Shpesh nuk perceptohet që po bie tërmet
IV	I moderuar	4	Ndihet nga të gjithë brenda një ndërtese dhe nga një pjesë jashtë. Objektet në ndërtesë lëvizin po pa dëme
V	Disi i fortë	4-5	Ndihet nga të gjithë. Një pjesë e objekteve brenda në ndërtesë mund të bien, dëme shumë të lehta

VI	I fortë	5-6	Ndihet nga të gjithë. Mund të lëvizin mobiljet nga vendi, dëmtohen objekte. Shkakton panik
VII	Shumë i fortë	6	Dëme të lehta në struktura të ndërtuara mirë, dhe më shumë në konstruksione të dobta. Objekte që mund të bien. Ndihet dhe duke ngarë makinën.
VIII	Shkatërrues	6-7	Dëme të konsiderueshme në ndërtesa të zakonshme dhe të mëdha në ndërtesa të dobta. Mund të shkaktojë viktima.
IX	I dhunshëm	7	Dëme shumë të mëdha në shumicën e ndërtesave dhe panik i përgjithshëm. Shkakton viktima në njerëz, ndërtesa të tëra mund të bien.
X	Ekstrem	7-8	Dëme masive, shumica e ndërtesave bien, çarje dhe rrëshkitje toke, shkatërrim masiv, shumë viktima.
XI	Katastrofik	8	Pak ndërtesa mbeten pa u rrëzuar, çarje dhe deformime masive të tokës, toka lëviz si dallgë. Dëmi total, numër shumë i lartë viktimash.
XII	Kataklizmik	Mbi 8	Shkatërrim total, asnjë ndërtesë nuk mbetet në këmbë. Toka lëviz si dallgë, objekte që fluturojnë në ajër. Edhe rrjedhat e lumenjve mund të ndryshojnë.

Disa vlerësime të riskut sizmik në ndërtesat e banimit

Si bazë për vlerësimin e dëmtueshmërisë dhe të rrezikut për fondin e ndërtesave të banimit shërbejnë të dhënat e regjistrimit të popullsisë të bërë nga INSTAT-i, 2011.

- Materialit të ndërtimit (qerpiç, tullë, gur dhe betonarme [BA]) dhe sistemeve strukturore (mure mbajtëse, parafabrikate, skelet BA);
- Moshës, d.m.th. periudhës së ndërtimit (para vitit 1960: pa rezistencë kundrejt tërmeteve; 1960-1990: me mbrojtje të ulët sizmike; pas 1990-s: me mbrojtje të pamjaftueshme); (3) lartësisë së ndërtimit, d.m.th. numrit të kateve (1-2 kate, 3-5 dhe >5). Për elementet në rrezik të formuluar - 54 gjithsej – analizat e dëmtueshmërisë janë kryer për tri gjendje dëmtimi karakteristike:
- Aspak- shënohet me K-D&P-I;
- E rëndë - shënohet me K-D&P-II;
- Totale - shënohet me K-D&P-III. Ndërsa ndërtesat me K-D&P-I (ose shkallët e dëmtimit D1 dhe D2) mund të përdoren pa asnjë kufizim pas një tërmeti, ato me K-D&P-II (ose D3 dhe D4) duhen zbrazur, duke shkaktuar përkohësisht mbetjen e njerëzve pa shtëpi dhe nevoja për strehim të tyre. Ndërtesat K-D&P-III (ose D5) shkaktojnë dëme në njerëz (vdekje ose plagosje). Për periudhat e pranuara të përsëritjes së tërmeteve prej 50, 100, 200 dhe 475 vjetësh, pasojat e ngjarjes së skenarit paraqiten në tabelën 5 sipas numrit të pritshëm të ndërtesave të dëmtuara (D3 dhe D4) që duhen zbrazur dhe ndërtesave të dëmtuara totalisht dhe/ose të shembura (D5)

PËRQINDJA E DËMTIMIT TË BANESAVE TË BANIMIT

PERIUDHA E PËRSËRITJES 50,100,200,475 VJET

PK – 50 VJET		PK 100 VJET		TERMET I SKENARIT TEPELENE	PK – 200 VJET		PK – 475 VJET	
D3 + D4 %	D5 %	D3 + D4 %	D5 %		D3 + D4 %	D5 %	D3 + D4 %	D5 %
0.91	0.03	1.6	0.08		2.89	0.27	5.63	1.09

Tabela 3 Përqindjet e dëmtimit të ndërtesave të banimit janë llogaritur kundrejt ndërtesave gjithësej

SASIA E NDËRTESAVE TË DËMTUARA STRUKTURALISHT (D3,D4) DHE TË SHEMBUR (D5)SIPAS SKENARIT TE TERMETIT TEPELENË

PK – 50 VJET		PK 100 VJET		TERMET I SKENARIT TEPELENE	PK – 200 VJET		PK – 475 VJET	
D3 + D4	D5	D3 + D4	D5		D3 + D4	D5	D3 + D4	D5
4 046	134	7 118	347		12 900	1 194	25 105	4 860

Tabela 4

SASIA E NDËRTESAVE TË DËMTUARA STRUKTURALISHT SIPAS SKENARËVE TË TËRMETEVE
QARKU GJIROKASTËR

PK – 50 VJET		PK 100 VJET		QARKU GJIROKASTËR	PK – 200 VJET		PK – 475 VJET	
D3 + D4	D5	D3 + D4	D5		D3 + D4	D5	D3 + D4	D5
2 234	302	3 808	841		6 979	2 833	7 710	5 632

Tabela 5

PK – 50 VJET		PK 100 VJET		QARKU GJIROKASTËR	PK – 200 VJET		PK – 475 VJET	
D3 + D4 %	D5 %	D3 +D4 %	D5 %		D3 + D4 %	D5 %	D3 + D4 %	D5 %
6.65	0.47	11.94	1.62		20.35	4.50	37.30	15.14

Tabela 6

Shënim : Tabelat me ndërtesat për qëllime banimi sipas llojit , numurit të kateve dhe periudhës së ndërtimit , shiko **shtojcën D**

Dëmtimet e njerëzve në ndërtesat e banimit – Elementet në rrezik
Lidhja ndërmjet dëmeve në njerëz dhe shembjeve strukturore merr parasysh parametra të tillë si ; sasia e banorëve në ndertesë , sasia në kohën e tërmetit , pjesa e banorëve që ngecin brenda nga shembja strukturore , përhapja e lendimeve në castin e shembjes dhe vdekjet pas shembjes . Nëpermjet një faktori të vdekjeve pas shembjes modeli përfshinë dhe aftesinë e kërkimit dhe të shpëtimit të sistemit të emergjencave civile .

Modeli me perzgjedhje prej katër pikash :
I1 - Lëndime të lehta
I2 – Lëndime vetëm për shtrime në spital
I3 - Lëndime që kërkojnë vemendje të menjeherëshme mjekësore e më pas shtrim në spital
I4 – Vdekje dhe të plagosur për vdekje .
Tipologjia mbizoteruese e lëndimeve që kërkojnë vemendje të menjeherëshme mjekësore (lëndimet I3) janë lëndime të indeve të buta (plagë dhe kontuzione) thyerje gjymtyrësh dhe lëndime të kokës .
Ndërtesat me sisteme strukturore të demtuara (grada e demtimit D3 dhe D4) nuk janë të sigurta për tu përdoruur menjëherë pas një tërmeti të fortë . Ato duhen zbrazur dhe për popullsinë e nxjerë jashtë duhet të sigurohet strehim i përkohshëm . Këto ndërtesa trajtohen si përkohësisht të paqendruashme , pasi rimkëmbja e tyre fizike është e përligjur nga ana ekonomike . Ndërtesat që kanë pësuar dëmtim total ose që kanë pësuar shembje (grada e demtimit D5) shkaktojnë deme tek njerëzit . Ato duhet të trajtohen si të papërdoreshme për gjithnjë .

PK – 50 VJET				QARKU GJIROKASTER	PK 100 VJET			
I1	I2 + I3	M	Pa SHTEPI		I1	I2 + I3	M	Pa SHTEPI
0.01	0.12	0.04	715		1.39	4.01	1.57	1383

PK –200 VJET				QARKU GJIROKASTER	PK 475 VJET			
I1	I2 + I3	M	Pa SHTEPI		I1	I2 + I3	M	Pa SHTEPI
21.56	54.29	21.88	2524		134.82	354.83	141.29	5073

I1 – lëndime të lehta, I2 – lëndime për shtrim në spital, I3 – per trajtim mjekesor, M – vdekje
Tabela 9 Llogaritjet për demet te njerëzit dhe të pa strehët për tërmetet e skenarëve 50,100,200,475 vjet (Për 10.000 banorë të qarkut)

Llogaritjet për demet në njerëz janë bërë për një tërmet që ndodh në mesnatë (ora 24.00), kur numuri i njerëzve në banesë është më i madh d.m.th. 94 % të maksimumit të mundshëm për ndërtesat rurale dhe 78 % për ato në qytet . Llogaritjet për të pa strehët dhe demet bëhen në nivel bashkie , njësie administrative , fshati.

Rreziqet për ndërtesat e sistemit arsimor

Vleresimi i rreziqeve për instalimet e sistemit arsimor të qarkut përqendrohen tek shkollat 9-vjecare dhe të mesme . Mbështetet në të dhënat e siguruara nga zyrat arsimore (shih të dhenat për arsimin) për vlerësimin e reziqeve të tilla si :

- Viti ndërtimit
- Numuri kateve
- Zona e ndërteses / instalimit
- Numurin e klasave
- Zona e truallit të shhkollës
- Numuri nxënësve

Në planet e emergjencave të cdo shkolle janë sistemi strukturor i ndërtesave, cilësia e konstruksionit ,mirëmbajtja, kushtet e instalimit , mundesinë që lokali shkollës ti përgjigjet

ngjarjeve të tjera rrezikuese , kushtet për zbrazjen e shpejtë , pajisjet ,trajtimin e ngjarjeve rrezikuese etj.
Për të përballuar situatat sizmike është e nevojshme një analize e gjithanshme e fondit të ndërtesave shkollore nga zyrat arsimore të retheve . Për këtë nevojitet një inspektim ndërtese për ndërtese që të jap gjithë informacionin teknik për tipologjinë ekzistuese dhe një pamje të kushteve të ndërtesës ,verifikimin e pasojave dhe të fakteve lidhur me demet e shkaktuara nga tërmetet e mëparshme . Mbi këtë bazë të duhet të përgatitin plane sipas klasës së ndërtimit për menaxhimin e emergjencës të lidhur me tërmetin.
Shumica e ndërtesave shkollore në qark janë përdhese dhe deri në kp + 2kate dhe vetë ndërtesat janë me plan të thjeshtë duke dhenë mundësinë për zbrazjen e lehtë dhe të shpejtë.

Rreziqet për ndërtesat e sistemit shëndetësor

Vetë natyra e ndretesave të kujdesit shendetësor në qark dhe e spitaleve në vecanti kërkon që ato të jenë plotësisht në veprim gjatë fazës së ndikimit të emergjencës të shkaktuar nga tërmeti .Shpresat më të mëdha janë që ndërtesat dhe pajisjet e kujdesit shendetësor të jenë të përgatitura mirë për përballimin e cdo situate . Tërmetet e kohëve të fundit kanë treguar se spitalet dhe qendrat shendetësore u nënshtrohen pasojave të fatkeqësise ngë tërmeti dhe nuk mund të plotësojnë funksionon e tyre pikërisht ku nevojitet më shumë pasi ato për vete bëhen pre e demeve . Ndonese ndërtimi i një instalimi përkujdesin shendetësor është e ngjashem me atë të ndërtesave të tjera , përmasat numuri i njerëzve brenda dhe qëllimi i këtyre ndërtesave diktojnë që sigurisë sizmike ti kushtojmë vemendje të vecantë sepse :

- Janë ndërtesa komplekse që ndërthurin funksionet e një hoteli , zyre laboratori dhe depoje .
- Janë ndërtesa shumë të ngarkuara , ku gjejnë strehë shumë të semurë , personeli mjeksor , punonjësit dhe vizitorët si dhe janë të zëna me njerëz 24 orë në ditë.
- Shumë furnizime me dhe pajisje të kujdesit shendetësor janë me rendësi jetike për mbijetesën e të semureve dhe të pa zëvendësueshme për trajtimin e viktimave të një tërmeti .
- Mjaft nga objektet shendetësore janë me rrezik po të përmbysen apo të rezohen

Nga shumë pikëpamje , instalimet e kujdesit shendetësor kanë mundësitë pësojnë fatkeqësi të brendëshme ndërkohë që duhen t'u përgjigjen kërkesave të jashtëme për fatkeqësinë me aftesinë dhe kapacitetin më të madh . Analiza e skenarëve nga tërmeti dhe të humbjeve të njerëzve tregon se në rastin më të keq vetëm një pjesë do të ketë pasojat më të mëdha , kështu që në një pjesë të teritorit do të ketë prishje të shërbimeve spitalore . Kapacitete të mbetura të pa prekura të qarkut, të kujdesit të sistemit shendetësor, mund ta përthith këtë trysni vetëm nëse :

- Spitalet dhe qendrat shendetësore në bashkitë dhe njesitë administrative hapen në kohën e duhur
- Sigurohet logjidtika e përshtatshme e transportimit të të lënduareve për tri ditët e para sidomos në 12 orët e para në 24 orë.
- Pjesa e paprekur e sistemit menjeherë e zvogëlon pranimindhe e pakëson numurin e rasteve të shtrimit për ti trajtuar në shtëpi.
- Trajtimi lëndimeve të lëvizeshme bëhet në institucionet lokale pa shtrim të të sëmurëve

Këto cështje do të trajtohen dhe do të përfshihen në planet e gatishmërisë të bashkive dhe institucineve shendetësore

Mundësitë për bllokimin e rrjetit rugor

Rjeti rrugor i qarkut kalon nëpër formacione gjeologjike që karakterizohen prej shpatesh të qendrueshme , relativisht të qendrueshme dhe të paqendrueshme. Rjeti gjithashtu kalon nëpër tri zone karakteristike të ngacmimit sizmik që përcaktohen si zonë të nivelit të ulët NU (< 0.15g),nivelit mesatar (NM, NMT= 0.15 - 0.30g) dhe të lartë (NL, NMT > 0.30g).
Duke ndërlidhur informacionin gjeoteknik me kriteret e qendrueshmërisë përkatëse me nivelet e ngacmimit të cilave do tu nënshtrohej rrjeti rrugor llogaritet paqendrueshmëria e potenciale dinamike e tokës përgjatë sistemit të rrjetit rrugor në qark si dhe potenciali i bllokimit të tyre . Raporti ndërmjet paqendrueshmërisë së tokës dhe potencialit të bllokimit është i drejtpërdrejtë. Paqendrueshmëria mesatare e tokës i përgjigjet drejtperdrejt bllokimit mesatar dhe paqendrueshmëria e lartë i përgjigjet drejtperdrejt potencialit të lartë të bllokimit të seksionit të rrugëve .

Segmentet rrugore më të rrezikuara nga ngjarjet sizmike me M > se 7.5 sipas drejtimeve :

Kufi Mallakastër - Kakavijë

- Kufi mallakastër – Memaliaj (Iliras – Qesarat 1.5km)
- Memaliaj – Tepelenë (Mamaj 1km)
- Tepelenë – Ura e Leklit (Tepelenë – Karburant 2km)
- Ura e leklit – Subash (Uji Ftohtë – Shkalle e Zezë 3km)

Ura e Leklit – Tri Urat

- (Gryka e Kelcyrës 2.5km , Rrapi Kuqarit 0.5km , Rethi Badlonjës 1 km, Strembec – Iljarë 2km, kthesat e Zhepës 3 km)
- Sipas skenarit të tërmeteve (Sa – 8 ,Tepeleneë) me periudhe kthimi 50,100,200,475 vjet më të rrezikuara janë segmentet rrugore Subash – Tepelenë, Degëzim Memaliaj – Izvor, Tepelenë – Progonat

Faktorët e përkeqësimit

Reshjet atmosferike, erërat dhe ndryshimi i temperaturave janë faktor përkeqësues, si në mundësinë e dridhjeve të mëvonshme, po ashtu edhe në përkeqësimin dhe krijimin e kushteve të vështirësuara për reagim dhe përkujdesje për banorët goditur. Ndërtimi pa kritere dhe cilësia jo adekuate e strukturave ndërtimore në qark , i bënë të ndjeshme vendbanimet e saj.

Flukset e rreziqeve:

• Shëmbja e objekteve të larta banesave dhe atyre publike,
• Dëmet në infrastrukturë dhe transport,
• Çrregullimet në ambient (rrjedha e ujit, rrëshqitja e terrenit),
• Efektet sekondare (zjarret, shembjet, rrjedhja e kanalizimeve dhe e prodhimeve toksike

PROFILI

RREZIKU : TËRMET	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): **Kritike**	
Frekuenca e ndodhjes: E mundshme: Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e	**Modeli sezonal** Ne cdo stinë. Mundësia e përsëritjes së tërmeteve me magnitutë Ms =

ardhshëm, ose së paku mund të ndodh në 10 vitet e ardhshme.	5,0 kanë periudhë përsëritje prej 3.6 vjetësh (me ± 1 σ vlerësimet janë 3-4.6 vjet), ndërsa tërmetet me Ms = 5.5, 6.0, 6.5 dhe 7.0 kanë periudhë përsëritje 10, 29, 94 dhe 505 vjet, respektivisht Nga pikëpamja probabilitare, ka 75 për qind shans që Shqipëria të preket: çdo vit, nga një tërmet me magnitutë jo më të lartë se Ms = 4.7; një herë në 50 vjet nga një tërmet me magnitutë jo më të madhe se Ms = 6.1; një herë në 100 vjet nga një tërmet me magnitutë jo më të lartë se Ms = 6.4.
Zonat qe mund te goditen : - **Zona sizmike e Kurveleshit (Tepelene)** - **Zona sizmike Zhulat – Kardhiq- F.Bardhë (Gjirokastër)** - **Zona sizmike Zhapokike – Luftinje – Rabie (Tepelenë)**	
Kohë zgjatja e mundëshme : E castit (2 – 10 sekonda)	
Shpejtësia e mundshme (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit): Pa paralajmerim . Paralajmërim minimal (ose fare).	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: Nuk ka	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? o Po X o Jo	

Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

PROFILI	PASOJAT E MUNDESHME	SHKALLA E GODITJES
Banorët	Dhjetëra vdekje, qindra lëndime të rënda dhe trauma	E lartë
Pasuria	Shkatërrim / dëmtim i pasurisë publike dhe private	E lartë
Infrastruktura	Shkatërrim /dëmtim i rrjetit: rrugor, të ujësjellësit dhe kanalizimit, energjetik, telekomunikacionit,	E lartë

	etj	
Objektet e rëndësisë së vecantë	Shkatërrim /dëmtim i ndërtesave të administratës, bankat, zyrat, objektet shkollore, shendetesore ,objektet qeveritare, dyqanet, qendrat tregtare, restorantet, etj.	E lartë
Demet ekonomike	Shkatërrim /dëmtim i pasurisë publike dhe private .	E lartë
Mjedisi	Dëmtim / degradim i mjedisit për shkak të derdhjeve të ndryshme, gazrave dhe tymit, kontaminim i ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokës pjellore, ushqimit dhe kafshëve.	E lartë
Trashëgimia kulturore	Demtim të objekteve të trashegimisë kulturore	E ulte
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Sherbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

SKENARI
Elementet kryesore
Ngjarja : Termet
Zona e emergjencës : Tepelenë - Memaliaj
Shkalla e goditjes: E ashper (Kritike).
Magnituda : M- 6 ballë e shkallës Rihter.
Periudha persëritëse : Një herë në **200** vjet.
-**Zonat e prekura : Bashkia Memaliaj (N**jësia Administrative Luftinje, Njesia administrative Qesarat ,**N**jësia Administrative Krahs).
Lekundje te lehta jane ndier ne nj.Ad. Memaliaj , Memaliaj Fshat si dhe ne nj. Ad. Lopes te bashkise Tepelene me demtime te lehta ne ndertesa banimi.
-**Periudha e tërmetit :** Stina e vjeshtës (shtator).
-Fondet e banesave të dëmtuara **:**
-Dëme strukturore mesatare e të rënda (të konstatuara të pa baneshme) : 1000 banesa-Të rrënuara plotësisht **320**

Bashkia	**Popullsi e ban. të shëmbura**	**Pop.ban. dëmtuara**	**Të plag. për spital**	**Të plag. ndihmë e menjëher**	**Të vdekur**	**Pa shtëpi**	**Nën rrënoja**

Memaliaj	**800**	**1200**	**135**	**200**	**25**	**2000**	**140**

Totali i viktimave të pritshme : reth 40
- Plagosje për trajtim spitalor 400 vetë .
- Plagosje për trajtim të menjëhershëm spitalor : 50.
- Vdekshmëria : 25
- Të pa strehë : 2000 .

Dëmtimet më të mëdha janë në zonën e Izvorit dhe të Luftinjës dhe kryesisht në shtëpitë e banimit .
Rruga nacionale Tepelenë - Memaliaj ka shkarë rreth 150 m duke bërë të pa mundur qarkullimin e mjeteve dhe te njerezve.
Ruga rajonale qe lidh bashkine Memaliaj me nj. Ad. Luftinje dhe Izvor ka pesuar reshqitje 250 m ne Sektorin e trete dhe 150 m ne Sektorin e katert si dhe ura ne kete segment rrugor me gjatesi 50m.
Ne fshatin Izvor ndertesa e shkolles 9 – vjecare ka pesuar deme te konsiderueshme ne strukture
Miniera e Memaliaj ka çarje e fundosje në një sipërfaqe prej 10.000 m^2 .
Ndërlidhja telefonike fikse është ndërprerë, po kështu edhe furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike në tëgjithe fshatrat e nj. Ad. Luftinje..
Komunikimi në zonën e goditur bëhet vetëm me celularë dhe mjetet ndërlidhëse të Komisariatit të Policisë .
Struktura të përfshira në momentin e parë : Komisioni MC të Qarkut e të bashkive Tepelenë e Memaliaj, njësitë e shërbimit zjarfikës ,Kom. e Policisë .,shërbimi i urgjencës e ambulancës njësi vullnetare për kërkim e shpetim.
Nevoja emergjente : Mbështetje me forca të specializuara per kërkim e shpëtim , forca tokësore të MM, njësi të MZSH të bashkive të qarkut , Ambulanca për transportimin e të dëmtuarëve , mbështetje me mjete logjistike .
Faza e kërkim- shpëtimit 80 - 100 orë.
Emergjence aktuale : 1 vit e 3 muaj.

3.5.B) RRËSHQITJET E TOKËS DHE EROZIONI

KATEGORIA E RREZIKUT :	Gjeologjike
LLOJI :	Fatkeqësi natyrore
RREZIKU :	Shëmbje dhe erosion
VENDNDODHJA :	Teritori qarkut Gjirokastër
MODELI	Sezonal
VLERËSIMI :	Duke marë për bazë kushtet fiziko – gjeologjike , përbërjen e tokës , kushtet klimatologjike dhe faktorë të tjerë të cilët kanë ndikimin në krijimin e rrëshqitjeve dhe erozionit të tokës , eshtë vlerësuar se një dukuri e tillë nuk është e përmasavë të mëdha në qarkun Gjirokastër , megjithatë vitet e fundit ka patur ndodhi të tilla.

Mbi qendrueshmërinë e shpateve natyrore ndikojnë mjaft katër grupe të gjera faktorësh :

Gjeologjia e rajonit dhe vendndodhjes , gjeomorfologjia , hidrologjia dhe klima , bimësia dhe mbulesa e tokës. Përvec faktorëve gjeologjik , që kanë ndikim mbizotërues , faktorë të tjerë kanë ndikim parësor mbi qëndrueshmërinë e shpateve natyrore në qarkun Gjirokastër janë ; relievi malor dhe kodrinor i rreth 75% të tëritorit të saj , copëzimi i ndjeshëm vertical dhe horizontal i masave shkëmbore , modelet e rrjedhjes së ujërave mi sipërfaqen e tokës , gërryerja nga lumenjtë , klima , proceset tektonike e sizmike dhe bimësia .

Format mbizotëruese të paqëndrueshmërisë së tokës në qarkun Gjirokastër

Rënia e shkëmbinjëve është karakteristikë e shpateve gelqerore të zbuluara ndaj kushteve të klimës se ftohtë dhe shirave të bollshme në rrëzë të **malit Nemërckë e përgjatë luginave që formohen në të dy anët ë saj** . rastet më të fundit janë rëniet e gurëvë **në kalanë e Gjirokastrës (1970)**

Shëmbje (Rrëzim shkëmbinjësh dhe copave shkëmbore) gjithashtu janë karakteristike për zonat malore të qarkut. Një shembull klasik eshtë shembja e 12.000.000 m^3 gëlqerorë në Kapriel (Gjirokastër 1977) ,

Rrëshqitje me rrokullisje (Vithisje shkembinjësh ose vithisje toke) . Janë karakteristike për zonat me shpate të shkëmbinjëve reshpore me pjerrësi mbi 45^0 **Shembull i rrëshqitjeve me rrookullisje në rajonin e Libohovë – Dhoksat (Gryka e Selckës 1999)**

Rrëshqitje me zhvendosje (Rrëshqitje shkëmbinjësh , rrëshqitje toke dhe rrëshqitje blloqesh e prej dheu) Janë rrëshqitjet më të dëndura në qaek . Ato jane karakteristike për bartjen e mbulesave të holla deri në 5 m .

Rrëshqitjet (vithisje toke), më evidente gjatë vitit 2002 dhe 2003, përgjatë rrugës nacionale Shkallë e Zezë (afër Ujit të Ftohtë Tepelenë) – Tepelenë, Memaliaj - Vasjar (Njësia Administrative Qesarat) rrethit Tepelenë, në rrugët rurale Poliçan – Nivan (Njësia Administrative e Pogonit dhe Zagories), Bënçë – Progonat, (Njësia Administrative Kurvelesh), në fshatin Dhoksat të Njësisë Administrative Lunxhëri dhe në pjesën veri-perëndimore të malit të Buretos në afërsi të bashkisë së Libohovës, si dhe në një pjesë dërmuese të rrugëve rurale

Fenomeni i rrëshqitjes së dheut në qarkun e Gjirokastër e konkretisht në qytetin e Gjirokastrës ka qënë më problematik në këtë drejtim , si rezultat i rreshjeve të pazakonta të datave 30 deri më datat 1 dhe 2 Dhjetor 2017ku ranë 281 mm shi si dhe 1-2 Shkurt të 2018 ranë 279 mm . Pati dëme të mëdha dhe shkarje dheu në disa banesa në lagjen "Cfakë, në pallatin 5 katësh dhe 1 banesë tre katëshe në lagjen "Punëtori" e më së fundi pallati 8 katësh në lagjen "Kodra e Shtufit" që u rrezikua jeta e banorëve të tyre

Rrjedhje (rrjedhje toke dhe rrjedhë shkëmbinjëve) Janë karakteristike për zonat reshpore e të gropsve të brendëshme malore . Rrjedhat në sipërfaqe e në trajtën e rrymave të baltës nga grimca të ngurta të paqëndrueshme të shpatit , që bëhen të rrjedheshme prej ujërave të përrenjëve gjatë shtërngatave të rënda me shi . Ato janë karakteristike për zonat malore të qarkut me rreshje vjetore që i kalon 200 cm dhe në luginat e perrenjtë me pjerësi të madhe . Laharët shpesh perbëjnë problem për qëndrat e banuara sidomos në **bashkinë Gjirokastër e Përmet (2002 – 2003 , dhe 2017)**

Zona më e prekur në qark nga rrjedhjet eshtë bashkia Tepelenë dhe Memaliaj.

Permet 2017 (Rrokullisje guresh)

Gjirokaster 2017 Rreshqitje (Kodra e shtufit

Rrëshqitje e aksit të segmentit rrugor (Rruga Nacionale) Përmet - Tri Urat,
(Kthesat e Zhepës Përmet.)



Harta gjeoteknike e qarkut Gjirokastër

EROZIONI

Erozioni është një fenomen që rrezikon tokën ose burimin më të rëndësishëm mjedisor. Ai është një fenomen natyror që kë të bëjë me gërryerjen, ç'vendosjen dhe transportin e lëndëve të ngurta ose materialit tokësor kryesisht nën forcën e veprimit të ujit, akullit ose erës. Aktiviteti human, mund të shkaktojnë erozionin e tokës qoftë edhe në përmasa të mëdha (ndërtimet, turizmi, vullkanet, katastrofat natyrore etj). Erozioni vepron në kundërshti me ekuilibrin natyror të ekosistemeve. Në një këndvështrim të përgjithshëm, nevojitet një kohë shumë e gjatë për të kompensuar humbjen e lëndës të shkaktuar nga erozioni për një kohë fare të shkurtër. Disa nga faktorët që influencojnë erozionin janë :

- sasia dhe intensiteti i reshjeve
- kushtet e relievit (pjerrësia) dhe mënyra e përdorimit të tokës
- degradimi i mbulesës bimore (ç'pyllëzimet, zjarret, mbikullotja etj)
- modifikimi i topografisë (p.sh. ndertimi i rrugëve, qendrave urbane etj)
- politika e administrimit të ujrave (kanalizimet, veprat hidrike, pritat, etj)

Masat e luftës kundër erozionit synojnë parandalimin e rreziqeve për mjedisin human ose konservimin e burimeve jetësore. Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në afatgjatë ndikon drejtëpërdrejtë cilësinë e jetesës. Midis formave të erozionit dhe efekteve të shkaktuara dallohen :

- erozioni sipërfaqësor : ç'vendosja e shtresës së sipërme të tokës nga reshjet dhe era; humbje dhe degradim i tokës bujqësore, i florës dhe faunës;
- erozioni në formë rrëkesh : çarje, frizura deri në rrëke që përshkojnë sipërfaqen e tokës kjo është formë më e përkeqësuar e erozionit sipërfaqësor;
- gërryerja e tokës: formë e erozionit që karakterizohet nga gërryerja dhe ç'vendosja e masës nga rrjedha e ujit në përrenj dhe lumenj. Efektet e kësaj forme të erozionit veprojnë mbi rrjedhën e ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, tokat e kultivuara dhe infrastrukturën;
- lëvizjet dhe shkarjet e tokës: provokohet nga forca e gravitetit dhe faktorë natyrorë ose anthropik që influencojnë degradimin e mjedisit dhe infrastrukturës; Reabilitimi i ekuilibrit natyror të tokave në një ekosistem të caktuar si dhe masat biologjike të

integruara në përshtatje me natyrën dhe peisazhin ndihmojnë në përmirësimin e mjedisit. Objektivi kryesor i luftës kundër erozionit është ulja e shkallës së erozionit në një nivel të pranueshëm për kushtet e mjedisit. Janë raste shumë të rralla kur shkaqet e erozionit ose lëvizja e lëndës mund të mënjanohen totalisht. Masat e ndërmarra në të shumtën e rasteve jënë të natyrës tekniko-biologjike dhe përfshijnë:

- konsolidimin e sipërfaqeve të kërcënuara nga erozioni (pyllëzimi, brezat e erës, prita të vogla etj.);
- mënyrat e punimit të tokës të mos favorizojnë erozionin ose rrjedhën e ujit (punimi në drejtimm tërthor, punim minimal);
- ndërhyrje topografike (ndërtimi i tarracave dhe mureve mbajtës);
- masa për veshjen e përrenjëve dhe shtratit të rrjedhës, modifikimi i profilit të tyre
- modifikimi i prurjeve të rrjedhës: ndërtime për të bërë shpërndarje të rrjedhës në drejtime të ndryshme duke ulur forcën e saj;
- vepra mbrojtëse për infrastrukturën : diga, prita, kanale etj.

Vlerësimi i elementëve mbrojtës me karakter Inxhinjerik për parandalimin e erozionit, gërryerjeve dhe përmbytjeve

Në teritorin e qarkut është e nevojshme monitorimi dhe vlerësimi gjendjes se veprave mbrojtëse si p.sh prita malore, pragje për reduktimin e energjisë së ujit, pritat mbrojtëse për parandalimin e përmbytjeve, pendat e banuara ku vërehen mure, brezare ose ledhe të ngritur posaçërisht për mbrojtjen e tokës. Në këto zona janë evidentuar si masa më të rëndësishme për parandalimin e erozionit:

- prita të thjeshta të ndërtuara me gardhe ose gurë,

- praktika agronomike të përshtatëshme për zbutjen e forcës gërruerëse etj.

Erozioni i tokës në qarkun Gjirokastër ngelet njërrezik përmanent . Për më shumëse dy dekada faktorët që favorizojnë erozionin janë fuqizuar. Veprat antierozive në përrenjtë e monitoruar mungojnë ose kanë degraduar. Vitet e fundit janë bërë investime sporadike vetëm në disa përrenj në afërsi të zonave të banuara ose në funksion të akseve rrugore. Praktikat agronomike në këto zona kanë tendencë orjentimi drejt bimëve livadhore (jonxhë) duke kontribuar në mbrojtjen e më të mirë të tokës nga erozioni. Kultivimi i arroreve dhe ullirit kane thene kontribut ne mbrojtjen e tokes nga erozioni. Manaxhimi i pyjeve nga komunitet, ulja e nivelit të prerjeve për dru zjarri ka ndikuar në përmirësimin e situatës së pyjeve të ulta (dushqeve) duke ndikuar pozitivisht në mbrojtjen e burimeve tokësore.

Megjithatë, vrojtimet dhe matjet tregojnë se masat antierozion janë sporadike kryesisht nga fermerët. Pritat prej guri në shtratin e lumenjëve janë dëmtuar rëndë dhe nuk ka patur investime të rëndësishme që pas viteve 1990.

Monitorimi i erozionit dhe shkarjeve të tokës.

Në tokat bujqësore të qarkut tonë reziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë. Të dhënat tregojnë së në rreth 25% të tokave bujqësore reziku potencial është mesatar, ndersa në rreth 75% të tokave reziku është i lartë. Metodologjia për vlerësimin e erozionit potencial

bazohet në konvertimin e gjithë faktoreve natyrorë që ndikojnë mbi procesin e erozionit në indekset që janë paraqitur në figurën e mëposhtëme.

Në mënyrë të grupuar faktorët mund të renditen si më poshtë:

- Faktorë klimatikë: rreshjet dhe temperaturat
- Faktoret tokësorë: tekstura, thellësia e tokës dhe përmbajtja e gurëve, që përcaktojnë erodibilitetin e tokës ose aftësinë e saj për tu shkëputur, transportuar dhe depozituar gjatë procesit të erozionit.
- Relievi: pjerrësia e terenit përbën një faktor bazë në përcaktimin e rezikut potencial të erozionit.
- Vegjetacioni: vlerësimi i shkallës së mbulesës bimore si faktor frenus mbi erozionin që njekohësisht bën lidhjen midis rezikut potencial dhe erozionit aktual.

Tabela 1. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Q.Gjirokastër

Rrethi / Bashkitë	Sip ha	Indeksi erodibilitetit		Indeksi erozivitetit	Indeksi pjerrësisë	Indeksi rrezikut potencial të tokës		
		Absolut	Relati			Absol	Relativ	vlerësimi
Gjirokastër Dropull Libohovë	16500	6.2	3	3	1.69	15.2	3	I lartë
Tepelenë Memaliaj	10514	8.1	3	2	2.43	14.6	3	I lartë
Përmet Këlcyrë	11429	7.9	3	2	2.07	12.4	3	I lartë

Janë monitoruar përrenjtë në zonën **e Gjirokastrës , Tepelenës e Përmetit** ku përmbytjet e këtyre përrenjëve kanë çuar në shtimin e depozitimeve të inerteve mbi siperfaqen të tokës bujqësore. Një formë specifike e degradimit të tokave është zenia e tyre me materiale të ngurta si pasojë e mbulimit me zhavorr të shkaktuar nga vërshimi i përrenjeve dhe lumenjeve të cilet në momente të rreshjeve të rrembyeshme shfaqin efekte negative. Fenomeni i zhavorizimit më i dukshëm është në zonat e rrjedhes ujore të përrenjëve në **Përmet, Gjirokastër**. Megjithese, ky fenomen i lokalizuar kryesisht në grykederdhjen e përrenjeve të thatë (pjesa më e madhe e kohës janë pa prurje uji), përbën një rrezik serioz për tokat bujqësore, prishjen dhe demtimin e infrastrukturës dhe qendrave të banuara.

Sipërfaqet e zëna me depozitime të ngurta hasen edhe në brigjet e lumenjëve Vjosë e Drino të qarkut tonë,.

Identifikimi i rreziqeve nga shkarjet dhe erozioni në qarkun Gjirokastër

Për identifikimin e zonave dhe vlersimin e rrezikshmeris së tyre, janë studiuar dhe janë marë për bazë elementët dhe parametrat që ndikojn në mundësin e ndodhjeve erozive si :

Rreshqitjet e tokës në qëndrat e banuara ku rrezikohen ndërtesat :

Qyteti Gjirokastrës në lagjet : Kala , Kodra e Shtufit , Cfakë , Punëtori .

- Në bashkinë Tepelenë : Ndertesat në pjesën Veri – Perëndimore të qytetit deri tek kalaja .
- Në bashkinë Këlcyrë fshatrat : Gur , Katundisht
- Në bashkinë Përmët : Shembje , rrëzim shkëmbinjësh në qytetin Përmet , fshatrat Gjinkar e Zhepë

Rrëshqitjet në akset rrugore nacionale :

Segmentet rrugore të rrezikuara nga rrëshqitjet në aksin rrugor Kufi Mallakastër – Memaliaj – Tepelenë - Gjirokastër në vëndët e quajtura:

- Fshati Iliras 0.8 km
- Në hyrje të Qytetit Memaliaj 400 m pa vajtur tek ura , 0.15 km segment i rrezikuar nga rrëshqitja
- Kufiri ndarës midis Tepelenës dhe Memaliajt , 200 m segment rrugor
- Ura e Leklit – Uji Ftohtë – Subash , 3.5 km të gjatësisë së saj .

Segmentet rrugore të rrezikuara nga rrëshqitjet në aksin rrugor Ura e Leklit – Këlcyrë – Përmet – Tri Urat në vëndët e quajtura:

- Ish rep . usht. Dragot 300 m (Restorant Mullaraj – Reparti – Restorant Kasneci)
- Kufiri ndares midis Tepelenës dhe Kelcyres 100 m (Në hyrje të Grykës së Këlcyrës)
- Kufiri ndarës midis Këlcyrës dhe Përmetit 150 m (Rrapi Kuqarit)
- Rrethi i Badlonjës Përmet 250 m segment rrugor
- Iljarë 0.5 km

- Kthesat e Zhepës 3 km rruge që paraqit rrëshqitje në segmente të vecanta

Segmentet rugore rajonale të rrezikuara nga rrëshqitjet në pjesë të ndryshme te gjatësisë së saj

- Në bashkinë Gjirokastër : Picar – Kolonjë – Golem ,
- Në bashkin; Dropull : Polican - Sopik
- Në bashkinë Libohovë : Libohovë - Zagorie
- Në bashkinë Tepelenë : Bencë – Progonat – Nivicë , Dukaj – Dhëmblan - Sinanaj
- Në bashkine Memaliaj : Degëzim – Luftinje – Izvor , Qafa e Kicokut – Buz
- Ne Bashkinë Këlcyrë : Këlcyrë - Sukë , Këlcyrë – Malëshovë
- Në bashkinë Përmet : Degëzim – Bredhi Hotovës – Frashër – Gostivisht – Petran

Segmentet rrugore rrurale

Të rrezikuara nga rrëshqitjet e dherave sidomos në periudhen Vjeshtë – Dimër janë të gjitha segmentet rrugore në zonat malore të qarkut , të cilat lidhin qëndrat administrative me fshatrat. Këto më të theksuara në zonën e Frashërit , Malëshovës , Buzit , Luftinjës , Kurveleshit , Zagorisë , Sopikut e Dropullit të Siperm

Gryerja e tokës në brigjet e lumenjëve (Erozioni)

- Nga gërryerja në të dy brigjet e lumit Vjosa rrezikohen :
- Në bashkinë Përmet ; Tokat bujqësore të Njesive administrative Carshovë , Petran e Piskovë
- Në bashkinë Këlcyrë ; Tokat bujqësore të Nj.administrative Deshnicë e Këlcyrë
- Në bashkinë Tepelenë : Tokat bujqësore te nj.administrative Qendër Tepelene
- Në bashkinë Memaliaj : Tokat bujqësore të nj.administrative Memaliaj Fshat , Qesaraat e Krahës

Nga gërryerja në të dy brigjet e lumit Drino

- Në bashkinë Dropull : Tokat bujqësore në njësinë administrative Dropull i Siperm , dropulli Poshtem
- Në bashkinë Libohovë : Tokat bujqësore në mj.ad. Q. Libohovë
- Në bashkine Gjirokastër : Tokat bujqësore ne nj. Administrative Lazarat, Antigone , Lunzheri , Picar , Odrie , Cepo

- Nga erozioni të rrezikuara jane tokat e lëna djerrë në në të gjitha fshatrat e braktisura në tëritorin e qarkut

MASA PREVENTIVE :

Me qellim të pengimit të krijimit të ndodhjeve të rreshqitjeve nga vërshimet, shembjeve dhe erozionit në teritorin e Qarkut Gjirokastër përgjatë rrjedhës së lumejve Vjosae e Drino dhe përrenjëve, të cilët përshkojn këte teritor, e me qellim të pengimit të ngjarjeve emergjente, ruajtjes së tokave bujqësore, ruajtjes së ambientit dhe ruajtjes së shendetit të njerzve e ruajtjen e pasuris së tyre, nga bashkitë dhe institucionet të ndermeren këto masa preventive të domosdoshme:

- ✓ Kërkimi i mundësive financiare për rregullimin e shtretërve të lumejve dhe mbrojtseve anësore të brigjeve të tyre me qellim të ruajtjes së tokave bujqësore , akseve rrugore dhe urave.
- ✓ Pastrimi i shtretërve të lumejve nga mbeturinat.
- ✓ Ndalimi i hedhjes së mbeturinave përgjatë rrjedhës së tyre.
- ✓ Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të rerës dhe zhavorit nga shtretërit e lumejve.
- ✓ Ndertimi i pritave për pengimin e grryrjes së shtratit të lumejve dhe ndaljen e bartjes së rerës, zhavorit, gurve dhe materjalit tjetër që bartin rrymat e ujit.
- ✓ Ndalimi i prerjes së drunjëve përgjatë brigjeve të lumejve.
- ✓ Mbjellja bimësisë përgjatë brigjeve.
- ✓ Pastrimi i pritave në shtretërit e lumejve dhe prrojeve nga gurët,zhavori, rëra dhe materjali tjetër,
- ✓ Riparimet e pritave të damtuara,
- ✓ Inspektimi në teren i objekteve të evidentuara në këte vlersim nga inspektoret bashkiak të urbanizmit, bujqësisë dhe ambijentit dhe propozimi i masave sanksionuese.
- ✓ Mos respektimi i normave teknike të punëve ne dhe me rastin e ndërtimit të objekteve ndërtimore, si dhe masat e ndalimit të ndërtimit të objekteve ndërtimore në zonat të cilat janë evidentuar si terene jo stabile.
- ✓ Ndertimin e mureve mbrojtëse për pengimin e proceseve erozive në lumenjtë epërren

Gërryerje, erozion përroi në lagjen “Zinxhira” dhe përroi në lagjien “Mane” Gjirokastër

Rrëzimi i mureve në lagjen “Pazari i Vjetër “Gjirokastër”

3.5. C) RREZIQET NGA PËRMBYTJET

Reference historike

Qarku Gjirokastër karakterizohet si një teritor që preket në mënyrë të shpeshtë nga fenomeni i rreshjeve të dëndura të shiut, përmbytjeve, rrëshqitjeve të tokës, borës e ngricave. Kryesisht, lumenjtë që kanë shkaktuar deri më sot përmbytje të përmasave të konsiderueshme, janë lumenjtë Vjosa me degët e saj prr.Carshovës ,Langaricë , Lemnicë, Deëhnicë , Zagori, Drino , Bencë, e Luftinjë si dhe lumi Drino me degët ; Kserias, Suhës e Kardhiqit.

Duke qënë se pjesa dërmuese e teritorit të qarkut Gjirokastër është një terren me reliev të thyer kodrinor dhe malor dhe me strukturë tokash përgjithësisht zhavorishte në luginat e lumenjve, në raport me reshjet dhe prurjet e shumta të lumenjve dhe përrenjve malorë historikisht përmbytjet kanë qënë me pasoja relativisht më të vogla krahasuar me zonat veriperëndimore të vendit ku mesatarja vjetore e reshjeve është në shifra përafërsisht të barabarta. Megjithatë dëmet e shkatuara nga përmbytjet në 40 - 50 vjetët e fundit kanë qënë relativisht të konsiderueshme në infrastrukturë dhe ekonomi.

Për të konkluduar mund të themi se rreziku i përmbytjeve është shumë i shpeshtë, kryesisht për arsye të shirave shpeshherë të shumta dhe stuhive ose një përiudhe të gjatë të motit te keq, të

shoqëruar me një rrjet te evakuimit te ujërave të shiut dhe me një sistem të alarmimit meteorologjik
Vershimet në qark, të parë në bazë të historikut të ndodhjes së tyre shohim se ato janë të shpeshta (2-3 herë) gjatë vitit dmth me mundësi shumë të mundëshme dhe me një efekt deri të mesëm.

Burimet arkivale si dhe të dhënat e grunmbulluara ,tregojnë se përmbytje të mëdha janë vrojtuar dhe në të kaluarën .Sipas historianëve, gjatë kësaj periudhe, janë vrojtuar 11 vërshime të konsiderueshme të shoqëruara secila me dëme të pasurisë së qytetareve siç janë përmbytjet në vitet 1860, 1865, 1867, 1868, 1869, 1870 dhe 1871. Nga këto përmbytje më e madhja është ajo e vitit 1860. Në pellgun e Vjoses e Drinos ka patur edhe disa përmbytje të tjera në vitet 1937, 1952, 1962-63. Në pellgjet e Vjosë e Drinos ka ndodhur një plotë e madhe në vitin 1937, e cila mendohet të jetë më e madhe se plota e nëntorit 1962. Gjithashtu në pellgun e Vjosës ka ndodhur një plotë e madhe në 1 Janar 1971, e cila konsiderohet si plota më e madhe se ajo e viteve 1937 dhe 1880.

Një ndër përmbytjet më të mëdha të shkaktuara nga lumi Vjosë në të shkuarën jo të largët ka qënë ajo e 31 Dhjetorit 1970 - 1 Janar 1971 e shoqëruar me përmbytjen e 9500 ha tokë bujqësore, shkatërrimin e argjinaturave, kanaleve ujitëse, urave dhe stacioneve të pompimit.
Problematikë kanë qënë reshjet (në rastet kur ndodh mbi mesataren vjetore) e vitit 1978, 1983, reshjet e dëborës në dimrin dhe pranverën e vitit 1986, ku rezultuan dëme të konsiderueshme në ekonomitë bujqësore dhe segmenteve rrugorë, dëmtime të rrjetit elektrik, ujësjellës dhe telefonik në të gjithë territorin e qarkut.
Me pasoja serioze dhe dëme të konsiderueshme në vlera materiale dhe monetare ishin përmbytjet e shkaktuara nga reshjet e shiut në datat 22 deri 26 Shtator të vitit 2002, e prurjeve dhe daljes nga shtrati i lumenjve kryesorë Drino e Vjosë, por dhe e lumenjve të vegjël dhe përrenjeve malorë, shkaktuan përmbytje e dëmtime të rreth 53 shtëpive të banimit (ndërtesa të ulta dhe të kateve të para), u mbytën rreth 130 kokë bagëtive të imta, mbi 2500 ha tokë me kultura bujqësore. U përmbytën nënstacionet elektrik të qytetit të Gjirokastrës, të Grapshit, Memaliajt e Përmetit, duke dëmtuar rëndë rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike ku më problematiku rezultoi ai i qytetit të Gjirokastrës, duke e lënë rrethin pa drita rreth 72 orë, u përmbytën 35 stacione pompimi, u dëmtuan rëndë infrastruktura rrugore në rrugë nacionale Kakavijë - Ballsh dhe Tepelenë - Tri Urat në Çarshovë, mbi 70 % e rrugëve rurale u bënë të pakalueshme, u dëmtua biznesi i vogël, kryesisht ato pranë brigjeve të lumenjeve. Dëmet më të mëdha u shkaktuan në këtë periudhë nga lumenjtë jo shumë në konsideratë, si Drino, Suha, Kseria, Dishnica, Langaricë, dhe përrenjtë e vegjël malorë që në kohë normale janë lehtësisht të kalueshëm për shkak të sasisë së pakët të prurjeve. Nuk pati viktima në njerëz. Dëmi i vlerës monetare arriti në 40.000.000 lek. Ndërprerja e reshjeve çoi në uljen e ujrave deri në largimin përfundimtar të tyre me pasojat e lëna pas.
Edhe gjatë fundit të muajit Tetor të vitit 2003 pati një tendencë të përsëritjes duke qenë se brenda 2.5 orësh u regjistruan më datën 29 tetor, 70 mm shi dhe duke rrezikuar seriozisht nënstacionin elektrik të qytetit të Gjirokastrës.
Dëme të konsiderueshme u shkaktuan në bashkinë e Libohovës me vlerë 5.000.000 lek dhe në ish Komunën Qëndër Libohovë (sot Njësia Administrative Qëndër Libohovë) me vlerë 2.331.095.lek, pasojë e daljes së burimeve dhe përrenjve molorë dhe shkatërrimit të pritave të tyre. Gjithashtu nga rritja e menjëhershme e nivelit të lumit Vjosë u bllokuan dhe u rrezikuan serozisht dy barinj dhe 150 kokë bagëti në Njësine Administrative Qesarat të bashkisë Memaliaj.
Në muajin Shkurt 2004 u krijua e njëjta situatë.
Në datën 31 janar dhe datat 1 - 2 shkurt 2015 si rezultat i reshjeve të konsiderueshme të shiut të rënë për gati 50 orë pa ndërprerje në territorin e Qarkut Gjirokastër, lumi Vjosa në njësitë e vetëqeverisjes vendore: Përmet, Këlcyrë, Tepelenë dhe Memaliaj, si dhe lumi Drino, lumi Suhës,

lumi Kseras në njësitë e vetëqeverisjes vendore: Gjirokastër, Dropull e Libohovë dhe përrenjtë malorë pothuaj dolën nga shtrati i tyre me pasojë përmbytjeje të shoqëruara me rrëshqitje të mëdha të dheut (vidhisje e tokës) kryesisht në segmente të rrugëve nacionale, rurale si dhe ne banesa e përmbytje të tokave bujqësore.

Si rezultat i reshjeve të pazakonta në periudhën 30 nëntor deri 1 - 2 Dhjetor 2017 ranë 279 mm shi si dhe 1-2 Shkurt të 2018 ranë 281 mm shi, ndodhi fenomeni i rrëshqitjes së dheut po thuaj në tërë territorin e qarkut e Gjirokastër, por me pasoja më të mëdha dhe evidente u krijuan në qytetin e Gjirokastrës në disa banesa në lagjen "Cfakë", në pallatin 5 katësh, 1 banesë tre katëshe në lagjen "Punëtori" e më problematiku pallati 8 katësh në lagjen "Kodra e Shtufit" që rrezikoi jetën e banorëve të tyre. Rrjedhjet e tokës u shfaqën edhe në zonën e Izvorit (miniera e Memaliaj) në Njësinë Administrative Luftinjë, bashkia Memaliaj.

Ngjarjet e 03 – 18 Janar 2019 u shoqëruan me borë deri 50 cm në zonat malore (Zagori , Polican , Kurvelesh ,Maleshove , Frashër etj.) dhe 20 cm ne zonat e ulëta (lugina e Vjosës e Drinos) me temperatura të ulëta deri në - 15^{o} C , të cilat sollën bllokime të rrugës nacionale Tepelenë – Kakavijë, Ura e Leklit – Tri Urat, bllokimin e rrugëve në qendrat urbane Gjirokastër, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, rrugëve rrurale sidomos në njësitë administrative të bashkisë Gjirokastër, njësitë administrative Kurvelesh, Buz, zonën e Malëshovës, njësitë administrative Frashër e Zagori. Gjatë kësaj periudhe pati ndërprerje të energjisë elektrike për shkak të difekteve dhe këputjes së linjave elektrike, ndërprerje të mësimit në shkolla etj. Periudha e rikthimit në gjëndjen normale zgjati 1 muaj.

Situata emergjente e shkaktuar nga rreshjet e dendura të shiut vërshimit të prurjeve të lumit Vjosë e Drino, përrenjve kryesor në bashkitë Gjirokastër, Dropull e Përmet në **datën 10.07.2019,** bllokoi disa segmente të rrugës nacionale Gjirokastër – Dropull, grykën e Këlcyrës nga prurjet rrëshqitjet e inertet, rrëzimin e pemëve, në bashkinë Përmet dëmtimin e pasarelës dhe dëmtimin e ujësjellësit të fshatit Kaludh.

Situata emergjente e shkaktuar nga rreshjet e shiut, erërat e forta **më datën 23 – 24 .09.2019** preku bashkinë Gjirokastër e Tepelenë.

Gjatë natës së **datës 23 shtator 2019**, në territorin e bashkisë Gjirokastër pati reshje të shumta shiu e për pasojë u krijuan edhe disa probleme nga këto reshje si bllokime të disa grykë derdhje të përrenjeve në qytetin e Gjirokastrës, tek hotel "Qiqi", shkolla Petagogjike, Ura e Lumit si dhe rreth rrotullimi i stadiumit.

Në lagjen e Viroit pati bllokim të një kanali i cili shkarkonte ujrat në liqenin e Viroit e për pasojë pati mbushje të tij me inerte. Ujrat vërshuan në sipërfaqe të vreshtave e në afërsi të banesave.

Në Njësinë Administrative Lazarat pati bllokim të një rruge që lidh dy lagje. (kjo e ndodhur në shtratin e përroit të Sopotit).

Në Njësinë Administrative Picar probleme pati në rrugën Kolonjë - Golem. Më datën 11.10.2019, u desh ndërhyrja nga mjetet e batalionit të xhenjos të Ministrisë së Mbrojtjes për rehabilitimin këtij aksi rrugor.

Edhe në Njësinë Administrative Cepo, pati probleme në aksin rrugor Taroninë - Fushëbardhë.

Po kështu në Njësinë Administrative Lunxhëri pati probleme nga prurjet e inerteve në rrugë që krijuan probleme të qarkullimit të mjeteve.

Në bashkinë Tepelenë u bllokua në Njësinë Administrative Kurvelesh rruga Kurvelesh - Tepelenë si rezultat i rrëshqitjes massive të dherave mbi rrugë. Më datën 26-28.09.2019, u desh ndërhyrja nga mjetet e batalionit të xhenjos të Ministrisë së Mbrojtjes për zhbllokimin plotësisht të këtij aksi rrugor. Për zgjidhjen e këtyre situatave nga sektori EC janë kordinuar e bashkërenduar veprimet midis bashkive, e institucioneve sidomos me ARSH –në , DMR-në për qarkullimin normal të njerëzve e mjeteve.

Probleme të konstatuara :

Ngjarjet e emergjencës të shkaktuara nga reshjet, treguan drejtimin dhe menaxhimin e situatave për përballimin e saj. Në qoftë se nga ana e institucionit të Prefektit të qarkut u vu re një angazhim maksimal, nuk ndodhi e njëjta gjë në bashkitë e qarkut që nga informacionet, vlerësimin e gjendjes, dhënien e përgjigjes, aktivizimin në kohë të burimeve njerëzore e teknike e deri në konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve.
Gjate menaxhimit të situatave emergjente në fazën e përgjigjes pati vonesa në aktivizimin e burimeve njerëzore dhe teknike sidomos në zhbllokimin e segmenteve rrugore në rrugët rajonale dhe rrurale që lidhin njësitë adminisrative me fshatrat. Për këtë, është e domosdoshme që çdo bashki të krijojë grupet e ndërhyrjes në njësitë administrative si dhe të lidhin kontrata me subjekte private në ato njësi që nuk e përballon dot me forcat dhe mjetet e tyre.
Pothuajse të gjitha bashkite e qarkut Gjirokaster , ku më shumë e ku më pak janë të prekura nga rreziku i vërshimeve(shih hartat e rrezikut), të cilat manifestohen në formën e:
• Vërshimeve pas stuhive në zonat malore,
• Vërshimeve pas shirave të vazhdueshme në luginen e Vjoses e te Drinos
• Vërshimeve pas shkrirjes së borës të shoqëruara apo jo me mot të keq.
Referuar vëzhgimit në vendmatjen pasarela e Përmetit, niveli i arritur i takon vlerës 9 m në hidrometër (laten treguese), që në fakt nuk ekzistonte, por që u përcaktua në bazë të gjurmës që kishte lënë tabela e vendosur në bllokun e betonit për nivelin historik të vitit 2015 (shiko foton më poshtë). Niveli i vitit 1970 ishte 8.58 m dhe për krahasim po japim në tabelën më poshtë nivelet maksimale ndër vite përperiudha perseritje.

Tabela. Nivelet e Vjosës me periudhë përsëritjeje të ndryshme, pasarela Përmet

Perseritja ne vite	10	20	50	100
Niveli ne cm	676	757	861	939
Lartesia mbi nivelin e detit	224.94	225.75	226.75	227.57

Megjithëse intensiteti dhe shpeshtësia e përmbytjeve do të rritet nga shpyllëzimet pa kriter, përmbytjet në teritorin e qarkut mund të karakterizohen kryesisht, si fenomen natyror dhe që lidhen më tepër me kushtet mbizotëruese gjeomorfologjike dhe klimatike. Në këto kushte, zgjidhja e problemit duhet të kërkohet më tepër në masat për zbutjen e efekteve të përmbytjeve
Duke mare parasysh kushtet klimatike që dominojnë në qarkun tonë me shtim të reshjeve atmosferike gjatë sezonave vjeshtë- dimer- pranverë,si dhe disnivelit të burimit te lumenjeve e të përrenjeve deri në teritoret urbane me rrjedhë të fuqishme dhe të furishme e sasi të madhe të ujit, mundësi të bartjes së materjalit drunor,guror, rërës dhe zhavorit plus mbeturinat e hedhura të hekurishtave, betonarmes e te automjeteve ,është konstatuar dhe vlerësuar se këta lumej dhe perenje në mënyrë të pashmangëshme do te dalin nga shtrati duke vershuar jo vetëm token bujqesore por edhe rrezikun te njërëzit dhe shtëpitë e tyre.

Tabela : Përmbytja nga lumenjtë dhe përrenjtë (Zonat e prekura)

Lumi / përroi	Bashkia	Nj.adm/ fshati	Cenueshmeria në faktorët kyc të komunitetit						
			Banore	banesa	Objekt biznesi	Toke Bujqha	Rruge km	Ura/ pasarela	Stacione Pompimi/ Ujesjellsa
Vjosa	Përmet	Carshov/ Carshove	_	_	_	_	_	2	-

		Zhepe	-	-	-	-	-	1	-
		Strembec	-	-	-	-	-	1	-
		Petran/ Kaludh	-	-	-	-	0.3	1	1
		Përmet	5	1	6	3	0.2	-	-
		Piskovë/ Kutal	-	-	-	-	-	1	-
		Bual	-	-	-	-	-	1	-
		Kosinë							1
	Kelcyrë	Kelcyrë	-	-	-	-	-	2	-
	Tepelenë	Tepelenë	50	10	-	0.5	-	-	-
		Q.Tepelë	5	1	1	-	0.4	-	-
	Memaliaj	Memalij	60	15	3	5	-	-	1
		Krahës/ Qesarat	-	-	-	10	0.5	-	-
Drino	Dropull	Dropull i Poshtëm/ Dervican	-	-	-	80	-	1	1
	Gjirokastër	Lazarat Lunxheri	- -	- -	- -	40 30	- -	1 1	- -
		Cepo (Mashkullorë)	-	-	-	80	-	1	1
		Odrie ,	-	-	-	50	-	-	2
Perroi i Madh	Përmet	Përmet	50	15	8	-	0.4	1	1
Perroi Deshnicë	Këlcyrë	Këlcyrë	20	5	2	2	-	1	-
		Ballaban	20	4	2	10	-	2	-
		Sukë	-	-	-	20	-	3	-
		Dëshnic/ Katundishtë	-	-	-	15	-	2	1
		Bëdyqas	-	-	-	25	-	-	1
Lumi Kserias	Dropull	Vrisera	5	1	-	10	0.3	1	-
Lumi Suhës	Libohovë	Suhë	-	-	-	35	-	1	-
Përrenjte Sopot, Cullos	Gjirokastër	Nj.ad.Gjirokastër	50	200	20	50	2	2	1
Liqeni Viroit	Gjirokastër	Nj.ad.Gjirokastër	-	-	1	-	1	1	-
Lumi Kardhiq	Gjirokastër	Kardhiq, Prongji	5	20	1	40	-	1	-

it		Plesat, Kodër Cepun							
Lumi Bencës	Tepelenë	Nj.ad.Tepelenë, Veliqot	5	25	-	15	-	1	-
Lumi Luftinjës	Memaliaj	Martallos, Cërrilë	-	-	-	30	-	1	-

Gjendja aktuale:
Faktorët që ndikojnë në intensitetin e rreziqeve nga erërat e fuqishme konsiderojmë se mund të jenë: distanca nga bregdeti, relievi me vargmale dhe pyje të mbuluara me vegjetacion të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në frenimin natyror, duke zvogëluar intensitetin e erërave, në veçanti në luginat e fushës që e rrethojnë. Përkundër saj konsiderojmë se rreziqet e shkaktuara nga stuhitë nuk mund të nënvlerësohen dhe të përjashtohen. Sa i përket vërshimeve, ato ndodhin më së shpeshti në stinën e dimrit, pranverës dhe në vjeshtës.
Vërshimet në qarkun Gjirokaster zakonisht janë pasojë e reshjeve atmosferike ku prurjet e mëdha të ujit në rrjedhat e lumenjve e perrenjeve që dalin nga shtrati dhe vërshojnë në zonat urbane dhe rurale shkaktojnë dëme të konsiderueshme në infrastrukturë, pronë private, bujqësore, etj. Si pasojë e reshjeve atmosferike dhe vërshimeve në zonat urbane për shkak të rrjetit të vjetruar, kapacitetit të pamjaftueshëm, si dhe mungesës së impianteve për trajtimin e ujërave të zeza,rrisin efektet e dëmeve edhe më shumë.
Kohëzgjatja e çdo lloj vërshimi është relativisht e shkurtër (e shumta 3 - 4 ditë).

Dëshmi lokale: Përfaqësues të komunitetit në qarkun Gjirokaster theksojnë se problematika e përmbytjeve është rreziku më urgjent dhe i kushtueshëm për ta. Pothuajse çdo vit ka përmbytje të tokës bujqësore, por jo gjithnjë me dëme të larta. Përmbytjet domethënëse më të fundit në zonë përmenden ato të para 3-4 viteve (2015 dhe 2017). Kryesisht përmbytjet vijnë si pasojë e problemeve me infrastrukturën teknike, me mirëmbajtjen e kanaleve dytësore e tretësore bujqësore, si dhe përrenjtë malorë. Më poshtë jepet një përmbledhje e problematikave të identifkuara me banorë dhe kryetarë fshatrash:
• Kanalet e dyta dhe të treta, pastrimi i të cilave është përgjegjësi e bashkive, nuk janë pastruar rregullisht ndonjëherë në këto 30 vjet.
• Gërryerja e lumenjeve Vjosa e Drino për shkak të funksionit të linjave të inerteve në shtratin e tij është shkaku i përmbytjeve.
• Problem i madh janë përmbytjet ne te dy luginat. Argjinaturat mbrojtese ashtu dhe nga lumi Vjosa e Drino duhet të mirëmbahen dhe të perforcohen sipas rastit.
• Infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimet përbëjnë problem, por në këtë drejtim pritet një përmirësim në sajë të projekteve te parashikuara ne planet e pergjithshme vendore te bashkive dhe do të përmirësojë infrastrukturën e Ujësjellësit dhe kanalizimet e ujrave të zeza në zonat urbane
• Mbingopja e shtretërve të përrenjve me mbeturina, pasi mungojnë kolektorët e mbetjeve në fshat.
• Shtretërit e përrenjve të pasistemuar, si dhe mungesa / dëmtimi i pritave bëjnë që rruget e fshatrave të tërë në njësitë malore të përmbyten në raste rreshjesh më të gjata se 3 orë

IDENTIFIKIMI I ZONAVE ME RISK TË PËRMBYTJEVE

Nga identifikimi dhe analizimi i deritanishëm i situatës me gjithë punën e bërë vitet e fundit si thellimi i kanalit kullues K-1 që mbron nga përmbytja fushat e Dropullit (bashkia Dropull) dhe Nepravishtës (bashkia Libohovë), rikonstruksioni i argjinaturës së lumit Drino që largoi përmbytjen e tokave të Nj.Ad.Cepo (bashkia Gjirokastër) ose gërryerje e tokave bujqësore në vendin e quajtur kthesa e Subashit, ka ende mjaft pika kritike që paraqesin rrezik

Bashkia Gjirokaster

Dalja nga shtrati i lumit Drino rrezikon:

- **Gëryerjen nga erozioni i urës monument kulture në zonën e Kordhocës e Lazaratit**
- **Përmbytjen e tokave bujqësore në fshatin Mashkullorë rreth 80 ha**
- **Përmbytjen e tokave bujqësore të fshatit Palokastër**
- **Përmbytjen e tokave bujqësore në nj.ad.Cepo , kthesat e Subashit**
- **Përmbytjen e tokave bujqësore në nj.ad.Odrie në fshatin " Andon Poci "**

Dalja nga shtrati i lumit te Kardhiqit rrezikon :

- **Përmbytjen e tokave bujqësore në nj.ad.Cepo të fshatrave Prongji , Kodër ,Plesat e Cepunë me një sipërfaqe reth 40 ha**

Dalja nga shtrati i përrenjeve Sopot,liqeni Viroit rrezikon përmbytjen dhe bllokimin e segmenteve rrugore ;

- **Ne hyrje te fshatit Lazarat 100 m**
- **Varezat e qytetit 50 m**
- **Rrethrrotullimi 50 m**
- **Ura e Lumit 500 m**
- **Virua 1 km**

Bashkia Dropull

Dalja nga shtrati i lumit Drino rrezikon :

- **Tokat bujqësore të fushës së Dropullit nj.ad. Dropull i Poshtëm ,fshati Dervican rreth 80 ha**

Dalja nga shtrati i lumit Kserias rrezikon :

- **Tokat bujqësore të nj.ad.të Dropullit të Siperm , fshati Vrisera rreth 40ha**

Basshkia Libohovë :

Dalja nga shtrati i lumit Drino dhe Suhë rrezikon :

Përmbytjen e tokave bujqësore të fushës së Suhës rreth 90 ha si dhe urën e Zonjës monument kulture

Bashkia Tepelene :

Dalja nga shtrati i lumit Drino rrezikon :

- Përmbytjen e tokave bujqësore të nj.ad.Qendër Tepelenë të fshatrave Hormovë e Luzat rreth 25 ha

Dalja nga shtrati lumit Vjosa rrezikon :

- Përmbytjen e një banese dhe një objekt biznesi si dhe 300 m rrugë nacionale në fshatin Dragot
- Përmbytjen e 10 banesave dhe reth 5ha tokë bujqësore në lagjen e lumit nj.ad Tepelenë

Dalja nga shtrati i lumit te Bences rrezikon :

- Gëryerjen dhe erozionin e tokave në të dy brigjet e lagjes të ish rep. ushtarak dhe te 5 banesave

Bashkia Memaliaj

Dalja nga shtrati i lumit Vjosa rrezikon :

- Përmbytjen e 10 banesave në nj.ad.Memaliaj (qytet)
- Përmbytjen e 10 ha tokë bujqësore nj.ad.Memaliaj

- Përmbytjen e 50 ha toke bujqësore të fshatrave Qesarat, Kalivac

Dalja nga shtrati i perroit te Luftinjes rrezikon

- Përmbytjen e tokave bujqësore të fshtit Martallos e Cerrilë rreth 25 ha

Bashkia Përmet :

Dalja nga shtrati i lumut Vjosa rrezikon :

- Dëmtim të pasarelave , Mesare, Zhepë , Buhal , Kutal
- Përmbytje të 300 m segment të rrugës nacionale Përmet- Carshovë ne vendin e quajtur Redhi Badlonjës
- 400 m segment rrugor rural Dracovë - Zhepë
- Përmbytje të150 m segmentit rugor Ura – Guri Qytetit Përmet
- Përmbytje 4 objekteve të biznesit përgjat rrugës Ura – G. Qytetit
- Përmbytje të një banese në vendin e quajtur ish karburanti ushtrisë
- Përmbytje të siperfaqes së tokës bujqësore rreth 3 ha në vendin Guri Hatos
- Stacionin e pompimit të ujit të pishëm, Guri Hatos
- Stacionin e pompimit teë ujit të pishëm Kosinë
- Erozionin në të dy brigjet e lumit të tokave bujqësore të njësive administrative Carshovë, Petran e Piskovë
- Muret mbajtëse (Pritëse) të ndërtuara për mbrojtjen nga erozioni përgjate bregut të majtë të lumit në lagjen e Re – L. Bajame – Ura – L. Mejden - pasarela e Përmetit.

Vërshimi ujrave të përrenjëve në zonën urbane (Përmet)

Përroi Bardhë rrezikon :

- Banesat e lagjes Sede , Teqe
- Bizneset përgjatë rruges Lagja Bajame - Tregu Kaleshi
- Përmbytje të tregut
- Përmbytje të segmentit rrugor Teqe – Tregu , lagja Bajame – Hotel Redi

Perroi Lipes rrezikon :

- Lagjen Mejden
- Spitalin
- Rruget Spitali – Hotel Ramizi , Spitali – Guri Qytetit

Përenjtë e Dyshit dhe i ish SMT rrezikon :

- Përmbytjen e segmentit rrugor Karburanti – Kryqëzimi i rrugës për në Ersekë
- Banesën tek ish karburanti i ushtrisë
- Dy objekte karburanti dhe një objekt biznesi restorant
- Stacionin elektrik

Bashkia Kelcyrë

Dalja nga shtrati i lumut Vjosa rrezikon :

- Banesat e lagjes në hyrje të qytetit Këlcyrë
- Urën në Grykën e Këlcyrës
- Erozionin në të dy brigjet e lumit të tokave bujqësore të njësive administrative Këlcyrë e Dëshnicë

Dalja nga shtrati i lumit Dëshnicë rrezikon :

- Përmbytjen e 5 banesave dhe 2 bizneseve të lagjes “Ura”të nj,ad. Këlcyrë
- Përmbytjen e tokave bujqësore të njësive administrative : Dëshnicë 35 ha , Sukë 25 ha dhe Ballaban 20 ha .
- Urat e fshatrave Psar , Corogunj , Podgoran , Qafë Sukë , Kodrishtë , Katundishtë
- Erozion të tokave bujqësore në të dy brigjet e lumit përgjatë luginës

Dalja nga shtrati i perroit te Zhepoves rrezikon :

- Përmbytjen e 7 banesave , 3 biznese të fshatit Sukë

- Përmbytjen e 150 m segment rugor
- Urën në hyrje të nj.ad. Sukë

Vershimet e perrenjeve

- Vërshimi i përrenjëve të Bëdyqasit përmbyt 30 m segment rrugor
- Vërshimi i përroit të Goricës përmbyt 50 m segment rrugor
- Vërshimi i përroit të Rodenjit përmbyt 30 m segment rrugor
- Vërshimet e përroit të F. Ri përmbyt 40 m segment rrugor dhe 3 ha tokë bujqësore
- Vërshimi përroit të Varibopit përmbyt 100 m të rrugës nacionale Këlcyrë - Përmet

Foto nga Permbytjet

Liqeni Viroit

Lumi Vjosa Permet

Përmbytje të segmenteve rrugore nga vërshimi i ujrave në qytetin Gjirokastër

Foto te permbytjeve ne Permet

Karakteristika të rrjetit hidrografik

(Shiko përshkrimin gjeografik **)**

Shkaqet kryesore të vërshimeve:

• Reshjet,
• Ndërtimet e pakontrolluara në hapësirat buzë lumenjve,
• Hedhja e mbeturinave të ngurta në lumenj,
• Mungesa e mirëmbajtjes së shtretërve të lumenjve dhe argjinaturave.

Faktorët e përkeqësimit:

• Rrjeti i dendur hidrografik,
• Pjerrtësia e lehtë e lumenjve,dhe e madhe e perrenjeve
• Intensiteti dhe kohzgjatja e reshjeve,
• Thellësia e pamjaftueshme e shtretërve të lumenjve,
• Vegjetacioni,
• Prania e pengesave në qarkullimin e ujërave.

Skenarët e mundshëm:

Vërshimet e lumenjeve

• Vërshimet e shkaktuara nga përrenjte vërshues,
• Vërshimet e shkaktuara nga rritja progresive e ujërave.

Pasojat: Rreziqet nga vërshimet në qark kanë shkaktuar lëndime, pasoja traumatike në njerëz, dëme të konsiderueshme në të mirat materiale, infrastrukturë kritike, objekte të rëndësisë së veçantë, trashëgimi kulturore, mjedis si dhe në ekonomi.

Periudhat e rrezikut nga vërshimet: Janë dy periudha sezonale gjatë vitit që karakterizohen me vërshime:

• Sezoni dimërore që manifestohet me reshje të shumta të borës, dhe
• Sezoni pranverore dhe vjeshtore që manifestohet me sasi më të shumta të reshjeveshiut.

Reshjet: Në bazë të dhënave historike gjatë dhjetë viteve të fundit nga statistikat e stacioneve meteorologjike rezulton se reshjet më të dendura të borës gjatë vitit është dimri në muajt Janar dhe Shkurt, kurse stinët me reshjet më të dendura të shiut janë Pranvera (Prill- Maj) dhe Vjeshta (Shtator-Tetor).

Temperaturat: Klima është kryesisht kontinentale me disa ndikime mesdhetare dhe alpine, verërat janë të nxehta dhe dimrat të ftohtë. Temperaturat ekstreme shkojnë deri në 39/40°C në verë dhe – 10°C në dimër. Relievi është i ndryshueshëm me variacione termike të mëdha në mes të zonave më të nxehta dhe atyre më të freskëta (ftohta). Temperaturat si faktor zakonisht pak ndikojnë në ndjeshmërinë e vërshimeve përveç ndoshta në dy situata krejt të veçanta.

Era: Është një teritor qe në përgjithësi që nuk goditet me shpeshtësi të madhe të erërave të cilat kryesisht janë të intensitetit të mesëm dhe të ulët, ku drejtimi i erës kryesisht është nga veriu.

Valët e të ftohtit, bora: Temperaturat mesatare dimërore mund të arrijnë deri në – 10°C ku bora është më e shpeshtë në zonat malore

Thatësia:. Qarku është një vend me sipërfaqe të konsiderueshme rurale ku gjatë sezonës verore mund të ketë periudha më të gjata të vapës që kryesisht manifestohen me mungesa të mëdha të të reshjeve atmosferike të cilat mund të shkaktojnë thatësi, ku mungesa e ujit është e madhe.



Përfundime lidhur me menaxhimin e zonave me rrezik të lartë përmbytjeje ne qark.

Siç u përmend edhe më sipër permbytjet dhe vershimet e ujerave , janë një dukuri e natyrshme në kushtet fiziko-gjeografike të qarkut tonë që karakterizohet prej një reliev shumë malor, prej rrebeshesh e shirash me intensitet shumë të lartë, me lumenj me shpate shumë të pjerrët etj. Në këto kushte mund tëmerren masa vetëm për zvogëlimin e pasojave të dëmshme të shkaktuara nga përmbytjet e plotave. Këto masa mund të klasifikohen në dyllojesh: masa afatshkurtra dhe masa afatgjata.

Masa afatshkurtra

Masat afatshkurtra janë masa që konsistojnë në punime të karakterit lokal, me kosto relativisht të vogël dhe që mund të kryhen brenda një stine apo viti nga bashkite e qarkut. Ato konsistojnë në punime mirëmbajtjeje si dhe në masa organizative që synojnë të paralajmërojnë organet përkatëse dhe popullsinë sa më parë të jete e mundur. Në mënyrë të përmbledhur këto masa janë: Masa për

• Përmirësimin e punës të sistemit të kanaleve, sidomos të atyre të ujërave të larta dhe hidrovorëve.
• Organizimi i shërbimit të paralajmërimit të përmbytjeve, nepermjet pikave te monitorimit Carshove , Permet , ura e Leklit , ura e Memaliajt do të informojë në mënyrë të rregullt bashkite dhe prefekturen mbi reshjet dhe gjendjen e lumenjve në raste përmbytjesh.
• Ndërmarrja e një studimi mbi permbytjet dhe vershimet e ujerave duke përfshirë të dhënat e viteve 2015-2020.

Masa afatgjata

• Kryesore është zbatimi me rigorozitet i masave që përcakton Strategjia për Menaxhimin e Zonave me Rrezik të Lartë Përmbytjeje ne qark. Kjo strategji bazohet mbi ligjin përkatës mbi emergjencat i cili ngarkon bashkite dhe institucionet e qarkut të hartojnë Plane bashkiake apo zonale për menaxhimin e këtyre zonave duke gjetur pasqyrim ne planet e pergjithshme vendore te cdo bashkie si p.sh:

o Përcaktimi i zonave me rrezik të larte përmbytjeje dhe i dëmeve që shkaktohen nga përmbytjet me madhësi të ndryshme

o Organizimi periodik i fushatave për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës dhe organizatave publike për dëmet nga përmbytjet

• Evidentimi i gjendjes së argjinaturave dhe marrja e masave të nevojshm për rehabilitimin e argjinaturave në të dy brigjet e lumenjve, (pjesërisht ne Vjose dhe Drino)
• Mbrojtja e zonave me erozion të theksuar me prita malore e pyllëzime,,pergjate lumit Vjosa , Drino si dhe degeve te tyre , lumenjeve Deshnice , Kserias , Suhe , Kardhiq, Bence e Luftinje etj., masa këto që do të ndikonin në zvogëlimin e permbytjeve
• Studimi i normave ekzistuese të modulit të kullimit të tokave me synim rillogariten e tyre

Nga studimet e kryera, institucionet përgjegjëse kanë konkluduar se për shmangien e situatave të emergjencës është kërkuar çelja e investimeve për riparimin e argjinaturave, mbrojtjen nga gërryerjet, rehabilitimin e veprave të marrjes dhe rivënien në gatishmëri të shkarkuesve katastrofik.

Nga lumi Drino rrezikohen nga gërryerja e tokave bujqësore të fshatit Palokastër dhe kërkohet ndërhyrje duke bërë sistemimin e shtratit të lumit për një gjatësi prej 600-800 ml si dhe kërkohet rikonstriksion i argjinaturave mbrojtëse në këtë zonë. Rehabilitimi i saj siguron mbrojtjen në total një sipërfaqe toke bujqësore prej 500 ha.

Mbrojtja nga gërryerja nga lumi Drino i Urës Monument Kulture zona Kordhocë në Lazarat. Mbrojtja nga gërryrjet e lumit Drino i tokave bujqësore në fshatin Dervician. Po kështu problem mbeten tokat bujqësore të fshatit Mashkullorë rreth 80 ha nga gërryerja dhe përmbytja nga lumi Drino. Nga lumi Kserias në Njësinë Administrative Dropulli i Sipërm rrezikohen gërryerje dhe përmbytje tokash bujqësore si dhe qendra e banuar e fshatit Vrisera rreth 300 ml.

Mbrojtja dhe gërryerja nga lumi Suhës i tokave bujësore të fshatit Suhë si dhe kërkohet sistemim i shtratit të lumit për një gjatësi prej 600-700 ml, kjo në zonën ura e Zonjës Monument Kulture ku në krahun e majtë të rrjedhjes së tij ka tokat bujqësore të fshatit.

Rehabilitimi i sistemimit të lumit të Suhës siguron mbrojtjen në total një sipërfaqe toke bujqësore prej 400 ha.

Lumi i Kardhiqit në zonën e fshatit Kardhiq gërryen, përmbyt dhe zhavoron tokat bujqësore të fshatrave Prongji, Kodër e Çepunë për një sipërfaqe prej 40 ha.

Në bashkinë Këlcyrë nga lumi i Dëshnicës kërkon mbrojtje nga gërryrja e zonës të Ballbanit, po kështu nga ky lumë kërkon mbrojtje nga gërryrja e zonës të fshatit Kodrisht rreth 30 ha tokë bujqësore.

Edhe lumi Vjosa gërryen e përmbyt tokat bujqësore në nj.ad. Qesarat bashkia Memaliaj, në njesine administrative Qender Tepelene , Erozion te tokave bujqesore ne luginen e Vjoses ne nj.ad.Carshove , Petran e Piskove te bashkise Permet

Profili i rrezikut

KATEGORIA E RREZIKUT :	Hidrologjike
LLOJI :	Fatkeqësi natyrore
RREZIKU :	Përmbytje (Vërshime + Erozion)
VENDNDODHJA :	Teritori qarkut Gjirokastër

Rreziku : Përmbytje (Vërshime + Erozion)	
Madhësia e mundshme : (Përqindja e goditjes së kmunitetit) E mesme 10 - 15%	
Frekuenca e ndodhjes : Shumë e mundshme : Mundësia deri ne 50% , e paketa 2 herë ne vit	Modeli sezonal : Pranverë (Mars – Prill) Vjeshtë (Tetor – Nentor) Dimër (Dhjetor – Janar – Shkurt)
Zonat që mund të goditën më shumë : Bashkitë ; Gjirokastër , Dropull ,Tepelenë , Memaliaj, Përmet dhe Këlcyrë .	
Kohë zgjatja e mundëshme : 2 – 4 ditë	
Koha e mundëshme e paralajmerimit : Paralajmerim minimal **,** 6 – 12 orë , 12 – 24 orë dhe paralajmerim më shumë se 24 orë .	
Sistemet ekzistuese të paralajmerimit : IGJUEM , Sistemi itegruar i lajmërimit 112, Policia e shtetit 129 , shërbimi zjarrfikës dhe shpëtimi 128, stacionet e monitorimit në lumin Vjosa dhe Drino	
A ekziston analiza e dobesive / cenueshmerise ? Po	

Goditja e faktorëve kyc të komunitetit

PROFILI	PASOJAT E MUNDËSHME	SHKALLA E GODITJES
Banorët	Dhjetëra vdekje dhe qindra lëndime të rënda, për shkak të goditjes së valës së ujit, rrënimeve, dhe prurjeve të materialeve të ngurta	E Lartë
Pasuria	Në zonat e goditura nga vërshimet uji depërton në oborret dhe shtëpitë e qytetarëve, duke shkatërruar pasurinë, dhe të mirat materiale të qytetarëve	E Lartë
Infrastruktura	Dëmtimi i ujësjellësit, kanalizimit, energjisë, tokave të bukës,teknologjisë informative	E Lartë
Objekte të rëndësisë së vecantë	Dëmtimi i objekteve shkollore, objekteve qeveritare, rrugëve, urave etj.	E Lartë
Ambienti	Për shkak të prurjeve të mëdha të ndryshme, llumit dhe kontaminimit, dëmtohet mjedisi.	E Mesme
Dëmet ekonomike	Shkatërrim dhe dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E Mesme
	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe	

Shërbimet shtetërore	shërbimeve për qytetarë	E Mesme
Shërbimet e emergjencës	Dëmtime të pajisjeve të njësive reaguese (operacionale)	E Mesme

SKENARI (Niveli i rrezikut i mesëm)

Ngjarja : Përmbytje (Vërshimi ujërave)
Shkaku : Rreshjet intensive dhe shumë intensive të shoqëruara me stuhi
Koha : 31 janar – 4 shkurt

Situata e përgjithshme :

Në periudhën 31 janar – 4 shkurt, si pasojë e reshjeve të shumta të shiut (280 mm) që përfshine gjithë teritorin e qarkut Gjirokastër, lumi Vjosa dhe degët kryesore të saj Carshovë , Langaricë , Lemnicë, Dëshnicë, kanë rritur nivelin e ujit në 7 m sipas vrojtimeve në hydrometër (Pasarela e Përmetit).Nga shtrati në disa pjesë të gjatesisë së tij ka dalë lumi Drino si rezultat i prurjeve të degëve të tij Kserias , Suhë , Sopot ,Viroit , Kardhiqit . Niveli i prurjeve i matur në uren e Leklit tregon 5m. Dalje nga shtrati ka patur dhe nga lumi i Bëncës e lumi i Luftinjës .Prurjet e këtyre lumenjëve kanë shkaktuar përmbytje në toka bujqësore dhe vërshime të ujerave në zonat urbane të bashkive të qarkut duke rrezikuar njerëz , gjënë e gjallë dhe dëmtuar prona e infrastrukturën , paralizimin e shërbimeve emergjente e shërbime ndaj komunitetit..

Zona e emergjencës , ndikimi , cënueshmëria :

Përfshinë gjithë teritorin e qarkut (Bashkitë: Gjirokastër , Dropull, Libohovë , Tepelenë , Memaliaj , Kelcyrë e Përmet)

Nga raportimet e para nga shërbimet monitoruese situata emergjente e shkaktuar nga rreshjet është kjo :

Në bashkinë Gjirokastër

- Shkarje masive e dheut në lagjen “Kodra e Shtufit” duke rrezikuar pallatin 7-katësh dhe në rrezik më të madh tre banesa private mbi rrugën e dëmtuar. Përmasat e pjesës së dëmtuar 30×15×10 ml.
- Në tre banesa të Lagjes “Cfakë”, ka çarje të mureve mbajtës dhe dëmtimi i banesave nga depërtimi i ujrave dhe dherave në katet e para dhe oborret e shtëpive.
- Në zonën e Teqesë së Zallit janë dy banesa të përmbytura nga uji dhe çarje të 20 m segment rrugor. Kati parë dy pallateve (ish Star - Market) është i përmbytur nga vërshimi i ujrave.
- Përmbytje nga vërshimi i ujrave i segmentit rrugor me gjatësi 200 m tek Ura e Lumit.
- Përmbytje e Urës së Viroit dhe 300 m segment rrugor i rrugës nacionale (Niveli i ujit 30 cm mbi Urë).
- Rruga nacionale Gjirokastër - Sarandë në zonën e fshatit Lazarat e bllokuar kalimi i automjeteve bëhet vetëm në një korsi.
- Bllokim i rrugës nacionale me gjatësi 50 m tek ura e Varrezave të qytetit nga prurjet e përroit.
- Bllokim rruge 20 m segment rrugor tek Unaza në Gërhot, 10 m^3 inerte.

- Rruga në lagjen “Palorto” për në shkollën “Urani Rumbo” tek familja Kadëna, ka dëmtime të shtresës së betonit me gjatësi 25 m, uji ka dal poshtë betonit.
- Argjinatura e fushës së Mashkullorës ka çarje tek kthesa e Viroit në një gjatësi rreth 60 ml.
- Përmbytje të fushës së Mashkullorës në një sipërfaqe rreth 50 ha nga dalja e lumit Drino.
- Rruga e fshatit Palokastër e dëmtuar rëndë, e kalueshme por me rrezik të lartë shëmbjeje në një gjatësi rreth 150 ml.
- Në fshatrat Karjan dhe Palokastër si rezultat i çarjes së argjinaturës mbrojtëse u përmbytën sipërfaqe toke me pemë frutore.
- Dëmtimi tubacionit të ujësjellësit në Lagjen “Zinxhira”.
- Në fshatin Kardhiq përmbytje dhe gëryerje të sipërfaqes së tokës nga dalja e lumit të Kardhiqit.

Në bashkinë Dropull

- Në njësinë administrative Dropull i Poshtëm në fshatin Dervician janë 10 banesa pjesërisht të përmbytura.
- Në fshatin Vrisera 100 ha të përmbytura si dhe gërryerje të tokës bujqësore në të dy anët e lumit Drino.
- Urë e dëmtuar në fshatin Likomil dhe ura që lidh fshatrat Llongo - Koshovicë e dëmtuar.
- Bllokuar 50 m segment rrugor i rrugës nacionale në Dervican nga prurjet e përroit.
- Në fshatin Vrisera gërryerje nga lumi Kseras në krah të djathtë të rrjedhjes në pjesë të rrugës Vrisera - Llongo si dhe gërryerje të argjinaturës mbrojtëse që mbron qendrën e banuar dhe disa objekte biznesi. Gjatësia e përshkuar nga gërryerjet 1.5 km si dhe dekantim të madh aluvionesh.
- Rruga Likomol - Klishar në Njësinë Administrative Dropull i Sipërm është 1 km e dëmtuar

Në bashkinë Libohovë

- Në Njësinë Administrative Zagori është i bllokuar nga dherat aksi rrugor Nivan - Konck - Nderan - Topovë.
- I bllokuar është edhe aksi rrugor Poliçan - Sheper.
- Një banesë e dëmtuar në Hoshtevë, njësia administrative Zagori.
- Në Hoshtevë e shkatërruar ura e fshatit.

Në Bashkinë Tepelenë

- Në njësinë administrative Kurvelesh, aksi rrugor Lekdush - Tepelenë 50 m vazhdon të jetë i bllokuar. Po punohet për hapjen e rrugës.
- Në rrugën nacionale Tepelenë (Uji i Ftohtë) bllokim rruge, po punon një mjet tip “Fadromë” për pastrimin e inerteve.
- Njësia administrative Kurvelesh pa energji elektrike.
- Bllokim i rrugës nacionale Ura e Leklit - Këlcyrë në Dragot si rezultat i rrëshqitjes së tokës rreth 60 m.
- Bllokim i aksit rrugor Ura e Leklit - Këlcyrë në kufirin ndarës midis dy bashkive në Grykën e Këlcyrës

Në Bashkinë Memaliaj

- Ndërprerje të shkurtra të ujit të pijshëm nga dëmtimi në rrjet.
- Në Njësinë Administrative Qesarat kemi dalje të lumit Vjosa nga shtrati ku janë përmbytur 10 ha tokë bujqësore.
- Bllokimi i sgmentit rrugor Memaliaj - Luftinjë në vendin e quajtur Sektori i Tretë nga rrëshqitja e aksit rrugor 30 m.
- Të bllokuara rrugët e fshatrave Maricaj, Arrëz e Madhe, Vagalat të Njësisë Administrative Luftinjë si dhe të fshatrave të Njësisë Administrative Buz.
- Ndërprerje e energjisë elektrike në Njësitë Administrative Luftinjë e Buz.
- Depërtimi i ujrave në katet e para të lagjes "1 Maji" në qytetin Memaliaj dhe në disa biznese.

Në Bashkinë Përmet

- Bllokim i segmentit rrugor Përmet - Çarshovë në vendin e quajtur Rethi i Badlonjës si rezultat i daljes nga shtrati i lumit Vjosa (Përmbytje 300 m rrugë nacionale).
- Bllokim i segmentit rrugor Përmet - Çarshovë në vendine quajtur Rethi Badlonjës si rezultat i rreshqitjes së dherave dhe rrokullisjes së gurëve rreth 20 m^3.
- Përmbytje segmentit rrugor Guri i Qytetit 150 m nga dalja e lumit Vjosa.
- Rrëshqitje e aksit rrugor 50 m në vendin e quajtur Kthesat e Zhepës (Rrugë nacionale).
- Përmbytje e stacionit të pompave të ujit të pijshëm "Guri Hatos" Nj. Ad. Përmet.
- Përmbytje stacionit të pompës së ujit të pijshëm Kosinë, Nj. Ad. Piskovë.
- Të bllokuara rrugët rurale të Nj. Ad. Frashër (Miçan, Vërçisht, Zavalan, Ogren) si rezultat i shkarjes së dherave dhe prurjeve të përrenjve.
- Ndërprerje të energjisë elektrike në NJ. Ad. Petran, Çarshovë dhe Frashër si rezultat i këputjes së linjave dhe difekteve nga erërat e forta.
- Përmbytja e një banese në qytetin Përmet.

Në Bashkinë Këlcyrë

- Aksi rrugor Këlcyrë - Sukë rrëshqitje të dherave dhe gurëve.
- Rrëshqitje të dherave në fshatin Shtikë.
- Rrëshqitje të dherave dhe bllokim të aksit rrugor Mbrezhan - Malëshovë.
- Në akset rrugore Ballaban - Psar dhe Ballaban - Pavar - Kajcë ka rreshqitje të dherave nga ana e poshtme e tyre dhe ka ngushtim të rrugëve dhe rrezikon të këtë bllokim të plotë të tyre.
- Pjesa tjetër e rrugëve rurale ka pasur mbushje me dhera nga prurjet e shumta të përrenjve malorë megjithse janë të kalueshme kanë nevojë për ndërhyrje e pastrim të tyre.
- Urat e fshatrave Podgoran-Fushë dhe Podgoran kanë dëmtime në këmbët e tyre për shkak të zhveshjes së shpatullave dhe gërryerjes në thellësi.
- Rezervuari i Këlcyrës për shkak të prurjeve të mëdha të cilat nuk u përballuan nga shkarkuesi katastrofik pati rrjedhje të ujrave edhe nga ana e digës. Me ndërhyrjen që u realizua duke vendosur thasë me rërë e granil u evituan rrjedhjet anësore në anën e digës

dhe u mbajt nën vëzhgim nga shërbimi MZSH-së deri sa ra niveli i ujit në parametrat e duhur teknik.

- Përmbytje të sipërfaqes së tokës në fshatin Bedyqas Nj. Ad. Dëshnicë rreth 3 ha.

Nevojat emergjente :
Evakuimi të prekurve , pritja , strehimi sigurimi ushqimeve ,veshmbathje, dhënia e ndihmës së parë dhe sigurimi rrugor për qarkullimin e njerëzve dhe të mjeteve.
Strukturat e përfshira në momentin e parë :
Mbledhja e Komisionit të Mbrojtjes Civile (qark ,bashki) , caktimi drejtuesit të operacionit , zbatimi i planit në fazën e përgjigjes etapa e aktivizimit , aktivizimi forcave operacinale (Stacionet e MZSH-ve , Shërbimet e urgjencës , forcat e DMR-s ,forcat e policisë së shtetit (Drejtoria e policisë qarkut , komisariatet , postat e policisë ne bashki) dhe strukturave mbështetëse të bashkive si dhe institucionet qëndrore në nivel vendor.
Kohëzgjatja e mundëshme :
2 – 4 ditë
Rikthimi në gjëndjen normale :
Një muaj

3.5. D) VLERËSIMI I RREZIKUT NGA CARJA E DIGËS SE REZERVUARËVE

IDENTIFIKIMI RREZIKUT

KATEGORIA E RREZIKUT :	Hidrologjike
LLOJI :	Fatkeqësi natyrore , dhe nga dora e njeriut
RREZIKU :	Shpërthim dige rezervuari
VENDNDODHJA :	Teritori qarkut Gjirokastër

PROFILI RREZIKUT	
Rreziku : Shpërthim dige	
Madhësia e mundëshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): E lartë	
Frekuenca e ndodhjes : E mundëshme	**Modeli :** Gjatë vitit
Zonat që mund të goditen më shumë :	
Kohëzgjatja e mundëshme :1 – 2 ditë	
Koha e mundëshme e paralajmerimit : Pa paralajmërim ose paralajmërim minimal	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit : Nuk ka .	
A ekziston analiza e dobësive / cënueshmëria ? Po	

CËNUESHMËRIA NGA GODITJET NË FAKTORËT KYC TË KOMUNITETIT

PROFILI	PASOJAT E MUNDËSHME	SHKALLA E GODITJES
Banorë	Vdekje , lëndime të rënda ,përmbytje masive	E Lartë
Pasuria	Shkatërrim /dëmtim i pasurisë private dhe publike	E Lartë
Infrastruktura vitale	Shkatërrim / dëmtim i rrjetit energjetik ,ujësjellësit dhe kanalizimit, infrastruktura rrugore , etj.	E Lartë

Demet ek0nmike	Shkatërrim / dëmtim i përgjithshëm i zonës së goditur	E Lartë
Ambienti	Shkatërrim / dëmtim i mjedisit.	E Lartë
Trashgimia kulturore	Shkatërrim/ dëmtim i trashëgimisë kulturore, në objekte dhe arkeologji	E Lartë
Shërbimet shtetërore	Dëmtim /paralizim i infrastrukturës shtetërore.	E Lartë
Shërbimet emergjente	Shkatërrim/ dëmtim i pajisjeve të shërbimeve operacionale emergjente	E Lartë

Ngritja e digave të rezervuarëve dhe ndërtimi i tyre ka nisur 65 vjet me parë të cilat u ndërtuan për qëllime bujqësore. Sot në qarkun Gjirokastër ka … rezervuar. Të gjitha digat janë te ndërtuara me mbushje dheu . Lartesia e digave arrin nga 10 – 60 m . Rezervuarët në radhë të parë janë ndërtuar për nevoja të bujqësisë dhe të ujitjes .

Kushtet ekzistuese

Projektimi dhe ndërtimi digave është mbështetur në një analizë të gjithëanshme të gjitheë proceseve të ndërtuara prej njeriut , që mund të prekin sigurinë operative të vetë digës dhe të gjithë sistemit digë – rezervuar. Për të siguruar kufijtë e sigurisë së projektuar gjatë gjithë periudhës së ekzistencës , rëndësi të dorës së parë ka mirëmbajtja e rregullt e sistemeve gjatë shfrytezimit të tyre. Mirëmbajtja e rregullt dhe e frytshme duke perfshirë reabilitimin në kohën duhur , janë në vecanti thelbësore për sistemin dige – rezervuar me dhe e gurë.Me vjeterimin e digave siguria e punës së tyre bëhet problem. Kjo kërkon me shumë vëmëndje në formën e inspektimeve , vlerësimeve , modifikimeve dhe përmirësimit të digave të vjetëruara në mënyrë që të përballojnë standartet dhe rregullat e teknolgjisë së kohës.

Vëzhgimi digave të rezervuarëve për gjëndjen si dhe rreziqet që ato paraqesin janë të paraqitura në tabelat e shtojcës (Shih shtojcën e rezervuarëve)

Poshtë digave të rezervuarëve , pronat materiale që janë të ekspozuara , përfshijnë : Shtëpi banimi , strehime për kafshët , objekte biznesi , tokë bujqësore të kultivuar , infrastrukturë rrugore , sisteme kanalizimi etj.

Shumica e defekteve të konstatuara lidhen me :

- Problemet e shpatit (rrëshqitje ose dëmtime .)
- Trupit të digës (zgjerim i digës , plasaritje , deformim i digës , rrjedhje , deportime .)
- Keqfunksionim ose dëmtimin e instalimeve për largimin e ujit (dëmtim të sistemit hidraulik , dëmtime ose bllokime të sistemeve të daljes së ujit .
- Depozitimi i sedimenteve prej rjedhjes së përroit (**Të gjithë rezervuarët**)

Një pjesë e digave kanë nevojë dhe vuajnë nga problemet e vjetërsisë , disa kanë mungesa teknike dhe të gjitha vuajnë nga mungesa e mirëmbajtjes . Një pjesë e mirë e tyre kanë nevojë për ndërhyrje , ku përvec fondeve të mirëmbajtjes kërkojnë një modifikim të ndjeshëm për përmirësimin e tyre

Emergjencat e lidhura me digat e rezervuarëve në qarkun Gjirokaastër që kërcënojnë jetën e popullsisë poshtë tyre nuk njihen . Defektet e përcaktuara dhe keqfunksionimi i disa elementeve të digës në vecanti nuk janë aq të mëdha sa për të shkaktuar ndonjë katastrofë me pasoja të rënda gjatë regjimit të rregullt të shfrytëzimit të këtyre instalimeve , nga pikëpamja e grumbullimit në kohë ato e shtojnë ndjeshëm potencialin e përgjithshëm . Në rast të një ndikimi të madh të agjenteve të tjerë negative natyrore,si tërmeti me zgjatje të madhe dhe i fuqishëm , dobesitë e përcaktuara fare lehtë mund të kthehen në shoqerues të mëdhenj të fatkeqesisë sidomos për rezervuarët

Rreziqet nga carja e digave lidhet me :

- Prishja e pjesëshme ose totale strukturore të digës me mbushje dheu ose guri të shkaktuar nga rjedhja e ujit nëpër trupin e digës si pasje e daljes së tij si rrjedhë , krisjes së digës ose ndonjë prishje e madhe e shpatit të digës.
- Kapërcimin e kreut të digës për shkak të kapacitetit të pa mjaftueshëm të largimit të ujit, të rrëshqitjeve të mëdha të dheut në rezervuar , të gabimeve në vprime etj.

Parametrat kryesore të carjes / prishjes së digës janë ; koha e carjes ,trajta e carjes ,thellësia e carjes dhe shpejtesia e shëmbjes së elementeve të digës . E përbashkëta e dukurive të renditura për carjen e digës është përmbytja është përmbytja e menjëhershme nga përhapja tatepjetë e një dallge me energji të madhe . Ky është rreziku më i madh i carjes së digës për popullsinë poshtë dhe pronën materiale. Ka dhe rreziqe të tjera , por përmbytja e menjëhershme tatepjetë është dukuria me pamjen me katastrofike dhe me pasojat më të rënda për zonat poshtë digave të rezervuarëve.
Parametrat e dallgës së përmbytjes varen nga :

- Tipi digës
- Gërryeshmëria e trupit të digës ose pritësve në rast se uji kapërcen nga sipër.
- Vëllimi dhe energjia e ujit që del
- Dinamika e rjedhjes tatepjetë të dallgës përmbytëse

Shkaqet natyrore antrapogjenike që mund të sjellin ngjarje të tilla të skajshme janë :

- Rrëshqitja e madhe e menjëhershme e dheut brenda rezervuarit
- Një tërmet i fortë
- Ardhja e ujërave përmbytëse për një katastrofë , veprimi të cilave nuk mund të asnjanësohet prej veprimeve të mundshme në sistemin e digës së rezervuarit.
- Gabime të ndjeshme në projektin e digës gjatë ndërtimit ose punës së saj.
- Aktet teroriste

Arsyet e emergjencës së carjes së digës

FENOMENI	PERSHKRIMI SHKURTER DHE ARSYETIMI
Përmbytje	Prurje të jashtëzakonshme së bashku me kapacitet të kufizuar të shkarkuesve
Tërmete	Tërmet i mjaftueshëm për të dëmtuar digën
Akte teroriste	Aktet terroriste, lëndët eksplozive në diga ose elementet e tjera kryesore, aktet e vandalizmit
Masivet rrëshqitës	Masivët rrëshqitës shumë të mëdhenj që bien në basenin e rezervuarit ose pranë digës, të mjaftueshëm për të dëmtuar digën
Mos funksionimi shkarkuesve katastrofik dhe veprës së marrjes së ujit	Mosfunksionimi i plotë ose i pjesshëm i portave si rezultat i ndërprerjes së energjisë, i dëmtimit në sistemin e lëvizjes së tyre ose i mirëmbajtjes
Probleme të tjera	• Rritja e rrjedhjeve • Zhvendosjet • Plasaritjet ose çarjet • Prishja e elementëve elektromekanikë • Sjellja strukturore e pazakontë • Mbushja me llum

SKENARI 1. I MUNDSHEM

Rasti kur, nëse nuk do të ishin zbatuar masa korrigjuese (teknike, operacionale, shkarkim i ujit të digës etj.), mund të shkaktohej dëm i rëndë dhe i rrezikshëm ose prishje e digës, megjithëse situata mund të përballohej me siguri duke zbatuar masat dhe mjetet në dispozicion dhe ndihmen e bashkive fqinje

Lloji i rrezikut : Carja e diges se rezervuarit

Niveli i rrezikut: I larte

Zona e emergjences : Rezervuari i Kelcyres (Qyteti Kelcyre)

Situata e pergjithshme : Rreshjet intensive dhe shume intensive te rena prej dates 01.12 – 03 .12 kane shkaktuar prurje te medha te perroit qe derdhet ne rezervuarin e Kelcyres dhe si rezultat eshte ngritur niveli i ujit ne piken kritike . Prurjet e medha te perroit jane duke sjelle material drusor , gure e llum te cilat kane bere te mundur bllokimin e dy shkarkuesve katastrofik dhe vepren e marrjes se ujit . Jane verejtur shenjat e para te kapercimit te te ujit mbi digen e rezervuarit ,

Ne kete gjendje dhe nga efekti i peshes te materialit te grumbulluar, diga veshtire se mund te perballoje gjate ne qofte se nuk nderhyet per pastrimin e kanaleve te shkarkuesve katastrofik te cilet jane ne te dy krahet e rezervuarit

Carja e dige se rezervuarit rrezikon jeten e 30 familjeve (30 banesa) me rreth 120 banore ne lagjen ne hyrje te qytetit Kelcyre, nenstacionin elektrik , teqene e kelcyres , nje pike karburanti dhe 3 biznese , permbytjen e 35 ha toke me prodhime bujqesore e vreshtari ,pronen e pasurine , gjene e gjalle te ketyre familjeve ,0.7 km segment i rrugs nacinale Kelcyre – Permet , 1.5 km rruge rurale

Nevojat emergjente : Evakuimi te prekurve (30 familjeve 120 banore) , pritja , strehimi sigurimi me ushqim ,veshmbathje, dhenia e ndihmes se pare dhe sigurimi rrugor per qarkullimin e njerezve dhe te mjeteve.

Aktivizimi i forcave dhe mjeteve te bashkise si dhe ato te njesive vullnetare te fshatit per pastrimin e zhbllokimin e kanaleve te shkarkimit katasrofike te rezervuarit.

Kerkese per ndihme bashkive Permet e Tepelene per mbeshtetje me forca e mjete te njesive zjarrfikese

Kerkese Prefektit te Qarkut per mbeshtetje me forcat tokesore

Strukturat e perfshira ne momentin e pare : Mbledhja e Komisionit te mbrojtjes Civile , caktimi drejtuesit te operacionit , zbatimi i planit ne fazen e pergjigjes etapa e aktivizimit , aktivizimi forcave operacinale (Kom.Policise . Stacioni MZSH , Sherbimi urgjences) dhe strukturave mbeshtetese te bashkise

Kohe zgjatja e mundshme : 24 ore

Rikthimi ne gjendjen normale : Nje jave

SKENARI 2.

Niveli rrezikut shume i larte

"Ekziston rreziku i thyerjes së digës ose i shembjes katastrofike të digës dhe nuk ka asnjë garanci që kjo mund të kontrollohet me zbatimin e masave dhe mjeteve në dispozicion ".

Harta e elementeve te ekzpozuar Rezervuari Kelcyres

3.5. E) RREZIQET NGA DËBORA E NGRICAT

IDENTIFIKIMI RREZIKUT	
Kategoria e rrezikut	Atmosferike
Lloji	Fatkeqësi natyrore
Rreziku :	Rreshjet e dëborës të shoqëruara me ngrica
Modeli :	Stinor (stina e dimrit) Dhjetor – Janar - Shkurt
Vendndodhja :	Kryesisht zonat malore të teritrit të qarkut Gjirokastër

Reshjet e dëborës janë karakteristike për zonat malore të qarkut .Ato janë dukuri e rrallë në luginën e Vjosës e të Drinos .Në zonat malore , rënia e dëborës zakonisht në nëntor dhe vazhdon deri nga fundi i marsit , por në lartësi të maleve dhe në shpatet me drejtim nga veriu

Treguesit që e karakterizoojnë variacionin e dëborës në kohë e në hapësirë janë :

- Numuri mesatar i ditëve me dëborë (NMDD)
- Numuri mesatar vjetor i ditëve me mbulesë dëbore (NMVDMD)
- Thellësia më e madhe e mbulesës së dëborës (THMMD)

Të gjithë treguesit luhaten në drejtimin perëndim – lindje dhe sipas lartësisë . Gjatë vitit treguesit më të lartë mujorë janë karakteristikë për janarin dhe shkurtin , ulen pak për dhjetorin e marsin dhe janë relativisht të vegjël në nëntor , kur nis stina e dëborës në male , dhe në prill , kur mbaron shkrirja e dëborës në male .

Ngjarjet e mundëshme rrezikuese tipike për dëborën janë :

- Bllokimi i popullsisë ,
- Bllokimi infrastrukturës

Potenciali për bllokimin e rrjetit rrugor :

Mbajtja e trafikut pa ndërprerje ka rëndësi jetike për një operacion emergjence . Cdo menaxhues dhe vendim marrës fatkeqësie ka nevojë për këto informacione :

- Zonat ku pritet potenciali bllokimi
- Kushtet në të cilat ndodh bllokimi , dhe
- Nëse bllokimi ndodh , sa do të zgjasë

Trashësia e mbulesës së dëborës prej 10 cm sjell një shtresë akulli me trashësi 5 mm , që është e mjaftueshme për të ndërprerë trafikun normal dhe prek , madje pengon (në zonat malore , operacionet e emergjencës . Megjithatë , grumbullimi i dëborës rreth 25 – 30 cm e bllokn tërësisht qarkullimin e mjeteve të zakonshme . Në rast se nuk bëhet pastrami i përshtatshëm

rregullisht prej dëborës , sidomos në zonat malore lëvizja mund të bëhet vetëm me automjete të posacme.
Duke u mbështetur në regjistrimet për periudha të gjata të mara nga rrjeti metorologjik , janë përpiluar këto dy harta të rreziqeve të qarkut :
Harta e rresikut të bllkimit të rrjetit rrugor fig 12 paraqet zonat e qarkut që një herë brenda një periudhe të dhëna (për shembull, 2,5,10 ose 20 vjet) mbulohen nga dëbora me të paktën 10 cm trashësi . Harta e rrezikut të mbulimit me dëborë për 5 ditë (fig 14)tregon zonat që nbeten nën mbulesën e dëborës të paktën për 5 ditë të njëpasnjëshme .Hartat interpretohen në këtë mënyrë :
Interpretimi fizik : Harta tregon zonat ku dukuria pritet të ndodhë .Në rast të tillë , vijat e paraqitura të konturit kanë karakter shtesë d.m.th. konturi i një periudhe të caktuar rikthimi fizikisht përfshinë gjithë teritorin e përvijuar me konture të periudhës më të shkurtër të rikthimit.
Interpretimi i propabilitetit : Harta përvijon propabilitetin vjetor , që dukuritë , mund të ndodhin në zonën e përvijuar
Qarku ka një potencial të madh për ndërprerjen e trafikut dhe për bllkim . për periudhat e rikthimit prej 2, 5 , 10 dhe 20 vjetësh mbulesa e debores prej të paktën 10 cm thellësi mbulon përkatësisht rreth 60% , 70% , 75 % dhe 85% e teritorit të qarkut Pra ka një mundësi prej 50% ,20 % ,10 % , dhe 5 % që cdo vit , rreth 60 % , 70 % , 75 % dhe 85 % e teritorit të mbulohet me shtresë dëbore me trashësi 10 cm .
Harta për rrezikun e dëborës 5 ditë tregon zonat që do të mbulohen me mbulesë dëbore për të paktën 5 ditë të njëpasnjëshme ,për përiudha e rikthimit 2 , 5 , 10 e 20 vjet
Potenciali i bllokimit nga dëbora analizohet për gjatësinë e rrjetit rrugor kryesor për rrugët kombëtare dhe rajonale. Hartat për rrezikun e ngricave dhe grumbullimet e dëborës 30 cm si dhe hartat për rrezikun e mbulesës për 5 ditë paraqiten ne fig.12,13,14. Për periudhat e rikthimit prej 2,5,10dhe 20 vjet .

Infrastruktura rrugore më të rrezikuara ku potencialisht pritet të ndodhë bllokimi nga bora jane ;

Rruga kombëtare :

Kufi Mallakastër – Memaliaj – Tepelenë – Gjirokastër – Kakavijë , në segmente të caktuara
Ura e Leklit – Këlcyrë – Përmet – Tri Urat , në segmente të caktuara
Rrugët rajonale :

Bashkia Gjirokastër ;Votuc – Golem – Guri Shpuar , Ura e Drinos – Erind – Cajup
Bashkia Dropull : Polican – Sopik , Kthesa e Koshovicës – Koshovicë
Bashkia Libohovë : Kthesa Libohovë – Hoshtevë , Kthesa e suhës – Labovë e Sipërme
Bashkia Tepelenë : Bëncë – Progonat , Kthesa Salari – Salari – Nivicë
Bashkia Memaliaj : Kicok - Buz – Gllavë
Bashkia Këlcyrë : Kelcyrë – Malëshovë
Bashkia Përmet : Piskovë – Frashër – Ogren – Petran

Më të rrezikuara nga bllokimi i dëborës janë rrugët rrurale të zonave malore të fshatrave të njësive administrative **Pogon , Zagori , Picar , Kurvelesh , Buz , Malëshovë e Frashër .**



Fig.12 Rreziku i bllokimit të rrjetit rrugor nga akulli (Rreziku i bllokimit të rrjetit rrugor nga depozitimi 10 cm i dëborës)



Fig. 13 Rreziku i bllokimit të rrjetit rrugor nga depozitimi 30 cm i bores

Bllokimi i popullsisë , rreziku dhe elementët e parapërgatitjes

Potenciali i bllokimit të popullsisë banuese brenda konturit të thellësisë së dëborës të paktën 30 cm shkon afërsisht 8 – 10 % deri në 30-35 % në kushtet e klimës më të skajshme . Duke mbajtur parasysh rezervat e ushqimit brenda shtëpive të tyre dhe të furnizimeve të tjera si dhe stoqet e tregut në qark , një periudhë bllokimi më të gjatë se 30 ditë duhet të quhet kritike për planifikimin e parapërgatitjes për emergjencë .

Fig. 14 Rreziku i mbulimit 5 ditë nga bora

Duke u mbështetur në regjistrimet për periudha të gjata, tregon se rreziku ne keto zona mbetet nën mbulesën e dëborës të paktën për 5 – 15 dite

Rreshjet e bores, shkaktojnë një numer problemesh në jetën e përditëshme dhe në punë. Ato arrijne deri të ndërprerja e komunikacionit rrugor në rajonet urbane e sidomos në rajonet rurale,

duke vështirësuar zhvillimin normal të jetës e punës në zonat e përmendura, e cila pasqyrohet në veshtirësimin e furnizimit të banorve me artikuj jetësor, veshtiresimin e qasjes së objekteve të ndryshme publike si shkollave, enteve shëndetësore, të punës dhe atyre ekonomike. Në situata të tilla, shpesh arrin deri të prishja në linja elektrike, sistemin e ujësjellësit dhe objekte tjera ifrastrukturore qe shkaktojnë ndërprerje të shpeshta në furnizimin e objekteve banese dhe objekteve tjera. Nderprerjet e punes ne institucione e shkolla zgjatjen e kane me se shumti 2-3 dite.

Shkalla e problemeve të mundëshme kërkon organizim të mirë të shërbimeve të mirënmbajtjes së rrugëve dhe pastrimin e e rregullt të dëborës nga rrjei rrugor . Vetëm një organizim bashkërenduar për mirëmbajtjen e rrugëvë mund të sigurojë veprime që ti zvogëlojnë ndjeshëm rreziqet nga bllokimi i popullsisë nga dëbora .

Në terë teritorin e qarkut Gjirokastër, organizohet mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale dhe rrugëve tjera të pa kategorizuara, të cilat janë nën autortetin e bashkivee dhe te njesive administrative. Ndërsa rruga kombëtare mirëmbahet nga ARrJugor nëpërmjet firmave kontraktore . Ky organizim u pa në dëborën e rënë e shoqëruar me ngrica në periudhën 03-15.01.2019 , ku përfshiu tërë teritorin e qarkut (Trashesia e dëborës në luginën e Vjosës dhe Drinos arriti mbi 10 cm , ndërsa në zonat malore të qarkut 30 – 50 cm)

Rreziqet e mundëshme të bllokimit të popullsisë nga dëbora

Bashkia	Njesia administrative	Fshatrat	Populsia
Gjirokastër	Picar	Shtëpëz, Kolonjë, Golem, Kaparjel.	250
Dropull	Pogon	Poliçan, Skore, Sopik, Çatistër, Mavrojer, Hllomo, Selckë.	430
Libohovë	Zagori	Sheper, Nivan, Konckë, Vithuq, Hoshtevë, Doshnicë, Zhej, Lliar, Topovë, Nderan.	200
Tepelenë	Kurvelesh	Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin	350
Memaliaj	Luftinjë	Gllavë e Vogël, Maricaj, Arrez e Madhe, Vagalat,	250
	Buz	Buz, Kalemaj, Badër, Kurtjez, Golemaj, Arrëz e Vogël, Shalës, Xhafaj, Gllavë, Selckë, Selckë e Vogël, Komar, Bardhaj.	450
Përmet	Frashër	Frashër, Zavalan, Ogren – Kostrec, Gostivisht, Miçan, Vërçisht, Kreshovë, Soropull	187
Këlcyrë	Këlcyrë	Malëshovë, Limar, Leskaj.	75

Tabela e rrezikut të bllokimit të popullsisë nga rënia e dëborës

Gjirokaster , Janar 2019

Permet , Janar 2019

SKENARI MUNDSHEM

Niveli rrezikut : I ulët deri i Mesëm
Zona e emergjences : Gjithe teritori i qarkut Gjirokastër
Lloji rrezikut : Bllokim nga bora
Situata e përgjithshme :
Rreshjet e borës të filluara ditët e para të muajit janar kanë përfshirë gjithë teritorin e qarkut. Ato kanë qënë të shoqëruara me stuhi dëbore në zonat malore .Trashësia e borës në fshatrat e njesive administrative malore , Picar , Polican , Zagorie , Kurvelesh ,Buz, Malëshovë e Frashër ka aritur 30 - 50 cm , ndërsa në luginën e Vjosës e Drinos 10 – 15 cm përfshi qendrat e banuara .Nga shërbimet e informacionit të DVP plicise e cila ka ndjekur situaten , njofton se jane bllokuar akset rrugore te rrugore te rruges nacionale , Tepelenë –Gjirokastër – Kakavijë ,Kelcyre -Permet – Tri Urat si dhe rruget rajonale e rurale të fshatrave malore si dhe kerkesa per ndihme nga fshatrat e izoluara nga bora te këtyre nj. Administrative
Nga informacionet e mara nga njësitë vendore (Bashkitë e qarkut) situata emergjente deri në orën 09.00 paraqitet si më poshtë :
Në bashkinë Gjirokastër :

- Janë bllokuar nga bora popullsia e nj.ad. Picar ,fshatrat Shtëpëz, Kolonjë, Golem, Kaparjel
- Rruga nacionale Subash – Gjirokastër është e qarkullueshme vetëm me zinxhirë

- Segmentet rrugore rajonale ,Votuc – Golem , dhe Erind Cajup të bllokuara
- Rrugët kryesore të qytetit janë të paqarkullueshme për shkaktë trashësisë së borës e ngricave
- Të bllokuara qëndrojnë të gjitha rrugët rrurale të zonës malore
- Eshtë ndërprerë energjia elektrike në nj.ad. Picar dhe Lunxheri .
- Mësimi në shkolla është ndërprerë

Në bashkinë Dropull :

- Të bllokuara nga bora fshatrat e nj.ad. Pogon (Poliçan, Skore, Sopik, Çatistër, Mavrojer, Hllomo, Selckë.)
- Bllokim i rrrugës Polocan – Sopik
- Ndërprerje të energjisë elektrike në këto njësi
- Ndërprerë mësimi në shkolla

Në bashkinë Libohovë :

- Të bllokuara nga bora fshatrat e njësisë administrative Zagori (Sheper, Nivan, Konckë, Vithuq, Hoshtevë, Doshnicë, Zhej, Lliar, Topovë, Nderan)
- Bllokim rrugës rajonale kthesa e Libohovës – Sheper, si dhe rrugët rurale të fshatrave
- Në të gjithë fshatrat e nj.ad. Zagori është ndërprerë energjia elektrikepër shkak të rrëzimit të shtyllave e këputjes së përcjëllsave

Në bashkinë Tepelenë :

- Të bllokuara nga bora dhe ngricat fshatrat e nj. Ad. Kurvelesh (Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin) si dhe fshati Salari i nj.ad. Qendër Tepelenë
- Bllokim i rrugës i rrugës rajonale Tepelenë – Progonat , Salari - Nivicë
- Në fshatin Nivicë është bllokuar një stan bagëtie me 200 kokë (të imta)

Në bashkinë Memaliaj :

- Të bllokuara nga bora dhe ngricat fshatrat e nj. Ad. Luftinjë (Vagalat , Maricaj , Arrëz e Madhe) si dhe të nj.ad. Buz (Arrëz e Vogël , Buz , Golemaj e Gëllavë)
- Bllokim in rugës rajonale Q. Kicok – Buz – Gëllavë si dhe Bylysh – Maricaj – Arrëz e Madhe
- Në këto njësi ad. Ka ndërprerje të energjisë elektrike

Në bashkinë Përmet :

- Në nj.ad. Përmet janë bërë të paqarkullueshme rugët hyrëse dhe në brendësi të qytetit
- Bllokuar rruga rajonale Kthesa e Frashërit – Bredhi Hotovës – Frashër – Ogren – Petran
- **Në njësine administrative Frashër :** Ne fshatrat Frashër , Zavalan , Ogren , Gostivisht , Mican , Vërcisht , Kreshovë , bora ka bllokuar banoret per kryerjen e aktivitetit të përditshëm si dhe gjenë e gjallë . Dy familje , një në Frashër dhe tjetra në Mican kanë kërkuar ndihmë për emergjencë shendetësore . Një familje në fshatin Vercisht i është dëmtuar catia e baneses nga pasha e dëborës , 5 familje kërkese për ndihma ushqimore , ndërsa në fshatin Zavalan 1 familje e cila ka 100 kokeë të imta, i kanë mbaruar rezervat me bazë ushqimore për bagëti. Rugët rurale të fshatrave të pakalueshme . Është ndërprerë energji elektrike në fshatrat Mican , Vercisht për shkak të këputjes së percjellsave elektrik dhe rrëzimit të dy shtyllave .

- **Në njesinë administrative Petran :** Bllokim segmenteve rugore me fshatrat Lipivan , Ogdunan Tremisht . Nga renia e borës e shoqëruar me erëra të forta u demtua catia e strehimit të bagëtive në fshatin Petran si dhe ngordhjen e 28 kokë bagëti te imta nga rënia e materialeve të catisë. Furnizimi me ujë është ndërprerë për shkak të ngrirjes së tubacioneve të ujësjellesit të fshatit Kaludh e Badlonjeë
- **Në njësinë administrative Carshovë :** Eshtë bllokuar segmenti rrugor Carshovë – Biovizhdë si dhe ndërprerja e energjisë elektrike në fshatrat Biovizhdë e Vllah – Psilloterë
- **Në nj. Ad. Piskovë :** Janë të bllokuara fshatrat Mokricë , Hotovë ,Zleushë ,Raban . Kanë kërkuar ndihmë emergjente për dy familje në nevojë për ushqim.

Në bashkinë Këlcyrë :

- **Në njësinë administrative Këlcyrë**: Janë bllokuar segmentet rugore brenda qendrës urbane si dhe ato hyrëse në qytet.
- Në fshatrat Malëshovë , Limar , Leskaj , Kala , bora ka bllokuar banorët për kryerjen e aktivitetit të përditshëm si dhe gjenë e gjallë . Dy familje , një në Leskaj dhe tjetra në Limar kanë kërkuar ndihmeë për emergjencë shendetësore . Një familje në fshatin Malëshovë i është dëmtuar catia e banesës nga pasha e dëborës , 5 familje kërkesë për ndihma ushqimore , ndërsa në fshatin Maleshovë ,1 familje e cila ka 100 kokë të imta, i kanë mbaruar rezervat me bazeë ushqimore për bagëti. Rruga Këlcyreë– Malëshvë , Maleshove – Limar, Maleshovë – Leskaj e bllokuar nga bora si dhe rugët rurale të fshatrave . Eshte nderprere energji elektrike ne fshatrat e zones se Maleshovës , për shkak të këputjes së përcjellsave elektrik dhe rrëzimit të tre shtyllave .
- **Në njësinë administrative Dëshnicë :** Bllokim segmenteve rugore me fshatrat Tolar – Fratar Mërtinj. Nga renia e borës e shoqëruar me erëra të forta u demtua catia e strehimit të bagetive në fshatin Mërtinj si dhe ngordhjen e 20 kokë bageti të imta nga renia e materialeve të catisë, furnizimi me ujë është ndërprerë për shkak të ngrirjes së tubacioneve të ujesjellësit të fshatrave Katundishtë e Senican
- **Ne njësinë administrative Sukeë:** Eshte bllokuar segmenti rrugor **Sukë – Zhepovë** si dhe ndërprerja e energjisë elektrike në fshatrat Rodenj , Shelq e Topojan
- **Në nj. Ad. Ballaban :** Janë të bllokuara fshatrat Bubës i I , Bubës i II , Vinokash , Toshkëz ,. Kanë kërkuar ndihmë emergjente për 5 familje në nevojë për ushqim.

Nevojat emergjente : Krijimi grupeve emergjente në cdo njësi me forca dhe mjete për pastrimin e zhbllokimin e rugëve,organizimi i ndihmës për emergjencat shëndetësore nga njësia e kujdesit shendetësor , ndihmës së kërkuar në ushqime , evakuimin e banorëve dhe të gjesë së gjallë.

Zyrat Arsimore në qark , kanë ndërprerë mësimin në shkolla e kopeshte për shkak të bllokimit të rrugëve dhe temperaturave të uleta deri në një urdhër të dytë.

Struktura të përfshira në momentin e parë: Komisioni Mbrojtjes Civile të qarkut dhe të Bashkive , forcat e DVP ,kom. e policisë DMR-së të përfshira në shpëtimin e jetës së njerëzve , sigurinë rugore në të gjitha akset problematike , forcat e njësive MZSH , shërbimet e ambulancës si dhe strukturat e tjera mbështetëse të qarkut e të bashkive në bashkëpunim me institucionet shtetërore

Autoriteti Jugor i Rrugëve i aktivizuar që në momentin e parë për zhbllokimin e pastrimin nga bora të segmenteve rrugore kombëtare që përshkojnë qarkun.

- **Kohë zgjatja e emergjencës** : Deri në 5 ditë
- **Rikthimi në gjëndjen normale** : 20 ditë

3.5. F) RREZIQET NGA ZJARRET

ANALIZA PER FONDIN PYJOR / KULLOSOR

TERITORI

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Qarkut Gjirokater, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5 i këtij Ligji ku shprehimisht thuhet : Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit pika 5. administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor dhe kullosor është ligji nr 9385/2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9385/2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kështu në administrim të Bashkive kalon fondi pyjor/ kullosor i bazuar në VKM nr 433 dt 08.06.2016 " Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike , sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive" pika 48.

Në sistemin natyror pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e qarkut, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhike.

Ekosistemet pyjore luajnë një rol të rëndësishëm ne aspektin ekonomik për prodhimin e lendës së drurit dhe druve të zjarrit, punësimin në zonën rurale, në shërbimet mjedisore si reduktimi i dioksidit të karbonit, zbutja e ndryshimeve klimatike, mbrojtja e tokës nga erozioni dhe rrëshqitjet, zbutet klima, reduktohet dioksidi i karbonit, pasi thithet nga pemët nëpërmjet fotosintezës ku gjatë rritjes depozitohet në dru, lëvore, gjethe e rrënjë. Sipërfaqet pyjore shërbejnë si rezervuar karboni, ndaj shtimi apo përmirësimi i këtyre sipërfaqeve do të ndihmonte në reduktimin e dioksidit të karbonit në atmosferë. Në kuadër të protokollit të Kjotos ku bën pjesë edhe Shqipëria, shtetet janë dakordësuar të luftojne efektin sere nëpërmjet uljes së sasisë së karbonit, nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Nëse ky objektiv arrihet, krijohen kapacitete të lira karboni (kreditë karboni), të cilat mund të shiten tek vendet me teprica karboni. Pyjet kryesore, gjenden në zonën malore të qarkut .

Në sipërfaqen pyjore dominojnë pyjet e larta bredhi dhe pisha, shkurre të ndryshme. Ne kushtet e terrenit të pjerrët në zonën malore, pyjet janë faktori kryesor i mbrojtjes së tokës nga rreshqitjet dhe erozioni, mbrojtjen e brigjeve te lumenjve per mbrojtjen nga ndryshimet morfologjike Sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e situatës aktuale.

Shumëllojshmëria e kushteve natyrore ka përcaktuar jo vetëm tiparet dhe llojet e bimësisë, por edhe një shpërndarje jo uniforme e me ndryshime të dukshme. Kjo vihet re qartë jo vetëm midis tipeve të ndryshme të relievit nga ai fushor tek ai malor, por edhe midis shpateve lindore e perëndimore të çdo mali. Në lartësitë e maleve kjo bimësi është e rrallë. Territoti i qarkut dallohet për katëzimin vertikal të bimësisë së shprehur në praninë e **katër brezave fitoklimatike: brezi shkurreve mesdhetare, brezi dushkut, brezi bredhit dhe brezi kullotave alpine.**

Karakteristike është se ekspozimi i ndryshëm i shpateve kundrejt masave ajrore të ndryshme shkakton shmangie të kufijve të tyre dhe ndërthurje të llojeve me ato të lartësive. Në shpatet jugore e perëndimore më të ngrohtë të maleve, kufinjtë ngjiten më lart se në shpatet lindore e veriore.

Brezi i shkurreve mesdhetare përfshin territore më të ulta të maleve dhe luginat deri në lartësinë **600 m**. Ky brez duket qartë në Grykën e Këlcyrës, Grykën e Suhës dhe rrjedhjen e përrenjve të Mezhgoranit dhe të lumit të Zagories.

Brezi i dushkut është brezi më i rëndësishëm pyjor, ka shtrirje në drejtim **horizontal d**he atë **vertikal d**he zë **80 %** të sipërfaqes së zonës. Llojet më të përhapura të dushkut janë shparthi dhe qarri. Ky brez fillon nga **800 - 900 m** deri në **1000 - 1300 m** mbi nivelin e detit. Në disa sektorë si në Grykën e Selckës ky brez shtrihet nga **550 - 1300 m,** kurse tek pylli i Mavrojerit arrin deri **1500 m.** Pllaja e Hllomosë është e pyllëzuar me qarr dhe arrin lartësinë **1450 m.**

Brezi bredhave mesdhetarë formohet nga bredhi i Maqedonisë që në lartesitë **1000-1700 m**, zë vendin e ahut. Ahu në këtë zonë nuk rritet me përjashtim të një masivi në zonë në faqen verilindore. Bredhi është pak përhapur kryesisht në formë vatrash pa formuar masive të vërtetë. Këtë e shohim ne parkun Kombetar **" Bredhi Hotoves "** Permet , mund ta shohim tek **Shkëmbi i Zhejit** (Mali Lunxhërisë) me një sipërfaqe të kufizuar. Më shpesh duket në faqet lindore të **Malit të Nemërçkës**, në fshatin Kaludh dhe në Petran (Permet) ku ai zbret shumë poshtë duke u përzier me brezin e shkurreve.

Brezi i kullotave alpine përfaqëson brezin bimor më të lartë në zonë nga **1500 - 1700 m** deri në **2400 m**. Bimësia barishtore është mbizotëruese në vargmalet: Trebeshinë - Dhëmbel - Nemërçkë dhe Shëndëlli - Lunxhëri - Bureto po ashtu edhe në Malin e Gjerë, Malin e Leftokaresë dhe atë të Muzinës.

Bashkite ,njësitë Administrative nevoitet që nëpërmjet planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave mund ti ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha ku ka aktivitete të punimeve pyjore. NjA-të, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drunjëve të lartë mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.

Referuar vendimit të mësipërm , të dhënat e fondit pyjor/kullosor qe kanë kaluar në pronësi dhe administrim nga bashkite janë:

SIPËRFAQET E PYJEVE DHE KULLOTAVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE QARKU GJIROKASTËR

Bashkia	Njësia administrative	Sipërfaqe pyjore (ha)	Sipërfaqe kullosore (ha)
GJIROKASTËR	Gjirokastër	262.75	1354
	Cepo	3568.4	2253
	Picar	3009	4471
	Lazarat	92.75	1191
	Lunxhëri	1064.8	1214
	Antigone	316.6	1031
	Odrie	1096.2	1088
	Totali	**9411.3**	**12602**
	Libohovë	333	552.6
	Qendër Libohovë	553.1	1947.1

LIBOHOVË	Zagorie		88.2
	Totali	**886.1**	**2587.9**
DROPULL	Dropulli i Poshtëm	597	3257.8
	Dropulli i Sipërm	3237.8	3673.4
	Pogon	6223.9	5963.4
	Totali	**10058.7**	**12894.7**
PËRMET	Çarçovë	3819.7	1834.6
	Petran	3787.1	2176.9
	Piskovë	2376.5	2079.7
	Frashër	620	1016.1
	Totali	**10603.3**	**7107.3**
KËLCYRË	Këlcyrë	1175	2662
	Ballaban	1412	2822
	Dishnicë	2849	2113
	Sukë	1482	1625
	Totali	**6918**	**9165**
TEPELENË	Qendër Tepelenë	6051	9282
	Lopës	753	5080
	Kurvelesh	2780	6162
	Totali	**9584**	**20524**
MEMALIAJ	Memaliaj		708.1
	Fshat Memaliaj		
	Krahës	3928.1	1038.5
	Qesarat		
	Luftinjë		
	Buz	4686.7	3857.7
	Totali	**8614.8**	**4896.2**
TOTALI		**56076.2 ha**	**69777.1 ha**

ZONAT E MBROJTURA QARKU GJIROKASTER

Sipërfaqet pyjore e kullosore të parkut kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli" në bashkinë Përmet

Nr.	**Njësia administrative**	**Sipërfaqe pyjore**	**Sipërfaqe kullosore**
1.	Çarçovë	1945	609
2.	Petran	5897.3	813
3.	Piskovë	6748.4	923
4.	Frashër	2810.6	2431

Shënim : Brenda këtij parku ndodhen 1706 ha sipërfaqe pyjore private.

Sipërfaqet pyjore e kullosore të "Bredhit të Sotirës", bashkia Dropull

Nr.	Njësia administrative	Sipërfaqe pyjore	Sipërfaqe kullosore
1.	Dropull i Sipërm	1600	0

Sipërfaqe pyjore e kullosore të "Bredhit të Kardhiqit", bashkia Gjirokastër

Nr.	Njësia administrative	Sipërfaqe pyjore	Sipërfaqe kullosore
1.	Cepo	1600	200

Sipërfaqet pyjore e kullosore të parkut natyror"Zagori", bashkia Libohovë

Nr.	Njësia administrative	Sipërfaqe pyjore	Sipërfaqe kullosore
1.	Libohovë	1244.4	1893
2.	Zagori	2218.5	6841
3.	Qendër Libohovë	1449.2	699



Përbërja e pyjeve Qarku Gjirokastër

Nr.	Njësia Administrative	Njësia	Gjithësej	Pyje të lartë	Pyje të ulët	Shkurre
1.	- Gjirokastër - Libohovë - Dropull	ha	30471	4680	13920	11871
2.	- Tepelenë - Memaliaj	ha	17284	2190	5194	9900
3.	- Përmet - Këlcyrë	ha	38000	7300	12230	18470
4.	Si Qark	ha	85755	14170	31344	40241

VLERËSIMI DHE IDENTIFIKIMI I RREZIKUT NGA ZJARRET

IDENTIFIKIMI RREZIKUT

KATEGORIA E RREZIKUT :	Teknologjike (te shkaktuara nga dore e njeriut , rrufetë)
LLOJI :	Fatkeqësi Bio - Fizike
RREZIKU :	Zjarr në pyje
VËNDNDODHJA :	Teritori qarkut Gjirokastër

IDENTIFIKIMI I ZONAVE ME RREZIK NGA ZJARRET NË PYJE

Identifikimi ngjarjeve që mund të shkaktojnë emergjencë nga zjarri është bere në zonat e prekura historikisht dhe në ato që kanë mundësi të preken në të ardhmen.

Në bashkine Gjirokastër :

- **Siperfaqa pyjore dhe kullosore e " Bredhit te Kardhiqit"**
- **Kurora e gjelbërt e qytetit**

Në bashkinë Dropull

- **Sipërfaqa pyjore dhe kullosore e Bredhit të Sotirës**
- **Kurora e gjelbërt e fshatrave të Dropullit të Poshtëm**

Në bashkinë Libohovë

- **Sipërfaqa pyjore e kullosore e "Parkut Natyror Zagori"**
- **Sipërfaqa pyjore e kullosore e " Bredhit të Zhejit "**

Në bashkinë Tepelenë :

- **Sipërfaqa pyjore dhe kullosore e parkut natyror " Uji Ftohte "**

Në bashkinë Memaliaj :

- **Masivi pyjor me Pisha Mirice - Cërrilë – Martalloz – Xhafaj- Buz – Izvor**

Në bashkinë Përmet :

- **Sipërfaqa pyjore e kullosore e Parkut Kombëtar " Bredhi Hotovës "**
- **Kurora e gjelbert e qytetit**

Në bashkinë Kelcyrë

- **Kurora e gjelbert e qytetit që përfshinë pyjet halore të fshatrave : Kuqar , Varibop Riban , Këlcyrë , Gurë.**

Vlerësimi i shkallës së rrezikut të paraqitjes të zjarrit në pyje

Për shkak të shumë faktorëve që ndikojnë në shfaqjen e zjarreve pyjore, par- ashikimi ose vlerësimi se ku mund të ndodhin është shumë i vështirë. Por, në natyrën e njeriut është nevoja të parashikojë ndonjë rrezik dhe për tu mbrojtur kundër tij.

Vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë nga zjarret në pyje : Përcakëtimi i shkallës së rrezikshmerisë së pyjeve dhe tokave pyjore nga zjarret, bëhët sipas nr. të pikeve të nxjerrë nga kriteret specifike sipas llojeve të drunjëve të grumbullit pyjor dhe karakteristikave tjera (Sistemi Kanadez)

Klasa	**Numuri pikeve**	**Shkalla e rrezikut rrezikut**
I	Me pak se 300	Shume e ulet
II	301 – 1000	E ulet
III	1001 – 4000	E mesme
IV	4001 - 10000	E larte
V	Me shume se 10000	Shume e larte

Profili i rrezikut	
Rreziku : Zjarr në pyje (Siperfaqe të hapura)	
Madhësia e mundshme (Përqindja e goditjes në komunitet): Mesatare 20 – 30 %	
Frekuenca e ndodhjes : Shumë e mundshme . mundësia 100 % së paku dy herë në vit	**Modeli sezonal :** Qershor – Shtator
Zonat që mund të goditen më shumë : ❖ **Zonat e mbrojtura në bashkitë e Qarkut** ❖ **Kurorat e gjelbërta të qyteteve : Gjirokastër , Tepelenë , Përmet , Kelcyrë**	
Kohëzgjatja e mundshme : 10 orë deri në 2 ditë	
Shuma e mundshme e kohës se paralajmerimit : 6 – 12 orë	
Sistemet ekzistuse të paralajmërimit : IGJEUM , Sistemi integruar 112 , Shërbimet e informacionit të pol. Shtetit . MZSH	
A ekziston analiza e dobësive / cënueshmërisë : Po	

Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyc të komunitetit

Profili	Pasojat e mundëshme	Shkalla e goditjes
Banorë	Shkalla e goditjes në banorë gjatë kohës së zjarrit në vendin e ngjarjes e larte(vdekje , lendime te renda per shkak te afersise me qendrat e banuara)	**E Lartë**
Pasuria	Dëmtim i pasurisë , shtetërore e private	**E Lartë**
Infrastruktura	Dëmtimi i linjave përcjellëse elektrike	**E Mesme**
Objekte të rëndësisë së vecantë	Mungesa e objekteve te rendesise se vecante dhe infrastruktures në zonat pyjore	**E Ulët**
Dëmet ekonomike	Shkatërimi masivit pyjor , erozioni , ripyllëzimi	**E Lartë**
Ambienti	Për shkak të zjarreve të mëdha dhe tymit dëmtohet mjedisi si dhe krijohen parakushtet për erozion masiv	**E Lartë**
Trashëgimia kulturore	Dëmtimi i objekteve të trashëgimisë kulturore ,dëmtimi i vegjetacionit, flora, fauna, speciet e veçanta dhe pikat turistike	**E Lartë**
Shërbimet shtëtërore	Nuk ka infrastructurë që mund të dëmtojë shërbimet	**E Ulët**
Shërbimet emergjente	Dëmtime të pajisjeve të shërbimeve të forcave operacionale	**E Ulët**

Sipërfaqet e përshkuara/djegura nga zjarri.

Arsyet e rënies së zjarreve janë nga më të ndryshmet , por në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme në 99% të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu (direct ose indirect) evidenca e rënies së zjarreve për 2019 e vërteton më së miri këtë fakt. Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 1% të rasteve. Renia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu ndodh nga pakujdesia , padituria , piromania si sëmundje apo qëllim i pastër. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria , përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojne në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operacionale në këto zona. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e herëshme kur vegjetacioni barror nga viti i kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri akoma nuk ka filluar. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale , gjetarët, fremerët apo edhe turistët. Zjarret e qëllimshme bëhen me qëllim që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet . Ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik , për përfitim dru të lirë për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale etj. Zonat më të rrezikuara nga zjarret janë, Kurora e gjelbert e Dropullit te poshtem në të cilin ka pasur raste zjarri në vitet 2017,2018,2019 kryesisht në këtë zonë është e pyllëzuar me pyje prodhues. Gjithashtu ekonomia pyjore ne njesine ad.Luftinje bashkia Memaliaj është një zonë shumë e rrezikuar nga zjarret në këtë ekononomi pyjore ka pasur vatra zjarri te perseritura gjate vitit 2019 . Në ekonomin pyjore te njesise administrati Deshnice bashkia Kelcyre e ne fshatin Leuse njesine ad. Petran bashkia Përmet ka pasur raste të shumta zjarri të shtrirë në vite ku mund të përmendim zjarret e rëna në vitin 2015 ,2019 , 2020 .

Tabela përmbledhëse e evidencave të zjarreve në pyje dhe kullota per vitin 2019 , 2020 ne qarkun Gjirokaster

TABELA
me vatrat , sipërfaqet e djegura dhe të përshkuara dhe forcat e angazhuara në shuarjen e zjarreve në qarkun Gjirokastër për vitin 2019

Mbi Situatën e zjarreve në periudhën Korrik - Gusht - Shtator 2019		**Sipërfaqe e prekur dhe djegur dhe çfarë është djegur /ha, dy, m2**									**Forca të angazhuara në shuarjen e zjarrit**			
Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	**Raste Zjarri**	**Shkurre / Kullotë/ha**	**Pyll pishe/ha**	**Pyll i përzier/ha**	**Rrënjë Hardhie**	**Sipërfaqe me vresht**	**Rrënjë Ullinj**	**Koshere bletësh**	**Të ndryshme**	**Banesa**	**Mjete të MZSH**	**Forca të MZSH**	**Punonjës të bashkisë, banorë vullnetarë, Forca të DMR Gjirokastër**	**Shkaku i rënies së zjarrit**
Bashkia Gjirokastër	19	55.8	-	-	-	-	-	-	-	-	31	122	-	
Bashkia Libohovë	10	5.3	-	-	-	-	-	-	-	-	11	50	10	
Bashkia Dropull	12	303.7	43	-	-	-	-	-	-	-	15	82	55+32 ushtri	
Bashkia Tepelenë	10	59.5	-	-	-	3 dy	200	-	-	-	6	46	105	
Bashkia Memaliaj	13	42.5	-	-	-	-	300	-	-	-	8	61	29	
Bashkia Përmet	11	9.6	-	-	-	500 m2	15	15	**1** mullar, **1** objekt privat	-	9	72	68	
Bashkia Këlcyrë	7	7.5	3.6	-	50	-	-	-	1 mullar,	-	8	45	47	
TOTALI =	**81**	**483.9 ha**	**46.6 ha**	**-**	**50**	**3.5 dy**	**515**	**15**	**2** mullarë bari, **1** objekt privat lokal dhe dyqan	**-**	**88**	**358**	**346**	

TABELA
me vatrat , sipërfaqet e djegura dhe të përshkuara dhe forcat e angazhuara në shuarjen e zjarreve në qarkun Gjirokastër për vitin 2020

Njësitë Vendore (Bashkitë)	Numuri vatrave të zjarrit	Siperfaqe e djegur , përshkuar nga zjarri (ha)									Forca të angazhuara në shuarjen e zjarrit			Shkaqet
		Shkurre / Kullotë	Pyll halorë (Pishë , bredh)	Pyll i përzier	Vresht	Pemëtore (ulli,molle,lajthi	Tokë arë , të mbjella	Banesa	Objekte biznesi	Të ndryshme	Mjete MZSH	Forca MZSH	Bashkie , DMR , vullnetare policie eti.	
Gjirokastër	20	14.07	-	-	0.06	-	-	2	1	-	41	130	69	
Dropull	3	0.08	0.13	-	-	-	-	-	-	-	3	12	-	
Libohovë	3	30.8	-	-	-	-	-	-	-	-	5	45	59	
Tepelenë	15	57.3	-	-	0.21	72	-	-	-	-	25	127	141	
Memaliaj	3	5	-	-	4	-	-	-	1	-	5	32	40	
Përmet	12	1.07	2.6	-	0.03	-	-	2	-	-	12	70	36	
Këlcyrë	17	13.96	0.08	-	-	-	-	1	-	2	22	84	38	
TOTALI	**73**	**122.8**	**2.81**	**-**	**4.3**	**72**	**-**	**4**	**2**	**3**	**113**	**500**	**383**	**Pa kujdesia 8 Të qëllimshëm 11 Të pa njohur 43 Elektrike 6 Vetëndezje 4 Atmosferike 1**

Foto : Zjarret ne Pyje

Martallos , bashkia Memaliaj

Leuse, bashkia Permet

Pyje e kullota Goranxi , Dervican , bashkia Dropull

Qafa e rrapit , Bashkia Kelcyre

Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmeren dhe me cfarë qëllimi , ndahen në :

- ✓ Masa preventive

- ✓ Masa përgatitore
- ✓ Masa direkte

a.**Masat preventive**

Janë masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Kjo për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve edhe këto masa janë të përqëndruara plotësisht ndaj njeriut.Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë.

Masa ligjore , mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve por edhe e pronarëve (bashkisë apo subjekteve private) si edhe subjekteve që i menaxhojnë ato.

Masat edukative , këto janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerëzve dhe përdoren për të gjithë grupmoshat, mgjs më të përdorurat janë për të rinjtë deri në 18 vjet. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shokllorë , leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletpalosjeve, internetit tv etj.

Masa informative- propagandistike , qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit ne pyll.Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

b.Masa përgatitore. Duke patur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret , është e domosdoshme marrja e masave përgatitore Këto masa kanë një natyrë të përherëshme gjatë gjithë vititqe merren nga bashkite dhe AZM dhe përfshihen :

- ✓ Zbulimi në kohë i zjarrit
- ✓ Transferimi i Informacionit mbi zjarrin
- ✓ Organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve
- ✓ Ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit
- ✓ Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.

Zbulimi në kohë i zjarrit është i një rëndësie të madhe për lokalizimin dhe fikjen shpejt të ij. Zonat tona malore kanë një dukshmëri të dobët, me qëllim që zjarri të mund të zbulohet në kohë organizohet shërbimi i monitorimit në terren nga **vëzhguesit kundra- zjarr / vrojtuesve kryesisht me patrullim nga toka** në periudhën më të rrezikuar të vitit (Sipas VKM nr 1080/2010 për 5 muaj). Ky sherbim do te organizohet ne ZM dhe ne cdo ekonomi pyjore e kullosore ne bashkite e qarkut per periudhen Qershor - Shtator

Paralajmerimi i herëshem bëhet nga IGJUEM , nëpermjet publikimit të buletinit mbi parashikimin e rreziqeve nga zjarret pyjore . Ky buletin i dërgohet nga QKOMC ne MM Prefekturës , e cila ua shpërndanë bashkive dhe institucioneve ,njësive administrative , kryetarëve të fshatrave dhe strukturave përkatëse për rritjen e gadishmërisë të cilët kanë përgjegjësi për njohjen me sistemin e paralajmerimit të herëshëm dhe trasmentimin në kohë publikut dhe institucioneve duke i këshilluar ata për për rreziqet dhe hapat e nevojshëm që duhet të merren prej tyre.

Ndërsa njesitë administrative , kryetarët e fshatrave marrin masa për vëzhgimin vullnetar të teritorit të tyre nëpërmjet qytetarëve të thjeshtë dhe barinjeve.

Ky informacioni i dërgohet të gjitha palëve përkatëse të interesit në mënyrë të koduar dhe rregulluar. Informacion është jetik për ndërmarrjen e masave parandaluese dhe miratimin e procedurave, dhe për pasojë duhen marrë hapat e nevojshme për të siguruar përfshirjen e tyre në procedurat e planifikimit dhe ato operative në planet e prefectures , bashkive e AZM.

SKENARET

EMERGJENCE E SHKALLËS SË ULET – E MESME
SKENARI 1

KOHA :ORA 10.00 Dt. 05.07._____
VENDI : BASHKIA PËRMET
SITUATA E PERGJITHSHME
Qendra Kombëtare Për Parashikim dhe Monitorim të Rreziqeve Natyrore nëpërmjet Buletinit të muajit Korrik ka parashikuar rritje të temperaturave deri në 40^0 C
QKOMC nëpërmjet Sektorit të Emergjencave civile të Prefekturës ka dhënë njoftimin në orën 10.00 për " Alarm për rritje gadishmërie " për të përballuar situatë emergjente që mund të shkaktohen nga zjarret si rezultat i rritjes së temperaturave.
Niveli i rrezikut parashikohet i lartë në gjithë teritorin e qarkut.
Në Qarkun e Gjirokastrës në dhjetë ditëshin fundit të muajit Qershor janë shfaqur vatra të vogla zjarri në pyje, kullota dhe tokë arë në bashkitë Gjirokastër, Tepelenë dhe Kelcyrë, të cilat janë menaxhuar në kohë .
Në bashkinë Përmet zonat dhe objektet me të rrezikuara nga zjarri janë :

- Parku Kombetar "Bredhi Hotovës "
- Kurora e gjelbërt e qytetit Përmet
- Pikat e shpërndarjes së Karburantit
- Tokat arë në luginën e Vjosës (Carshovë , Petran , Piskovë)

Në rast të rënies së zjarrit ndikimi dhe shkalla e dëmtimeve do të jetë i lartë duke prekur njerëz , banesa , pyje si dhe në infrastrukturë.
Forcat operacionale të bashkisë , (Stacioni MZSH , Komisariati Policisë , Shërbimi i kufirit , Shërbimi urgjencës), monitoruese / njofuese, Shërbimi vullnetar MNZ, qëndrojnë në gadishmëri për përballimin e cdo situatë të shkaktuara nga zjarret.
Kohëzgjatja e " Alarmit për rritje gatishmërie " deri në një njoftim të dytë .

SITUATA Nr. 1

(Në vazhdim)
Data ____15.07._____ ora___11.15___

VENDI : Kurora e Gjelbërt e Qytetit të Përmetit

(Kodra e Bolengës)

Në orën 11.15 dt.__15.07._____ vrojtuesi i Kurorës së gjelbërt të qytetit Përmet njofton për shfaqen e një vatre zjarri në Kodrën e Bolengës 250 m në perëndim të spitalit të qytetit.
Në orën 11.20 njofton kryeplaku i fshatit Lipë për shtëllunga të mëdha tymi e flake, skena të tilla raportohen edhe nga banorë të fhatit Lipë.
Era fryn me shpejtësi 5 m në sekondë me drejtim veri – perëndim duke faforizuar përhapjen e mëtejshme të zjarrit.
Përhapja e mëtejshme e vatrës së zjarrit rrezikon :

- Lagjen Bolengë , 5 banesa (25persona)
- Lagjen në lindlje të Fshatit Lipë 15 banesa

- 3 vilat në të majtë të përroit të Lipës
- Kodrën e pyllëzuar me pisha 5 ha
- Rrjeti elektrik Përmet – Lipë, Përmet - Bolengë

Me zmadhimin e sipërfaqes së zjarrit rrezikohen banesat e Lagjes'' Partizani''në Jug teë kodrës, banesat e fshatit lipë në jug – perëndim si dhe spitali Përmet në Lindje të kodrës Bolengë.
Nevojat e mundshme që mund të lindin gjatë situatës: Evakuimi i 3 familjeve,shtesë të personelit zjarrfikës, mjet zjarrfikës si dhe mjte fikëse(Bombula)
Popullsia që rrezikohet : 40 banorë të fshatit Lipë. (Lagja në jug- lindje)Me marrje e sinjalit për rënien e zjarrit nga vrojtuesi dhe sektori emergjencave civile të bashkise u njoftuan forcat e gadishmerisë të cilat angazhohen në momentin e parë:
-Shërbimi i MZSH
-Komisariati Policisë Përmet
-Shërbimi i ambulancës
Parashikimi i kohëzgjatjes së emergjencës jo me pak se 8 orë.
Shkakui rënies së zjarrit i panjohur

SITUATA Nr. 2
(Në vazhdim)

Zjarri i ndihmuar nga era që fryn në drejtim të prëndimit , po përhapet me shpejtësi në drejt lagjes lindore të fshatit Lipë. Forcat operacionale të bashkisë po bëjë të gjitha përpjekjet për fikjen e zjarrit dhe ndalimin e përhapjes së metejshme të tij.
Përhapja e mëtejshme e zjarrit rrezikon 15 banesa , pronën , gjenë e gjallë dhe bazën ushqimore
Deri në orën 15.15 është djegur një sipërfaqe pyjore dhe me shkurre gjithësej 1.5ha . Si rezultat i përpjekjes për shuarjen e zjarrit janë lënduar lehtë nga asfiksia një zjarrfikës , dy vullnetar , një banesë me gjithë materialet dhe orenditë shtëpiake.

SITUATA Nr.3
(Në vazhdim)
ORA 19.30
Pas shumë përpjekjesh të forcave të ndërhyrjes së bashkisë dhe ndihmës së dhënë nga shërbimi zjarrfikës Kelcyrë në orën 19.30 zjarri u vu nën kontroll, u bë i mundur fikja e dhe ndalimi i përhapjes së metejshme të tij.
Dëmi i shkaktuar :
Të lënduar lehtë : Një zjarrfikës , tre vullnetarë , një banesë e djegur me materiale dhe orendi shtepiake, sipërfaqe e djegur pyll dhe shkurre 2.3ha, linja elektrike Përmet – Lipë, bazë ushqimore për bagetitë , etj.

SKENARI MUNDSHEM : (I mesëm deri në i lartë)
SKENARI 2
KOHA : ORA 11.00 Dt. 25.07. 2020
Zona e emergjencës: Kodra e Kardhiqit (Zonë e mbrojtur)
Vendndodhja : Fshati Kardhiq , Nj.Ad Picar ,Bashkia Gjirokastër ,Qarku Gjirokastër
Përshkrimi : Kodra e Kardhiqit ndodhet në veri të fshatit Kardhiq. Ajo kufizohet ; në very me fushën e Kardhiqit , nga jugu me fshatin Kardhiq , nga lindja me fushen e Kardhiqit ,nga perëndimi me përroin e fshatit dhe rrugën automobilistike . Kodra e Kardhiqit është zonë e

mbrojtur me bimësi të përzier kryesisht dushk , ka një siperfaqe reth 18 ha. Kjo siperfaqe zonë e mbrojtur përshkohet nga rruga automobilistike Degëzim – Kardhiq me gjatësi km . Brenda sipërfaqes në jug të saj ndodhen banesa një katëshe . Kodra shtrihet në gjerësinë gjeografike 40^0 07' 30'' dhe gjatësi gjeografike 20^0 01' 45''. Lartësia mbi nivelin e detit m

SITUATA E ORES 11.00 (Situata e pergjithshme)

Qendra Kombetare për Parashikim dhe Monitorim të Rreziqeve Natyrore nëpermjet Buletinit të 10 ditëshit të tretë të muajit Korrik ka parashikuar rritje të temperaturave deri ne 40^0 C

QKOMC , nëpermjet sektorit të emergjencave civile të prefekturës ka dhënë njoftimin në orën 10.00 për " Alarm për rritje gatishmërie " për të përballuar situatë emergjente që mund të shkaktohen nga zjarret si rezultat i rritjes së temperaturave.

Niveli i rrezikut parashikohet **i lartë** në gjithë teritorin e qarkut Gjirokastër

Në qarkun e Gjirokastrës në fillim të muajit korrik janë shfaqur vatra të vogla zjarri në pyje, kullota dhe tokë arë në bashkitë Gjirokastër, Memaliaj Dropull dhe Përmet të cilat janë menaxhuar në kohë dhe me efkasitet nga strukturat për shuarjen e zjarreve .

Në qarkun Gjirokastër zonat dhe objektet më të rrezikuara nga zjarri janë :

Në bashkinë Gjirokastër :

- **Siperfaqa pyjore dhe kullosore e " Bredhit të Kardhiqit"**
- **Kurora e gjelbërt e qytetit**

  Në bashkinë Dropull
- **Sipërfaqa pyjore dhe kullosore e Bredhit të Sotirës**
- **Kurora e gjelbërt e fshatrave të Dropullit të Poshtëm**

  Në bashkinë Libohovë
- **Sipërfaqa pyjore e kullosore e "Parkut Natyror Zagori"**
- **Sipërfaqa pyjore e kullosore e " Bredhit të Zhejit "**

  Në bashkinë Tepelenë :
- **Sipërfaqa pyjore dhe kullosore e parkut natyror " Uji Ftohtë "**

  Në bashkinë Memaliaj :
- **Masivi pyjor me Pisha Miricë – Cerrileë – Martalloz – Xhafaj- Buz – Izvor**

  Në bashkinë Përmet :
- **Sipërfaqa pyjore e kullosore e Parkut Kombëtar " Bredhi Hotovës "**
- **Kurora e gjelbërt e qytetit**

  Në bashkinë Kelcyrë
- **Kurora e gjelbërt e qytetit që përfshinë pyjet halore të fshatrave : Kuqar , Varibop Riban , Kelcyrë , Gurë.**

Në rast të rënies së zjarrit ndikimi dhe shkalla e dëmtimeve do të jetë i lartë duke prekur njerëz , banesa , pyje si dhe në infrastrukturë.

Forcat operacionale të qarkut, (Stacioniet e MZSH , Komisariatet e Policisë , DMR , Shërbimi pyjor i bashkive , zjarrfikës të ZM , Shërbimet e urgjences , monitoruese / njofuese, sherbimet vullnetar e MNZ) , qëndrojnë në gatishmëri për përballimin e cdo situate të shkaktuara nga zjarret.

Kohëzgjatja e " Alarmit për rritje gatishmërie " deri në një njoftim të dytë .

SITUATA E ORËS 11. 30

Në orën 11.30 dt 25.07 vrojtuesi- sinjalizuesi i zonës së mbrojtur Kardhiq , shërbimi informacionit MZSH i bashkisë Gjirokastër , shërbimi policisë së DVP njoftojnë për zbulimin e një vatre zjarri në Kodrën e Kardhiqit

Në orën 11.35 njofton kryeplaku i fshatit Kardhiq për shtëllunga të medha tymi e flake. Skena të tilla raportohen edhe nga banorë të fshatit

Era fryn me shpejtësi 10 m / s me drejtim veri – jug duke faforizuar përhapjen e mëtejshme të zjarrit në drejtim të fshatit.
Përhapja e mëtejshme e vatrës së zjarrit rrezikon :

- Gjashtë banesa në jug të kodrës dhe tre banesa në veri të k. Kardhiqit , rreth 25 banorë të fshatit Kardhiq dhe gjenë e gjallë të këtyre familjeve.
- Një stan
- Të mbjellat në fushën e Kardhiqit në veri dhe lindje të kodrës
- Bllokimin e rugës automobilistike të fshatit Degëzim – Kardhiq
- Rjetin e furnizimit me energji elektrike
- Bimësia e zonës së mbrojtur

Nevojat e mundshme që mund të lindin gjatë situatës: Evakuimi i 6 familjeve,shtesë të personelit zjarrfikës, mjete zjarrfikës si dhe mjte fikese(pompa shpine)
Popullsia që rrezikohet : 25 banorë të fshatit Kardhiq. (Lagja në jug- lindje)
Me marrje e sinjalit për rënien e zjarrit nga vrojtuesi dhe sherbimet e informacionit ,sektori Emergjencave civile të Prefektit ndjek situatën për njoftimin e strukturave te gatishmërisë të cilat angazhohen në momentin e parë:

- Shërbimi i MZSH
- Komisariati Policisë Gjirokastër
- Shërbimi i ambulancës
- Sherbimet e ZM për fikjen e zjarrit
- Shërbimi vullnetar

Parashikimi i kohëzgjatjes së emergjencës jo më pak se 12 orë.
Shkakui rënies së zjarrit për momentin , i panjohur
SITUATA E ORËS 15.00
Zjarri i ndihmuar nga era që fryn në drejtim të jugut , po përhapet me shpejtësi në drejtim të lagjes veriore të fshatit Kardhiq. Forcat operacionale të bashkisë po bëjnë të gjitha përpjekjet për fikjen e zjarrit dhe ndalimin e përhapjes së metejshme të tij.
Përhapja e metejshme e zjarrit rrezikon 10 banesat e para të fshatit, pronën , gjenë e gjallë dhe bazën ushqimore
Deri ne orën 15.00 është djegur një sipërfaqe pyjore dhe me shkurre i ZM gjithesej 2.5ha .
Si rezultat i përpjekjes për shuarjen e zjarrit janë lënduar lehtë nga asfiksia 2 zjarrfikës , dy vullnetar , 2 banesa me gjithë materialet dhe orenditeë shtëpiake.
Në bazë të situatës së krijuar drejtuesi operacionit njofton për ndihmë në forca mjete si dhe një mjet ajëror për shuarjen e zjarrit pasi rrezikohet seriozisht nga përhapja e metejshme e flakëve fshati Kardhiq.
Nevojat e mundshme gjatë kësaj situate :

- Evakuimi i 10 familjeve
- Forca dhe mjete zjarrfikëse nga bashkitë fqinje
- Aktivizimi i forcave e mjeteve të DMR
- Kërkesa për një mjet ajeror

SITUATA E ORES 20.20
Pas shumë përpjekjesh të forcave të ndërhyrjes të bashkisë , ZM, dhe ndihmës së dheneë nga shërbimi zjarrfikës bashkive Tepelenë e Dropull , DMR si dhe mjetit helikopter në orën 20.30 zjarri u vu nën kontroll, u bë i mundur fikja e dhe ndalimi i përhapjes së metejshme të tij. Nga

forcat e shërbimit zjarrfikës dhe forcat e DMR organizohet vrojtimi dhe vezhgimi i vatrës së zjarrit për shkak të mundësisë së aktivizimit të saj.
Dëmi i shkaktuar : Të lenduar lehtë ; një zjarrfikës , tre vullnetarë , gjashtë banesa të djegura me materiale dhe orendi shtëpiake, sipërfaqe e djegur pyll dhe shkurre 7 ha ZM, linja elektrike e fshatit, bazë ushqimore për bagëtitë , etj.

Vendosja e forcave dhe e mjeteve për shuarjen e zjarrit (Kodra e Bolëngës Përmet)



VENDOSJA E FORCAVE DHE E MJETEVE PER SHUARJEN E ZJARRIT K. KARDHIQ

3.5. F/1 Vlerësimi i rrezikshmërisë së zjarreve në fusha

Popullsia që jeton në zonat rurale , varet kryesisht prej bujqësisë ekstensive dhe blegtorisë, megjithatë, ndodhja e zjarreve në tokat bujqësore është përgjithësisht jo e dendur dhe prekë

sipërfaqe të kufizuara. Mirëpo, viteve të fundit janë shpeshtuar zjarret në fusha të cilat janë të shkaktuara kryesisht nga faktori antropogjen si pakujdesi ose për interesa përsonale:

- djegia e mbetjeve të kulturave bujqësore,
- djegia e barërave të këqija,
- djegia e barit të thatë,
- djegia e shkurreve në favor të zgjerimit të tokës punuese,
- djegia e mbetjeve të kashtës gjatë sezonit të korrje shirjeve

Zonat më të rrezikuara nga zjarret në fusha janë :

- Tokat bujqësore në luginën ë Vjësës të mbjella me grurë , misër , pemë frutore , vreshta etj
- Tokat bujqësore në luginën e Drinos të mbjella me grurë , misër , pemë frutore , vreshta etj
- Tokat bujqësore të mbiella , në të dy anët e lumenjëve Ddëshnicë bashkia Këlcyrë , Kardhiq bashkia Gjirokastër dhe Luftinjë bashkia Memaliaj

Masat preventive të zjarreve në fusha

Njësitë administrative në sezonin e korrje-shirjeve,sipas Ligjit të mbrojtjes nga zjarri, janë të detyruar që para fillimit të zezonit të korrje-shirjeve të hartojnë planin e mbrojtjes nga zjarri, në të cilin duhet të parashikojnë dhe të ndërmarin këto masa:

Organizimi i kujdestarisë, shërbimit të vëzhgimit, lidhjes dhe informimit të përhershëm gjetë korrje shirjeve;

Makinat të cilat marinë pjesë në korrje shirje duhet të jenë teknikisht në rregull dhe të siguruara kundër shkaktimit të zjarrit me anën e hedhjes së shkendijave , nxehtësisë së madhe dhe mënyrave tjera;

- Makinat duhet të jenë të pajisura me aparate zjarrfikëse, lopata, kazma dhe pran tyre të sigurohen depozita me ujë;
- Furnizimi i makinerisë me karburant të bëhet në vend të sigurt dhe karburanti rezervë të ruhet së paku 150 m larg të lashtave në hije i shoqëruar me mjete përkatëse për shuarjen e zjarrit;
- Ndalohet pirja e duhanit dhe zjarri i hapur;
- Tokat e mbjellura me të lashta të ndahen në ngastra përafërsisht. Ngastrat të kufizohen me korridore në gjersi prej 15m. dhe kjo gjerësi të kositet menjëherë dhe të lërohet;
- Njësitë administrative në bashkëpunim me shërbimin zjarrfikës të bashkisë , për punëtorët të cilët marinë pjesë në korrje shirje, janë të detyruar të organizojnë trainime me qellim , aftësimin për aplikimin e masave kundër zjarrit

Zjarre fushore

Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit

Studimi për mbrojtje dhe shpëtimnga zjarri është pjesë përbërëse e studimeve urbanistike . Në këto parashikohet zbatimi dispozitave të ligjit të ndërtimit ,ligjit për mbrojtjen nga zjarri , normave , rregulloreve teknike për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarri , projektet për të gjitha llojet e ndërtimeve përfshijnë edhë **projektin e mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri.**

Në qarkun e Gjirokastrës pas viteve ’90 , për shkak të lëvizjes së popullsisë drejt qëndrave të qyteteve në bashkitë e qarkut , solli dëme të mëdha në ndërtim në një numur mjaft të madh të objekteve të banimit , industrial , publike e private . Shumica e këtyre ndërtimeve nuk i përmbushin kërkesat për mbrojtje dhe shpëtimnga zjarri si :

- Mundësia e zgjerimit të zjarrit në objektet fqinjë
- Zgjerimi i zjarrit në ndërtesë
- Qëndrueshmëria e konstruksionit
- Rrugët e evakuimit
- Sistemet e lajmërimit dhe alarmit
- Ndërhyrja e zjarrfikësve në object

Shkaqet dhe pasojat :

- Ndërtimet pa leje
- Mospërfillja e procedurave dhe kritereve për leje ndërtimi
- Zbatimi jo efikas i ligjit të ndërtimit në aspektin e mbrojtjes nga zjarri etj.

Planifikimi

Për t’u siguruar se cdo ndërtim të jetë i sigurt për shfrytëzim , punë , banim , argëtim , administratë etj.duhet që të :

- Planifikohet
- Projektohet
- Ndërtohet dhe
- Shfrytëzohet

konform ligjeve dhe rregullave teknike që janë në fuqi , përgjegjësi kj e institucioneve qëndrore e lokale .
Masat që duhen marë :

- Kordinimi punëve në mes të institucioneve që janë përgjegjëse në fushën e mbrojtjes nga zjarri në aspektin e ndërtimit të objekteve .
- Zbatimi ligjit të ndërtimit dhe ligjit të MZSH – ës
- Hartimi i projekteve konform ligjit , kontrollimi i punimeve dhe pranimi teknik i objekteve duke respektuar kërkesat e mbrojtjes nga zjarri .
- Respektimi udhëzimeve mbi procedurën e marjes së lejeve dhe përbërjen e dokumentacionit teknik për mbrojtjen nga zjarri
- Zbatimi i rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri
- Plotësimi i kushteve teknike të objekteve ekzistuese e sidomos objekteve publike të institucioneve dhe private .
- Të kryhet ndërprerja e veprimtarive të pa ligjëshme që sjellin pasoja për jetën e njerëzve dhe të pronës.

3.5. F/2 Zjarret ne objekte banimi

KATEGORIA E RREZIKUT :	Teknologjike (të shkaktuara nga faktori njeri)
LLOJI :	Fatkeqesi Bio - Fizike
RREZIKU :	Zjarr në objekte
VENDNDODHJA :	Teritori qarkut Gjirokastër
MODELI :	Gjatë vitit

Për sa i takon zjarreve të shtëpive, banesave kolektive, lokaleve private , objekte biznesi etj. theksojme faktorët e mëposhtëm:

- Ekzistenca e ndërtesave të banimit kolektiv me linja elektrike të vjetra dhe të mirë mbajtura keq. Ky është renditur si njëri prej shkaqeve kryesore.
- Përdorimi i pakontrolluar i energjisë elektrike pas ndërprerjeve të gjata të saj shkaktojnë zjarre nëpër shtëpi dhe objekte tjera. Kur njerëzit më në fund furnizohen me energji elektrike ata i mbingarkojnë rrjetet ngaqë përpiqen ti shfrytëzojnë sa më shumë. Shpesh ata rrezikojnë duke bërë lidhje të paligjshme në rrjet. Si pasojë, vetëm gjatë viteve 2015–mars 2020 ka pasur mbi 50 zjarre në banesa në tëgjithë qarkun , kryesisht për shkak të mbingarkimit të rrjetit
- Vendosja e ushqimit të kafshëve në brendi të objekteve të banimit dhe pranë objekteve të tilla,
- Mos kujdesi i prindërve që burimet e zjarrit (mjetet ndezese) të i lënë afër dorës së fëmijëve
- Mungesa e dijeve në komunitet për parandalimin e zjarrit,
- Mungesa e hidrantëve ose jo funksionaliteti i tyre ne zonat rurale
- Mungesa e pajisjeve kundër zjarrit
- Rrufeja

- Keqpërdorimi me energji elektrike nga njerëz të pandërgjegjshëm dhe nganjëherë të pakujdesshëm etj.

GODITJA :

Djegia e një objekti banese

- ❖ Numuri kufizuar i familjeve të goditura
- ❖ Evakuimi banorëve të rrezikuar nga banesat
- ❖ Gjendja paraqitet kritike për objektin dhe objektet e tjera për rreth për shkak të përhapjes së zjarrit
- ❖ Do të paraqiten efekte dytësore për ambjentin dhe familjet përreth
- ❖ Mbështetje e mjaftueshme nga niveli lokal

PSOJAT :

- ❖ Vdekje , djegie të rënda , të lehta të banoreve
- ❖ Djegia e banesës , objektit (Dëmtime të lehta dhe të renda)
- ❖ Të mirat materiale (orendi , pajisje shtëpiake , veshmathje , ushqim etj,)

Foto te zjarreve ne objekte banimi

Kakodhiq , bashkia Gjirokaster

Picar , bashkia Gjirokaster

SKENARI I MUNDSHEM

Në Lagjen " Palorto" , të qytetit Gjirokastër më datën _____, në orët e vona të mbrëmjes ka shpërthyer një zjarr në një objekt banimi, ku është djegur shtëpia një katëshe prej tri dhomave dhe zgjerim me një aneks. Në këtë shtëpi kanë banuar familja 4 anëtarëshe. Një fëmijë (gjinisë mashkullore) i moshës 6 vjecar ka pësuar dëmtime të renda nga djegiet e shkaktuara nga flakët e zjarrit. Në rastin e shpërthimit të zjarrit familja ka qenë duke fjetur. Zjarri është vrejtur nga fqinjët e kësaj familje të cilët kane njoftuar shërbimin zjarrfikes . Ndërhyrja për shpëtim lokalizim dhe shuarja e zjarrit është bërë nga Njësia e Zjarrfikësave të bashkisë.

3.5. F/3) Zjarret në stacione karburantesh

KATEGORIA E RREZIKUT :	Teknologjike
LLOJI RREZIKUT :	Fatkeqësi teknolgjike
RREZIKU :	Zjarr
MDELI :	Gjatë vitit
VENDNDODHJA :	Stacionet e karburanteve

HISTORIKU

Në qendrën administrative dhe vendbanimet në pjesën rurale të qarkut janë të evidentuara:
Stacione (Pika) karburanti
Depozita për shpërndarje gazi
Pika shitje gazi
Fatmirësisht deri më tani nuk është evidentuar asnjë rast zjarri në këto pika të shitjes, edhe pse është një numër i këtyre pikave të shitjes që nuk i plotësojnë kushtet teknike dhe hapësinore për një veprimtari të tillë duke marë për bazë shkallën e lartë të rrezikshmërisë që paraqesin, sidomos ato pika të cilat veprimtarin e vetë e ushtrojnë brenda qendrës urbanistike dhe më të frekuentuara nga automjetet dhe kalimtarët e rastit të qytetit, ku nga shpërthimi dhe zjarri eventual pasojat njerëzore, materiale dhe hapësinore do të ishin shumë të larta dhe të pa parashikueshme. Shikuar në aspektin e mos ndodhjes së zjarreve në këto vende duhet që shebimet MZSH vemendjen kryesore duhet ta përqendrjnë në kontrollin e shpeshte të këtyre stacioneve e pika shitjesh karburanti e gazi.

GODITJA :

- ✓ Infrastruktura e stacioneve të karburantit
- ✓ Objekte të rendësisë se vecantë në afërsi
- ✓ Rrjeti ndricimit të rugëve
- ✓ Si dhe elementë të tjerë të ekspozuar në afërsi të stacionit të karburantit

PASOJAT :

- ✓ Rrezikimi i jetës së banorëve në afërsi nga djegia , asfiksimi nga tymi i derivative të naftës
- ✓ Rrezikimi i jetës së personelit të stacionit
- ✓ Rrezikimi banesave dhe objekteve përreth
- ✓ Frikë dhe panik nga shpërthimi

SKENARI MUNDSHEM

Zona e emergjencës : Stacini karburantit " ELDA" qyteti Përmet
Në orët e mesëditës të datës 10.08. , gjatë shkarkimit të autocisternës me karburant, për shkak të mos respektimit të rregullave për shkarkimin dhe depozitimin e derivateve të naftës dhe mos respektimit të rregullave të mbrojtjes ndaj zjarrit, ka shpërthyer zjarri në stacionin e shitjes së karburantëve "Elda " Fillimisht, zjarri e ka përfshirë autobotin , pastaj nga përhapja e zjarrit janë përfshirë edhe stabilimentet për mbushjen e atomjeteve me karburant , janë krijuar flakë zjarri të cilat kanë krijuar valë të nxehta përvluese dhe tym të dendur. Nga kjo situatë e krijuar, janë rrezikuar serizisht zjarrfikësit dhe përsoneli i stacionit në fjalë. Përhapja e flakëve të zjarrit ka përfshirë infrastrukturën e stacionit dhe parkingun e mjeteve të firmës së ndërtimit, që gjendet në krah të stacionit .Nga zjarri janë të rrezikuara servisi e makinave si dhe një pikë shitje për pjesë

kembimi , një makinë transporti e ngarkuar me materjal ndërtimor druri e cila ndodheje parkuar 35 m larg stacionit karburanti ngarkuar me material ndërtimor druri e cila ndodhej e parkuar 35 m larg stacionit karburanti.
Elemenët të ekspozuar : Restorant " 24 oreshi", Varezat e dëshmoreve ,Restorant " Kupola ",
300 m të rruges së hyrjes në qytet të cilat kanë nje distancë rreth 100 m larg vendit të ngjarjes si dhe grumbulli pyjor (pisha) në siperfaqen e lulishtes " Trekendeshi ".
Me marrjen e njoftimit forcat e kmisariatit të policisë benë sigurimin e vendit të ngjarjes dhe shpëtimin e personelit dhe evakuimin e banorëve përreth.
Nga kjo situatë e krijuar, nga komandanti i stacionit zjarrfikës , është dhënë alarmi për evakuimin e personelit të pikës si dhe të banorëve për rreth . Pas shpëtimit dhe evakuimit, të demtuar rendë nga djegiet janë shoferi autobotit dhe punëtori i shërbimit të stacionit të cilët u transportuan nga shërbimi ambulancës në urgjencën e spitalit .Ndihmë mjekësore kanë kërkuar 5 banorë, të cilët kanë patur lëndime të lehta, 2 nga paniku dhe frika kanë patur shenja të humbjes së ndjenjave
Meqënëse, mbështetëja lokale e forcave për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit ka qenë e pa mjaftueshme, është kërkuar ndihma e njësisë të zjarrfikjes të bashkisë Këlcyrë.
Falë vetëmohimit dhe profesionalizmit të këtyre njësive, në orët e vona të pasditës së kësaj date është arritur që zjarri të vihet nënë kontroll dhe të lokalizohet.
Në këtë ngjarje kontribuan edhe punonjësit e ndërmarjes së pastrim – gjelbërimi të shërbimet e tjera të bashkisë.
Plani I vendosjes se forcave dhe te mjeteve . Pika e shperndarjes se karburantit Permet

3.5. G) FATKEQËSITË NË KOMUNIKACION (AKSIDENTET)

HISTORIKU

Pas viteve '90 infrastruktura rrugore e qarkut ka qënë e dëmtuar ku dhe ka munguar edhe sinjalistika horizontale e vertikale e shënjave të komunikacionit . Me kalimin e kohës infrastruktura rrugore dhe shenjae komunikacoionit u përmirësuan dhe janë standartizuar në të rrugët kombëtare që përshkojnë qarkun tone dhe pjesërisht në rrugët rurale. Shqetësimi lidhet me një numur aksidentesh në trafik , ku si pasojë kanë gjetur vdekjen dhjetra persona . shkaqet janë të ndryshme , por sigurisht që faktori njeri është më i shpeshtë pasi nuk janë respektuarrregullat e përgjithshme në trafik , nga pasiguria në automjet, tejkalimi i shpejtësisë , mos respektimi i distancës , mos respektimi i shenjave të qarkullimit , përdorimi i shpeshtë i telefonave në lëvizje , ndikimit të lodhjes apo pagjumësisë etj.
Masat që duhen marë për zvogëlimin e rrezikut nga aksidentet në komunikacion :

- Zhvillimi i infrastrukturës rrugore , sidomos në qytet në bazë të planeve urbanistike
- Inspektimet e rregullta ne komunikacion
- Sinjalizimi horizontal dhe vertical i rrugëve
- Kufizimi i shpejtësisë dhe mbikqyrja e rrugëve
- Kontrolli i detyrueshëm i automjeteve etj.

Vlerësimi ka të bëjë me dy lloje aksidentesh të transportit rrugor :
Transporti kolektiv rrugor është relativisht përdorur në qarkun tonë . Ky rrezik lokalizohet kryesisht në akset e përdorura nga linjat e rregullta dhe atyre të përdorura nga fluksi I madh I qarkullimit në mëngjes ,në mesditë dhe në mbrëmje sidomos në aksin kombëtar Mallakastër – Memaliaj – Tepelenë – Gjirokastër – Kakavijë .

- Aksidente t e autobuzëve , ku të gjithë udhëtarët e e autobuzit janë të përfshirë

- Aksidentet që përfshijnë një numur automjeteshtë cilët shkaktojnë bllokimin dhe qarkullimin .

Një aksident (vdekjeprurës ose j) I komunikacionit rrugor :

- Shkakton e pakëta një viktimë
- Ndodh në një rrugë të hapur për qarkullimin public
- Përfshinë e pakta një automjet.

Një aksident përfshinë një numur të caktuar të pjesëmarësve në komunikacion . në mes tyre dallojmë :

- Të shpëtuarit – të përfshirët në aksident që nuk kanë vdekur dhe gjëndja e tyre nuk kërkon asnjë trajtim mjekësor.
- Viktimat – të implikuar në aksident që nuk kanë shpëtuar pa pasoja .

Në mes të lënduarëve dalljmë :

- Të lënduarit rëndë – të lënduarit gjëndja e të cilëve kërkon hospitalizimmë shumë se pesë ditë
- Të lënduarit lehtë – të lënduarit lehtë gjëndja e të cilëve kërkon një hospitalizim ose përkujdesje mjekësore deri në pesë ditë.

Shkaqet e rrezikut :

- Të gjitha automjetet e transportit
- Zonat me dëndësi të madhe të trafikut

Faktorët e përkeqësimit

- Gjëndja e rrugëve , kushtet atmosferike , gjëndja teknike e automjeteve transportuese , mungesë sinjalistike etj

Karakteristikat e fluksit

Për rrezikun e transportit të përbashkët rrugor , ekziston një numur fluksesh të rreziqeve ku ndër më kryesoret janë :

- Goditjet (rrotullimi ,rrëshqitjet , rrokullisjet)
- Përplasjet
- Zjarri

Pasojat

- Pasojat e këtyre fatkeqësive manifestohen duke shkaktuar vdekje , lëndime ,shkatërime të automjeteve dhe ndotje ambjenti.

Profili i rrezikut	
Rreziku : Aksidentet në transportin kolektiv rrugor	
Madhësia e mundëshme (Përqindja e goditjes në komunitet): E lartë 20 – 30 %	
Frekuenca e ndodhjes : Shumë e mundshme . mundësia 100 % brenda vitit	**Modeli sezonal :** Gjatë vitit

Zonat më të rrezikuara nga aksidentet : **Rruga kombëtare ; Mallakastër – Memaliaj – Tepelenë – Gjirokastër Kakavijë** **Rruga kombëtare ; Ura e Leklit – Këlcyrë – Përmet – Tri Urat** **Qarkulimi në zonat urbane të qarkut (Gjirokastër , Tepelenë e Përmet)**
Kohëzgjatja e mundshme : 3 – 5 orë
Shuma e mundshme e kohës së paralajmerimit : Pa paralajmërim
Sistemet ekzistuse të paralajmërimit : Sistemi integruar 112 , Shërbimet e informacionit të pol. Shtetit 129
A ekziston analiza e dobësive / cënueshmërisë : Po

Profili	Pasojat e mundëshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Shkalla e goditjes gjatë kohës së rreziqeve të transporit kolektiv , në vendin e aksidentit , shumë e lartë (vdekje dhe lëndime të rënda , për shkak të përplasjeve , rrokllisjeve dhe zjarreve) .	**Sh. e lartë**
Pasuria	Shkatërim dhe dëmtim i automjeteve private e publike .	**Sh. e lartë**
Ambienti	Dëmtohet mjedisi për shkak të derdhjeve të karburanteve të ndryshme gjatë përplasjeve , tymërat nga zjarret ,kontaminimi i ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore .	**E Mesme**
Dëmet ekonomike	Shkatërim i automjeteve , pasurisë , infrastrukturës , vitale dhe asj teknike	**Sh. e lartë**

SKENARI
Zona e emergjencës : Rruga kombëtare Tepelenë – Gjirokastër
Vendi : Fabrika e ujit (Uji Ftohtë)
Përiudha e ndodhjes së ngjarjes : Dhjetor
Situata e përgjithshme :
Shërbimi informacionit të policisë të komisariatit Tepelenë në orën 06.30 njofton për një aksident automobilistik me këtë situatë : Patrulla e qarkullimit e ndodhur në afërsi të vendit të ngjarjes raporton se si rezultat i shpejtësisë dhe parakalimit të gabuar dhe terrenit me lagështirë në vendin e quajtur kthesa e fortë tek Fabrika e Ujit ka ndodhur një përplasje midis dy automjeteve njëri kamion transporti dhe tjetri minibus 10 vendesh me pasagjerë . Nga përplasja midis dy automjeteve , minibuzi me pasagjerë pasi ka bërë 3- 4 rotullime ka përfunduar në lumin Drino . Nga kqyrja e vendit të ngjarjes dhe kontrollit të pasagjerëve konstatohet për dy shtetas të vdekur , 3 kanë përfunduar në rrjedhën e ujit dhe 5 të dëmtuar rëndë .
Patrulla e qarkullimit rrugor ka bërë sigurimin e vendit të ngjarjes .
Forca të përfshira në operacion : Grupi i gatshëm , dy patrulla qarkullimi të kom. pl Tepelenë , Shërbimi zjarrfikës , shërbimi ambulancës të spitalit Tepelenë .
Prefekti i Qarkut pasi vlerësoi situatën caktoi drejtues operacioni Drejtorin e DVP ,
Elementë të tjerë që do të përfshihen në në operacion : Në operacion do të përfshihen 1 mjet dhe 6 trupa të shërbimit zjarrfikës të bashkisë Gjirokastër , si dhe një grup i gatshëm e 1 patrullë policie të kom.policisë Gjirokastër.

I bëhet kërkesë Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për mbështetje me forca të specializuara për kërkime në ujë (lumin Drino)
Kohëzgjatja e emergjencës : 3 – 10 orë

Skema e organizimit te vendit te aksidentit ne rruge (Fabrika e ujit Tepelene)

3.5. H) RREZIQET NGA EPIDEMITË

HISTORIKU

Që në vitin 1950 Shqipëria ka bërë përpjekje të mëdha për të mbajtur nën kontroll sëmundjet infective për shkak të ndikimit të madh të tyre në shëndetin e njeriut . Zbatimi i përhershëm dhe i plotë i masave të kontrollit e të parandalimit i rregulluar me një kuadër të përshtatshëmligjor ka cuar në rritje të ndjeshme . Sot ka po ato modele të vdekshmërisë si dhe në vëndet e zhvilluara të europës.
Sëmundjet infective renditen në vendin e 5-6 me normat e përgjithshme të vdekshmërisë duke pasur ulje të vazhdueshme të normave të vdekshmërisë , duke pasur ulje të vazhdueshme të normave të vdekshmërisë me kalimin e kohës . Norma e incidencës për sëmundjet ngjitëse të parandalueshme me anë të vaksinimit është pa peshë . Disa prej tyre janë zhdukur (poliomieliti që më 1977 ,) ose janë në rrugën e zhdukjes (lia dhe rubeoola). Sifilizi është zhdukur në periudhën 1972 – 1994 . Rasti i fundit i njoftuar për maliarien vëndase i përket vitit 1967 .

Megjithatë sëmundjet infective ende përbëjnë pjesën më të rëndë të vdekshmërisë , duke mbetur kështu kërcënim i përhershëm për shëndetin e popullsisë , sepse ende ka nivele të larta vdekshmërie sidomos në inektimet e frymëmarjes dhe sëmundjetdiaretike , duke patur si bazë të përsëritjes së tyre ngjarjet e mundshme rrezikuese mjedisore fiziko- kimike . Sëmundjet zoonotike , që janë nën kontrollin dhe parandalimin veterinar (brucloza , leishmanioza , leptospiroza) vijojnë të shtohen mes popullsisë. Rishfaqa e sifilizit (1995) dhe prirja në rritje e infeksionit HIV , (rasti parë më 1993) janë një tregues iqartë për rrezikun real që paraqesin për shëndetin e popullsisë.

Një kontekst tillë kërkon të shtohet mbikqyrja epidemiologjikepër sëmundjet infektuese dhe të rritet mbikqyrja e ngjarjeve të mundshme rrezikuese mjedisore (ndotësit e ujit , të ajrit dhe të tokës) , si dhe nje planifikim për parapërgatitjen e hollësishme për cfarëdo fatkeqësie që mund të ndodh , me qëllim që të sigurohet përgjigje e menjëherëshme me kontroll të përshtatshëm dhe masa parandaluese.

Ky vlerësim jep përgjigje të plota dhe të hollësishme për gjendjen e sotme epidemiologjike të sëmundjeve infective në qark. Duke u mbështetur në vrojtimin e epidemive janë vlerësuar këto tipe :

- Sëmundje diaerrike (nga uji ,nga ushqimi etj)
- Hepatiti viral
- Sëmundjet infective me burim nga ajri
- Turbekulozi(TB)
- Zoonat (me natyrë kontrolli prej veterinarisë)
- Sëmundjet infective me vatra natyrore
- Sëmunddje infective prej parazitëve
- Infeksionet e transmetueshme seksualisht (ITS) dhe HIV/AIDS etë tjera

Sistemi i detyrueshëm i njoftimit në qark është vendosur në vitin 1990 dhe që nga ajo kohë ka patur mbikqyrje epidemiologjike . Studimet kanë arritur në këto rezultate dhe përfundime :

- ✓ Sëmundjet infective që vijnë kryesisht prej problemeve të pa zgjidhura higjeniko – epidemiologjike përbëjnë problem shëndetësor me rëndësi
- ✓ Sëmundjet infective nëpërmjet frymëmarjes janë sëmundjet më të zakonshme , të ndjekura nga sëmundjet gastrointestinal .
- ✓ Shumë nga prirjet shqetësuese janë të lidhura me shëndetin e mjedisit
- ✓ Denduria e zoonozave nën kontrollin dhe parandalimin veterinar të karakterit parësor (vaksinimi kundër plasjes), dytësor (brucelinizimi) ose të tretë (diagnostikimi dhe kontrolli I leshmaniiozës) .
- ✓ Niveli I gjetjes së sëmundjeve infective me anë të laburatorëve është i pa përshtatshëm për shkak të nivelit të punës së laburatorëve mikrobiologjiktë të spitaleve në tre rrethet e qarkut (të shëndetit publik).

Për të ruajtur niveli e arritur të mbrojtjes së popullsisë kundrejt sëmundjeve infective dhe për të përmirësuar atë , është e nevojshme të plotësohen këto kushte :

Sigurimi i vaksinave pa ndërprerje dhe në sasi të mjaftueshme për mbulimin e normave të popullsisë

- Vlerësimin e rezultateve të arritura për imunizimin , mbajtjen nën kontrollt të sëmundjeve me vaksinim të detyrueshëmë vazhdueshëm
- Mbajtja nën kontrolle dhe parandalimi sëmundjeve diaerrike , nepëpërmjet mirëmbajtjes profesionale të sistemeve rurale të tubacioneve dhe inspektimit të tyre të rregullt .

- Shtimit të aftësive dhe mundësive të laburatorëve mikrobiologjik

Përgjigja e emergjencës pas ndikimit të fatkeqësisë , masat dhe veprimet për mbajtjen nën kontrolldhe parandalimin e sëmundjeve infective , në të vërtetë janë vazhdimi I po atyre masave dhe veprimeve që janë ndërmarë përpara shfaqes së sëmundjes . Të lidhura me emergjencën janë disa kërkesa si më poshtë :
Mbrojtja e popullsisë kundrejt sëmundjeve infective në zona që mund të preken prej fatkeqësive natyrore natyrore duhet të planifikohen në periudhen para fatkeqësisë
Gjatë dhe pas shfaqes së fatkeqësisë duhet kryer hetimi epidemiologjik i rreptë i zonës së prekur
Të ndërmeren masa mbrojtëse , duke përfshirë vaksinimin , dezinfektimin , kontrollet e bartësve dhe deratizimin
Ekipet parandaluese mjekësore duhet të jenë të lëvizshme dhe të pajisura me mjetet e tyre dhe burimet financiare për punë të pa varur



Fig. 19b Denduria vjetore e sëmundjeve diarreike sipas rretheve

Përhapja e epidemisë së shkaktuar nga **COVID-19** pothuajse në gjithë botën, si sëmundje infektive e shoqëruar deri me humbjen e jetëve të qindra mijëra njerëzve në muajin Mars preku edhe vendin e qarkun tonë.
Në zbatim të ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" si dhe masave të menjëhershme të marra nga Qeveria Shqiptare ndaj virusit COVID-19, bënë të mundur parandalimin dhe përhapjen e virusit COVID-19, në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës.
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me epideminë e shkaktuar nga COVID-19 nxorri një sërë Urdhërash e ndër të tjerë edhe Urdhërin nr.156/2, datë 11.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së epidemisë nga infeksioni COVID-19".
Për këtë, Prefekti në rolin e Kryetarit të Mbrojtjes Civile në qark, më datën 11.03.2020, hartoi Planin e Veprimit Rajonal "Për marrjen e masave për menaxhimin e situatës COVID-19". Në këtë plan veprimi u përcaktuan detyrat për t'u zbatuar si për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe për degët territoriale dhe institucionet shtetërore që veprojnë në qarkun tonë.
Në zbatim të masave të përcaktuara në planin e veprimit të Prefektit të qarkut Gjirokastër për menaxhimin e situatës COVID-19 u informuan gjithë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, degët

territoriale dhe institucionet shtetërore që veprojnë në qarkun tonë dhe u kërkua marrja e masave si:

- Hartimi i planit të masave në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, degët territoriale dhe institucionet shtetërore për menaxhimin e situatës COVID – 19.
- Ngritja e Komisionit të Mbrojtjes Civile në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
- Zbatimi i Urdhrit nr.132 "Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jo publike dhe anulimin e grumbullimeve masive ne vende të mbyllara apo të hapura", Urdhrit nr.135 "Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin dhe përhapjen e COVID-19", Urdhrit nr.135/1 "Për mbylljen e veprimtarisë së çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19", Urdhrit nr.156 "Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", Urdhrit nr.156 "Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19".

❖ Dizinfektimi i ambienteve arsimore, shëndetësore, tregjeve, hapësirave publike ambienteve të shërbimit si dhe institucioneve të tjera.

❖ Iu bë thirrje komunitetit për reduktimin e pranisë në sporteleve si dhe për komunikimin me pika kontakti me mjete elektronike e telefon.

❖ Bashkëpunimi me policinë e shtetit për evidentimin e personave dhe menaxhimin për mbajtjen në vetëkarantinë (në banesa) për 14 ditë për të gjithë qytetarët që vijnë nga Italia e Greqia. Shtetasit që kthehen nga vendet e infektuara të plotësojnë tabelën e poshtëshënuar:

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Nr. personal	Numri telefonit	Qyteti /fshati	Shteti prekur

Të gjithë shtetasit të ndjekin me përpikmëri normat higjeniko-shëndetësore të parandalimit të sëmundjeve infektive që konsistojnë kryesisht në:

- Mbulimin e gojës dhe hundës në rastet kollitje apo teshtime, mundësisht me letra duarsh të cilat duhet të hidhën në kosh pas përdorimit.
- Larjen e shpeshtë të duarve, por jo më pak se 20 sekonda me ujë dhe sapun, ose me detergjentë me bazë alkooli.
- Kufizim maksimal të mundshëm të kontakteve fizike me të gjithë (shtërngime duarsh apo përqafime).
- Ruajtjen e distancave me të gjithë (të paktën 1.5 metra).

Nga NJVKSH Gjirokastër, Tepelenë e Përmet, shërbimi epidemiologjik të vazhdojë punën në terren. Të bëhet monitorimi i Pikave të Kalimi Kufitar në Kakavije dhe Tre Urat Përmet si dhe plotësimi i skedave, termometrimi dhe këshillimi i personave të ardhur nga të gjithë zonat e prekura për vetëkarantinim dhe hedhja e skedave në regjistrin ditor të udhëtarëve. Bashkëpunim me institucionet vendore (Njësia Vendore Kujdesit Shëndetësor, Spitalit, Komisariatet e Policisë).

Zbatimi me rigorozitet i të gjitha Urdhrave e akteve normative në mbrojtje të popullatës nga COVID-19 bënë të mundur që në territorin e qarkut Gjirokastër u shfaqen një numur I kufizuar rastesh të personave të infektuar nga ky virus (dei më 25 korrik 2020 , 22 raste active 14 të shëruar dhe 0 vdekje). Po kështu, nga ana e NJVKSH Gjirokastër, Tepelenë e Përmet, u vijua

monitorimi i situatës së COVID-19 dhe kontakti i përditshëm me çdo mjek e qendra shëndetësore për punën e kryer mbi parandalimin e përhapjes së këtij virusi.
Për këtë u bë vetëkarantinimi 14 ditor pranë hoteleve apo banesave të tyre i personave që kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar të Kakavijes dhe Tre Urat Përmet që erdhën nga shteti grek.
Po kështu, në zbatim të detyrimeve ligjore dhe Planit të Veprimit të Prefektit të qarkut Gjirokastër për situatën e krijuar, nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe institucionet shtetërore vendore u kërkuan dhe u ndoqën me prioritet dhe angazhim maksimal e në vazhdimësi të gjitha masat për parandalimin dhe përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës.
Për marrjen e informacionit ditor për monitorimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarkun tonë, në mbështetje të Shtabit Koordinues të qarkut, nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe institucionet shtetërore me Urdhrin nr.52, datë 10.04.2020 u organizua dhe funksionoi Zyra e Informacionit pranë Shtabit Koordinues në qark.
Çdo ditë është informuar AKMC për situatën e virusit COVID-19 në qarkun Gjirokastër.
Kanë përfunduar afatin 14 ditor të vetëkarantinimit në hotele deri më datën 29 Maj 2020, gjithsej 244 shtetas si dhe të vetëkarantinuar pranë banesave të tyre në qarkun Gjirokastër prej datës 11.05.2020 deri më datën 26.05.2020 gjithsej 259 shtetas.
Gjatë vitit 2020, numri i të prekurve me virusin Covid-19 në qarkun Gjirokastër, që prej fillimit të pandemisë deri më 31 dhjetor 2020 është 1860 persona, prej të cilëve 1650 persona janë shëruar dhe kanë humbur jetën 35 persona.

Nr.	**NJVKSH-të e qarkut Gjirokastër**	**Numri i testeve të kryera**	**Të prekur nga COVID-19**	**Persona aktiv pozitivë**	**Të shëruar**	**Vdekur**
1.	NJVKSH Gjirokastër	4185	1080	77	991	12
2.	NJVKSH Tepelenë	1415	367	49	306	12
3.	NJVKSH Përmet	1531	413	49	353	11
4.	**Totali**	**7131**	**1860**	**175**	**1650**	**35**

Gjithsesi, kjo pandemi ende nuk ka përfunduar dhe masat e mbrojtjes për parandalimin dhe përhapjen e virusit COVID-19 ende vazhdojnë . Që prej muajit mars 2021 ka filluar vaksinimi i popullatës .

3.5. I . Rreziku nga sulmi terrorist

Duhet të theksohet se qarku Gjirokastër nuk ka përjetuar ndonjë sulm terrorist dhe, në përgjithësi, nuk konsiderohet si vend me rrezik të veçantë për sulmet terroriste. Sidoqoftë, ngjarjet e sulmeve terroriste janë rritur. Një përshkrim i përgjithshëm që lidhet me sulmet terroriste.

Karakteristikat bazë• Ekspertiza për aktet terroriste dhe parandalimi i tyre realizohet nëpërmjet një pune shumë të specializuar ku përfshihen shërbimet sekrete, njësi të specializuara të policisë dhe të forcave të armatosura dhe shpesh edhe rrjete ndërkombëtare të specializuara. Si rezultat, këto çështje janë jashtë përgjëgjësive dhe parametrave të punës së atyre që merren me çështjet e emergjencave civile.

• Sidoqoftë, në rast të ndodhjes së ndonjë akti terrorist mbi objekte ose mbi njerëz, atëherë janë mekanizmat e përballimit të emergjencave civile, të cilët duhet të përgjigjen në të njëjtën mënyrë, si në rastet e fatkeqësive natyrore.
• Eksplozionet mund të kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme të grupeve të kërkim-shpëtimit dhe menaxhimin e të dëmtuarve në masë për të shpëtuar jetët e njerëzve në të njëjtën mënyrë si dhe në rastin e një tërmeti të vogël. Në mjaft situata kërcënuese terroriste janë dashur evakuime të shpejta dhe masive të njerëzve për t'i siguruar ata nga kërcënimet e mundshme, madje edhe nga një paralajmërim.
• Megjithate, ka faktorë të veçantë shtesë që duhet të merren parasysh, duke përfshirë sulmet dytësore pas një sulmi që, nga pamja e jashtme, duket si kryesor, si dhe ngjarje jo të zakonshme, si për shembull sulmet me armë të shkatërrimit në masë (ASHM), për të cilat nuk ka shumë përvojë.
• Duke u nisur nga natyra e tyre, sulmet terroriste zakonisht ndodhin pa paralajmërim ose me një lajmërim në çastin e fundit, por mund të pasohen nga një numër ngjarjesh të lidhura dhe ndonjëherë të koordinuara që shkaktojnë panik dhe strese të mëdha.

Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së Parandalimt dhe Lehtësimit

• Parandalimi është detyrë e strukturave dhe e institucioneve të specializuara.
• Sidoqoftë, detyra për të koordinuar strukturat për përballimin e emergjencave civile do të jetë kurdoherë detyrë e strukturave të shërbimit të emergjencave civile.
• Si rezultat, koordinimi për përballimin e situatës mbetet çelësi, ndërkohë që rrjedha koherente e informacionit dhe fushatat e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe të strukturave përkatëse janë kurdoherë të domosdoshme. Në këtë mënyrë duhet të inkurajohen strukturat përkatëse dhe publiku i gjerë që të jenë sa më të përgatitur për çdo emergjencë civile duke bërë që të lehtësojnë ndikimin mbi jetën dhe pronën.
• Sulmet terroriste janë të paparashikueshme, kështu që, për përballimin e tyre, parapëlqehet të planifikohet në të njëjtën mënyrë si për çdo emergjencë civile tjetër, në mënyrë që të jetë e mundur të kalohet në këto plane, nëse një situatë e tillë bëhet realitet. Procedurat e evakuimit, planet, informimi i publikut, identifikimi i strehimit të sigurt dhe asistenca humanitare për emergjencat, mbështetja logjistike dhe të gjitha përgjegjësitë e tjera të lidhura me to duhet të merren nga seksioni i përballimit të PKEC-së dhe nga planet e emergjencave/gatishmërisë të përgatitura në nivel rajonal dhe lokal.

Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Përgatitjes dhe të Mbrojtjes

• Sulmet terroriste shpesh nuk kanë paralajmërime të hershme, megjithëse mund të ndodhë të bëhen lajmërime me telefon në minutën e fundit. Në rast të tillë, mobilizimi i shpejtë i forcave operacionale duhet të aktivizojë strukturat përkatëse si dhe për rastet e fatkeqësive natyrore. Zakonisht përparësi kanë evakuimi i shpejtë dhe i sigurt si dhe izolimi i zonës së kërcënuar.
• Për ndërgjegjësim publik në lidhje me kërcënimet terroriste është e nevojshme të merret një vendim nga instancat e larta qeveritare. Marrja e këtij vendimi për rritjen e gatishmërisë, pra rritja e vigjilencës dhe e njohurive të publikut mbi atë çfarë duhet të bëhet në raste të tilla, është me rëndësi shumë të madhe pasi në këtë mënyrë shpëtohen jetë njerëzish. Këto aktivitete duhet të bëhen në të njëjtën mënyrë si për rastet e tërmeteve ose të përmbytjeve. Si rezultat, duhet të ndërmerren të gjitha aktivitetet për angazhimin e përbashkët të publikut dhe të institucioneve në këtë drejtim. Shkollat, administrata publike, spitalet, subjektet private, media lokale dhe publike duhet të angazhohen për të transmetuar mesazhe të thjeshta dhe koherente nëpërmjet të gjitha mjeteve të komunikimit, duke u bazuar në njoftimet zyrtare.
• Planifikimi për përballimin e emergjencave në nivel qendror dhe lokal, përfshirë edhe planet specifike të përgatitura për fatkeqësitë natyrore, do të aplikohet edhe në rastin e një akti terrorist. Meqenëse skenarët për emergjencat që mund të shkaktohen nga akte terroriste nuk mund të kenë terren të përcaktuar, për këto raste mund të zhvillohen tipa duke i kushtuar rëndësi përdorimit të stukturave në situata konkrete

• Praktikimi dhe testimi i planeve nëpërmjet stërvitjeve është me shumë vlerë edhe në një situatë sulmi terrorist.

Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Përgjigjes

• Veprimet e menjëhershme të kërkim–shpëtimit ndërmerren kryesisht nga komunitetet e prekura, ku pjesa më e madhe e njerëzve shpëtohen nga familjarët, miqtë ose fqinjët.

• Trajtimi i menjëhershëm mjekësor do të nevojitet për t´ua ofruar të plagosurve. Një fatkeqësi e një përmase të madhe do të kërkojë angazhim të gjerë jo vetëm të kapaciteteve lokale, por edhe të atyre kombëtare.

• Bëhet, gjithashtu, edhe një vlerësim i shpejtë i sigurisë së objekteve si dhe për dëmet dhe nevojat më emergjente.

• Mbajtja e rendit publik dhe dhënia e një informacioni të saktë janë shumë të rëndësishme për të vendosur qetësinë si dhe për të ulur pështjellimin e mëtejshëm që të mos shkaktohen viktima të tjera.

• Mund të jetë e nevojshme të evakuohet e gjithë popullsia nga zona e prekur ose nga zona të tjera që mund jenë nën rrezik të lartë. Në këtë situatë nevojitet mbajtja nën kontroll e rendit publik, dhënia e informacioneve të qarta, dhënia e mesazheve dhe e udhëzimeve për popullsinë si dhe informimi për zonat e sigurta të identifikuara më parë.

• Mund të kërkohen ose të ofrohen operacione ndërkombëtare të specializuara të kërkim-shpëtimit. Ardhja e skuadrave të kërkim-shpëtimit do të shoqërohet me kërkesa për transportin ajror dhe për mjetet e transportit rrugor gjatë përpjekjeve për t'i dislokuar ato në zonat e prekura sa më shpejt të jetë e mundur.

• Edhe gjatë trajtimit të menjëhershëm mjekësor dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit mund të vlerësohen rreziqet dytësore për objektet e dëmtuara.

• Mbështetja logjistike është shumë e rëndësishme për një përballim të suksesshëm. Rrjeti rrugor, aeroportet, telekomunikacioni dhe infrastuktura tjetër duhet të vihen në funksion sa më shpejt dhe sa më mirë që të jetë e mundur, me gjithë kufizimet.

• Nëse njerëzit mbeten brenda strukturave të prishura, skuadrat e specializuara të kërkim-shpëtimit, pasi të sigurohen, duhet të fillojnë menjëherë operacionet. Pjesa më e madhe e personave që shpëtohen do të jetë gjatë 24-48-orëshit të parë pas ngjarjes.

Faktorët për t'u marrë parashysh gjatë Rikthimit në Gjendjen Normale

• Siguria, eliminimi i materialeve të rrezikshme ose pastrimi i zonës nga ndotjet si dhe sigurimi i strukturave të dëmtuara duhet të garantohen përpara se popullsia të kthehet e sigurt në zonën e prekur.

• Shërbimet publike bazë ku përfshihen uji i pijshëm, ujërat e zeza, përdorimi i rrugëve dhe furnizimi me energji duhet të sigurohen sa më shpejt të jetë e mundur.

• Duhet të merren vendime të shpejta në lidhje me objekte bazë publike (duke përfshirë ndërtesat e shkollave dhe të spitaleve) që mund të jenë shkatërruar ose dëmtuar rëndë. Ndërtesat që nuk riparohen, duhet të prishen plotësisht dhe të merret në konsideratë zëvendësimi i tyre i përkohshëm ose i përhershëm.

• Duhet të merren vendime të shpejta për strehimin e sigurt të popullsisë së prekur. Mund të nevojitet që njerëzit të vazhdojnë të qëndrojnë në strehime të përkohshme edhe për njëfarë kohe.

• Një emergjencë e përmasave të mëdha shpesh shoqërohet me ndihmë ndërkombëtare ose mbështetje të mundshme financiare apo materiale. Për strukturat shtetërore, është e rëndësishme të vendoset ritmi i jetës ashtu siç ishte, të koordinohen në mënyrë efektive donacionet në bazë të nevojave parësore dhe të jenë vazhdimisht të informuara për të qenë në gjendje të refuzojnë donacionet jo të përshtatshme dhe /ose ofertat për mbështetje.

Përfundime :

Duke u mbështetur në vlerësimin e rreziqeve për fatkeqësitë e mundshme natyrore të cilave ka prirje t'u nënshtrohet territori i qarkut studimi i tyre ka krijuar një bazë të shëndoshë për :

- **Përpunimin e përgatitjes në rang qarku ndaj fatkeqësive dhe të planit të menaxhimit të emergjencave**
- **Vlerësime të rreziqeve dhe plane në nivel qarku e bashkie**
- **Fuqizimin e strukturave të emergjencave civile në nivel vendor**
- **Ngritjen e ndërgjegjësimit publik për rreziqet mbizotëruese lokale**

3.3 HARTAT E RREZIKUT , EKSPOZIMIT DHE RISKUT

Hartat mund të jenë mjete të rëndësishme për të paraqitur informacione për rrezikun, ekspozimin, cenueshmërinë dhe risqet në një zonë të veçantë, dhe si rrjedhojë mbështesin procesin e vlerësimit të riskut dhe strategjinë e përgjithshme të menaxhimit të riskut. Ato mund të ndihmojnë në vendosjen e prioriteteve për strategjitë e reduktimit të riskut. Hartat luajnë edhe role të rëndësishme për të siguruar se të gjithë aktorët kanë të njëjtin informacion për rrezikun në vlerësimin e riskut dhe në shpërndarjen e rezultateve të vlerësimit të riskut te palët e interesit. Së fundi, hartëzimi i riskut mund të jetë i dobishëm edhe në kontekst më të gjerë të planifikimit të përdorimit të tokës.

Projektet kërkimore dhe literatura akademike për çështjen e hartëzimit të riskut konfirmojnë kompleksitetin e tij dhe faktin se ka ende mangësi në metodologji. Ndërkohë që hartëzimi i rrezikut është përmirësuar nëpërmjet përdorimit të gjerë të teknikave GIS, përfshirja e variablave sociale, ekonomike dhe mjedisore në modelet GIS mbetet ende një sfidë.

- Hartat paraqesin shpërndarjen hapësinore të pritshme të rreziqeve madhore. Rreziqet dhe intensitetet e ndryshme duhet të paraqiten në harta të veçanta.
- Hartat e rrezikut duhet të shoqërohen me harta që tregojnë shpërndarjen hapësinore të të gjitha elementeve që duhen mbrojtur, si popullsia, infrastruktura, zonat e mbrojtura natyrore, etj. Gjithashtu, mund të përgatiten hartat e veçanta për çështje të ndryshme të mbrojtjes. Megjithatë, nëpërmjet përdorimit të Sistemeve të Informacionit Gjeografik mund të mblidhen informacione të tilla.
- Një seri e tretë hartash duhet të tregojnë shpërndarjen hapësinore të cenueshmërisë lidhur me ndjeshmërinë ndaj dëmit për të gjitha çështjet përkatëse të mbrojtjes (në harta të veçanta për çështje të ndryshme të mbrojtjes).
- Në një fazë të dytë, këto harta mund sigurojnë më pas edhe bazën për përgatitjen e hartave të riskut lidhur me paraqitjen e kombinimit të mundësisë dhe ndikimit të një ngjarjeje të caktuar, si dhe për hartat e përmbledhura të rrezikut.

Shënim : Hartat e rreziqeve nga fatkeqësitë e natyrës, ekspozimit dhe të riskut shih në shtojcën **B** të planit

4. SISTEMI I ALARMIT

Ndërtimi i një sistemi të sigurt të mbrojtjes civile, për një rrezik specifik, bazohet në sisteme komunikimi, sinjalizimi dhe alarmi që i përcillet autoriteteve të mbrojtjes civile dhe kur është e domosdoshme dhe qytetarëve. Ajo ndahet në fazat: **VËMENDJE**, **PARA ALARM, ALARM.**

Zakonisht, faza **VËMENDJE,** aktivizohet në bazë të vlerësimeve parashikuese dhe lidhet në përgatitjen e sistemit të mbrojtjes civile; faza **PARA ALARMIT** dhe **ALARMI** aktivizohen në ngërçin ose në vazhdimin e ngjarjes, kur me gradualitet në rritje, duhet të informohet dhe të vihet në siguri popullsia në zonën në rrezik.

Skenari: Përmbytje është tipik në përfshirjen e të **tre fazave**.

Fazat: **VËMENDJE, PARA ALARMIT** dhe **ALARMI** mund të përfshihen në varg të njëra-tjetrës dhe në rrezikun nga shembjet (rrëshqitjet masive) ose më rrallë në rastin e tërmeteve kur shkenca e sizmologjisë e paralajmëron një fenomen të tillë.

4.1 SISTEMI SHQIPTAR I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM

Shërbimi i paralajmërimit të hershëm në Republikën e Shqipërisë bazohet në një sistem qendror, pa përjashtuar marrjen informacionit në rrugë të ndryshme.

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit: është një njësi kombëtare kërkimore shkencore që vepron nën "ombrellën" e Universitetit Politeknik të Tiranës.

Fragment Buletini meteorologjik. Nivelet e alarmit



Pragjet e alarmit për reshjet e shiut sipas buletinit të IGJEUM-it

Tabela 1

Parashikimi Hidrologjik/Hidraulik (IGJEUM)	Niveli korrespondues i alertit i adoptuar nga vëmendja e Prefektit	Faza Minimale Operacionale për t'u adoptuar nga i gjithë sistemi Para - Alarm
I GJELBËR	I GJELBËR	Aktivitete të Zakonshme
I VERDHË	I VERDHË	Faza e Vëmendjes
PORTOKALLI	PORTOKALLI	Faza e Para Alarmit
I KUQ	I KUQ	Faza e Alarmit

Tabela 2

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm/24 orë)
----	Nuk priten
I ulët	Të dobëta (0 – 15)
Mesatar	Mesatare (15 – 45)
I lartë	Intensive (45 – 90)
Shumë i lartë	Shumë intensive (> 90)

Misioni i Institutit të Gjeoshkencave Energjisë, Ujit dhe Mjedisit është përmirësimi i kërkimit shkencor në fushën e gjeoshkencave në Shqipëri. Një ndër detyrat është realizim i kërkimit shkencor në fushën e rreziqeve natyrore si dhe të atyre të krijuara nga aktiviteti i njeriut (*rrëshqitje, erozion, përmbytje, ndotje e mjedisit etj*).

Studim i mikrozonimit në lidhje me vlerësimin e riskut sizmik në shkallë lokale dhe kombëtare.

Adaptimi i standardeve evropiane në studimet sizmike, studimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i aktivitetit sizmik të vendit dhe mundësimi i shpërndarjes së të dhënave në kohë reale për vendimmarrësit dhe opinionin e gjerë.

Nisur nga ky këndvështrim, informacioni i dhënë nga IGJEUM është një informacion shumë i rëndësishëm për rritjen e vëmendjes (kujdesit) për rreziqe të mundshme, të gatishmërisë dhe shkallës së alarmit.

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak (*Ministria e Mbrojtjes).* Funksionon në bazë të Ligjit nr.9224 datë 29 prill 2004 "*Mbi shërbimin meteorologjik Shqiptar*".

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak ka si objekt; studimin e faktorëve që rregullojnë dinamikën e atmosferës dhe të hidrosferës, kërkon të parashikojë evoluimin e motit e të klimës mbi një shkallë rajonale e globale.

Parashikimi i motit është një element tepër i rëndësishëm për marrjen e masave të përballimit të situatave emergjente. Në këto kushte, të gjithë janë të interesuar për situatën meteorologjike në pritje. Moti është i lidhur direkt me jetën e njerëzve, të aktivitet ditor, në bujqësi, fluturime, aktivitetin detar etj. Të dhënat e shërbimit meteorologjik sot jepen në internet dhe për pasojë ky shërbim informon qytetarët dhe në celularët e thjeshtë.

Nga Shërbimi Meteorologjik Shqiptar janë bërë investime të mëdha në ndërtimi e një rrjeti informativ. Si rezultat i kooperimit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të sistemit satelitor etj është bërë e mundur parashikimi i motit me një siguri të lartë. Përveç parashikimit është ndërtuar një sistem lidhje e këtij shërbimi me strukturat e Emergjencave Civile. Si Shërbimi

Meteorologjik Shqiptar ashtu dhe IGJEUM janë në kontakt të vazhdueshëm për të informuar për pritshmërinë e situatave meteorologjike, sizmike etj.
Për të monitoruar prurjet dhe nivelin e ujit të lumit Vjosë, në Përmet (ura), Memaliaj (ura) janë të vendosur hidrometra të cilët japin kuota relative (*jo nga niveli i detit*) të nivelit të ujit. Ka persona të cilët raportojnë ose u kërkohen të dhënat. Këta persona janë në listën e kontakteve.
Monitoruesi:

- **Ura në qytetin Memaliaj - Astrit Balili - nr. Tel. Celulari 0695859708**
- **Ura në qytetin Përmet - Fadil Guci - nr. Tel. Celulari 0692255766.**

Rritja e nivelit profesional të personelit të shërbimit është shoqëruar dhe me futjen e pajisjeve moderne matëse dhe satelitore, të cilat e kanë bërë raportin meteorologjik shumë të besueshëm.
Sistemi meteorologjik bazohet në një sërë stacionesh matëse në disa qytete të vendit si dhe lidhjeve satelitore sipas marrëveshjeve të bëra.
Shërbimi Meteorologjik Ushtarak nëpërmjet buletineve të transmetuara ditë për ditë ose dhe dy herë në ditë finalizon për situatat e pritshme.
Të dhënat (*për 5 ditë por dhe më shumë*) konsistojnë në; reshje në milimetra (të ndara në çdo dy orë), era, lagështia, pika e vesës etj.
Buletini meteorologjik nuk është thjesht një dokument tekst që lajmëron për situatën e pritshme, buletini nëpërmjet kodeve bën të mundur gjykimin e nivelit të alarmit. Ngjyrat e përdoruara janë në përputhje me marrëveshje që përdoren në të gjitha nivelet kombëtare dhe më gjerë.

4.2 AKTIVITETE MONITORUESE NË KOHË REALE

Aktiviteti monitorues i një skenari zhvillohet në disa faza në varësi të skenarit. Po trajtojmë aktivitetin monitorues të përballimit të përmbytjes (*rrëshqitjet masive*) ose situatave të cilat të japin kohë për lajmërim të hershëm dhe që janë tipike në përfshirjen e të gjitha fazave.
Ky rrezik përfshin ngjarjet që lidhen me lëvizjen e pakontrolluar të masave të ujit në një zonë, të shkaktuar nga shirat e rëndë ose lirimi i sasive të mëdha të ujit nga rezervuarët (*përmbytjev*e), si dhe ngjarjet e lidhur me paqëndrueshmërinë e shpateve (*rrëshqitjet e tokës*) edhe është i lidhur me rënien e reshjeve të forta.
Në ngjarje të tilla, për të cilat është përgjithësisht e mundur të paralajmërohen, përgjigjja e sistemit të mbrojtjes civile mund të bëhet përmes tre fazave të alarmit (*vëmendje, para alarmi dhe alarmi*).

Vëmendje
Faza e vëmendjes aktivizohet kur parashikimet dhe vlerësimet meteorologjike bëjnë të mundur verifikimin e dukurive të fenomeneve të rrezikshme. Kjo fazë aktivizohet nga strukturat rajonale të E.C. pas vlerësimit dhe integrimit të njoftimeve të dërguara, në nivelin e kritikalitetit. Nëse parashikimet e motit tejkalojnë vlerat (*pragun*) e paracaktuar bëhen vlerësime mbi shtrirjen territoriale dhe pasojat e fenomenit të pritshëm.

Para Alarm

Aktivizohet në saj të parashikimit të motit në disfavor dhe/ose ndonjë informacion mbi elemente të rrezikut apo të shqetësimit në vend nga territori, nga njësitë dhe/ose strukturat e caktuara për aktivitetet territoriale të mbrojtjes dhe monitorimit.

Alarm

Faza alarm aktivizohet kur të dhënat e reshjeve dhe/ose hidrometrike tejkalojnë pragje negative të caktuara, me parashikimet e motit dhe paralajmërimet e fenomeneve të rrezikshme afrohen ose po ndodhin në territor, të siguruara nga njësitë dhe/ose sektorët përgjegjës për aktivitetet e mbrojtjes territoriale dhe monitorimit.

Në këtë fazë, ngjarja me rrezik e paralajmëruar ka shumë gjasa të ndodhë.

4.2.1 Procedurat e monitorimit

Monitorimi sistematik i rreziqeve, mbajtja nën kontroll e territorit, kërkojnë përcaktimin e saktë të roleve dhe përgjegjësive të strukturave të emergjencave. Institucionet monitoruese në qark kanë detyrë të japin informacion periodik dhe specifik Prefektit të Qarkut (*specialistit të emergjencave*). Kërkesat për monitorim përfshijnë:

- Monitorimin e aktivitetit sizmik dhe hidrometeorologjik.
- Monitorimin e nivelit të ujit brenda kapaciteteve të sigurisë së digave.
- Monitorimin e zonave me rrezik rrëshqitje, veçanërisht shpateve me pjerrësi mbi 30 gradë.
- Monitorimin e reshjeve lokale të dëborës, shpejtësinë e erës/drejtimin dhe kushtet e temperaturës, të cilët ndikojnë në bllokimin e rrugëve.
- Monitorimin e trashësisë se konsoliduar të dëborës në faqet e thepisura me pjerrësi mbi 30 gardë.
- Monitorimin e shpateve të rrugëve të cilët "lotojnë" ujë nga prania e ujit me rrezik kthimin në ngricë, në orët në orët e vona.
- Monitorimin e kushteve dhe rreziqeve të rënies së zjarreve në pyje në zonat në rrezik.
- Monitorimin e funksionimit të kushteve të sigurisë në objektet industriale dhe ndërtesat.
- Monitorimin e ndotjes se mjedisit në tërësi.
- Monitorimin e kushteve të higjienës së epidemiologjisë.
- Monitorimin e sëmundjeve në bimë dhe kafshë.

Rolet dhe përgjegjësitë

Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive të strukturave të emergjencave civile janë detyrime që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore.

Përgjegjësitë në nivel qarku

Prefekti (*specialistët e emergjencave civile pranë Prefektit*), mban komunikim të vazhdueshëm me AKMC-në dhe deshifron buletinet.

- Njoftojnë në mënyrë të vazhdueshme AKMC-në, për ndryshimin e të dhënave të pikave të kontakteve të KMCQ-së, për strukturat e emergjencave civile brenda qarkut, për zyrtarët e caktuar si përgjegjës për çështje të emergjencave civile të bashkive dhe pikat kyç në sektorët publik, privatë dhe vullnetarë.

- Sigurojnë që sistemet e paralajmërimit të publikut dhe të komunikimit janë funksionale.
- Kontrollojnë dhe freskojnë të dhënat rreth gjendjes ushqimore si dhe të dhënat në lidhje me ilaçet rezervë në institucionet shtetërore dhe ato private, në nivel qarku.
- Kontrollojnë dhe freskojnë detajet e logjistikës së transportit, duke përfshirë numrin e makinave, gjendjen e tyre teknike, disponueshmërinë e karburantit dhe rezervën e tij në nivel qarku.
- Kontrollojnë dhe freskojnë të dhënat për llojet e makinerive dhe vendndodhjen e makinerive të rënda, të zotëruara si nga sektori shtetëror, ashtu edhe nga ai privat në nivel qarku.
- Bëjnë veprimet e duhura për sjelljen e mjeteve të rënda të transportit dhe vendosjen e makinerive të rënda në zonat që mund të izolohen, nëse është e nevojshme.
- Kontrollojnë marrjen e masave të tjera në nivel qarku, për t'u mbrojtur nga dukuri të mundshme rreziku duke përfshirë:

- Marrjen e masave për të siguruar pastrimin e kanaleve dhe të kolektorëve;
- Njohjen e komunitetit me rrugët e evakuimit, mjetet për komunikimin gjatë emergjencave, mjetet e informimit, zonat e mbrojtjes dhe vendstrehimet e sigurta;
- Ndërgjegjësimin e komunitetit për ruajtjen e ushqimit të nevojshëm, të ujit dhe të rezervave të tjera materiale;
- Marrjen e masave për hapjen e rrugëve ekzistuese dhe të rrugëve alternative, nëse është e nevojshme.

Në bashki

Strukturat e caktuara me përgjegjësitë për emergjencat civile në bashki:

- Njoftojnë në mënyrë të rregullt Prefektin e qarkut (*sektorin e EC-ve pranë Prefektit)* për të gjitha ndryshimet e pikave të kontaktit në njësinë përkatëse, si për kryetarin e bashkisë, punonjësin e emergjencave civile në bashki, anëtarin e KVMC-së në bashki dhe kontaktet e tjera kyç në sektorët publik, vullnetarë dhe privat.
- Sigurojnë funksionimin e sistemit të paralajmërimit dhe të komunikimit të publikut.
- Kontrollojnë dhe freskojnë inventarin e logjistikës së transportit, duke përfshirë numrin e makinave, gjendjen e tyre teknike, disponueshmërinë e karburantit dhe rezervën e tij në nivel bashkie.
- Kontrollojnë dhe freskojnë të dhënat rreth llojeve dhe vendndodhjes së makinerive të rënda të zotëruara si nga sektori shtetëror, ashtu edhe ai privat në nivel bashkie.
- Kontrollojnë marrjen e masave të tjera për mbrojtjen nga dukuri të mundshme nga rrezikut në nivel bashkie duke përfshirë:

- Marrjen e masave për të siguruar pastrimin kanaleve dhe të kolektorëve nga mbeturinat dhe materialet inerte.
- Njohjen e komunitetit me rrugët e evakuimit, mjetet për komunikimin gjatë emergjencave, mjetet e informimit dhe zonat e mbrojtjes dhe vendstrehimet e sigurta.
- Ndërgjegjësimin e komunitetit për domosdoshmërinë e ruajtjes se ushqimit, ujit dhe rezervave të tjera materiale.

VËMENDJE

Në këtë fazë u komunikon (*telefon, e-mail etj*.) strukturave të mëposhtme, situatën eventuale me zhvillimet e mundshme duke e saktësuar këtë fazë, bazuar në të dhënat e IGJEUM dhe QKOMC.

- bën me dije bashkitë për situatën në pritje.
- siguron azhurnimin e vazhdueshëm të vlerësimit u bazuar në të dhënat e reja të transmetuara nga sistemet kombëtare ose informacione të tjera të verifikuara dhe vërtetuara.
- komunikon ndërprerjen eventuale të fazës së vëmendjes.
- bën rikonjicion për situatën e kanalizimeve dhe zonave të emergjencës.

U jep informacionin e duhur (*për sa u takon*); **a) Strukturave monitoruese e njoftuese.**

Shënim: Nëse ngjarja është e lokalizuar bëhet ***njoftim me zgjedhje për mos rëndimin e strukturave.***

PARA ALARM

- Njofton **aktivizimin e fazës së para alarmit**, për autoritetet në mënyrë të njëjtë si u tregua më lart për fazën e vëmendjes, mbajtja e strukturave vazhdimisht të informuara për motin, matësit hidrometrikë (Gjirokastër, Përmet, Memaliaj) dhe pluviometrik.
- Njofton shërbimet monitoruese rajonale teknike të përfshira në aktivitete të mbrojtjes territoriale dhe strukturat e tjera të rajonit të përfshira në përballje, si dhe organizatat vullnetare;
- Aktivizon, sipas rastit, Komisionin e Mbrojtjes Civile me specifikat e rrezikut hidrogjeologjike (përmbytjet);
- Deklaron dhe komunikon përfundimin e fazës së para-alarmit në bazë të të dhënave hidrometrike dhe parashikimeve të motit dhe/ose informacionit nga zona.
- Në këtë fazë përveç rifreskimit të informacionit për strukturat:
  a) Strukturat monitoruese e njoftuese; njoftohen dhe
  b) Strukturat vepruese aktive respektive.

ALARM

- bazuar në informacione nga IGJEUM, nga grafikë, eksperienca të mëparshme, njofton për aktivizimin e fazës së alarmit.
- thërret KMC në përbërje të plotë dhe verifikon nëse janë aktivizuar ndërhyrjet e nevojshme të shpëtimit.
- siguron që menaxhimi i unifikuar i shërbimeve emergjente të aktivizohet në nivel rajonal, duke koordinuar ato me ndërhyrjet e kryetarëve të njësive administrative përkatëse.
- përcakton, kur shihet e përshtatshme, në varësi të ashpërsisë së situatës, një ose më shumë qendra të përbashkëta operacionale.
- parashikon zbatimin nga policia të shërbimeve të jashtëzakonshme mbikëqyrëse dhe mbrojtëse të kërkuara nga emergjenca dhe siguron përdorimin, për nevojat e para urgjente,

të Forcave të Policisë Vendore të qarkut (Policia Kufitare e etj) të pajisur në mënyrë të përshtatshme për shpëtim publik.

- verifikon nëse është e nevojshme ndërhyrja e Forcave të Armatosura.
- të verifikojë që strukturat kanë aktivizuar personelin e duhur dhe veprimet janë në përputhje me planet bashkiake e specifike të emergjencës.
- merr masa të mëtejshme, ndoshta të nevojshme, për të garantuar efektivitetin e asistencës për popullatën dhe siguron, nëse është e nevojshme, masa shtesë.
- shpall përfundimin e fazës së alarmit në bazë të të dhënave nga QKOMC, IGJEUM ose informacion nga territori.
- informon ZOS, QKOMC rreth fillimit të çdo vështirësie dhe problemesh që kërkojnë ndërhyrje nga strukturat rajonale.
- bashkëpunon me Nën/Prefektët dhe kryetarët e bashkive për aktivizimin e ndërhyrjeve të parashikuara në planin e emergjencës krahinore.
- aktivizon disponueshmërinë e shërbimeve të saj të mbrojtjes civile.
- kontrollon strukturat e mbikëqyrjes teknike dhe monitorimit në rrjetin rrugor në territorin e qarkut.

Në këtë fazë përveç futjes në veprim të strukturave:

a) Strukturat monitoruese e njoftuese,

b) Strukturat vepruese aktive respektive, futen në veprim dhe

c) Strukturat vepruese mbështetëse.

4.2.2 Shkëmbimi i të dhënave të monitorimit

Marrja e të dhënave (*informacionit*) për një skenar të mundshëm, sipas proceduarve ligjore dhe atyre që tashmë quhen të vërtetuara, bazohet në përgjegjësitë e strukturave. Burimi i besueshëm dhe zyrtar për skenarë të mundshëm është ai i marrë nga Instituti i Gjeoshkencës, Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, monitoruesve në terren që mbajnë në vëzhgim hidrometrat, pluviometrat etj.

Çdo strukturë sipas rastit vendos atë që quhet **pragu i rrezikut**.

Të dhënat e marra mund të sistemohen në tabela të tilla, të cilat monitorohen në vazhdimësi, pasi fenomeni ndryshon reagimin dhe për pasojë indikatorët që i përgjigjen një niveli kritik ndryshojnë.

Përdorimi i kodeve (indikatorëve) dhe monitorimi në vazhdimësi.

Tabela 1

1	VERDHË	2	PORTOKALLI	3	KUQ

Indikatorët e Kontekstit (IK)		Pikat Kritike të Parashi – kuara (K)
IK_0	Buletin Metereologjik përmban të paktën një nga si më poshtë: • Intensiteti i Precipitimit deri në **MODERUAR;** • **Sasia e** Precipitimit deri në të D**obëta.**	**Kritikalitet zero**
IK_1	Buletin Metereologjik përmban të paktën një nga si më poshtë: • Intensiteti i Precipitimit deri në **i Fortë,** • **Sasia e** Precipitimit deri në **Mesatare.**	**Kritikalitet i ulët**
IK_2	Buletin Metereologjik përmban të paktën një nga si më poshtë: • Intensiteti i Precipitimit ndërmjet **i Fortë dhe Shumë i Fortë;** • **Sasia e** Precipitimit ndërmjet **Intesive.**	**Kritikalitet i mesëm**
IK_3	Buletin Metereologjik përmban të paktën një nga si më poshtë: • Intensiteti i Precipitimit **Shumë e Fortë;** • Sasia e Precipitimit **Shumë Intesive.**	**Kritikalitet i lartë**

Tabela 2

Indikatori i Statusit (IS)		Informacion nga Rrjeti i Monitorimit ose Ekipet e Vlerësimit të Shpërndara në Terren	Kritikalitet (K)
IS1	**$IS1_1$**	Intensiteti i reshjeve të shiut deri në i moderuar, pa stuhi, jo – stacionare. (shiko Tabelën 1dhe 2 për vlerat specifike).	**Kritikalitet i Ulët**
	$IS1_2$	Në Rrugë: Pellgje të izoluara.	
		Shtretërit e lumenjve: shkarkim i ulët.	
		Në një lumë të mbuluar: 1/3 e hapjes së seksionit të mbuluar.	
		Rrëshqitjet e dherave: prezencë modeste e ujërave të larguara.	
IS2	**$IS2_1$**	Reshjet me intensitet të lartë. (shiko Tabelën 1dhe 2 për vlerat specifike).	**Kritikalitet i Mesëm**
	$IS2_2$	Nivelet Hidrometrike: në ngritje, duke arritur pragun e alertit.	
	$IS2_3$	Në Rrugë: ujëra të larguara që arrijnë deri tek gomat, kyçet e këmbëve të kalimtarëve, uji shumë i turbullt.	
		Kanalet e Kullimit të shtrëngatave janë bllokuar.	
		Shtretërit e lumenjve: rritet niveli i shkarkimeve.	
		Lumenj të mbuluar: 1/2 e hapjes së seksionit të mbuluar me ujë.	
		Rrëshqitjet: Ujëra të rrëmbyeshëm me prezencë materialesh të ngurta.	
	$IS3_1$	Reshjet me intensitet shumë të lartë, persistente dhe auto-regjeneruese .	
	$IS3_2$	Nivelet Hidrometrike: rritje e shpejtë e nivelit të ujit që arrin deri tek brigjet e lumenjve.	

IS3	**$IS3_3$**	Në Rrugë: uji në lartësinë e shasisë, vështirësi në lëvizjen e pluskimit të materialeve të rënda.	**Kritikaliteti i Lartë**
		Në lumenj: shkarkim deri në buzë të brigjeve.	
		Lumenjt të mbuluar: 2/3 e seksionit të hapjes e zënë me ujë.	
		Rrëshqitje e dherave: lëvizjet e tokës, rrugë të bllokuara.	

Shqipëria bën pjesë në një rrjet të financuar nga Programin IPA, i cili mbledh 7 partnerë; Italia, Kroacia, Sllovenia, Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovinë. Ky Program synon të kapitalizojë dhe shfrytëzojë arritjet kryesore të projektit ADRIARadNet (*tashmë të financuara nga Programi IPA)* duke kontribuar në zbatimin e disa veprimeve të Strategjisë së BE-së për shtyllat Adriatik-Jon (EUSAIR). CapRadNet, merr në konsideratë edhe përvojat dhe disa rezultate të projekteve të tjera të financuara nga IPA, të tilla si CAPS2 (ËËË.caps2.eu) dhe RoofOfRock (ËËË.roofofrock.eu) që mbulojnë disa çështje, identifikuesi i përbashkët i të cilave është rreziku hidrometeorologjik.

5. MODELI I NDËRHYRJES

Modeli i ndërhyrjes që do të pranohet për përballimin e një E.C. për një skenar konkret, konsiston në masa konkrete dhe të planifikuara (*të parashikuara*), të përshtatura (*adaptuara)* sipas situatës konkrete dhe përgjegjësive të caktuara. Modeli i pranuar (*zgjedhur, planifikuar*) përmban ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive në faza të ndryshme të operacionit dhe që përcaktohen progresivisht në planin e hartuar, në përputhje me evoluimin e ngjarjes, për të shfrytëzuar në mënyrë racionale burimet dhe koordinimin e operatorëve të E.C. në territor.

Thelbi i modelit të ndërhyrjes konsiston në mbajtjen në mënyrë të vazhdueshme e konstante të shkëmbimit të informacionit midis sistemit periferik (*strukturave monitoruese*) dhe sistemit qendror të mbrojtjes civile, në mënyrë që të aktivizohen në mënyrën më efikase strukturat operative njerëzore dhe logjistike në formën më logjike të organizuar.

Modeli i ndërhyrjes, zgjidhet nga:

- **a)** Ngjarja me njoftim (parashikim).
- **b)** Ngjarja pa paralajmërim.
- **c)** Ngjarje të veçanta.

a) Ngjarjet me njoftim janë ngjarje të cilat mund të parashikohen dhe për pasojë japin kohë për marrje vendimesh. Të tilla ngjarje janë: përmbytjet, zjarret në pyje, kur ata krijohen në periudhën dhjetor – prill, shembjet, kur ka pasur një indikacion sinjalizimi (*çarje, zgavër etj*).

b) Ngjarjet pa paralajmërim janë ngjarje të cilat japin efekte negative të dimensioneve të ndryshme, pa sinjale pa paralajmëruese (*tërmete, rrëshqitje masive*).

c) Ngjarje të veçanta janë ngjarje për të cilat nuk ka praktika standarde (*aksidente të rënda me dëmtime me jetë njerëzish ose dëmtime mjedisore*).

RRETHI MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE



5.1 PËRSHKRIMI I MODELIT TË NDËRHYRJES

Modeli i ndërhyrjes zgjidhet në varësi të rrezikut në pritje (përmbytje, rrëshqitje, zjarr, ndotje industriale apo akt terrorist). Çfarëdo qoftë modeli i ndërhyrjes, ai përmban këto faza:

VËMENDJE, PARA ALARM, ALARM.

Fillimi dhe mbarimi i çdo faze përcaktohet nga strukturat që menaxhojnë emergjencat civile.
Strukturat ligjore në qark, ngrihen bazuar në ligjin nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM nr. 663, 655, datë 18.12.2002, VKM nr. 531, 532, 533, datë 1.8.2003, VKM nr. 965.
Pranë Prefekturës së Qarkut, ngrihet dhe funksionon Komisioni i Mbrojtjes Civile. Komisioni funksionon mbi bazën e një rregulloreje që përcakton detyrat e këtij komisioni bazuar në Ligjin Nr.107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", në Ligjin Nr.45/2019 "*Për Mbrojtjen Civile"*, në VKM nr. 965, datë 02.12.2015 "*Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e Emergjencave Civile dhe Krizave"* si dhe në udhëzimet e Ministrisë së Mbrojtjes (Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile) për mbrojtjen civile për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimin e tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

Modeli i ndërhyrjes gjatë rrezikut nga përmbytjet nga lumenjtë

Në këtë ngjarje përfshihen të gjitha fazat: **vëmendje, para alarm, alarm**.

Suksesi i ndërhyrjes në këtë model ndërhyrje mbështet në koordinimin me efikasitet të: **Strukturave a), b), c);**

a) Strukturat monitoruese e njoftuese.

- Sektori i emergjencave civile në administratën e Prefektit.
- Sektorët e emergjencave civile në 7 bashkitë e Qarkut Gjirokastër.
- Sektori i Ekstensionit Bujqësor Gjirokastër.
- Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve.
- Drejtoria e Shëndetit Publik.

b) Strukturat vepruese aktive respektive.

- Reparti Ushtarak DMRajonale Gjirokastër.
- Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Gjirokastër.
- Stacionet e MZSH-ve në 7 bashkitë e Qarkut Gjirokastër.
- Shërbimet e urgjencës mjekësore Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet.
- Drejtoria e Shëndetit Publik Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet.
- Drejtoria Rajonale e OSSHE-së Gjirokastër (Njësitë, Agjensitë).
- Skuadrat e likuidimit të avarive të rrjetit elektrik.

c) Strukturat vepruese mbështetëse.

- Zyrat e Arsimimit në Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet, Universiteti "E. Çabej".
- Shërbimet Pyjore të 7 bashkive të Qarkut Gjirokastër.
- Drejtoria e Autoritetit të Rajonit Jugor (të Rrugëve Nacionale Gjirokastër).
- Grupet e avarive të Telekomit Gjirokastër.
- Degët e Kryqit të Kuq Shqiptar në Gjirokastër, Tepelenë, Përmet.

Faza VËMENDJE, kërkohet:

Njohja me situatën kritike, me qëllim reagimin me kushtet kritike, kërkohet nga **Institucioni i Prefektit**:

- vlerësimi i vazhdueshëm i buletineve të parashikimit: (**QKOMC – në rast rreziku dërgon me e-mail ose dhe me mjete të tjera situatën në evoluim**),
- verifikimin e skenarëve të rrezikut (*nisur nga eksperienca dhe raportime në terren*) në lidhje me ngjarjen e mundshme,
- aktivizimin e pjesshëm të Qendrës Operacionale Rajonale për shkëmbimin e informacionit,
- informon Komisionin e Mbrojtjes Civile (ose një pjesë të tij) për situatën në pritje t'u njoftojë anëtarëve (ose një pjesë të tij) kushtet e rrezikut potencial që mund të çojnë në përfshirjen e tyre,
- bën rokonjicion në terren për masa parandaluese (në Fushën e Gjirokastrës dhe Dropullit), pastrimi i kanaleve I, II, III.
- **Vërejtje:** Jep detyra për gjitha bashkitë e qarkut Gjirokastër për rrezikun e mundshëm nga prurjet e lumit Drino, Vjosa.

Faza PARA - ALARM

Në këtë fazë, aktiviteti i kontrollit të zonave të territorit të konsideruar në rrezik (*aktivizimi i pikave të monitorimit)* është veçanërisht i rëndësishëm, me qëllim të marrjes së elementeve të njohurive që lejojnë një aktivizim në kohë të organizmave të mbrojtjes civile.

Kjo fazë operacionale e referuar në veçanti për fenomenet meteorologjike mund të iniciohet:
- Me nismën e Drejtuesit (*Drejtorit*) të Mbrojtjes Civile.
- Me nismën e Prefektit, duke vlerësuar dukuritë nga informacione të verifikuar për riskun, duke njoftuar institucionet qendrore (*AKMC, ZOS*).
- Pas marrjes së Buletinit që raporton një situatë kritike të moderuara:
Si rregull Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile / këshilltari për mbrojtjen civile, informon Prefektin për situatën në zhvillim dhe mund të përdorë Kodet (*Vëmendje, Para alarm, Alarm*).

Institucioni i Prefektit të qarkut
Për përballimin e përmbytjeve në zonat të rrezikuara:

- Njofton Kryetarin/kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore për statusin PARA ALARM, për zhvillimet në pritje.
- Informon (ose mbledh) Komisionin e Mbrojtjes Civile ose një pjesë të tij për situatën në pritje (merr/propozon vendime).
- Inicion (zbaton) masat e mbikëqyrjes dhe monitorimit në zonat e ekspozuara ndaj rrezikut që konsiderohen të nevojshme.
- Informon (mbledh) anëtarët e KMC, për praninë e kushteve potenciale të rrezikut që mund të çojnë në përfshirjen e tyre progresive.
- Aktivizon QOR për shkëmbimin e informacionit me njësitë vendore dhe ato në rajon.
- Organizon monitorimin e pikave kritike të theksuara në kontekstin e skenarëve të ngjarjeve.
- Sektori i Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, pranë Prefektit të qarkut, është me aktivitet të plotë dhe jashtë orarit ditor. Sektori u vë në dispozicion: Prefektit dhe Komisionit dokumente të vlefshme, grafikë, eksperienca. Gjithashtu i jep asistencë titullarit për hapat e mëtejshme. Raporton në QKOMC.
- Informon (*aktivizon pjesërisht*) shërbimet esenciale në zonën në rrezik, për statusit, para alarmit.
- Intensifikohen rikonjicionet në zonat e rrezikuar; dhe aktivizon grupe për të siguruar mbikëqyrjen e zyrave dhe shërbimeve jetike, duke punuar jashtë orarit të punës.
- Azhurnohen kontaktet.
- Kërkohet raport në lidhje me kapacitet dhe gjendjen konkrete të mjeteve (*FA, Polici, etj*).
- **Grupi a), b), c),** sipas situatës, pa bërë sforco të kapaciteteve njerëzore dhe teknike.
- Caktohet vendi i grumbullimit të mjeteve dhe strukturave.
- I raporton QKOMC dhe ZOS, për situatën dhe masat e marra.

Faza ALARM
Kjo fazë përkufizohet (*shoqërohet me masa konkrete*) si e tillë, pasi evoluimi i situatës ka tendencë negative me dukuri të dukshme kërcënuese për njerëzit, pasurinë e tyre dhe dëmtimin e mjedisit.
Prefekti sipas skenarit në pritje ose në zhvillim, organizon punën për përballimin e kësaj emergjence.
Detajon ndërhyrjen sipas planit që është miratuar më parë ose merr vendim për përshtatje të tij, në varësi të situatës.

Koordinon komunikimin më strukturat qendrore për mbështetje në rast se situata në pritje është jashtë kapaciteteve lokal dhe kërkon informacion të vazhdueshëm nga njësitë apo strukturat lokale.

Zgjedh elementët institucional sipas skenarit të paraqitur. Detyrimet e strukturave operative dhe mbështetëse, të cilat janë në zinxhirin që i përgjigjen emergjencë (*shërbimi zjarrfikës, kërkim-shpëtimi, forcave të armatosur, shërbimit shëndetësor, Kryqit të Kuq*) të cilët do të jenë pjesë në tetarin e kësaj ngjarje.

Prefekti cakton:

- Drejtuesin e Operacionit në nivel qarku dhe kërkon drejtuesin lokal nga njësia/njësitë e qeverisjes vendore.
- Precizohen sipas planeve të bërë nga qendrat koordinuese, Qendrën Operative të Qarkut qendrën/qendrat operative të njësive vendore, si pjesë integrale të Planit të E.C.
- Merren të gjitha masat e komunikimit dhe detyrimit të raportimit reciprok, në formatet e pranuara.
- Kërkon të dhëna për krijimin e zonave të emergjencës.
- Kërkon nga autoriteti rrugor marrjen e masave lehtësuese të evakuimit dhe transportit të të plagosurve.
- Për evakuimin e popullsisë, merren masat me njoftim nëpërmjet kryetarëve të fshatrave, personave, grupeve shëtitës, me megafon, me mjete mediatike. Mund të kërkohet evakuimi forcërisht.
- Kërkon dhe verifikon nëse hapësirat janë në dimensionet dhe kushtet e kërkuara.

Komisioni mblidhet sa herë është e nevojshme në varësi të situatave.

QOMC është strukturë bashkërendimi dhe komunikimi midis drejtuesve kryesorë, institucioneve dhe organizatave që përfshihen në përgjigjen ndaj emergjencave dhe lehtëson shkëmbimin e informacionit midis tyre. Ajo shërben dhe si një sekretariat teknik që ndihmon punën për funksionimin e Komisionit të Mbrojtjes Civile dhe drejtuesve të operacioneve në nivele të ndryshme, bashki, qark etj në varësi të përmasave të emergjencës.

Vendndodhja

Si rregull, QOMC ngrihet pranë institucionit të Prefektit të qarkut.

Aktivizimi

Kur situata e lejon, Prefekti në konsultim me sektorin e emergjencave civile dhe sekretarin e përgjithshëm, aktivizon QOMC dhe cakton drejtuesin e operacionit të veprimeve për menaxhimin e situatës së emergjencës.

Organizimi dhe personeli

Personeli i QOMC përbëhet nga:

- Drejtuesi/koordinatori i veprimeve (*mund të lind nevoja e dy personave nëse puna vazhdon 24 orë në ditë*).

- Specialistë përfaqësues të zyrave dhe strukturave që kanë lidhje me emergjencat dhe/ose organizatave që i ofrojnë ndihmë personelit.
- Personel mbështetës administrativ.
- Të tjerë.

Për menaxhimin e përballimit të situatave të emergjencave civile, **ngrihet Qendra Operacionale e Mbrojtjes Civile (QOMC)**.

Shënim: Nga eksperienca, në Institucionin e Prefektit ngrihet QOMC me shërbim 24 orësh me sistem turnesh.
Përfaqësues nga të gjitha agjencitë dhe organizatat e përfshira në përgjigje të emergjencës mund të jenë pjesë e personelit ose të marrin pjesë në bashkërendimin dhe takimet e shpërndarjes së informacionit të organizuar nga QOMC-ve.

Përgjegjësitë
Drejtuesi/koordinatori i QOMC -ve

- Bashkërendon përgjigjen e strukturave të qeverisjes në qark.
- Siguron lidhjet e komunikimit midis QOMC -ve dhe qendrave të tjera operacionale dhe bashkërendon përpjekjet e OJQ-ve dhe OJF-ve.
- Identifikon burimet për ndihma.
- Iu paraqet raporte të rregullta strukturave të larta, Komisionit të Mbrojtjes Civile dhe drejtuesve të tjerë përkatës.
- Përgatit njoftimet për shtyp, pas miratimit në komision dhe ia bën të ditur medias.
- Drejton punën e specialistëve të drejtimit të operacioneve dhe atij administrativ.

Specialisti

- Mban evidenca dhe tabela me informacion të situatës.
- Ndjek progresin e zërave/pikave të ndryshme të veprimit.
- Përgatit raporte për situatën.
- Siguron që mbështetja administrative të jetë funksionale.
- Mbledh informacion vlerësues nga agjensit e tjera.

a) Modeli i ndërhyrjes për fikjen e zjarreve

Në këtë ngjarje kalohet direkt në fazën: **ALARM**.
Suksesi i ndërhyrjes në këtë model ndërhyrje mbështet në koordinimin me efikasitet në kohë të shpejtë të strukturave përgjegjëse për fikjen e zjarreve.

SINJALI ZJARR ËSHTË = ALARM

Sinjali për zjarr në një zonë mund të vijë nga vrojtues të autorizuar, qytetarë etj. Sinjalin për zjarr mund ta marrë Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut (Salla Operative 129) ose Shërbimi Zjarrfikës 128.

Me marrjen e sinjalit, Salla Operative njofton Shërbimin Zjarrfikës, strukturat e Emergjencave Civile të Bashkisë/Njësisë Administrative, Prefekturën.
Shërbimi zjarrfikës vihet menjëherë në veprim pas njohjes së shpejt me intenerarin e lëvizjes dhe kapacitetet që duhen të angazhojë.
Shefi i MNZH-së është në këtë rast **Drejtues Operacioni.** Angazhimi në kohë është çelësi i suksesit të fikjes së zjarrit. Drejtuesi i Operacionit duke vlerësuar situatën, kërkon angazhim të forcave të tjera nga F.A. ose mbështetje ajrore. Kërkesa i drejtohet Prefektit.

Për fikjen e zjarreve angazhohen:

- Punonjësit e Shërbimit Zjarrfikës.
- Strukturat e shërbimit pyjor në 7 shtatë bashkitë e Qarkut Gjirokastër.
- Vullnetarë, barinj.
- Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve.
- Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura.

Kullotja e pakufizuar dhe zjarret e pakontrolluara, të shkaktuar shpesh për shkak të djegies me qëllime për pastrim kullotash, vazhdojnë të ndodhin në qark.
Qarku i Gjirokastrës vitet e fundit ka qenë më problematiku në shkallë vendi, përsa i përket dendësisë se zjarreve duke pasur mesatarisht 50 zjarre në vit.
Masat për menaxhimin e zjarreve, që duhet të përforcohen nga shërbimi pyjor tashmë kanë kaluar në administrimin e bashkive, në qark janë:
Vënia në punë e një sistemi vrojtimi dhe sinjalizimi, vigjilencë për raste zjarri gjatë gjithë periudhës së shtimit të rrezikut të zjarreve dhe ndërtimi i pritave kundër zjarreve mbeten detyra në vazhdimësi.
Në pyjet me rrezik zjarri kryesisht në Parkun e Antigonesë, në pyllin e Sotirës, të Zagories, të Bredhit të Hotovës dhe të Kardhiqit ka rrjet vrojtimi e sinjalizimi që përdoret nga shërbimi pyjor gjatë stinës së zjarreve. Infrastruktura në dispozicion dhe pajisjet për shuarjen e zjarreve do të vijnë duke u përmirësuar.

Karakteristikat bazë

Zjarret shpesh edhe pse janë ngjarje në një shkallë të vogël, kanë një ndikim dramatik mbi jetën dhe pronën. Përjashtim përbëjnë zjarret që mbulojnë sipërfaqe të mëdha shkurresh ose pyje ku përfshihen dhe zona të banuara, pasi këto të fundit mund të shkaktojnë shkatërrim në një zonë të gjerë.
Shkaqet kryesore të zjarreve vijnë nga njerëzit duke përfshirë neglizhencën, aktivitetet bujqësore të kontrolluara si për shembull djegia e kullotave, aksidentet dhe vëniet e qëllimshme të zjarrit.
Si rezultat, zonat specifike të rrezikut janë lehtësisht të identifikueshme ndërkohë që parandalimi, lehtësimi, mbrojtja dhe parapërgatitja janë të mundura dhe mund të kenë efekte të ndjeshme për uljen e rrezikut.
Në rastet e zjarreve që përfshijnë sipërfaqe të tëra, rezultatet janë shumë të vështira për t'u kontrolluar, qofshin këto zjarre të shkaktuara nga njerëzit ose zjarre natyrore dhe drejtimi i erës është një faktor i veçantë në përparësi për drejtimin e tyre.
Në qarkun Gjirokastër rreziku më i madh i zjarreve të pyjeve është evident në fund të pranverës

dhe gjatë periudhave të thata të verës. Që prej 1992-it rreziku i zjarreve të pyjeve në qark është rritur në mënyrë të konsiderueshme si në shpeshtësi ashtu dhe në përmasa të zonave të prekura.

Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së parandalimin dhe lehtësimit

Faktorët e parandalimit si fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe institucional mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në uljen e rrezikut. Këto fushata mund të ndërmerren në nivel rajonal ose në nivel lokal, sipas nevojave specifike të rreziqeve në zonën përkatëse.

• Publiku dhe institucionet duhet të jenë të ndërgjegjshëm për legjislacionin ekzistues që ndalon ndezjen e zjarreve në zonat me rrezik të lartë dhe rregullat duhet të jepen si mesazhe të thjeshta.

• Një sistem serioz patrullimi ndihmon në vendosjen e ndërgjegjësimit dhe zbatimin e legjislacionit.

• Mund të nevojiten ndryshime në praktikat bujqësore për sa i përket rreziqeve në rritje.

• Alternativa, opsione dhe udhëzime mund të jenë të nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin për mos djegien e kullotave në periudhat kur rrezikshmëria është e lartë ose në rastet e djegieve të bëhen të kotrolluara.

Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së parapërgatitjes dhe mbrojtjes

• Inkurajimi dhe zbatimi i masave ekzistuese të mbrojtjes si për shembull barrierat për parandalimin e zjarrit, kullat për monitorimin e pyjeve dhe një sistem patrullimi i përforcuar për pyjet është çelësi për mbrojtjen e zonave të mëdha nga zjarret.

• Mbështetja dhe përforcimi i një rrjeti permanent ekzistues të mbikëqyrjes sinjalizimit (*me disa kulla zjarri në rrethe)* jep këtë përgjigje esenciale të hershme.

• Investimet, trajnimi dhe përdorimi racional i teknikës, mund të çojnë në përballim të situatës përpara se kjo e fundit të mos mund të kontrollohet nga njeriu.

Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së përgjigjes

Shpejtësia e përgjigjes është faktori përfundimtar në parandalimin e zjarrit në një pyll të vogël ose zjarrit në shkurre për të mos marrë përmasat e një emergjence civile.

• Drejtimi i zjarrit është shumë i paparashikuar dhe e gjithë popullsia vendase ose e përkohshme në çdo rast duhet të përgatitet për t'u evakuar. Evakuimi duhet të bëhet mundësisht sipas planeve të gatishmërive ekzistuese dhe të testuar.

• Duhet të identifikohen dhe të parapërcaktohen zonat e sigurta për evakuimin së bashku me rrugët e sigurta për të shkuar në ato zona që ekzistojnë ose që janë dhënë si mundësi.

• Publiku dhe institucionet duhet të mbahen të mirëinformuara nëpërmjet mjeteve të nevojshme duhet të lejohen ose të inkurajohen që të kthehen në shtëpitë e tyre kur situata të jetë përsëri absolutisht e sigurt.

• Në emergjencat e zjarreve të një madhësie të konsiderueshme, kërkohet ndihmë në qarqet fqinjë dhe në qendër.

Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazë së rikthimit në gjendjen normale

• Dëmtimet në lidhjet e transportit, energjisë elektrike dhe telekomunikacioneve duhet të jenë me përparësi për t'u rregulluar, sapo situata të jetë e sigurt për të bërë një gjë të tillë.

• Situata duhet të monitorohet nga afër për shpërthime të papritura të vatrave të zjarrit fillestar ose të zjarreve dytësore, që ndodhin nga i njëjti shkak fillestar ose nga materialet djegëse që zhvendosen nga era.
• Kthimi i situatës në normalitet sjell mundësi për të mësuar nga një rishikim i plotë i shkaqeve dhe ndikimit të asaj se çfarë ndodhi, duke analizuar rëndësinë e paralajmërimit në kohën e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme si dhe përgjigjen e duhur.
• Humbja ekonomike që vjen si rezultat i zjarrit, duhet të paraqitet me koston e mundshme të lehtësimit kundrejt një situate të përsëritur, si mjet për të kërkuar investime për parandalimin.
• Etapa e menjëhershme e pas ngjarjes, mund të paraqesë një mundësi për të aplikuar për burime shtesë për parandalimin, lehtësimin dhe mbrojtjen.

b) Modeli i ndërhyrjes në rast tërmetesh

Në këtë ngjarje përfshihet vetëm faza: **ALARM**.
Suksesi i ndërhyrjes në këtë model ndërhyrje mbështet në koordinimin me efikasitet në kohë të shpejtë të strukturave përgjegjëse të operacionit të shpëtim-kërkimit.

SINJALI TËRMET = ALARM

- Veprimet e para janë prania e shërbimit shëndetësor dhe spitalor.
- Prania e OSHEE-së, për takime e stakime të linjës elektrike.
- Kryqi i Kuq Shqiptar (Dega).
- Ngritja e kampingjeve.
- Ndërtimi i magazinave provizore.

Futja në veprim:

a) Strukturat monitoruese e njoftuese, sipas kompetencave.
b) Strukturat vepruese aktive respektive, sipas kompetencave.
c) Strukturat vepruese mbështetëse, sipas kompetencave.

Karakteristikat kryesore

Në përgjithësi, tërmetet bien pa paralajmërim, por mund të pasohen nga një seri lëkundjesh të tjera, shtrirja kohore e të cilave mund të zgjasë për ore, ditë ose javë të tëra.
- Lëkundjet pasuese janë të një shkallë me të vogël se e para, por mund të shkaktojnë ndikim të madh, veçanërisht tek strukturat që janë dëmtuar tashmë.
- Tërmetet godasin nga thellësi të ndryshme dhe kanë kah lëvizje horizontal, vertikal ose të kombinuar.
- Në përgjithësi, e matur në shkallën Rihter, madhësia e një tërmeti nuk tregon intensitetin (*efektin sipërfaqësor*) e tij në një vend të caktuar.
- Dëmtimet e shkaktuara nga tërmetet varen nga këta faktorë: madhësia në shkallë Rihter, thellësia e vatrës, karakteristikat e truallit ku mbështeten objektet, cilësia e strukturave të prekura, intensiteti dhe numri i pasgoditjeve, pasgoditja kryesore, efektet dytësore që shfaqen në truall etj.

- Numri i viktimave nga tërmetet varet shumë nga aftësia që kanë objektet e ndërtimit për t'u rezistuar goditjeve sizmike si dhe nga koha lokale në të cilën ndodh goditja.
- Edhe efektet dytësore mund të çojnë në pasoja serioze si rrëshqitjet e tokës, dalja në sipërfaqe e thyerjeve tektonike, lëngëzimi i trojeve, përmbytjet që vijnë nga dëmtimi i ujëmbledhësve etj.
- Shkatërrimi i papritur i një dige kryesore nga goditjet sizmike do të sillte pasoja katastrofike për komunitetin që jetojnë afër saj.

Faktorë që duhet të merren parasysh në parandalimin dhe lehtësimin

- Një tërmet ose dukuri tjetër sizmike është e pamundur të parandalohet, por në zonat me rrezik të lartë mund të merren masa për të kufizuar efektet negative që lidhen me cënimin e jetës dhe të pasurisë.
- Investimet, bashkërendimi dhe fushatat e ndërgjegjësimit të institucioneve dhe të publikut inkurajojnë lehtësimin dhe uljen e rreziqeve.
- Përmirësimet, pranimi dhe zbatimi i kodeve dhe i standardeve të ndërtimit për të përballuar lëkundjet sizmike ulin dëmet në njerëz dhe në pasurinë private dhe publike.
- Ndërtimet e reja të një rëndësie të veçantë duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të përballojnë goditjet e forta sizmike.
- Sensibilizimi i strukturave në nivel lokal është i rëndësishëm për të zhvilluar strategji për zbatimin e kodeve ekzistuese me synim përmirësimin e tyre.
- Objektet e rëndësishme që paraqesin rrezik, si diga, infrastruktura publike dhe private duhet të mirëmbahen në gjendjen ekzistuese dhe po të jetë e nevojshme të bëhen përmirësime strukturore.

Faktorë për t'u marrë në konsideratë gjatë përgatitjes dhe mbrojtjes

Në përgjithësi, në rastet e tërmeteve ose goditjeve sizmike, paralajmërimi në kohë nuk është i mundur, por mund të bëhen përgatitje të veçanta në zonat e identifikuara si zona me rrezik të lartë sizmik.

Ndërgjegjësimi i publikut për momentet e para të tërmeteve është shumë i rëndësishëm për shpëtimin e jetës. Shkollat, administrata publike, spitalet, industria private, mediat lokale dhe publike duhet të shpërndajnë mesazhe të thjeshta e të kuptueshme.

Planifikimi i përballimit të emergjencave në nivel lokal dhe për çdo institucion si dhe autoriteti përkatës duhet të rriten pasi një gjë e tillë është e lidhur drejtpërdrejtë me bashkërendimin rajonal, me mobilizimin e burimeve nëpërmjet Planit të qarkut për emergjencat civile.

Planet e Përballimit të Emergjencave, duhet të praktikohen nëpërmjet stërvitjeve stimuluese dhe në terren.

Parashikimi i vendeve për evakuim në planet e emergjencave civile në bashki. Vendet për kampingje duhet të jenë të tilla që të ofrohet struktura e nevojshme për një jetesë ose rehabilitim të shpejtë. Kapacitet transportuese dhe trajnimi i personelit.

Të gjitha strukturat e emergjencave, linjat e komunikimit, rolet dhe përgjegjësitë duhet të qartësohen, të përgjithësohen dhe të testohen në bazë të planeve për të siguruar një përgjigje efektive të vazhdueshme.

Në planet e bashkive janë të përcaktuara, vendet për evakuimin e popullsisë dhe ndërtimin e kampingjeve. Në shtojcë janë listuar kapacitetet njerëzore, teknike si dhe vendet me kapacitete përkatëse.

Faktorët për t'u marrë parasysh në fazën e përgjigjes ndaj emergjencave civile

- Veprimet e menjëhershëm të kërkim-shpëtimit ndërmerren kryesisht nga komuniteti i prekur ku pjesa më e madhe e njerëzve shpëtohen nga familjarët, të afërmit ose fqinjët.
- Trajtimi i menjëhershëm mjekësor i të plagosurve do të jetë mjaft i domosdoshëm, kjo kërkon një plan për trajtimin e viktimave në masë dhe nëse është e nevojshme evakuimin për trajtim mjekësor jashtë zonës së prekur nga tërmeti.
- Vlerësimi i shpejtë rreth humbjeve, dëmtimeve dhe nevojave.
- Nëse njerëzit mbeten brenda strukturave të dëmtuara, duhet të fillojnë sa më shpejt operacionet e kërkim-shpëtimit duke pasur parasysh se 24-48 orët e para është koha gjatë së cilës mund të shpëtohen pjesa me e madhe e njerëzve.
- Në vartësi të shumë faktorëve, operacioni i kërkim-shpëtimit mund të vazhdojë në mënyrë të suksesshme për deri në 65 orë ose më shumë orë pas ngjarjes. Nëse është shkaktuar një dëmtim struktural i konsiderueshëm dhe nëse një numër i madh njerëzish kanë mbetur brenda, mund të kërkohet mbështetje edhe nga struktura të tjera në qarqet fqinjë ose nga qendra.
- Ardhja e skuadrave të kërkim-shpëtimit do të shkaktojë një ngarkesë të konsiderueshme mbi infrastrukturën e transportit ajror dhe rrugor si dhe kërkon angazhim për t'i shpërndarë ato në zonat e prekura sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Skuadrat ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit mund të vijnë edhe me spitale fushore. Për këtë, ka çështje specifike që duhet të qartësohen para pranimit/kërkimit të një spitali fushor, të cilat duhet të bëhen nëpërmjet drejtuesit të operacionit të qarkut me drejtuesin DQO.
- Rreziqet dytësore dhe dëmtimet strukturore të ndërtesave publike (spitale, shkolla, ndërtesa administratash etj) duhet të vlerësohen duke u siguruar se ato mund të funksionojnë pa pasur rreziqe.
- Vlerësimi dhe kujdesi i vazhdueshëm për nevojat për ujë të pijshëm, strehë të sigurt, furnizimin me ushqime dhe artikuj të tjerë jo ushqimore si dhe regjistrimin dhe kërkimin e personave që mungojnë.
- Mbështetja logjistike është shumë e rëndësishme për një përballim të suksesshëm. Rrjeti rrugor dhe infrastruktura tjetër duhet të vihen në funksion sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Për rastet e viktimave në masë (qindra të vdekur) duhet të merren hapa specifike në mënyrë që të menaxhohet si duhet një situatë e tillë.

Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së rikthimit në gjendjen normale

- Shërbimet publike bazë, që përfshijnë furnizimin me ujë të pijshëm, ujërat e zeza, akset kryesore të rrugëve dhe furnizimin me energji, duhet të jenë të sigurta.
- Vendime të shpejta duhet të merren në lidhje me ndërtesat kryesore të ndërmarrjeve publike duke përfshirë dhe ndërtesat e shëndetësisë dhe shkollat.
- Vendime të shpejta duhet të merren, gjithashtu edhe me strehimin e sigurt për popullsinë e prekur. Përdorimi i çadrave të jetë për një kohë të shkurtër.
- Ndërtesat industriale dhe objektet bujqësore që janë dëmtuar ose shkatërruar. Restaurimi i këtyre burimeve është shumë i rëndësishëm për rimëkëmbjen e ekonomisë dhe për punësimin e komunitetit.

- Një tërmet i fuqishëm i lë efektet e tij për një brez ose edhe për më tepër dhe rajoni i prekur do të ketë nevojë për mbështetjen ndërkombëtare për një afat më të gjatë derisa të bazohet në forcat e tij. Planifikimi për riaftësim duhet ta reflektojë këtë gjë.
- Rikthimi në gjendjen normale është mundësi për lehtësimin dhe parandalimin. Përveç presioneve të mëdha për të siguruar strehim dhe shërbim sa më të shpejtë të jetë e mundur, duhet të merren parasysh edhe çdo mundësi për të ndërtuar instalime të reja të një standardi që të përballojë goditjen sizmike, duke bërë ndërtimin në një zonë të studiuar me kujdes, përfshirë këtu edhe shërbimet publike.

Mirëmbajtja e strukturave ekzistuese duhet të inkurajohet në rastet e riparimeve, veçanërisht për shkollat e spitalet. Në rastin e strukturave shëndetësore duhet të sigurohet një funksionim i plotë për gjatë të gjitha fazave, duke përfshirë instalimin e rrjetit afatshkurtër të furnizimit me ujë dhe mjete për t'u përdorur në rastet e nevojshme, si gjeneratorë dhe ndriçim në rastet e kërkuara.

5.1.1 Organizimi i Qendrës Operacionale të Emergjencave (Organizimi brenda institucionit të Prefektit).

Sipas Ligjit *"Për Prefektin e Qarkut*" dhe Ligjit "*Për Mbrojtjen Civile*", Prefekti është autoriteti që mban përgjegjësinë për përballimin e emergjencave civile. Prefekti sipas skenarit në pritje ose në zhvillim, organizon punën për përballimin e kësaj emergjence:

- Detajon fazat e ndërhyrjes sipas planit që është miratuar më parë ose merr vendim për përshtatje të tij, në varësi të situatës.
- Koordinon komunikimin me strukturat qëndrore për mbështetje në rast situate në pritje është jashtë kapaciteteve lokale dhe kërkon informacion të vazhdueshëm nga njësitë apo strukturat lokale.
- Zgjedh strukturat institucionale sipas skenarit të paraqitur. Detyrimet e strukturave operative dhe mbështetëse, të cilat janë në zinxhirin që i përgjigjen emergjencë (*shërbimi zjarrfikës, kërkim-shpëtimi, forcave të armatosur, shërbimit shëndetësor, Kryqit të Kuq*) të cilët do të jenë pjesë në teatrin e kësaj ngjarje.
- Prefekti cakton Drejtuesin e Operacionit, në nivel qarku dhe kërkon drejtuesin lokal nga njësia/njësitë e qeverisjes vendore.
- Precizohen sipas planeve të bëra qendrat koordinuese; Qendrën Operative të Qarkut, qendrën/qendrat operative të njësive vendore, si pjesë integrale të Planit të E.C.
- Merren të gjitha masat e komunikimit dhe detyrimit të raportimit reciprok, në formatet e pranuara.
- Kërkon që Qendrat të furnizohen (*ose kërkohet*) të kenë në dispozicion tabela, shifra, eksperienca të mëparshme etj.
- Kërkon të dhëna për krijimin e zonave të emergjencës.
- Kërkon nga autoriteti rrugor marrjen e masave lehtësuese të evakuimit dhe transportit të plagosurve.
- Evakuimin e popullsisë.
- Kërkon dhe verifikon nëse hapësirat janë në dimensionet dhe kushtet e kërkuara.

Në ngjarjet, ku përfshihen të gjitha fazat: **vëmendje, para alarm, alarm**.

Faza VËMENDJE

Njohja me situatën kritike të zakonshme, me qëllim të afrimit të kushteve të moderuara kritike, kërkohet nga **Institucioni i Prefektit:**

- vlerësimi i vazhdueshëm i buletineve të parashikimit.
- verifikimin e skenarëve të rrezikut (nisur nga eksperienca dhe raportime në terren) në lidhje me ngjarjen e mundshme.
- aktivizimin e *pjesshëm* të Qendrës Operacionale Rajonale për shkëmbimin e informacionit.
- informon Komisionin e Mbrojtjes Civile *(ose një pjesë të tij)* për situatën në pritje.

Faza PARA-ALARMIM

Në këtë fazë, aktiviteti i kontrollit të zonave të territorit të konsideruar në rrezik (*aktivizimi i pikave të monitorimit)* është veçanërisht i rëndësishëm, me qëllim të marrjes së elementeve të njohurive që lejojnë një aktivizim në kohë të organizmave të mbrojtjes civile.

Kjo fazë operacionale e referuar në veçanti për fenomenet meteorologjike, mund të iniciohet:

- Me nismën e Drejtuesit (*Drejtorit*) të Mbrojtjes Civile.
- Në nismën e Prefektit duke vlerësuar dukuritë nga informacione të verifikuar për riskun, duke njoftuar institucionet qendrore (AKMC, ZOS).
- Pas marrjes së Buletinit që raporton një situatë: kritike të moderuara:

Si rregull Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile / këshilltari për mbrojtjen civile:

- Informon Prefektin / për situatën në zhvillim dhe mund të përdor Kodet (*Vëmendje, Para alarm, Alarm*).

Institucioni i Prefektit:

- Njofton Kryetarin / kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore, për statusin Para alarm, për zhvillimet në pritje.
- Informon (ose mbledh) Komisionin e Mbrojtjes Civile ose një pjesë të tij për situatën në pritje (*merr/propozon vendime*).
- Inicion (zbaton) masat e mbikëqyrjes dhe monitorimit në zonat e ekspozuara ndaj rrezikut që konsiderohen të nevojshme.
- Informon (mbledh) anëtarët e KMC, për praninë e kushteve potenciale të rrezikut që mund të çojnë në përfshirjen e tyre progresive.
- Aktivizon QOR për shkëmbimin e informacionit me njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Organizon monitorimin e pikave kritike të theksuara në kontekstin e skenarëve të ngjarjeve.
- Sektori i Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave është me aktivitet të plotë dhe jashtë orarit ditor.
- Informon (*aktivizon pjesërisht*) shërbimet esenciale në zonën në rrezik për statusin **para alarmit.**
- Bën rokonjicion në zonat e rrezikuar; dhe aktivizon grupe mundësinë për të siguruar mbikëqyrjen e zyrave dhe shërbimeve jetike, duke punuar jashtë orarit të punës.

- Informon zyrat kompetente për nevojën për të njoftuar, mbi ngjarjen në pritje përfshi menaxherët e aktiviteteve sportive, shfaqjeve, tregjeve, etj për ndodhjen e mundshme të situatave kritike në orët e mëposhtme.
- I raporton QKOMC dhe ZOS për situatën dhe masat e marra.

Faza ALARM

Kjo fazë përkufizohet (shoqërohet me masa) si e tillë, pasi evoluimi i situatës ka tendencë negative me dukuri të dukshme kërcënuese për njerzit, pasurinë e tyre dhe dëmtimin e mjedisit.

Në këtë fazë mund të kalohet direkt, në rastet e tërmeteve, zjarreve, shembjeve masive, avari në industri, akte terroriste. Detyrimin ligjor për këtë e ka Institucioni i Prefektit ose Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Nuk përjashtohen reagimet dhe veprimet që përfshihen në këtë fazë dhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose struktura lokale. Këto të fundit sapo bëjnë veprimet për Alarm, njoftojë institucionet qendrore.

Institucioni i Prefektit:

Nëpërmjet KMC merr vendime për situatën.

Jep detyrat specifike:

a) Strukturave monitoruese e njoftuese

- Sektorit të emergjencave civile në administratën e Prefektit.
- Sektorëve të emergjencave civile në 7 bashkitë e Qarkut Gjirokastër.
- Sektorit të Ekstensionit Bujqësor Gjirokastër.
- Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.
- Drejtorisë së Shëndetit Publik.

b) Strukturave vepruese aktive respektive

- Repartit Ushtarak DMRajonale Gjirokastër.
- Drejtorisë Vendore e Policisë së Qarkut Gjirokastër.
- Stacioneve të MZSH-ve në 7 bashkitë e Qarkut Gjirokastër.
- Shërbimeve të urgjencës mjekësore Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet.
- Drejtorisë së Shëndetit Publik Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet.
- Drejtorisë Rajonale të OSSHE-së Gjirokastër (Njësitë, Agjensitë).
- Skuadrave të likuidimit të avarive të rrjetit elektrik.

c) Strukturave vepruese mbështetëse.

- Zyrat e Arsimimit në Gjirokastër, Tepelenë e Përmet, Universiteti "E. Çabej".
- Shërbimeve Pyjore të 7 bashkive të Qarkut Gjirokastër.
- Drejtorisë së Autoritetit të Rajonit Jugor (të Rrugëve Nacionale Gjirokastër).
- Grupeve të avarive të Telekomit Gjirokastër.
- Degëve të Kryqit të Kuq Shqiptar në Gjirokastër, Tepelenë, Përmet.

Shënim: Futja në veprim mund të bëhet e kufizuar.

- përcakton kufijtë e zonave të përfshira në ngjarje, konstaton shkallën e dëmit dhe nevojat më të menjëhershme.
- aktivizon sallën e operacioneve.

• përhapja e alarmit te banorët në zonat e rrezikuara nga përmbytjet dhe informimi i tyre për sjelljen që duhet marrë, masa.
• siguron monitorim të vazhdueshëm të zonave në rrezik.
• vë në dijeni drejtuesit e strukturave në zonat në rrezik dhe anëtarët e njësisë së krizës.

5.1.2 Zonat e emergjencës

Zonat e emergjencës janë hapësira të cilat mund të përdoren ose përshtaten në rast të emergjencave civile në ndihmë të popullsisë të rrezikuar (*goditur*) deri në kalimin e situatës.
Në këtë kënd vështrim ato ndahen:

- **Zona për pritje të popullsisë**

Këto zona janë vende të sigurta për popullsinë si: sheshe, parkime, hapësira publike etj. Në këto vende njerëzit grumbullohen ose njoftohen për t'u informuar për zhvillimet e fundit dhe veprime në të ardhmen.
Këto vende administrohen nga personel i posaçëm dhe duhet të plotësojë kushtet për një jetë normale (*ujë, ajrim, hyrje – dalje etj*). Këto vende si rregull duhet të jenë të paracaktuara nga njësitë vendore dhe lokale.

- **Zona për trajtimin e popullsisë**

Janë vende ku janë të instaluara me infrastrukturat për një banim dhe marrje trajtimi shëndetësor për një kohë relativisht të gjatë.
Të tilla vende janë: konvikte, hotele, kapanone si dhe ambiente të përshtatura me infrastrukturën për banim dhe trajtim për një kohë të gjatë. Të tilla vende futen tendat dhe çadra të mirë administruara me gjithë infrastrukturën jetike. Këto vende mund të parashikohen dhe për 500 vetë dhe norma hapësire të caktuara. Ambientet e përshtatura duhet të jenë të kompletuar me shërbimet shëndetësore, përfshi, gratë shtatzënë, fëmijë dhe pleq.
Këto vende zgjidhen larg çdo rreziku.

- Zona për grumbullimin e bazës materiale, ushqimore dhe burimeve të tjera.

Këto vende janë zona për grumbullime materialesh të nevojshëm për përdorim për përballimin e situatës. Këtu mund të administrohen ndihma të kategorive të ndryshme si, kabina elektrike, tubacione, materiale spitalore, higjienike, dezinfektuese etj.
Shënim : Hartat e zonave të emergjencës sipas bashkive , shiko në **shtojcën B**

5.1.3 Mjetet e brendshme dhe të jashtme *(Burimet)*

Baza e suksesit të menaxhimit të emergjencave civile është koordinimi i strukturave që operojnë në rajon. Në mënyrë që strukturat të koordinohen në kohën e duhur kërkohet një "*inventar*", database të institucioneve, personave dhe mjeteve që mund të angazhohen për të përballuar emergjencat civile.
Kapacitetet institucionale në Qarkun Gjirokastër që menaxhojnë Emergjencat Civle në qark janë:
a) Strukturave monitoruese e njoftuese
b) Strukturave vepruese aktive respektive
c) Strukturat vepruese mbështetëse

- **Për më shumë shiko në SHTOJCËN A.**

5.1.4 Flukset e komunikimit

Komunikimi gjatë menaxhimit të një situate emergjente ka të bëj me suksesin e përballimit të emergjencës. Komunikimi midis palëve në emergjencë bëhet me mjetet e komunikim të kohës. Shërbimi celular tashmë konsiderohet si mjeti më efikas. Pavarësisht kësaj sistemi i komunikimit duhet të jetë i shumëfishtë. Sistemi me radio dhe linjë telefonike, janë sisteme alternative të nevojshme. Për komunikime në zona të vogla si për thirrje për rreziqe duhet thirrja me megafon, bilbil shoqëruar dhe me zë.
Komunikimi i strukturave bëhet sipas një grafiku të caktuar jo më pak se 2 herë në 24 orë. Në rast nevoje komunikimi bëhet në vazhdimësi.

6. FAZAT OPERACIONALE

Faza operacionale është tërësia e veprimeve dhe masave të ndjekura në kohë të ndërmarra nga Emergjencat Civile, qendrore dhe lokale para (*riskut të parashikuar*), gjatë zhvillimit të ngjarjes dhe pas saj.
Veprimet e aksionet janë të lidhura me statusin e fazës.
Fazat operacionale (*përgjigjes*) të sistemit të mbrojtjes civile, në përgjithësi ndahet: **në katër faza operacionale, të cilat nuk janë të detyrueshme,** të ndjekin njëra tjetrën.
Fazat Operacionale, janë materializim dhe vënie në jetë, të kombinimit të Kontekstit (*parashikimet Indikatori i Kontekstit*) dhe Indikatorët e Gjendjes (Indikatori i *Statusit IS*) të cilat përcaktojnë fazën operacionale të Sistemit të Mbrojtjes Civile.

Tabela 1



INDIKATORET JO SHIFROR TE SITUATES: MONITORIMI INSTUMENTAL DHE VLERESUES
Shënim 1: Indikatorët e Situatës (Statusit) (IS); IS1, IS2' IS3, janë ekujvlent me;
Etapa 1, Etapa 2, Etapa 3, Etapa 4, të përdorur më parë, përfshi faza ndërmjetëse të tyre
Shënim 2: Indikatorët e Kontekstit (IK): IKo; IK1; IK2; IK3, janë në përgjithësi, indikator (kode) që përdoren nga Shërbimi Gjelogjik në buletinin meteorologjik.

1- **S**hihet ka një listë indikatorësh jo shifror, që përcaktojnë shkallën e vlerësimit apo alarmit sipas indekseve dhe ngjyrave si më lartë.

Më poshtë jepet modeli sipas të cilit mund të gjykohet për të kaluar nga një fazë operacioneve në tjetrën.

Tabela 2

1 VERDHË	2 PORTOKALLI	3 KUQ

Indikatorët e Kontekstit (IK)		**Pikat Kritike të Parashi – kuara (K)**
IK_0	Buletin Metereologjik përmban të paktë një nga si më poshtë : • Intensiteti i Precipitimit deri në **MODERUAR;** • **Sasia e** Precipitimit deri në të D**obëta.**	**Kritikalitet zero**
IK_1	Buletin Metereologjik përmban të paktë një nga si më poshtë : • Intensiteti i Precipitimit deri në **i Fortë;** • **Sasia e** Precipitimit deri në **Mesatare.**	**Kritikalitet i ulët**
IK_2	Buletin Metereologjik përmban të paktë një nga si më poshtë : • Intensiteti i Precipitimit ndërmjet **i Fortë dhe Shumë i Fortë;** • **Sasia e** Precipitimit ndërmjet **Intesive.**	**Kritikalitet i mesëm**
IK_3	Buletin Metereologjik përmban të paktë një nga si më poshtë : • Intensiteti i Precipitimit **Shumë e Fortë;** • Sasia e Precipitimit **Shumë Intesive.**	**Kritikalitet i lartë**

Faza e Përgjigjes kalon në këto etapa:

- **VËMENDJE:** përfshin tërësinë e masave për njoftimin paraprak, pas marrjes së informacionit se **mund të lindë,** një situatë emergjence dhe shërben si sinjal për rritjen e gatishmërisë.
- **PARA ALARM:** përfshin tërësinë e masave për njoftimin paraprak, pasues, pas informacionit që një **situatë emergjence është e afërt** ose në zhvillim.
- **ALARM:** fillon kur një situatë **emergjence ndodh realisht**.
- **DALJA** *nga Situata:* është mbyllja e fazës së përgjigjes pavarësisht se sa etapa të mëparshme kanë ndodhur realisht.

Tabela 3

Indikatori i Statusit (IS)	**Informacioi nga Rrjeti i Monitorimit ose Ekipet e Vlerësimit të Shpërndara në Terren**	**Kritikalitet (K)**

IS1	**IS1₁**	Intensiteti i reshjeve të shiut deri në i moderuar, pa stuhi, jo – stacionare.	**Kritikalitet i Ulët**
	IS1₂	Në Rrugë: Pellgje të izoluara.	
		Shtretërit e lumenjve: shkarkim i ulët.	
		Në një lumë të mbuluar: 1/3 e hapjes së seksionit të mbuluar.	
		Rrëshqitjet e dherave: prezencë modeste e ujërave të larguara.	
IS2	**IS2₁**	Rreshjet me intesitet të lartë:	**Kritikalitet i Mesëm**
	IS2₂	Nivelet Hidrometrike: në ngritje, duke arritur pragun e alertit.	
	IS2₃	Në Rrugë: ujëra të larguara që arrijnë deri tek gomat, kyçet e këmbëve të kalimtarëve, uji shumë i turbullt.	
		Kanalet e Kullimit të shtrëngatave janë bllokuar.	
		Shtretërit e lumenjve: rritet niveli i shkarkimeve.	
		Lumenj të mbuluar: 1/2 e hapjes së seksionit të mbuluar me ujë.	
		Rrëshqitjet: Ujërat të rrëmbyeshme me prezencë materialesh të ngurta.	
IS3	**IS3₁**	Rreshjet me intesitet shumë të lartë, persistente dhe auto-regjeneruese .	**Kritikalitet i Lartë**
	IS3₂	Nivelet Hidrometrike: rritje e shpejtë e nivelit të ujit që arrin deri tek brigjet e lumenjve.	
	IS3₃	Në Rrugë: uji në lartësinë e shasisë, vështirësi në lëvizjen e pluskimit të materialeve të rënda.	
		Në lumenj: shkarkim deri në buzë të brigjeve.	
		Lumenjt të mbuluar: 2/3 e seksionit të hapjes e zënë me ujë.	
		Rrëshqitje e dherave: lëvizjet e tokës, rrugë të bllokuara.	

a) Ngjarjet me parashikim, janë ngjarje, me paralajmërim (*shenja*) që janë të lidhura me situatë meteorologjike (*reshje dhe përmbytje, aluvione, shembje*). Te të tilla ngjarje me parashikim (*me njoftim*), futen (*trajtohen*) dhe ngjarjet të cilat mund të parashikohen dhe për pasojë japin kohë për marrje vendimesh. Të tilla ngjarje janë dhe; zjarret në pyje: kur ata krijohen në periudhën dhjetor – prill, shembjet; kur ka pasur një indikacion sinjalizimi (*çarje, zgavër etj*). Rrallë herë mund të trajtohen me të tre fazat, ngjarjet sizmike, rreziqet industriale etj.

b) Ngjarjet pa parashikim, janë ngjarje, të cilat kanë efekt negativ, të dimensioneve të ndryshme, pa sinjale paralajmëruese *(tërmete, rrëshqitje masive)*, ku strukturat kalojnë direkt në gjendje **alarmi** dhe kërkohet ndërhyrje e shpejt operative.

Të tillë janë;

- Rrebeshe intensive (*të pa parashikuara dhe në buletine*) në zona relativisht të vogla;
- Ngjarjet sizmike;
- Shkarje (*pa sinjalizime)* masash dherash dhe materialesh të tjera;
- Emergjenca të lidhura me jetën e njerëzve;
- Aksident rrugor;
- Emergjencë sanitare;
- Zjarre në zonat urbane;

- Fenomene të ndotjes së ambientit në përgjithësi ose nga aksidente rrugore (derdhje karburantesh);
- Rrëzim objektesh;

c) Ngjarje të veçanta, janë ngjarje, për të cilat nuk ka praktika standarde (*aksidente të rënda me dëmtime me jetë njerëzish ose dëmtime mjedisore*).

Për të bërë të mundur detajimet në të gjitha fazat operacionale do të trajtojmë; **Ngjarje me parashikim**, të cilat janë ngjarje që lidhen me parashikime të më parshme (*reshje dhe përmbytje, aluvione, shembje*).

FAZA VËMENDJE

Institucioni i Prefektit

Me njohjen e situatës të dhënë direkt nga IGJEUM, QKOMC ose informacione të verifikuara nga terreni, nga ky institucion kërkohet:

• Vlerësimi i vazhdueshëm i buletineve dhe informacioneve të parashikimit.
• Verifikimin e skenarëve të rrezikut (*nisur nga eksperienca dhe raportime në terren*) në lidhje me ngjarjen e mundshme.
• Vlerësimi i informacioneve nga terreni (*zona në rrezik*).
• Aktivizimin e *pjesshëm* të Qendrës Operacionale Rajonale, për shkëmbimin e informacionit.
• Informon Komisionin e Mbrojtjes Civile (*ose një pjesë të tij*) për situatën në pritje.
• Njofton anëtarët e Shtabit të E.C. (*ose një pjesë të tij*) kushtet e rrezikut potencial që mund të çojnë në përfshirjen e tyre.

Fazat operacionale gjithmonë mbështeten mbi këto kapacitete e përgjegjëse institucionale:

a) Strukturave monitoruese e njoftuese

- Sektorit të emergjencave civile në administratën e Prefektit.
- Sektorëve të emergjencave civile në 7 bashkitë e Qarkut Gjirokastër.
- Sektorit të Ekstensionit Bujqësor Gjirokastër.
- Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.
- Drejtorisë së Shëndetit Publik.

b) Strukturave vepruese aktive respektive

- Repartit Ushtarak DMRajonale Gjirokastër.
- Drejtorisë Vendore e Policisë së Qarkut Gjirokastër.
- Stacioneve të MZSH-ve në 7 bashkitë e Qarkut Gjirokastër.
- Shërbimeve të urgjencës mjekësore Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet.
- Drejtorisë së Shëndetit Publik Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet.
- Drejtorisë Rajonale të OSSHE-së Gjirokastër (Njësitë, Agjensitë).
- Skuadrave të likuidimit të avarive të rrjetit elektrik.

c) Strukturave vepruese mbështetëse.

- Zyrat e Arsimimit në Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet, Universiteti "E. Çabej".
- Shërbimeve Pyjore të 7 bashkive të Qarkut Gjirokastër.
- Drejtorisë së Autoritetit të Rajonit Jugor (të Rrugëve Nacionale Gjirokastër).
- Grupeve të avarive të Telekomit Gjirokastër.
- Degëve të Kryqit të Kuq Shqiptar në Gjirokastër, Tepelenë, Përmet.

Në **fazën vëmendje:** Nëpërmjet, KMC dhe Shtabit të E.C. merr vendime për situatën; Jep detyrat specifike: **a) Strukturave monitoruese e njoftuese,** sipas kompetencave dhe detyrimeve.

FAZA PARA ALARM

Në këtë fazë, aktiviteti i kontrollit të zonave të territorit të konsideruar në rrezik (*aktivizimi i pikave të monitorim*it) është veçanërisht i rëndësishëm, me qëllim të marrjes së elementeve të njohurive që lejojnë një aktivizim në kohë të organizmave të mbrojtjes civile.
Kjo fazë operacionale, e referuar në veçanti për fenomenet meteorologjike, mund të iniciohet:
- Me nismën e Drejtuesit (*Drejtori*t) të Mbrojtjes Civile;
- Në nismën e Prefektit duke vlerësuar dukuritë nga informacione të verifikuar për riskun, duke njoftuar institucionet qendrore (*AKMC, ZOS*).
- Pas marrjes së buletinit që raporton një situatë: kritike të moderuara.

Si rregull Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile / këshilltari për mbrojtjen civile.
- Informon Prefektin / për situatën në zhvillim dhe mund të përdor Kodet (*Vëmendje, Para alarm, Alarm*);

Institucioni i Prefektit:
• Njofton Kryetarin / kryetarët e njësive administrative, për statusin **Para alarm**, për zhvillimet në pritje.
• Informon (*ose mbledh*) Komisionin i Mbrojtjes Civile ose një pjesë të tij për situatën në pritje (*merr/propozon vendime*).
• Mbledh anëtarët e Komisinit të M.C ose një pjesë për vendime në kushtet e rrezikut potencial që mund të çojnë në përfshirjen e tyre.
• Inicion (*zbaton*) masat e mbikëqyrjes dhe monitorimit në zonat e ekspozuara ndaj rrezikut që konsiderohen të nevojshme.
• Informon *(mbledh*) anëtarët e KMC, për praninë e kushteve potenciale të rrezikut që mund të çojnë në përfshirjen e tyre progresive.
• Aktivizon QOR për shkëmbimin e informacionit me njësitë e vetqeverisjes vendore dhe ato në rajon.
• Organizon monitorimin për pikat kritike të theksuara në kontekstin e skenarëve të ngjarjeve.
• Sektori i Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave është me aktivitet të plotë dhe jashtë orarit ditor.
• Informon (*aktivizon pjesërisht*) shërbimet esenciale në zonën në rrezik, për statusit, **para alarmit.**
• Bën rikonjicion në zonat e rrezikuara dhe aktivizon grupe për të siguruar mbikëqyrjen e zyrave dhe shërbimeve jetike, duke punuar jashtë orarit të punës.
• Informon zyrat kompetente për nevojën për të njoftuar, mbi ngjarjen në pritje përfshi menaxherët e aktiviteteve sportive, shfaqjeve, tregjeve, etj për ndodhjen e mundshme të situatave kritike në orët e mëposhtme.
• I raporton QKOMC dhe ZOS për situatën dhe masat e marra.
Në **fazan PARA ALARM:** Nëpërmjet, KMC dhe Shtabit të E.C merr vendime për situatën. Jep detyrat specifike:

a) Strukturave monitoruese e njoftuese,
b) Strukturave vepruese aktive respektive.

FAZA ALARM

Kjo fazë përkufizohet *(shoqërohet me masa*) si e tillë, pasi evoluimi i situatës ka tendencë negative me dukuri të dukshme kërcënuese për njerëzve, pasurinë e tyre dhe dëmtimin e mjedisit. **Në këtë fazë mund të kalohet direkt, në rastet e tërmeteve, zjarreve, shembjeve masive, avari në industri, akte terroriste.** Detyrimin ligjorë për këtë e ka Institucioni i Prefektit ose Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Nuk përjashtohen reagimet dhe veprimet që përfshihen në këtë fazë dhe nga njësitë vendore ose struktura lokale. Këto të fundit sapo bëjnë veprimet për Alarm, njoftojë institucionet qendrore.

Jep detyrat konkrete dhe ndjek zbatimin e:
a) Strukturave monitoruese e njoftuese,
b) Strukturave vepruese aktive respektive,
c) Strukturave vepruese mbështetëse.

Futja në veprim mund të bëhet e kufizuar.
- Përcakton kufijtë e zonave të përfshira në ngjarje, konstaton shkallën e dëmit dhe nevojat më të menjëhershme.
- Aktivizon sallën e operacioneve.
- Përhapja e alarmit te banorët në zonat e rrezikuara nga përmbytjet dhe ndërprerjet dhe informimi i tyre për sjelljen që duhet marrë masa.
- Siguron monitorim të vazhdueshëm të zonave në rrezik.
- Vë në dijeni drejtuesit e strukturave strategjike, sociale dhe produktive të pranishme në zonat në rrezik dhe anëtarët e njësisë së krizës.

Fazat operacionale për trajtimin:
Faza 1- Alarm për rritjen e Gatishmërisë.
Faza 2 -Vendosja e Gjendjes së Gatishmërisë.
Etapa 3 - Aktivizimi.
Etapa 4 - Dalja nga situata.
Trajtimet sipas Planit Kombëtar për Emergjencave Civile (viti 2004).

Etapa 1. VËMENDJE

1. Informon strukturat lokale për kalimin në gjendjen: "**Vëmendje**".
2. Komunikon me drejtuesin (*drejtuesit*) e qeverisjes vendore për situatën e krijuar.
3. Informon të gjitha institucionet dhe strukturat e duhura.
4. Informon Komisionin e Mbrojtjes Civile.
5. Raporton QKOMC nëse ka staf të mjaftueshëm dhe të pajisur për punë 24 orë, gjatë etapës së "***vëmendje*** ".
6. Nëpërmjet sektorit të emergjencave civile të institucionit bënë azhurnimin e kontakteve, kërkohen telefona shtesë dhe plotësohen e formularët e nevojshëm.
7. Kontakton nëse mjetet janë në gatishmëri (*karburanti, etj.).*

Etapa 2. PARA ALARM

1. Mbledh Komisionin e Mbrojtjes Civile.
2. Komunikon me drejtuesit vendor për situatën dhe koordinime të më tejshme.

3. Informon të gjithë institucionet dhe strukturat e duhura, veçanërisht ato që përfshihen në përgjigjen e parë (*njoftimi paraprak, informimi i publikut, evakuimi, kërkim shpëtimi, shërbimi zjarrfikës, strehimin e përkohshëm*).
4. Kërkon informacion nga njësitë vendore.
5. Cakton: Drejtuesin e Operacionit (DOQ).
6. Komunikon me strukturat monitoruese dhe kërkon informacion për situatën.
7. Raporton QKOMC dhe ZOS, për situatën dhe masat e marra.
8. Harton raportin (*komunikatën*) e parë për situatën.
9. Kontrollon nëse janë marrë dhe plotësuar gjitha masat dhe urdhrat e dhënë.
10. Krijon grupe të përbashkëta verifikimi për masat e marra, veçanërisht për zonat më të rrezikuara.
11. Përgatit raportin paraprak mbi pritshmërinë e dëmeve dhe kërkon masa shtesë nëse është e nevojshme.
12. Përgatit informacione për publikun.

Etapa e 3: ALARM

1.Fillon në rastet kur një ngjarje e papritur, ka shkaktuar dëmtime në njerëz dhe materiale, ose kur një ngjarje e ngadaltë është në zhvillim e sipër dhe mund të sjellë të njëjtat pasoja të cilat tejkalojnë mundësitë për t'u përballuar nga strukturat e Sh.E.C. në nivel lokal.
Në rast se emergjenca është e përmasave të mëdha kërkohet të shpallet gjendja e emergjencave civile. Gjendja e Emergjencës, aprovohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Etapa e 4: DALJA NGA SITUATA - është mbyllja e fazës së përgjigjes pavarësisht se sa etapa të mëparshme kanë ndodhur realisht.

KONSIDERATA PËR TË TRE FAZAT (PËRGJIGJA).

Raportimi i situatave të emergjencës civile

Është detyrë e çdo strukture shtetërore, jo shtetërore dhe qytetari në qark dhe më gjerë, që në mënyre të menjëhershme, të informojë tek njësite vendore: bashki dhe qark, në administratën e prefektit në lidhje me situata reale apo të mundshme për emergjenca civile. Pas marrjes së njoftimit, autoritetet zyrtare duhet të kenë si përparësi përcjelljen e informacionit në QKOMC.

Rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazës së Përgjigjes.

Menjëherë pas informimit rreth ndonjë situate emergjente ose ngjarje të mundshme të cilat munde të shkaktojnë një emergjence në nivel qarku, bashkie ose Prefekti, punonjësit e emergjencave civile dhe kryetari i bashkisë përkatëse, ndjekin këtë radhe pune:

Organet e Qeverisjes Vendore.
Gjatë fazës së përgjigjes, rolet dhe përgjegjësitë për çdo aktivitet janë si me poshtë:

Aktivizimi dhe bashkërendimi i forcave operacionale të nivelit vendor:
Aktivizimi i FO në nivelin vendor, bëhet nga drejtuesit **e** organeve të pushtetit vendor, ndërsa bashkërendimi i strukturave të Shërbimit të Emergjencës civile si: MZSH, FA dhe DVPQ, në nivel qarku është nën përgjegjësinë e Prefektit të Qarkut i cili këshillohet nga KQMC-së.

Aktivizimi dhe bashkërendimi i strukturave aktive vepruese dhe mbështetëse në qark:

Në raste se nuk janë mobilizuar ende, Drejtuesi i Operacionit u kërkon institucioneve përkatëse aktivizimin e strukturave vepruese aktive dhe menaxhon situatën nëpërmjet drejtimit të strukturave operacionale të shërbimit të emergjencave civile të aktivizuara. Drejtuesi i operacionit mbështetet dhe vepron sipas udhëzimeve të KQMC-së.

Operacionet e kërkim- shpëtimit (SAR).
Grupet e qarkut të kërkim shpëtimit sigurohen nga DMRajonale (ushtria), nga Drejtoria e Policisë, MZSH, Grupe vullnetare etj. Operacionet e kërkim shpëtimit mbështeten nga grupet kombëtare të kërkim- shpëtimit.

Vlerësimi i nevojave:
Bashkërendimi për Vlerësimin e nevojave për ngjarje apo emergjenca të shkallës se ulët, është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut si dhe e kryetarit të bashkisë të prekur nga fatkeqësia.
Për emergjenca të shkallës se lartë, bashkërendimi është përgjegjësi e KNEC nëpërmjet grupeve të përbashkëta të Vlerësimit. Prefekti angazhon specialistet në qark për bashkëpunim me këto grupe si: punonjësit e emergjencave civile, punonjësit e bashkive dhe personelin e degës të KLKSH.

Vlerësimi i dëmeve (n*ë aspektin e dëmtimeve të infrastrukturës dhe objekteve të ndërtimit).*
Vlerësimi i dëmeve në infrastrukturë dhe objektet e banimit për emergjenca të shkallës së ulët bëhet nga administrata e Prefektit e mbështetur nga AKMC dhe për emergjencat e shkallës së lartë nga grupet e përbashkëta të vlerësimit.

Qendra rajonale operacionale e emergjencave civile (QROEC).
QROEC është qendra kryesore për menaxhimin e informacionit. Ajo mbledh, përpunon, analizon dhe shpërndan informacion për përballimin e emergjencës. Mbështetje dhe informacion për QROEC-në, sigurohet nga të gjitha institucionet e qarkut dhe publiku i gjerë.

Sigurimi i informacionit për qendrën rajonale operacionale të emergjencave civile dhe për QKOEC- në.
Është përgjegjësi e të gjitha ìnstitucioneve, strukturave, autoriteteve lokale përkatëse dhe subjekteve të sektorit private dhe kur është e nevojshme edhe e publikut të gjerë të siguroj informacion të vazhdueshëm nga terreni për QROEC. Kjo i mundëson sektorit të emergjencave dhe AKMC për të bërë propozime të drejta sipas përkatësisë Prefektit të Qarkut dhe MM.

Ekipi i menaxhimit të emergjencës.
Me shpalljen e gjendjes së emergjencës civile, pranë QROEC, mblidhet Ekipi i Menaxhimit të Emergjencave civile (EMEC) i cili sipas situatës dhe llojit të emergjencave, përket nga përfaqësues të institucioneve në qark. Pranë këtij ekipi mund të punojnë, ndihmojnë dhe përfaqësues të degës së KKSH, të QJF- ve etj. Ky ekip përgatit tërë procesin e marrjes se vendimeve nga DOQ dhe KQEC.

Njoftimi i hershëm (i pari) informimi dhe këshillimi i publikut.
Përgjegjësia kryesore për informimin e popullsisë, në vartësi të shpejtësisë dhe shkallës se emergjencës, është e drejtuesve të organeve të pushtetit vendor të bashkive, Prefektit, SEC, si dhe të FO në terren. Njoftimi, informimi dhe këshillimi i publikut në qark bëhet kryesisht nga media private në të gjitha nivelet (elektronike dhe e shkruar), sistemi shkollor, vullnetarët e KKSH, organizatat e Shoqërisë Civile si dhe mjete e burime të tjera.

Lehtësirat/pajisjet e transportit të emergjencës duke përfshire transportin gjatë

emergjencës së njerëzve, evakuimit, grupeve të Kërkim-Shpëtimit, artikujve të ndihmës, depozitave të ujit,naftës etj.
Në nivel qarku e bashkie, zyrat e emergjencave civile mbajnë inventarin e kapaciteteve të disponuar nga subjektet shtetërore dhe ato private. Kërkesat për transport në situata të emergjencave civile i drejtohen DQO. Një përmbledhje e kapaciteteve të qarkut është bashkangjitur këtij Plani.

Hyrja për në zonat e prekura nga emergjenca.
Bashkërendimi i aktiviteteve për hyrjen në zonat e prekura në qark nga emergjenca, sigurohet nga DOQ, DOB/DOK, të mbështetura dhe në bashkëpunim me AKMC, DQO. Hapja dhe pastrimi i rrugëve nacionale është përgjegjësi e Autoritetit të Rajonit Jugor (Rrugëvë Nacionale) Gjirokastër, Tepelenë, Përmet si dhe Sarandë. Pastrimin e rrugëve rurale bëhet nga Drejtoritë e Rrugëve Rurale ndërsa bashkitë, përgjigjen për rrugët që kanë në inventarin e tyre. Për pastrimin e rrugëve rurale dhe të rrugëve që janë në inventar të OQV sipas nevojës mund të kërkohet dhe mbështetja e Autoritetit të Rajonit Jugor të rrugëve.

Kontrolli i kufijve në kohë emergjence.
Përgjegjësit për kontrollin, zbatimin e rregullave doganore, për kalime të paligjshme,
për emigracionin dhe kontrollin e kufijve, janë të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin të Qarkut (*Policisë Kufitare*), të Doganave, të cilat veprojnë sipas udhëzimeve të organeve qendrore të vartësisë, bazuar në konventat ose marrëveshjet ndërkombëtare.

Shërbimi shëndetësor parësor.
Drejtoritë e Shëndetit publik në qark përkatësisht në rrethet Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet, janë përgjegjëse për sigurimin e shërbimit të urgjencës dhe Shërbimit Shëndetësor Parësor nëpërmjet qendrave shëndetësore, të cilat janë funksionale. Kërkesat dhe nevojat koordinohen nga DOQ.

Shërbimi shëndetësor dytësor dhe tretësor.
Shërbimi Shëndetësor dytësor dhe tretësor në qark është në përgjegjësi të Drejtorive të Shëndetit Publik dhe të Drejtorive të Spitaleve. Ky shërbim në Qarkun Gjirokastër realizohet me 3 spitale, Spitali Rajonal Gjirokastër, 2 Spitale përkatësisht në rrethet Tepelenë e Përmet.
Një listë me kapacitetet e mundshme është në seksionin **Shëndetësia.**

Menaxhimi i të dëmtuarve/viktimave në masë.
Menaxhimi i viktimave dhe të dëmtuarve në masë në momentet e para drejtohet nga strukturat e para reaguese që janë forcat operacionale të shërbimit të emergjencave civile që janë me të afërta me vendin e ngjarjes. Ndihma e pare bëhet nga strukturat e shërbimit shëndetësor që ndodhën më afër zonës të prekur nga emergjencat, të mbështetura nga Reparti ushtarak, Drejtoria Vendore e Policisë, MZSh, Dega e KESH dhe vullnetar të kualifikuar nga sektori private. Evakuimi i të dëmtuarve për në shërbimin dytësor dhe tretësor është përgjegjësi e Drejtorive të Shëndetit Publik të rretheve dhe bashkive të prekura nga emergjenca. Kapacitetet përforcohen nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut, evakuimit, urgjencës dhe KKSH. Për identifikimin dhe menaxhimin e viktimave në masë, përgjigjet Këshilli i Qarkut Gjirokastër, bashkitë e prekura nga emergjenca, Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Gjirokastër dhe Drejtoria Rajonale e shfrytëzimit të automjeteve.

Sigurimi i shërbimit të shëndetit publik:
Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe Drejtoritë e Shërbimit Parësor, kanë përgjegjësinë për monitorimin e cilësisë të ujit të pijshëm dhe higjienës si dhe për zbatimin e programit të MSH

për vaksinimin e popullatës. Këto institucione mbështeten dhe bashkëpunojnë dhe me struktura të tjera shtetërore që veprojnë në qark.

Sigurimi dhe rivendosja në funksionim e shërbimeve jetike komunale:
Sigurimi i burimeve alternative me ujë duke përfshirë fuqizimin me autobote, ambalazhimin dhe riparimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm është përgjegjësi e Drejtorive të ujësjellësve në rrethe. Këto institucione mbështeten nga organet e qeverisjes vendore dhe reparti ushtarak të dislokuar në qark.
Sigurimi i burimeve alternative të energjisë dhe riparimet e sistemit të furnizimit me energji elektrike janë përgjegjësi e ndërmarrjeve elektrike (OSHEE-ja Gjirokastër) e cila realizohet nëpërmjet aktivizimit të grupeve të përgjigjes se menjëhershme (*Grupi i eliminimit të avarìve*), bashkëpunimit me bashkitë dhe të kontraktuarit që kryejnë këto shërbime.

Sektori privat: Shoqëritë e Tregtimit të Karburanteve dhe Gazit, kanë përgjegjësi të ngjashme për stacionet në pronësi të tyre, për masat e sigurisë dhe të furnizimit me gaz.
Sektori i Ekstensionit Bujqësor Gjirokastër dhe AKUshqimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër, ka përgjegjësi për sigurimin dhe shpërndarjen e lëndës drusore për ngrohje, mbështetur për transport nga Drejtoria Rajonale e Shfrytëzimit të Automjeteve.

Evakuimi i popullsisë civile:
Në nivel qarku, përgjegjësia për evakuimin është e Prefektit, në nivelin vendor e kryetarit të Bashkisë. Gjatë situatave të emergjencës, forcat operacionale në terren (Rep. Usht. Drejtoria Vendore e Policisë, Stacionet e MZSH- ve etj.) mund të vendosin evakuimin e menjëhershëm për territore të kufizuara, në vartësi të situatës, rol të rëndësishëm luajnë forcat operacionale, strukturat vepruese aktive të rep. usht.(DMR Gjirokastër) të Drejtorisë Vendore të Policisë, kontaktet me sektorin privat dhe Degët e Kryqit të Kuq Shqiptar.
Në fazën e evakuimit një rëndësi të veçante merr informimi publik për rrezikun dhe masat që duhen marrë për të lëvizur në zona të sigurta.

Sigurimi i digave, pritave, kanaleve, lumenjve, liqeneve etj:
Përgjegjësia për kontrollin, mirëmbajtjen, sigurinë dhe riparimin e digave e dambave, pritave, kanaleve, lumenjve dhe liqeneve është si më poshtë:
Drejtorisë së Ujërave dhe Kullimit Fier - Sektori Gjirokastër pritat bujqësore, stacionet e pompimit, sistemet e kanalizimeve primare dhe rezervuarët.

Mbështetja sigurohet nga:

- Agjencia Rajonale e Mjedisit, Sistemi i lajmërimit dhe nga bashkitë për sistemet e kanalizimeve dytësore dhe tretësor.
- Mbështetje me mjete dhe pajisje të rënda, në se është e nevojshme, sigurohet nga Reparti ushtarak, Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut, sektori privat.
- Shoqata e fermerëve, Përdorues të Ujit.
- Kontraktorët shfrytëzues të burimeve ujore dhe rezervuarëve.

Identifikimi dhe sigurimi i strehimeve të përkohshme.
Caktimi i objekteve dhe rajoneve për sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta, drejtohet nga autoritetet e bashkive, Këshilli i Qarkut dhe Prefekti, të mbështetur nga AKMC/DQO. Ndihmë jepet nga strukturat që kanë kapacitete në ndërtesa apo terrene për vendstrehime të përkohshme ku përfshihen, shkollat, rezervat e shtetit, Institucionet Sportive, Sektori i Policisë se Burgjeve (*evakuimi dhe strehimi i personave të paraburgosur dhe të*

burgosur) dhe Dega e KKSH.

Menaxhimi i artikujve të ndihmës emergjente nga burime të brendshme
Bashkërendimi për sigurimin, furnizimin, magazinimin dhe shpërndarjen e artikujve të ndihmës në qark bëhet nga DOQ/KQEC.

- Sigurimi dhe furnizimi me artikuj të ndihmës bëhet nga: Rep. Ushtarake, Rezervat e Shtetit, KQSH nëpërmjet organeve qendrore.
- Shpërndarja e ndihmës në qark bashkërendohet nga Prefekti (DOQ), dhe në nivel bashkie, nga Autoritetet lokale/DQB, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e DSHP (për ndihmën me ilaçe), strukturat e Drejtorisë Rajonale të Punësimit, të Përkrahjes Sociale, vullnetarët e Degës së KKSH dhe kontraktor.
-

Menaxhimi i artikujve të ndihmës emergjente nga burime ndërkombëtare
Kërkesa për ndihmë MM dhe KNEC, bëhet nga KQEC/DOQ.
Transportimi dhe shpërndarja e artikujve të ndihmës në nivel qarku bashkie dhe bashkërendohet nga Prefekti i qarkut dhe organet e pushtetit vendor, në bashkëpunim të ngushtë me Strukturat e Shëndetësisë (për ndihmë në ilaçe), të punësimit dhe çështjeve sociale, vullnetarët e Kryqit të Kuq SHqiptar Dega Gjirokastër në nivel qarku dhe kontraktohet.

Shërbimet e ndihmës sociale
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror merr rolin bashkërendues në lidhje me çështjet e ndihmës sociale. Për Vlerësimin e nevojave, identifikimin e të prekurve dhe hartimin e asistentes sociale të nevojshme, ajo punon ngushtë me Prefektin dhe organet e pushtetit vendor në punën e saj ajo asistohet nga Sektori i Emergjencave Civile, Dega e KKSH dhe OJF.

Ruajtja e sigurisë dhe rendit publik.
Për situata të jashtëzakonshme problemet e sigurisë në Qark bashkërendohen nga Prefekti i Qarkut i mbështetur nga autoritet e pushtetit lokal.
Në fatkeqësi të mëdha: Prefekti përgjigjet për organizimin e mbrojtjes së popullsisë dhe të pronës nga fatkeqësitë natyrore, ekologjike dhe nga dëmtimet e luftës.

Kërkesa për ndihmë kombëtare
Kërkesa për aktivizimin e kapaciteteve kombëtare, drejtohen nga Prefekti i Qarkut.
Për ndihmën Kombëtare dhe të qarqeve fqinjë, rolin koordinuesit e ka Prefekti i Qarkut/Drejtuesi i Operacionit të Qarkut.

Mbështetja financiare e emergjencës
Fonde Rezervë për Emergjencë munde të aktivizohen duke përdorur këto burime:

- Fondin e emergjencave civile në buxhetin e 7 bashkive dhe të Këshillit të Qarkut.
- Fonde të Emergjencave të akorduara institucioneve shtetërore në qark për emergjencat nga Ministritë përkatëse.
- Fonde rezervë të Këshillit të Ministrave.

Rolin drejtues për mbështetjen financiare në qark për emergjencat merret nga Prefekti Qarkut, në mbështetje dhe në bashkëpunim me autoritetet e pushtetit vendore dhe të institucioneve shtetërore përkatëse, në vartësi të natyrës së emergjencës civile.

6.4 .3 Shpërndarja transmetimi i informacionit publik
Informimi i publikut është element thelbësor i njoftimit të hershëm, parapërgatitjes dhe

këshillimit të komunitetit. Informimi i publikut mund të luaj një rol të rëndësishëm në shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pasurisë se tyre në raste emergjencash civile. Qetësia, korrektesa dhe shpejtësia e dhënies së informacionit është mjaftë e rëndësishme në raste të emergjencave civile, e cila sigurohet në nivel vendor nëpërmjet njoftimeve periodike të QREC (Sektorit të informacìonit) dhe nga drejtuesit e operacioneve në nivel qarku, bashkie.

Doganat, emigracioni dhe karantina

Në rast të pritjes se ndihmave ndërkombëtare institucionet shtetërore që veprojnë në pikat kufitare (Pika Kufitare Kakavije Gjirokastër dhe Pika Kufitare Tre Urat në Përmet, marrin detyra nga Prefekti / DOQ për zbatimin, lehtësimin e procedurave të hyrjes se personelit të ndihmës sipas dispozitave ligjore për ndihmat humanitare. Përparësi duhet të kenë grupet e kërkim-shpëtimit, dhe për qentë e kërkimit.

DOQ/ekipi i menaxhimi të emergjencave është përgjegjës për pritjen dhe trajnimin në dogana dhe kalimin kufitar ndihmës ndërkombëtare që futet në pikat kufitare të qarkut.

Në rast emergjence në vendet fqinje autoritetet në qark duhet të jenë të përgatitura për të pritur/përcjellë njerëzit dhe gjënë e gjallë të tyre sipas planifikimit të KNE13.

Çështjet financiare

Situatat e emergjencave civile kërkojnë planifikim paraprak për kostot e mundshme edhe në nivel qarku, bashkie.

Sipas nenit 41 të ligjit 45/2019 ‘’ Për Mbrojtjen Civile ‘’ E drejta e kompensimit.

Shteti shqiptar përgjigjet për dëmet që shkaktohen nga pasojat e një fatkeqësie.

2. Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile. (4% të buxhetit)

3. Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitin pasardhës, deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara.

4. Në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendosqë kompensimi të kryhet nga AKMC-ja.

5. Në çdo rast, kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore, kompensimi mund të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

6. Masa e kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen miratohenme vendim të Këshillit të Ministrave.

Problemet financiare në fazën e përgjigjes janë:

Problemet e menjëhershme financiare:

- Për veprime të menjëhershme të strukturave që kanë përgjegjësi për emergjencat civile është e nevojshme të kenë monedha kesh, për përgjigjen e parë. Duhet të merren të gjitha masat që pajisjet, mjetet e transportit, nafta dhe kostot e **komunikimit që** parashikohen të nevojshme, të jenë të disponueshme në çdo kohë për të siguruar ndërhyrje sa më të shpejtë në rajonin e prekur.

Probleme financiare dytësore:

- Zgjatja e situatës se emergjencës civile në qark, kërkon planifikimin afatgjatë të shpenzimeve buxhetore të konsiderueshme të cilat duhet të planifikohen nëpërmjet projekteve, preventivave, planeve dhe për vlerësimin e tyre duhet bashkëpunimi me organet qendrore.

Probleme financiare tretësor:

- Në fazën e përgjigjes, gjatë përpjekjeve për stabilizimin e situatës do të dalin kërkesa për

shtesë të kostove, për riparimin e ndërtesave dhe infrastrukturës se dëmtuar, rikonstruksionin e shërbimeve bazë, si: të ujit të pijshëm, të energjisë elektrike dhe sigurimin e strehimeve të sigurta për një periudhe afatgjatë, për ata të cilët nuk janë në gjendje të kthehen në shtëpitë e tyre. Gjatë kësaj faze, masat në vijim duhet të jenë të planifikuara nga të gjitha strukturat përkatëse të përfshira në zgjidhjen e heshtjeve të emergjencave civile:

- Mbajtja e një rezervë të mjaftueshme në kesh nga organet e Qeverisjes vendore për t'u përdorur në përgjigje të menjëhershme ndaj situatës emergjente.
- Për të gjitha strukturat në nivel vendor, përgjegjëse për emergjencat civile duhet të ekzistojnë plane dhe marrëveshje në mënyrë që të mbulojnë menjëherë kostot për matjen e mjeteve të transportit, të shofereve dhe karburantit, për vlerësimin e përgjigjes të menjëhershme ndaj situatës emergjente.
- Duhet të ekzistojnë lehtësira, në mënyrë që personeli i emergjencave civile të jetë në gjendje të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve për të mbuluar shpenzimet e bëra në fazën e parë të përgjigjes së menjëhershme.
- Kontratat e lidhura paraprakisht ose marrëveshje duhet të jenë bërë paraprakisht dhe të vihej në veprim në kohën e emergjencave civile.
- Është e nevojshme parashikimi i kostove të mundshme për përgjigje ndaj emergjencave civile duke u bazuar në përvojën e kaluar, në stërvitjet stimuluese dhe të përfshihen në planifikimet e buxhetit të strukturave vendore të interesuara.

Duke u mbështetur në këto vlerësime, organet e vetqeverisjes vendore dhe institucionet përkatëse duhet të përcaktojnë një përqindje e buxhetit vjetor për përgjigje ndaj emergjencave civile.

Raportimet dhe vlerësimet

Raportimet për situatën merren nga institucionet dhe strukturat e ndryshme në qark sipas formularëve standarde:

- Formulari i njoftimit të parë.
- Raportimi i të dhënave të para për fatkeqësinë.
- Kërkesë për organet qendrore në raste emergjence.

Formulari i raportit të të dhënave të para për fatkeqësinë duhet të përgatiten nga grupet e përbashkëta të vlerësimit të ngritura në nivel qarku bashkie.

Në situata të tejskajshme, mund të bëhen ndërhyrje të menjëhershme paraprake (si evakuim në masë i popullsisë, operacione kërkim- shpëtimi, dhënie e ndihmës mjekësore dhe aktivitete të tjera parësore, përpara ose gjatë bërjes së vlerësimit

7. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI

Për përballimin e një situate emergjente është e domosdoshme komunikimi me publikun për fatkeqësinë në pritje ose në zhvillim.

Për një komunikim efikas me publikun në radhë të parë duhet të dimë se kush është publiku i interesuar, për bashkëpunimin në fjalë.

Mesazhi i përcjellë publikut duhet ta bëjë atë bashkëpunues në përballimin e situatës si dhe të lehtësojë barrën psikologjike të grupeve në nevojë dhe fatkeqësi.

Mesazhi të përcaktojë saktë se kujt i drejtohet (prindërve, fëmijëve, adoleshentëve, mësuesve etj.).

Mesazhet duhet të jenë të destinuar se kujt u drejtohen: familjeve në zonë rurale, urbane, biznesit, drejtuesve të njësive, strukturave fetare etj.

Mesazhi (komunikimi) ka elementët kyç, që përveç të informuarit për rrezikun, të bëjë që publiku të bëjë veprime konkrete dhe inteligjente për të ulur pasojat e rrezikut.

Informacioni për ndërgjegjësim duhet të jetë i thjesht pa shumë terma teknik pa termologji shkencore. Komunikimi të jetë i thjesht dhe i shkurtër.
Informacioni duhet të përfshijë:

- Rrezikun kërcënues.

Cila është mundësia (probabiliteti). Mundësia e ndikimit. Kush do të jetë më i cënueshëm.
Udhëzime për të ulur rrezikun. Veprime për të rritur sigurinë. Operacione e veprime për mbijetesën në rast se je në fatkeqësi.

7.1 Parimet e komunikimit

Komunikimi nëse arrihet me mjete të shkruara, duhet të kihet parasysh grupi (audienca) që do ta përdorë. Duhet të jemi të qartë se çfarë duhet të dijen për fazat dhe pasojat etj. Duhet marrë në konsideratë moshën, arsimin, gjininë, punën, motivimet, interesat në lidhje me ngjarjen).
Në komunikimin, duhet:
Çfarë grupi paraprakisht për fatkeqësinë.
Burimet e informacionit, gazeta, televizioni, takimet që janë bërë etj.
Aktivitete për menaxhimin e fatkeqësisë etj.
Shënim : Listat me pikat e kontaktit , skemat e organizimit të lajmërimit dhe modelet për komunikim , shiko në **shtojcën A**

7.2 USHTRIME

Për të bërë të mundur kompaktësimin e strukturave me menaxhimin e emergjencave civile, është i domosdoshëm trajnimi i strukturave, në forma të ndryshme nëpërmjet:

- seancave teorike,
- punës me grupe,
- stërvitjeve në tryezë,
- stërvitjeve simuluese,
- stërvitjeve në terren me pjesëmarrjen e forcave operacionale dhe të komunitetit.

Grupet përfituese të këtyre aktiviteteve përfshijnë: forcat operacionale dhe personelin e planifikimit dhe të menaxhimit të emergjencave civile, si dhe të gjithë personelin e institucioneve shtetërore dhe të organizatave të shoqërisë civile të lidhur me çështjet e emergjencave civile.
Stërvitja në tryezë është një ushtrim i thjeshtë, i cili kërkon përgatitje dhe shpenzime minimale. Është aktivitet i mirë për trajnimin e stafeve të të gjitha niveleve, si operacionale, ashtu edhe vendimmarrës, në fusha të caktuara, si për shembull, në bashkërendim, ndarjen e përgjegjësive, përparësitë e lehtësimit pas situatës së emergjencës dhe çështje të tjera të ngjashme. Stërvitja në tryezë zbatohet në një mjedis ku lejohen gabimet, pra jo në terren dhe vërejtjet dhe korrigjimet bëhen më lehtë. Qëllimi i saj është të nxjerrë në pah problemet ekzistuese në bashkërendim, të zhvillojë fantazinë për zgjidhjen e skenarëve të ndryshëm, shpërndarjen e detyrave dhe të përgjegjësive specifike, identifikimin e problemeve në zbatimin e procedurave të cilat paraqiten më pas si nevojë për trajnime për rishikimin e planeve konkrete dhe përgatitjen e stërvitjeve të tjera në tryezë ose në terren.
Stërvitje në terren me pjesëmarrjen e forcave operacionale dhe të komunitetit. Stërvitjet në terren duke u bërë në formën e lojës (imitimit) bën të mundur aktivizimin në nivel të ulët ashtu dhe në nivel **komandues.**
Stërvitjet në shkallë të gjerë janë niveli më i lartë i stërvitjeve dhe shkalla më e lartë e një programi të përgjithshëm trajnimi. Kjo kërkon planifikimin më të mirë, burime dhe kapacitete më të shumta si dhe kohë e vullnet për t'a përgatitur dhe për t'a zhvilluar. Në këto stërvitje bëhet testimi i planeve të miratuara si dhe i elementeve bazë organizative në një situatë pothuajse pranë asaj reale dhe në një mjedis tejet të rënduar. Mobilizimi fizik dhe lëvizja e personelit dhe e

kapaciteteve janë të nevojshme për të demonstruar aftësitë e bashkërendimit, të përgjigjes dhe të rikthimit në normalitet pas situatës së emergjencës.

8. RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT

Organizatat dhe komuniteti mund të jenë partnerë të vyer në nisjativat që kanë të bëjnë me mbrojtjen civile. Kryqi i Kuq, OJQ-të, grupime të të rinjve, veteranëve etj. Janë një bazë e mirë për t'u aktivizuar në veprimtari për mbrojtjen civile si në kontributin direk qoftë në ndërgjegjësimin e komunitetit.
Organizatat dhe komuniteti jo gjithmonë mund të ofrojnë burime financiare, por ato mund të ofrojnë ndihma dhe kontribut në njerëz si dhe ndihma në forma të ndryshme.

Mundësit e ndërgjegjësimit mund të bazohen në disa baza si më poshtë:

- Puna me prindërit e shkollave lokale për përgatitjen në rast fatkeqësish.
- Puna me mësuesit shkollave në zonën e fatkeqësisë për të bërë të mundur futjen e mesazheve dhe pasurimin e kurrikulave me element ndërgjegjësimi.
- Puna me organizatë lokale në kontribute direkt në zonë në nevojë.
- Angazhimi i nxënësve, studentëve në kompozimin e posterave dhe fletë palosjeve me sens ndërgjegjësimin e komunitetit.
- Shfrytëzimi i festivaleve dhe koncerteve në përkujtim të ngjarjeve të cilat mund të përsëriten.
- Pyesni grupet e veteranëve ose klubeve të japin ndihmesën e tyre në hapjen e pavioneve për ndërgjegjësimin e publikut. Pavionet mund të hapen në panaire, festivale etj edhe pse destinacioni i tyre mund të jetë me temë tjetër.

Mënyra më e mirë për të ndërgjegjësuar dhe ulur rrezikun, është nëpërmjet shembujve dhe praktikave vendore dhe botërore. Solidariteti dhe fryma që janë ndeshur vendet kur janë ndodhur në nevojë, si ngjarja e 11 Shtatorit, cunami në Filipine, tërmeti në Itali, Tërmeti në Turqi etj.

9. PËRKUFIZIME (FJALORI I TERMAVE TË PËRDORURA (A-Z)

Përkufizime : Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: **(Sipas ligjit 45 / 2019)**

1. "Aftësi ripërtëritëse" është aftësia e sistemit, komunitetit apo shoqërisë së ekspozuar ndaj rreziqeve për të rezistuar, thithur, akomoduar, për t'u përshtatur, transformuar dhe për t'u rimëkëmbur nga efektet e një rreziku në kohën e duhur dhe në mënyrë efikase, mes të tjerash,nëpërmjet ruajtjes dhe restaurimit të strukturave e funksioneve të tij thelbësore themelore.

2. "Baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë" është grumbullimi i organizuar i informacionit në mënyrë sistematike, në lidhje me fatkeqësitë, dëmet, humbjet dhe impaktet e tyre.

3. "Cenueshmëri" janë kushtet e përcaktuara nga faktorë apo procese fizike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, të cilat rrisin ndjeshmërinë e një individi, komuniteti, pasurie apo rrjeti shërbimesh ndaj impakteve të rreziqeve.

4. "Degradimi mjedisor" është tëzvogëlimi i kapacitetit të mjedisit për të përmbushur objektivat dhe nevojat sociale e ekologjike.

5. "Ekspozim" është prania në zonat e prirura ndaj rrezikut të njerëzve, infrastrukturës, banesave, kapaciteteve prodhuese dhe të aseteve të tjera njerëzore, të cilët janë nën efektin e humbjeve të mundshme.

6. "Emergjencë civile" është situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

7. "Evakuimi" është tëzhvendosja e përkohshme e njerëzve dhe e pasurive në vende më të sigurta para, gjatë ose pas ndodhjes së një ngjarjeje të rrezikshme, me qëllim mbrojtjen e tyre.

8. "Fatkeqësi" është ndërprerja serioze e çfarëdolloj shkalle e funksionimit të një komuniteti ose shoqërie për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit, 3cenueshmërisë dhe kapacitetit përballues, duke çuar në humbje të mundshme njerëzore, materiale, ekonomike dhe mjedisore.

9. "Fatkeqësi natyrore" janëfatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

10. "Fatkeqësi të tjera" janëaksidentet teknologjike, rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore ekologjike ose industriale dhe aksidente të tjera të shkaktuara nga veprimi njerëzor, lufta ose gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste, si dhe lloje të tjera të dhunës masive.

11. "Gatishmëri" janënjohuritë e kapacitetet e zhvilluara nga sistemi i mbrojtjes civile dhe komuniteti, për të parashikuar, për t'iu përgjigjurdhe për t'u rimëkëmbur në mënyrë efektive nga impaktet e fatkeqësive të mundshme, të afërta apo reale.

12. "Gjendja e fatkeqësisë natyrore" është gjendja e vendosur nga Këshilli i Ministrave në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose të fatkeqësive të tjera.

13. "Impakti i fatkeqësisë" është efekti total, duke përfshirë efektet negative (p.sh. humbjet ekonomike) dhe efektet pozitive (p.sh. fitimet ekonomike), të një ngjarjeje të rrezikshme ose të një fatkeqësie. Termi përfshin impaktet ekonomike, njerëzore e mjedisore dhe mund të përfshijë vdekje, plagosje, sëmundje e efekte të tjera negative për shëndetin fizik, mendor dhe mirëqenien sociale të njeriut.

14. "Informacioni për riskun e fatkeqësisë" është informacioni gjithëpërfshirës mbi të gjitha dimensionet e riskut të fatkeqësisë, duke përfshirë rreziqet, ekspozimin, cenueshmërinë dhe kapacitetin përballues lidhur me personat, komunitetet, vendet dhe pasuritë e tyre.

15. "Infrastrukturë kritike" janëstrukturat fizike, rrjetet dhe pasuritë e tjera, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin ekonomik e social të shoqërisë ose komunitetit.

16. "Infrastrukturë kritike me efekt ndërkufitar" është ajo infrastrukturëkritike, ndërprerja ose shkatërrimi i së cilës do të kishte impakt të rëndësishëm në një ose disa shtete kufitare me Republikën e Shqipërisë. Rëndësia e impaktit duhet të vlerësohet sipas kritereve ndërsektoriale. Këtu përfshihen efektet që rezultojnë nga varësitë ndërsektoriale në llojet e tjera të infrastrukturës.

17. "Kapacitet" është kombinimi i të gjitha forcave, atributeve dhe burimeve brenda një komuniteti, shoqërie apo organizate për të menaxhuar e për të zvogëluar risqet dhe për të forcuar aftësinë ripërtëritëse.

18. "Kapacitet përballues" është aftësia e njerëzve, organizatave dhe sistemeve që përdorin aftësitë dhe burimet në dispozicion të tyre, për t'u përballur dhe për të menaxhuar kushtet e pafavorshme, emergjencat apo fatkeqësitë.

